



**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**

**Raport përfundimtar për auditimin e ushtruar në subjektin Bashkia Librazhd**

# **RAPORTI PËRFUNDIMTAR I AUDITIMIT**

**(Financiar dhe i Përputhshmërisë)**

**BASHKIA LIBRAZHD**

**Tiranë, 2025**

<b>Nr.</b>	<b>Përmbajtja</b>	<b>Faqe</b>
<b>I.</b>	<b>PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE</b>	<b>4 – 14</b>
1.	Përshkrim i shkurtër i Projektit të Auditimit....	
2.	Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve.....	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit.....	
<b>II.</b>	<b>HYRJA</b>	<b>14 – 19</b>
1.	Objektivat dhe qëllimi .....	
2.	Identifikimi i çështjes.....	
3.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese .....	
4.	Përgjegjësitë e audituesve.....	
5.	Kriteret e vlerësimit.....	
5.	Standardet e auditimit.....	
7.	Metodat e auditimit.....	
8.	Dokumentimi i auditimit.....	
<b>III</b>	<b>PËRSHKRIMI AUDITIMIT</b>	<b>19 - 224</b>
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin .....	19 – 20
2.	Përshkrimi i auditimit, sipas drejtimeve të auditimit	<b>20 - 190</b>
2.1	<i>Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditimin e brendshëm.</i>	20 – 24
2.2	<i>Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.</i>	24 – 42
2.2.5	<i>Mbi realizimin e të ardhurave dhe përdorimi tyre</i>	42 - 66
2.3	<i>Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2024.</i>	66 – 86
2.4	<i>Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik.</i>	87 – 132
2.4.4	<i>Auditim mbi zbatimin e kontratave punime ndërtimi.</i>	132 – 142
2.5	<i>Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.</i>	143 – 145
2.6	<i>Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillim Territorit.</i>	146 – 157
2.7	<i>Auditimit mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit (IMT)</i>	158 – 166
2.8	<i>Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi fundit.</i>	166 – 190
<b>IV</b>	<b>GJETJE DHE REKOMANDIME</b>	<b>190 – 224</b>

## LISTA E SHKURTIMEVE.

<b>AAJM</b>	Aktive Afatgjata Jo Materiale
<b>AAM</b>	Aktive Afatgjata Materiale
<b>AK</b>	Autoritet Kontraktor
<b>AQT</b>	Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara
<b>ASHK</b>	Agjencia Shtetërore e Kadastrës
<b>BOE</b>	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
<b>GMS</b>	Grupi i Menaxhimit Strategjik
<b>IFAC</b>	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
<b>INOTSAI</b>	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>IPSAS</b>	Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik
<b>ISA</b>	Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
<b>ISSAI</b>	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
<b>IT</b>	Teknologjia e Informacionit
<b>KLSH</b>	Kontrolli i Lartë i Shtetit
<b>KKT</b>	Këshilli Kombëtar i Territorit
<b>KPP</b>	Komisioni i Prokurimit Publik
<b>KVO</b>	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
<b>LP</b>	Listë pagesa
<b>LPP</b>	Ligji i Prokurimit Publik
<b>MAB</b>	Manuali i Auditimit të Brendshëm
<b>MF</b>	Ministria e Financave
<b>MFK</b>	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
<b>NA</b>	Nëpunës Autorizues
<b>NJA</b>	Njësi Administrative
<b>NJAB</b>	Njësia e Auditimit të Brendshëm
<b>NJP</b>	Njësia e Prokurimit
<b>NZ</b>	Nëpunës Zbatues
<b>OE</b>	Operator Ekonomik
<b>PF</b>	Pasqyrat Financiare
<b>QKB</b>	Qendra Kombëtare e Biznesit
<b>PV</b>	Procesverbal
<b>SHPK</b>	Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar
<b>SKK</b>	Standardet Kombëtare të Kontabilitetit
<b>UMF</b>	Udhëzim i Ministrisë së Financave
<b>VKB</b>	Vendim i Këshillit Bashkiak
<b>VKM</b>	Vendim i Këshillit të Ministrave

## I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

### **a. Përshkrim i shkurtër për subjektin nën auditim.**

Bashkia Librazhd, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar dhe Ligji nr.68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe përputhshmërisë të Bashkisë Librazhd për periudhën e aktivitetit financiar të vitit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e vijim KLSH), sipas legjislacionit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

Buxheti i Bashkisë Librazhd si të gjithë njësitë e qeverisjes vendore financohet nga të ardhurat e veta të krijuara në mënyrë të pavarur, nga transfertat e pakushtëzuar e akorduar nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të veta dhe të përbashkëta, nga transfertat e kushtëzuara të akorduara nga buxheti i shtetit për realizimin e funksioneve të deleguara, nga transfertat specifike për realizimin e funksioneve të reja, nga ndarja e taksave kombëtare, donacione e burime të tjera të parashikuara në ligj.

### **b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.**

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të Ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 “Për financat e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, nenit 50 pikat 1 dhe 2.

Gjithashtu ky auditim merr rëndësi të veçantë për arsye se, Bashkia Librazhd si çdo njësi vendore administron, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financimi nga të ardhurat e realizuara nga taksapaguesit qytetarë dhe fondet e transferuara nga Buxheti i Shtetit.

### **c. Qëllimi i auditimit, periudha nën auditim dhe paraqitja e objektivave.**

Për *auditimin financiar*, qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Për *auditimin e përputhshmërisë*, qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, nëpërmjet analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, duke vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

Periudha e auditimit, është nga data 01.01.2024 deri më datën 31.12.2024.

Objektivat e auditimit, sipas drejtimeve të auditimit për periudhën objekt auditimi 01.01.2021 – 31.12.2024, janë si vijon:

- *Auditim mbi kontrollin e brendshëm financiar e publik;*
- *Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e buxhetit;*
- *Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për pasqyrat financiare të vitit 2024;*
- *Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve;*
- *Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;*
- *Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (këtu e vijim IMTV);*
- *Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM përkatëse;*
- *Auditim mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i fundit.*

#### **d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.**

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sasiore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 60% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe të procedurave të prokurimit me vlerë të lartë dhe të vogël. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit.

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetit. Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetit në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Në dhënien e opinionit kemi marrë parasysh nivelin e materialitetit prej 30,054 mijë lekë për vitin 2024.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, janë përdorur teknikat e auditimit si: *Kontrolli aritmetik, Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese, Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese, Kontrolli i vlerësimit, Konfirmim nga të tretët. Kontrolli sipas një treguesi, Verifikimi i transaksioneve Intervistimi, Raporte dhe informacione, Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm.*

Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme:

- *Verifikimi i transaksioneve;*
- *Shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit;*
- *Intervistat;*
- *Verifikimi në sisteme dhe terrene, etj.*

#### **e. Numri i gjetjeve dhe rekomandimeve:**

Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar **28** gjetje dhe ka dhënë **36** rekomandime, nga të cilat; masa organizative 20 gjetje me 28 rekomandime, masa për shpërblim dëmi 5 gjetje me 5 rekomandime për vlerën 1,163 mijë lekë, masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara 3 gjetje dhe 3 rekomandime.

#### **f. Paraqitja e gjetjeve kryesore:**

- *Në fushën e zbatimit të buxhetit:*

Mbi planifikimin dhe realizimin e treguesve buxhetorë për vitin 2024 referuar kuadrit ligjor për buxhetin, u konstatua se:

- Nga auditimi i likuiditeteve dhe për “detyrimet e prapambetura”, rezultoi se kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2024 në shumën 6,123,679 lekë për vitin 2025, krahas vlerës së trashëguar nga viti 2023 në shumën 2,090,550 lekë për “vendime gjyqësore” nga shpronësimet. Bashkia Librazhd ka detyrime të prapambetura nga vitit i mbyllur ushtrimor 2024 për tu likuiduar në vitin 2025 në shumën totale 8,214,229 lekë, të ndara si më poshtë vijon:

- Bashkia Librazhd *nuk ka detyrime* të prapambetura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “investime” nga ministrinë e linjës;
- *Ka detyrime* të prapambetura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “vendime gjyqësore” nga të ardhurat e veta në vlerën 2,090,550 lekë;
- *Ka detyrime* të prapambetura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “Investime” nga të ardhurat e veta në vlerën 6,023,679 lekë;
- *Ka detyrime* të prapambetura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “mallra” në vlerën 100,000 lekë;
- Vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit *nuk përputhet* me atë të raportuar në MF, pasi nuk është përfshirë për asnjë vit detyrimi i vendimeve gjyqësore për shpronësimet dhe të larguarit nga puna në vlerën totale 7,754,561 lekë

➤ Në fushën e menaxhimit të të ardhurave nga taksat e tarifave vendore:

▪ Deri në datën 31.12.2024 debia progresive është 109,139,808 lekë për 6,507 debitorë, nga e cila vetëm për vitin 2024 është krijuar në vlerën totale 26,875,185 lekë për 2,109 debitorë, dhe paraqitet si më poshtë vijon:

- Nga kategoria “biznes i madh”, në vlerën 28,627,339 lekë për 83 debitorë;
- Nga kategoria “biznes i vogël”, në vlerën 13,625,180 lekë për 302 debitorë;
- Nga kategoria “institucione” në vlerën 391,397 lekë për 2 debitorë;
- Nga "ndërtesat social-ekonomike" në vlerën 6,493,131 lekë për 91 debitorë;
  - Detyrime progresive nga "TNI/legalizimet", në vlerën 8,377,411 lekë për 177 debitorë;
  - Detyrime progresive nga "familjet në qytet", në vlerën 6,083,077 lekë për 185 debitorë;
  - Detyrime progresive nga "familjet në 6 NJA", në vlerën 44,542,273 lekë për 5,669 debitorë;

Në Bashkinë Librazhd nuk janë zhvilluar takime të GMS, ku të trajtohen problematikat për pa/mundësinë e vjeljes së detyrimeve të 476 debitorëve problematik dhe të atyre nga ish komunitat dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, deri tani nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

➤ Në hartimin e pasqyrave financiare viti 2024:

Mbi plotësinë dhe saktësinë e informacionit të llogarive kontabël në pasqyrat financiare të vitit 2024 në Bashkinë Librazhd, sipas UMFE nr. 05, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, u konstatua si më poshtë vijon:

Rezultoi se llogaria 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” është nënvlerësuar për shumën 86,125,661 lekë;

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet në shumën 89,821,951 lekë dhe nuk kuadron me totalin e vlerës së grupit të llogarive të pagueshme për shumën 14,324,442 lekë, për keqklasifikim të faturave të palikuiduara në llog.467 “kreditorë të ndryshëm”, por të deklaruar si detyrim i prapambetur;

- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në shumën 117,171,082 lekë dhe nuk kuadron me grupin e llogarive të arkëtueshme, ku vlera e llog.468 “debitorë të ndryshëm” nuk është përfshirë në vlerën e saj të plotë, duke e nënvlerësuar llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” për shumën 11,583,628 lekë;

- Në llogaritë e klasës 20 “AAJM”/llogaria 202 “Studime e projekte” rezultoi se nga ana e DFB nuk janë marrë masat që për tetë projektet e hershme nga ish komunitat në shumën totale 5,632 mijë lekë, të sigurohet informacioni i nevojshëm dokumentar, për të kaluar vlerën e tyre në llogaritë përkatëse të klasës 21 AAM;

- Në llogarinë 212 “Ndërtesa Konstruksiione” paraqitet në shumën 559,422,867 lekë dhe rezultoi se: Për grupin e godinave të ndërtuara shumë herët, nga ana e bashkisë nuk janë ngritur komisione rivlerësimi, me qëllim pasqyrimin në vlerë reale të tyre në kontabilitet;

- Ujësjetllësi në vlerën kontabël 5,199 mijë lekë, si aktiv nuk i përket llogarisë 212, por referuar Nomenklaturës së llogarive kontabël i përket llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe nuk është transferuar në Shoqërinë Rajonale UK Elbasan, referuar dhe në zbatim të Marrëveshjes së lidhur nga kryetarët e 6 bashkive të Qarkut Elbasan 2022;

- Llogaria 213 “rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në shumën 1,132,195,853 lekë dhe janë përfshirë 6 aktive të llojit ujësjetllës në vlerën kontabël 70,025 mijë lekë, të cilët me lidhjen e marrëveshjes për krijimin e kompetencave të përbashkëta të ujësjetllës kanalizimeve, duhet të ishin transferuar në SHRUK Elbasan sha dhe shkarkuar nga kontabiliteti i kësaj llogarie;

- Llogaria 214 “instalime teknike, mjete e pajisje” paraqitet në shumën 18,413,053 lekë rezultoi e mbivlerësuar për shumën 8,140 mijë lekë, që përbën vlerën kontabël të aktiveve të llojit "pajisje kompjuterike" që sipas Nomenklaturës së llogarive kontabël, i përket llogarisë 218 “Inventar ekonomik”;

- Llogaria 215 “mjete transporti” paraqitet në shumën 28,674,584 lekë dhe rezultoi mospërputhje mes vlerës së paraqitur në pasqyrat financiare dhe regjistrin të aktiveve për diferencën për shumën 182,962 lekë; Llogaria 215 “Mjete transporti” është mbivlerësuar për shumën 182,962 lekë;

- Në llog. 210, llog.211, llog. 212 dhe llog.213 nuk janë përfshirë asetet e transferuara me VKM për Bashkinë Librazhd, pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK dhe nuk është bërë rivlerësimi i atyre të pajisura me titull pronësie. U konstatua se këto asete janë të pa kontabilizuara;

- Vlera e amortizimit në llogarinë 212 “objekte e konstruksione” për vitin 2024 është mbivlerësuar në shumën 65,821 mijë lekë pasi është llogaritur gabim me vlerën e amortizimit 15%, duke pasqyruar të nënvlerësuar tepricën neto të aktiveve të saj;

- Llog. 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” në pasqyrat financiare paraqitet pa vlerë. Referuar QKB për periudhën 1999-2022 vlera e aksioneve që Bashkia Librazhd zotëron në “UK Librazhd –Prrenjas” Sha ka qenë 240,772 mijë lekë, vlerë për të cilën llogaria 26 është e nënvlerësuar.

- Llogaria 7206 “financim i pritshëm nga buxheti” është në vlerën 6,123,679 lekë, e cila nuk kuadron me shumën e gjendjes së llogarisë kundërparti 4342 “operacione me shtetin (të drejta)”, e nënvlerësuar për 83,698,272 lekë.

➤ Në zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimin të kontratave:

**a-** Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, për disa nga procedura e zhvilluara nga AK Bashkia Librazhd, kryesisht të procedurave me destinacion investime publike (*objekte/rruge, etj.*), rezulton se në dosje nuk ndodhej e depozituar “leje ndërtimi/infrastruktura” (evidentuar kjo në dy raste). Zbatimi i kontratës së sipërmarrjes në mungesë të lejes së ndërtimit, përbën një risk të shtuar, për sigurimin e zhvillimit të qëndrueshëm të territorit, si dhe për plotësimin e kushteve për kryerjen e punimeve.

Gjithashtu, për disa nga investimet e realizuara, nga dokumentacioni në dosje, rezultoi se mungonte dokumentacioni mbi realizimin ose jo të “oponencës teknike” (evidentuar kjo në tre raste), edhe pse objekti i procedurës është një ndërtim publik apo me akses publik;

**b-** Nga grupi i auditimit mbi bazën e materialitetit dhe riskut, janë vlerësuar për auditim **8 procedura** prokurimi me fond limit 464,216 mijë lekë ose 80.49 % e fondit të audituar (576,723 mijë lekë).

- Nga 8 procedura prokurimi të audituara, rezultoi se në **8 procedura** me fond limit 464,216 mijë lekë ose 100 % e fondit të audituar (464,216 mijë lekë), janë konstatuar mangësi në specifikimet teknike dhe kriteret e aplikuara, të cilat janë të paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat kanë çuar në mos pjesëmarrje e operatorëve ekonomik në garë dhe ose në skualifikim e operatorëve ekonomik me ofertë më të leverdishme dhe me mundësi për realizimin e kontratës. Sipas të dhënave, rezultoi të jenë zhvilluar procedura me pjesëmarrjen e vetëm të një OE, 7 procedura me fond limit 35,852 mijë lekë ose 6.2% e fondit të prokuruar.

- Nga 8 procedura prokurimi të audituara, rezultoi se në **7 procedura** prokurimi me fond limit 389,216 mijë lekë ose 83.84 % e fondit të audituar (464,216 mijë lekë), nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, janë kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet kur këta të fundit nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, veprime të cilat kanë çuar AK në lidhjen e kontratave të zbatimit të punimeve me OE të cilat nuk plotësojnë të gjitha kërkesat e DST.

**c-** Nga auditimi i **5 (pesë)** kontratave për punë publike për periudhën e auditimit në vlerën totale **206,959,904 lekë me TVSH**, u konstatuan se në **5 (pesë)** raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **1,163,931 lekë pa TVSH**.

**d-** Në **1 (një) rast**, nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd” Bashkia Librazhd, me vlerë 71,085,637 lekë me TVSH, fituar nga BOE “Z.K.” SHPK & “A.A CO” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të kryera me cilësi jo të mirë dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në volumnin prej **133 m<sup>2</sup>** në vlerën **132,667 lekë**, për zërin “Shtresë binder me gur kave, 6 cm, me makineri” dhe zërin “Shtresë asfalto betoni me gur kave, 4 cm, me makineri” duhet të zbatohen në objekt (menjëherë) për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës.

➤ Në fushën e zbatimit të dispozitave ligjore për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe të certifikatave të përdorimit:

a- Në **të gjitha rastet**, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Në **3 (tre) raste** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në **4 (katër) raste** u konstatua se dokumentet e pasurisë nuk janë ngarkuar të rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi.

b- Në **1 (një) rast**, leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të dokumentacionit të pronësisë.

- Në **1 (një) rast**, DPZHT nuk ka respektuar mendimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila shpreh mosdakordësi për zhvillimin e projekt-propozimit. Gjithashtu në **1 (një) rast** DPZHT, nuk ka kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Leja e ndërtimit është miratuar në heshtje, pa marrë mendim nga DV ASHK.

c- Në **1 (një) rast**, objekti i miratuara nuk respekton kondicionet urbane, lidhur me: intensitetin maksimal të lejuar, koeficientin e shfrytëzimit të territorit, lartësinë maksimale të lejuar (e matur si në numër katesh, ashtu edhe në metra), si dhe numrin minimal të vend-parkimeve.

d- Në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit nr. 22/2018, datë 3.5.2018, “Për strehimin social, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 metra katrorë, kanë ndaj fondit publik për strehim social. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 3641 m<sup>2</sup>, nga të cilat **109.23 m<sup>2</sup>** do të duhej t’i kalonin të fondit publik të banesave sociale në natyrë ose në vlerë monetare ekuivalente **prej 4,806,120 lekë.**

➤ Në fushën e organizimit dhe funksionimit e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM.

- Nga auditimi mbi administrimin e pronave të Bashkisë Librazhd për periudhën objekt auditimi, rezultoi se sipas VKM-ve i janë transferuar kësaj njësie vendore, gjithsej **4,387 prona**, nga të cilat: 1,446 prona në pronësi dhe 2,941 prona në përdorim. Gjatë vitit 2024, janë bërë 81 aplikime nga të cilat, 18 janë pajisur me certifikatë pronësie.

- Bashkia Librazhd në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave nga dhënia me qira të tyre për vitin 2024 kanë qenë të lidhura **78 kontrata/marrëveshje** për dhënie me qira të aseteve që ka në pronësi (ndërtesa, truall, toka bujqësore, qera pyjore). Këto kontrata/marrëveshje janë lidhur bazuar në legjislationin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes.

- Nga auditimi u konstatua se janë gjithsej **9 subjekte** debitorë në vlerën **919,011 lekë** në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Librazhd, për marrjen me qira të objekteve/sipërfaqeve të ndryshme, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Mbi zbatimin e rekomandimeve nga auditimi i fundit.

Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 32/8 Prot, datë 09.05.2024, rezulton se:

Nga subjekti është **respektuar afati 20 ditor** për kthimin e përgjigjes për marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve, përcjellë me shkresën nr. 32/11 port., datë 03.06.2024, në zbatim të shkronjës “j” të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.

Gjithashtu, nga subjekti është respektuar afati 6 mujorë për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, përcjellë me shkresën nr. 32/12, datë 18.12.2024.

**- Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, kemi si vijon:**

**a.** Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **21 masa organizative** të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar **8 masa** janë zbatuar plotësisht, **1 masë** është zbatuar pjesërisht, **7 masa** janë në proces zbatimi dhe **5 masa** janë të pa zbatuara.

**b.** Masa shpërblim dëmi janë rekomanduar **5 masa** në vlerën **2,753,170 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar **3 masa** janë në proces zbatimi dhe **2 masa** janë zbatuar pjesërisht.

**b.** Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - (të ardhura të munguara) janë rekomanduar **1 masë** në vlerën **2,606,200 lekë**, e cila është pranuar, dhe është e pazbatuar.

**c.** Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomicitet, efikasitet dhe efektivitet të fondeve publike janë rekomanduar 2 masa, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht, dhe 1 masë është në proces zbatimi.

**d.** Masa disiplinore janë rekomanduar 22 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 22 masa janë zbatuar.

**dh.** Masa administrative janë rekomanduar 2 masa të cilat janë pranuar, dhe nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar.

#### **g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:**

##### **➤ Në fushën e zbatimit të buxhetit.**

- Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrin të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjes së detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime/shërbime/mallra; për të paguar detyrimet sipas planit të miratuar dhe raportuar në MF për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 8,214,229 lekë deri në fund të vitit 2025; për likuidimin e faturave për mallra/shërbime/investime në afat dhe sipas radhës, për të shmangur shpenzimet e panevojshme si dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e lindjes së detyrimeve të prapambetura në periudhat e ardhme.

- Drejtoria e Financës dhe buxhetit të bëjë planifikim sa më realist të fondeve të çdo programi në PBA dhe Planin vjetor buxhetor, si për likuidimin e detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme brenda afatit të përcaktuar dhe sipas radhës, por edhe për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit ushtrimor

##### **➤ Në menaxhimin e të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore:**

Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Taksa, Tarifa e Treg, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e debisë totale progresive prej **107,748,411 lekë për 6,507 debitorë**.

##### **➤ Në hartimin e pasqyrave financiare viti 2024:**

Drejtorja e Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Librazhd të marrë masa për rregullimin dhe sistemin e llogarive kontabël, duke përfshirë korigjimin e nën- dhe mbivlerësimeve, rivlerësimin e aseteve të paluajtshme, transferimin dhe çregjistrimin e aktiveve nga kontabiliteti, si dhe pasqyrimin korrekt të pjesëmarrjeve në kapital dhe financimeve buxhetore, me qëllim paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare.

##### **➤ Në zbatimin e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave:**

1- Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e Titullarit të AK- Bashkia Librazhd, në asnjë rast të zhvillimit të procedurave të investimeve publike, të mos lidhë kontratën e zbatimit pa miratimin paraprak të “*leje ndërtimi/infrastruktura*” dhe “*oponencës teknike*” të objektit (aty ku kërkohet).

2- Autoriteti Kontraktor Bashkia Librazhd, në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave, specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, duhet të argumentojë teknikisht dhe ligjërish çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kritere të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe duke i dokumentuar ato në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

3- Titullari i AK Bashkia Librazhd, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST, dhe se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të një procedure, duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesën për ofertë apo dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme.

5- Drejtoria e Infrastrukturës dhe Investimeve Publike në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit dhe Drejtorinë Juridike, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, masa për arkëtimin e vlerës **1,163,931.21 lekë, respektivisht:**

- **Vlera 279,357 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 5271 prot., datë 11.08.2023 me objekt “Ndërtim i shkollës së mesme Polis + Palestër, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, me sipërmarrës shoqërinë “E” SHPK.

- **Vlera 237,234 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 2854 prot., datë 12.06.2024 me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”, me sipërmarrës BOE “Z.K.” SHPK & “A.A CO” SHPK.

- **Vlera 451,390 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 2869 prot., datë 13.06.2024 me objekt “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashki Librazhd”, me sipërmarrës BOE “H” SHPK & “K” SHPK.

- **Vlera 78,200 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 3155 prot., datë 01.07.2024 me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd”, me sipërmarrës BOE “G-T” SHPK & “V. K” SHPK.

- **Vlera 117,749 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 28554 prot., datë 12.06.2024 me objekt “Rikonstruksion kanali i Allanit Dorez (Faza e parë hyrja + Skeja e në vazhdim)”, me sipërmarrës shoqërinë “Z.K.” SHPK.

➤ *Në fushën e zbatimit të dispozitave ligjore për miratimin e lejeve të ndërtimit dhe të certifikatave të përdorimit:*

Drejtoria e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Librazhd, të marrë të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi:

- Të kërkojnë ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, siç janë: licenca për ushtrimin e aktivitetit, certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për hartuesit e projekteve ndërtimore, oponencën teknike (kur është e detyrueshme), si dhe studimin gjeologjik dhe atë sizmologjik, të shoqëruar me projektin përkatës të mbrojtjes sizmike, etj.

- Të shqyrtojë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;
  - Të sigurohet që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi, dokumentacioni i pronësisë të jetë i rifreskuar brenda një periudhe jo më të gjatë se tre muaj nga data e aplikimit.
  - Përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të sigurojë respektimin e kushteve ligjore dhe urbane për zhvillim, duke verifikuar përputhshmërinë e aplikimeve të paraqitura përmes sistemit elektronik e-lejet, me kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe të miratojë vetëm ato aplikime që i respektojnë këto kondicione, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.
  - Për çdo projekt zbatimi, me objekt kontrollin dhe zbatimin e projektit të zbatimit, në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit të kontrollit dhe të zhvillimit të territorit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, dhe në përputhje me destinacionin e tyre.
  - Të identifikuar, që në fazën e shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, të gjitha rastet që përbëjnë subjekt të kontributit që sektori privat duhet të japë ndaj fondit publik për strehim social. Zhvilluesit duhet të njoftohen për detyrimin që u lind në këtë kuadër dhe, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të lidhin akt-marrëveshje me Bashkinë për kalimin pa shpërblim të sipërfaqeve përkatëse në funksion të fondit të strehimit social, duke përcaktuar edhe pozicionimin e këtyre sipërfaqeve në planimetri.
  - Të njoftuar zhvilluesin, i cili ka përfituar lejen e ndërtimit të sipërpërmendur, lidhur me detyrimin që ka ndaj fondit publik për strehim social. Nga Bashkia Librazhd duhet të ndiqen të gjitha hapat ligjorë deri në refuzimin e pajisjes me certifikatë përdorimi, nëse zhvilluesi nuk dakordësohet për hartimin e akt-marrëveshjes dhe përcaktimin e sipërfaqeve që do t'i kalojnë fondit të strehimit social, ose vlerës monetare, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.
- Në fushën e organizimit dhe funksionimit e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (aseteve dhe pyje kullotave) të transferuara sipas VKM.
- Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave dhe me Drejtorinë e Financës të marrin masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e vlerës **919,011** lekë nga **9 subjekte** qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për objektet/tokën e marrë me qira. Në çdo rast të mospagesës së detyrimeve kontraktore të kërkojë prishjen e kontratës ose të mos nënshkruajë kontratën e re për objektet/tokën e lëshuar me qira, si dhe të llogarisë penalitetet, sipas rastit.
  - Bashkia Librazhd, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë të gjitha masat për evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha pronave të kaluara me VKM në DVASHK Elbasan.

## **I.1. KONKLUZIONI DHE OPINIONI I AUDITIMIT.**

### **I. Opinioni i auditimit mbi pasqyrat financiare:**

Grupi i auditimit të KLSH-së, ka audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Librazhd për periudhën ushtrimore 01.01.2024 – 31.12.2024, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, të performancës financiare, të ndryshimit të aktiveve, të fluksit të mjeteve monetare dhe shënimet shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

*"Në opinionin tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, pasqyrat financiare të subjektit Bashkia Librazhd janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi të përshkruara në paragrafin e "Bazës për Opinionin", që*

*në gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit modifikuar me rezervë.*

### **Baza për opinion i modifikuar<sup>1</sup> me rezervë:**

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA<sup>-të</sup>). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga njësia shpenzuese Bashkia Librazhd, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit prej 30,054 mijë lekë, llogaritur mbi shpenzimet faktike të vitit 2024, si dhe parregullsitë e mëposhtme:

- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet në shumën 89,821,951 lekë dhe nuk kuadron me totalin e vlerës së grupit të llogarive të pagueshme për shumën 14,324,442 lekë, për keqklasifikim të faturave të palikuiduara në llog.467 “kreditorë të ndryshëm” por të deklaruar si detyrim i prapambetur;

- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në shumën 117,171,082 lekë dhe nuk kuadron me grupin e llogarive të arkëtueshme, ku vlera e llog.468 “debitorë të ndryshëm nuk është përfshirë në vlerën e saj të plotë, duke e nënvlerësuar llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” për shumën 11,583,628 lekë;

- Për llogaritë e klasës 20 “AAJM”/llogaria 202 “Studime e projekte” u konstatua se nga ana e DFB nuk janë marrë masat që për tetë projektet e hershme nga ish komunat në shumën totale 5,632 mijë lekë, të sigurohet informacioni i nevojshëm dokumentar, për të kaluar vlerën e tyre në llogaritë përkatëse të klasës 21 AAM;

- Llogaria 213 “rrugë, rrjete, vepra ujore” ka të përfshirë 7 aktive të llojit ujësjellës në vlerën kontabël 70,025 mijë lekë, të cilët duhet të ishin transferuar në SHRUK Elbasan sha dhe shkarkuar nga kontabiliteti i kësaj llogarie;

- Llogaria 214 “instalime teknike, mjete e pajisje” është mbivlerësuar për shumën 8,140 mijë lekë, që përbën vlerën kontabël të aktiveve të llojit “pajisje kompjuterike” që i përket llogarisë 218 “Inventar ekonomik”;

- Llogaria 215 “mjete transporti” ka mospërputhje mes vlerës së paraqitur në pasqyrat financiare dhe regjistrin të aktiveve, rezulton e mbivlerësuar për shumën 182,962 lekë;

- Në llog. 210, llog.211, llog. 212 dhe llog.213 nuk janë përfshirë asetet e e transferuara me VKM për Bashkinë Librazhd, pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK dhe nuk është bërë rivlerësimi i atyre të pajisura me titull pronësie. U konstatua se këto asete janë të pa kontabilizuara;

- Vlera e amortizimit në llogarinë 212 “objekte e konstruksione” për vitin 2024 është mbivlerësuar në shumën 65,821 mijë lekë pasi është llogaritur gabim me vlerën e amortizimit 15%, duke pasqyruar të nënvlerësuar tepriçën neto të aktiveve të saj;

- Llogaria 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” në pasqyrat financiare paraqitet pa vlerë. Referuar QKB për periudhën 1999-2022 pjesa takuese e kapitalit të UK Librazhd -Përrenjas për Bashkinë Librazhd ka qenë 240,772 mijë lekë, vlerë për të cilën llogaria 26 është e nënvlerësuar;

<sup>1</sup> Referuar Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së, miratuar me vendimin nr. 246, datë 29.12.2022 “Për miratimin e manualit të auditimit financiar “ të Kryetarit të KLSH-së, kapitulli VII, pika 7.3,5 (faqe 54 dhe 60-61), “Një “Opinion i Kualifikuar me rezervë”, jepet në rastet kur: *audituesi ka marrë dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit dhe arrin në përfundimin se: anomali të apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale, por jo të përhapura, në llogaritë vjetore apo transaksionet në fjalë;*

- Llogaria 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në “pasqyrën e pozicionit financiar”- format 1 dhe në “pasqyrën e performancës financiare”-format 2, paraqitet në shumën 77,753,417 lekë dhe duhet të kuadrojë me mbartjen e të ardhurave dhe transfertave të vitit 2024 për vitin 2025 sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit, e cila është në shumën 163,879,078 lekë. Rezultoi se llogaria 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” është nënvlerësuar për shumën 86,125,661 lekë.

## **II. Opinion për përputhshmërinë:**

Ne kemi audituar përputhshmërinë e veprimtarisë së subjektit Bashkia Librazhd, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve të Bashkisë Librazhd, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2024 - 31.12.2024.

*Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Librazhd, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një **opinionit të modifikuar**.*

### **Baza për opinionin të modifikuar:**

Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme<sup>2</sup> për të dhënë një bazë për opinionin tonë, (ISSAI 400 & ISSAI 4000), si më poshtë:

*Në fushën e procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave:*

- Nga 8 procedura prokurimi të audituara, rezultoi se në **8 procedura** me fond limit 464,216 mijë lekë ose 100 % e fondit të audituar (464,216 mijë lekë), janë konstatuar mangësi në specifikimet teknike dhe kriteret e aplikuara, të cilat janë të paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat kanë çuar në mos pjesëmarrje e operatorëve ekonomik në garë dhe ose në skualifikim e operatorëve ekonomik me ofertë më të leverdishme dhe me mundësi për realizimin e kontratës. Sipas të dhënave, rezultoi të jenë zhvilluar procedura me pjesëmarrjen e vetëm të një OE, 7 procedura me fond limit 35,852 mijë lekë ose 6.2% e fondit të prokuruar.

- Nga 8 procedura prokurimi të audituara, rezultoi se në 7 procedura prokurimi me fond limit 389,216 mijë lekë ose 83.84 % e fondit të audituar (464,216 mijë lekë), nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, janë kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet kur këta të fundit nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, veprime të cilat kanë çuar AK në lidhjen e kontratave të zbatimit të punimeve me OE të cilat nuk plotësojnë të gjitha kërkesat e DST.

- Nga auditimi i **5 (pesë)** kontratave për punë publike për periudhën e auditimit në vlerën totale 206,959,904 lekë me TVSH, u konstatuan se në **5 (pesë)** raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **1,163,931.21 lekë pa TVSH**.

- Në **1 (një) rast**, leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të dokumentacionit të pronësisë.

*Në fushën e dhënies së lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit:*

- Në **3 (tre) raste** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuar në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në **4 (katër) raste** u konstatua se dokumentet e pasurisë nuk janë ngarkuar të rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi.

- Në **1 (një) rast**, leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të dokumentacionit të pronësisë.

<sup>2</sup> ISA 500-ISSAI 1500, ku cilësohet se: “Objektivi i audituesit është të hartojë dhe kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mund të sigurojë evidence auditimi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme”

- Në **1 (një) rast**, DPZHT nuk ka respektuar mendimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila shpreh mosdakordësi për zhvillimin e projekt-propozimit. Gjithashtu në **1 (një) rast** DPZHT, nuk ka kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Leja e ndërtimit është miratuar në heshtje, pa marrë mendim nga DV ASHK.

- Në **1 (një) rast**, objekti i miratuara nuk respekton kondicionet urbane, lidhur me: intensitetin maksimal të lejuar, koeficientin e shfrytëzimit të territorit, lartësinë maksimale të lejuar (e matur si në numër katesh, ashtu edhe në metra), si dhe numrin minimal të vend-parkimeve.

- Në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit nr. 22/2018, datë 3.5.2018, “Për strehimin social, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 metra katrorë, kanë ndaj fondit publik për strehim social. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 3641 m<sup>2</sup>, nga të cilat **109.23 m<sup>2</sup>** do të duhej t’i kalonin të fondit publik të banesave sociale në natyrë ose në vlerë monetare ekuivalente **prej 4,806,120 lekë.**

.Në fushën e të ardhurave është konstatuar se: detyrimet debitorë nga subjekte e biznesit të madh, vogël dhe abonentë familjarë paraqiten në vlerën prej **107,748,411 lekë për 6,507 debitorë**

Ne administrimin dhe menaxhimin e Aseteve:

- Bashkia Librazhd në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave nga dhënia me qira të tyre për vitin 2024 u konstatua se nga 78 kontrata/marrëveshje, 9 subjekte rezultuan debitorë në vlerën **919,011 lekë**, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Librazhd.

## II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, i ndryshuar, në zbatim të Programit të Auditimit nr. 407/1 prot., datë 08.04.2025 “*Auditim financiar dhe Përputhshmërie në Bashkinë Librazhd*”, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, në subjektin Bashkia Librazhd nga data 08.04.2025 deri në datën 11.07.2025, u krye auditimi për periudhën nga data 01.01.2024 deri në datën 31.12.2024 nga grupi i audituesve të Kontrollit të Lartë të Shtetit:

1. P. Gj. *përgjegjës grupi;*
2. S. J. *auditues;*
3. F. Ç. *auditues;*
4. I. U. *auditues;*
5. H. A. *anëtarë;*
6. S. M. *auditues.*

### **1. OBJEKTIVAT, FUSHËVEPRIMI DHE METODOLOGJIA**

- Objektivat dhe Qëllimi i auditimit. Objektivi i *auditimit financiar* është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, nëse për vitin 2024, transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi.

Qëllimi është të vlerësohet nëse rezultatet dhe gjendja financiare e raportuar e subjektit që auditohet, si dhe përdorimi i burimeve janë paraqitur saktë dhe në përputhje me rregullat e raportimit financiar, si në fushën e të ardhurave dhe të shpenzimeve.

Në *auditimin e përputhshmërisë* synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave, kodeve të vendosura apo termave dhe kushteve, lidhur me veprimtarinë e subjektit për periudhën objekt auditimi 01.01.2024 – 31.12.2024.

Qëllimi është të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi për fushat e veprimtarisë së subjektit të audituar, i cili do realizohet pas analizës së implementimit të kërkesave të menaxhimit financiar dhe kontrollit, për të vlerësuar drejt nivelin e riskut në subjekt.

- **Identifikimi i çështjes.** Përcaktimi i nivelit të duhur të materialitetit, për të mundësuar kryerjen e saktë të auditimit (ISSAI 13), nëpërmjet një pune audituese sistematike me zgjedhje, duke saktësuar përputhshmërinë ligjore të akteve normative me qëllim që auditimi t'i shërbejë subjektit në marrjen e masave për përmirësimin e punës në të ardhmen dhe për të bërë të mundur evidentimin në kohë të mangësive dhe shkeljeve për përmirësimin e gjendjes.

Sipas përcaktimit të ISSAI 100 “*Auditimi i përputhshmërisë, përcakton se deri në çmasë subjekti i audituar ndjek rregullat, legjislacionin dhe aktet normative, politikat, kodet e miratuara apo kushtet e përcaktuara si, kushtet e kontratës apo klauzolat e një marrëveshjeje financimi*”, duke ofruar raporte të besueshme nëse fondet janë administruar siç duhet dhe nëse të drejtat e qytetarëve për një proces të rregullt janë respektuar siç kërkohet nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi.

Raporti Përfundimtar i Auditimit, synon të identifikojë përmbushjen e rolit të njësisë vendore dhe përgjegjësive të saj, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve dhe shërbimeve në dobi të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë Librazhd, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave dhe nevojave të tyre.

Saktësia, rregullshmëria, ndodhja e transaksioneve kontabël dhe regjistrimi i tyre me korrektësi dhe në përputhje me kuadrin e raportimit financiar në fuqi.

Në bazë të kriterëve të vlerësimit e gjykimit profesional, audituesit kanë bërë vlerësimin e rezultateve të testeve të kontrollit, analizimin dhe klasifikimin e gabimeve të zbuluara, si dhe është bërë vlerësimi i evidencave të grumbulluara për sa i përket mjaftueshmërisë dhe përshtatshmërisë për qëllimet e auditivit. Procedurat e kryera, varen nga gjykimi profesional i audituesit, përfshirë vlerësimin e rrezikut material, për shkak të mashtrimit apo gabimit që do përdoren për procedura auditivi që janë me të përshtatshme për rrethanat.

Nisur nga procedurat e ndjekura për auditiv, ne besojmë se evidencat e mbledhura janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të dhënë opinionin tonë mbi veprimtarinë ekonomiko-financiare të Bashkisë Librazhd.

- **Përgjegjësitë e strukturave drejtuese.** Strukturat drejtuese të Bashkisë Librazhd, janë përgjegjës për përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me kuadrin normativ të zbatueshëm për raportimin financiar në sektorin publik dhe për mirëfunksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, i cili garanton respektimin e kuadrit ligjor në fuqi, sipas përcaktimeve të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “*Për Vetëqeverisjen Vendore*”, Ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008, “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH*”, i ndryshuar, Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*”, i ndryshuar, etj.

- **Përgjegjësitë e audituesve.** Përgjegjësia e grupit të auditimit është të shprehë konkluzionin dhe një opinion mbi çështjet që janë nën auditim. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI-t, të cilat kërkojnë që audituesit të respektojnë kërkesat etike, si dhe të planifikojnë dhe kryejnë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

Përgjegjësia jonë (*audituesit e KLSH-së*), është që nëpërmjet auditimit të realizuar të krijohen bindjet, si dhe të shprehet me opinion mbi aspektet që duhet të vlerësojë:

- *Nëse shpenzimet janë realizuar në përputhje me ligjin e Buxhetit të Shtetit, me aktet përkatëse ligjore e nënligjore dhe me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin;*

- *Nëse janë zbatuar parimet e përgjithshme të sistemit të menaxhimit financiar në sektorin publik dhe të sjelljes së zyrtarëve të sektorit publik;*

- Nëse janë zbatuar kërkesat e përcaktuara në ligjet dhe aktet normative përkatëse, si Ligji organik i buxhetit apo Ligji i prokurimit publik, etj.;
- Nëse janë reflektuar shkeljet e institucionit të audituar, të evidentuara në auditimet e mëparshme;
- Interesin publik ose pritshmërinë publike (p.sh. shkelje të identifikuar nga media, ankesat, etj.).
- Fusha specifike të cilat janë objekt i fokusit për zbatimin e ligjit, etj.;

Në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, objektivi i audituesit është që të aplikojë konceptin e materialitetit në mënyrë korrekte gjatë planifikimit dhe kryerjes së auditimit. Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për të marrë evidenca auditimi rreth praktikave administrative e financiare, rreth shumave dhe raportimit të shifrave në Pasqyrat Financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Gjatë procesit të vlerësimit të riskut, audituesit vlerësojnë nivelin e kontrollit të brendshëm përkatës në Bashkinë Librazhd, në mënyrë që të programoheshin drejt procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme për kushtet e subjektit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të subjektit.

- Kriteret e vlerësimit. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Ligji nr. 154/2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;

- Në fushën e buxhetit dhe administrimit financiar: Ligji nr. 84/2022, datë 24.11.2022 “Për buxhetin e vitit 2023” dhe aktet normative që kanë ndryshuar këtë ligj; Ligji nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore” , i ndryshuar; Ligji nr. 48/2014, datë 24.04.2014 “Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare” ndryshuar me Ligjin nr. 24/2015, datë 19.03.2015; VKM nr. 783 datë 22.11.2006 “Për përcaktimin e standardeve dhe rregullave kontabël”; Udhëzimi i MF nr. 35, datë 5.11.2008 “Për zbatimin e Ligjit nr. 9869, datë 04.02.2008 “Për huamarrjen e qeverisjes vendore”; Udhëzimi i MF nr. 8, datë 29.03.2012 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm”; Udhëzimi MFE nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” , i ndryshuar; Udhëzimit i MF nr. 2, datë 02.06.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” , i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura” ndryshuar me udhëzimin nr. 5/1 datë 21.05.2014; Udhëzimi i MF nr. 10/1, datë 28.02.2017 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”; Udhëzimin plotësues të MF nr. 02, datë 10.01.2018 “Për buxhetin e vitit 2018”, pikat 82-91 “Detyrimet e prapambetura të njësisve të vetëqeverisjes vendore”; Udhëzimi plotësues i Ministrisë Financave nr. 01, datë 17.01.2019 “Për buxhetin e vitit 2019”, pikat 106-110, “Detyrimet e prapambetura të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, dhe pikat 116-117 “Raportimi i detyrimeve të prapambetura në njësitë e qeverisjes vendore”.

- Në fushën e mbajtjes Kontabilitetit dhe Hartimit të Pasqyrave Financiare: VKM nr. 248, datë 10.4.1998 “Për miratimin e planit kontabël publik, për organet e pushtetit lokal, institucionet shtetërore, qendrore dhe lokale, si dhe të njësisve që varen prej tyre” , i ndryshuar; VKM nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiviteteve dhe çdo dokumentacion tjetër zyrtar në njësitë e qeverisjes vendore, të prekura nga riorganizimi administrativo-territorial” , i ndryshuar; Udhëzimi i MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të të pasqyrave financiare vjetore të njësisve të qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar me Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 21.2.2022, etj.; Udhëzimi përbashkët i Ministrisë të Çështjeve Vendore dhe Ministrisë Financave nr. 3237 datë 16.07.2015 “Për procedurat afatet kohore standardet dhe kriteret e plotësimit të dokumentacionit të nevojshëm për riorganizimin administrativo-territorial”.

- Në fushën e prokurimeve publike dhe zbatimit të kontratave të punëve publike: Ligji nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 5, datë 25.06.2021, i Agjencisë së Prokurimit Publik (APP) “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, i ndryshuar; Udhëzimi i MF nr. 57, datë 12.06.2014, “Për gjurmët standarde të auditit për prokurimin me vlerë të vogël dhe të lartë”; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, etj.

- Në fushën e administrimit të taksave dhe tarifave vendore: Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar; Ligji nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për sistemin e taksave lokale”, i ndryshuar; Ligji nr. 9975, datë 28.7.2008, “Për taksat kombëtare”, i ndryshuar; VKM nr. 170, datë 25.4.2002 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e lejeve e të autorizimeve për tregtimin e naftës, gazit e nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar; VKM nr. 1064, datë 22.12.2010, “Për disa ndryshime në VKM nr. 391, datë 21.06.2006 “Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave”, i ndryshuar; Udhëzim i MF nr. 24, datë 02.9.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, etj.

- Në fushën e ndërtimeve, zbatimit të punimeve dhe kontrollit të territorit: Ligji nr. 10279, datë 20.05.2010, “Për kundërvajtjet administrative”, i ndryshuar; Ligji nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 107-2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; Ligji nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; VKM nr. 629, datë 15.7.2015, “Për miratimin e manualeve të ndërtimit”, i ndryshuar; VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” (i përditësuar); VKM nr. 894, datë 4.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; Udhëzimi i KM nr. 1, datë 18.7.2012 “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe si dhe akteve të tjera ligjore e nënligjore që kanë si objekt tokën bujqësore.

- Në fushën e marrëdhënieve të punësimit dhe pagave: Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr. 152-2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011, “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve”, i ndryshuar; VKM nr. 187, datë 08.03.2017, “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë”, i ndryshuar; VKM nr. 165, datë 02.03.2016, “Për pagat e vetëqeverisjes vendore”, i ndryshuar;

Rregullore e brendshme “Mbi procedurat e auditimit në KLSH”; Rregullore e brendshme “Mbi organizimin dhe funksionimin administrativ KLSH-së”; Rregullore e brendshme e organizimit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak dhe aparatit administrativ të Bashkisë; Vendimet e Këshillit Bashkiak dhe shprehja e ligjshmërisë nga Prefekti i Qarkut; Legjislacioni bazë dhe dytësor, dispozitat e tjera, si dhe kriteret përkatëse që janë përdorur dhe ju jemi referuar për kryerjen e vlerësimeve gjatë auditimit.

- **Standardet e auditimit.**

ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik”, i cili përcakton parimet themelore për auditimin e sektorit publik në përgjithësi; ISSAI 2000-2899 “Udhëzues të auditimit financiar”; ISSAI 2300 “Planifikimi i auditimit të pasqyrave financiare”; INTOSAI GOV 9100 “Udhëzues mbi standardet e kontrollit të brendshëm për sektorin publik” si dhe INTOSAI GOV 9110 “Udhëzues mbi raportimin e efektivitetit të kontrolleve të brendshëm”; ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, i cili përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të

auditimit të përputhshmërisë; ISSAI 4000 “*Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë*”; si dhe ISSAI 4200 “*Udhëzime për auditimin e përputhshmërisë*”; INTOSAI “*Për implementimin e standardeve ndërkombëtare të auditimit, ISSAI mbi auditimin e përputhshmërisë*”; etj. Standardet kombëtare të kontabilitetit; Standardet ndërkombëtare të auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC; Manuali i auditimit financiar dhe i përputhshmërisë të KLSH-së; Manuali i auditimit të brendshëm, etj. Standardet ndërkombëtare të auditimit mbi raportimin e audituesit të pavarur, (IFAC); Praktika të mira të fushës, si manualët e Gjykatës Evropiane të Audituesve, Kërkesat e udhërrëfyesit të IDI-t, etj.

#### **- Metodat e auditimit.**

Auditim i njëpasnjëshëm dhe me zgjedhje periudhash. Qasja audituese e KLSH-së është metodologji e bazuar në vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të auditimit në subjektin që auditohet, e cila shërben për kryerjen e auditimit me efikasitet dhe efektivitet, duke u fokusuar në natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit në fushat materiale dhe që vlerësohen me nivel të lartë risku. Nën gjykimin profesional të audituesve të pavarur, për përzgjedhjen e kampioneve për ekzaminim, në zërat e shpenzimeve, u morën në konsideratë dy elementë:

- *Risku i lidhur me shpenzimin specifik; dhe*
- *Pesha specifike që një zë shpenzimesh zë ndaj totalit të shpenzimeve të subjektit.*

Vlerësimi bazuar në riskun dhe materialitetin: Nisur nga gjykimi dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, duke ditur që materialiteti shpreh nivelin maksimal të devijimit, që audituesit e vlerëson si të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e informacionit financiar, kemi përcaktuar materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar.

Për arritjen e konkluzionit vlerësues, u përdorën teknikat e auditimit:

- *Kontrolli aritmetik.* Duke konsideruar faktin se në thelb, kontabiliteti konsiston në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike (që është edhe qëllimi i kontabilitetit), bëhen një seri veprimesh të cilat kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

- *Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.* Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Nga kontrolli me zgjedhje i pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatohet se shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar, sipas kërkesave të Udhëzimit të MF nr. 30, datë 27.12.2011 “*Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik*”, i ndryshuar.

- *Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese,* konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, llogarive, librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt u konstatuan probleme. Gjithashtu, për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël u krye mbikëqyrje fizike e magazinës.

- *Kontrolli i vlerësimeve.* Përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

- *Konfirmimi nga të tretët.* Transaksionet e përzgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimit periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

- *Kontrolli sipas një treguesi.* Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “jashtë normales”, të cilat përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka: mungesë të pjesëve justifikuese, gabime të shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.

- *Intervista*
- *Raporte dhe Informacione*
- *Pyetësorët për vlerësimin e sistemeve të Kontrollit të Brendshëm dhe MFK.*

#### **- Dokumentimi i auditimit.**

Mbi bazën e pyetësorëve dhe testeve përkatëse të miratuara në manualët e auditimit financiar dhe përputhshmërisë, nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, të kryera në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore të zbatueshme. Në bazë të procedurave të auditimit të kryera, evidencave të mbledhura u hartua Projekt Raporti i Auditimit i cili u dërgua Subjektit me shkresë nr. 407/5, datë 03.09.2025. Pas shqyrtimit të komenteve dhe shpjegimeve të subjektit të audituar, të ardhura me shkresën nr 6651, datë 29.09.2025 të protokolluara në KLSH nr. 407/6, datë 01.10.2025 dhe nr. 6809, datë 03.10.2025 të protokolluara në KLSH nr. 407/7, datë 08.10.2025 nga grupi i auditimit të KLSH-së, u përgatit ky Raport Përfundimtar i Auditimit dhe Opinioni i Audituesit të Jashtëm Publik. Rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra gjatë auditimit, si dhe çështje të tjera të rëndësishme që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre sipas gjykimit dhe skepticizmit profesional që audituesit ushtruan në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe ka shërbyer si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

### **III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT.**

#### **1. Informacioni i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim.**

Bashkia Librazhdi kufizohet në veri me Bashkinë Bulqizë, në lindje me Republikën e Maqedonisë së Veriut, në jug me Bashkinë Përrenjas dhe në perëndim me Bashkitë Elbasan dhe Tiranë. Kryeqendra e Bashkisë është qyteti i Librazhdit.

Sipas Censurit të vitit 2023, Librazhdi ka një popullsi prej 23,312 banorësh. Bashkia e re shtrihet në një sipërfaqe prej 793.36 km<sup>2</sup>. Densiteti i popullsisë është 55.68 banorë/km<sup>2</sup>.

Kjo bashki përbëhet nga 7 njësi administrative, të cilat janë: Librazhd, Qendër Librazhd, Hotolisht, Lunik, Stërblevë, Polis dhe Orenjë. Të gjitha njësitë administrative janë aktualisht pjesë e rrethit të Librazhdit dhe qarkut të Elbasanit. Bashkia e re ka nën administrimin e saj një qytet dhe 52 fshatra.

Bashkia e re e Librazhdit ka potencial për zhvillimin e turizmit malor, por një gjë e tillë ka qenë jashtë vëmendjes së drejtuesve vendorë deri më sot. Mbrojtja e parkut kombëtar Shebenik-Jabllanicë dhe përfshirja e tij në guidat e turizmit malor në vend do të krijonte një perspektivë të re zhvillimi për Librazhdin dhe banorët e këtyre zonave.

Paralelisht me resurset natyrore, zona e Librazhdit shquhet për folklorin e pasur, kostumet popullore të veçanta dhe zanatin e ndërtimit të shtëpive. Kjo zonë ka kultivuar gjithashtu mjeshhtërinë e përpunimit të gurit dhe të drurit.

*Misioni për njësinë që auditohet është:* Kryerja e funksioneve të veta, të përbashkëta dhe të deleguara në interes të komunitetit, duke përdorur në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme burimet natyrore dhe financiare (të ardhurat e veta, grandin dhe fondet e dhëna nga buxheti i shtetit me synim krijimin e kushteve të sigurisë dhe mirëqenies për komunitetin).

*Objektivat,* burojnë nga ligji “Për vetëqeverisjen vendore”.

*Ndërsa administrata (aparati) i këtij institucioni, ka si qëllim: përmirësimin e kushteve të punës, rritjen e nivelit të drejtimit dhe rishikimin funksional të Bashkisë, zhvillimin e politikave dhe strategjive, identifikimin, koordinimin dhe monitorimin e programeve, rritjen e efektivitetit të përdorimit të burimeve.*

*Bashkia siguron qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet: njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësisë; respektimit i të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera; zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë; ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga Bashkia; realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme dhe nxitjes efektive të pjesëmarrjes së bashkësisë në qeverisjen vendore.*

Synimi kryesor është plotësimi sa më i mirë i nevojave dhe kërkesave të komuniteteve përkatëse, nëpërmjet arritjes së një niveli sa më të lartë shërbimesh, në dobi të një zhvillimi të balancuar me qëllim përfundimtar standarde të larta të cilësisë së jetesës në territorin nën administrim.

Vetëqeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë siguron qeverisjen e efektshme, efikase dhe në një nivel sa më afër qytetarëve nëpërmjet:

*a) njohjes së ekzistencës së identiteteve dhe vlerave të ndryshme të bashkësive;*

*b) respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve, të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera;*

*c) zgjedhjes së llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësive të tjera publike vendore në dobi të bashkësisë;*

*ç) ushtrimit efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave nga organet e vetëqeverisjes vendore;*

*d) realizimit të shërbimeve në forma të përshtatshme, bazuar në nevojat e anëtarëve të bashkësisë;*

*dh) nxitjes efektive të pjesëmarrjes gjithëpërfshirëse të bashkësisë në qeverisjen vendore;*

*e) realizimit të shërbimeve, në përputhje me standardet e kërkuara me ligj ose akte të tjera normative.*

Bashkia Librazhd, si të gjitha njësitë e tjera të vetëqeverisjes vendore ka kuadrin legjislativ dhe operues, bazë e të cilave janë ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” dhe ligji nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” , i ndryshuar, krahas akteve të tjera ligjore, nënligjore dhe rregullatorë.

Rëndësia e auditimit financiar dhe përputhshmërisë të Bashkisë Librazhd për periudhën e aktivitetit 2024, krahas detyrimit kushtetues dhe ligjor që konsiston në kontrollin e përdorimit dhe mbrojtjes së fondeve shtetërore nga organet e pushtetit vendor, pra njësitë e vetëqeverisjes vendore janë subjekt i kontrollit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, sipas legjislationit në fuqi, qëndron në të bërit sa më transparente të veprimtarisë menaxhuese dhe administruese, për të rritur përgjegjshmërinë dhe llogaridhënien e të zgjedhurve dhe administratës publike, në funksion të rritjes së mirëqenies së qytetarëve.

## **2. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT, SIPAS DREJTIMEVE TË AUDITIMIT.**

### **Pika 2.1. Auditim mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm.**

*2.1.1. Identifikimi dhe vlerësimi i nivelit të implementimit të komponentëve të MFK. Mjedisi i kontrollit, Menaxhimi i riskut, Veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi dhe Monitorimi. Saktësia e deklaratës vjetore dhe raporti përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm në njësinë publike për periudhën viti 2024.*

Bashkia Librazhd ushtron funksionet e saj. në zbatimin e Ligjit nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”.

Aktivitetet kryesore të bashkisë Librazhd, për vitin 2024, drejtohen nga 11 drejtori kryesore si

më poshtë:

Drejtoria e Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtoria e Taksave Vendore dhe Tregjeve, Drejtoria e Shërbimeve Sociale, Drejtoria e Bujqësisë, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit Urban dhe Mbrojtjes së Territorit, Administrimit të Ujitjes, Kullimit dhe Mjedisit, Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Turizmit, Drejtoria e Projekteve, Integritit Evropian dhe Informimit Publik.

Për vitin 2024 struktura organizative e institucionit është miratuar nga KB me Vendimin Nr. 119 datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të Bashkisë Librazhd dhe njësisve në varësi të saj”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr. 117 datë 29.12.2023 “Për miratimin dhe kategorizimin e nivelit të pagave të aparatit të Bashkisë njësisve administrative dhe institucioneve në varësi”, Vendimin e Këshillit të Bashkisë Nr.116, datë 29.12.2023, “Për miratimin e numrit të punonjësve të bashkisë, institucioneve në varësi dhe të njësisve administrative”, dhe në Urdhrin Nr.9 datë 04/01/2024 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Librazhd, viti 2024”.

Për 44 pozicione pune, marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ndërsa 396 pozicione pune, janë punonjës administrativë (punonjës që kryejnë veprimtari administrative, sekretarie, mirëmbajtje, shërbimi, ruajtje, etj.) dhe marrëdhëniet e punës rregullohen nga ligji nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar. Numri i punonjësve me kontratë provizore është 46, dhe gjithsej janë 440 punonjës.

Mjedisi i Kontrollit nuk është implementuar i plotë, dhe në këtë mënyrë nuk funksionon në një shkallë të mjaftueshme.

Faktorët e mjedisit të kontrollit përfshijnë integritetin, vlerat etike dhe aftësinë e stafit të njësisë; filozofinë e drejtimit dhe stilin e punës; mënyrën sesi menaxhimi cakton përgjegjësi dhe të drejta dhe organizon dhe zhvillon stafin, si dhe përkushtimin dhe orientimet që jep bordi i menaxherëve.

Në rregulloren e brendshme, rregullat të përfshira janë ndërtuar kryesisht sipas linjave funksionale të përgjegjësisë, por nuk përshkruajnë me detaje proceset, rrjedhën e punës, fillimin dhe mbarimin e procesit, informimin dhe raportimin, dhe vendimmarrjen individuale me qëllim parandalimin e risqeve dhe përgjigjen ndaj tyre.

Nga ana e Kryetarit të bashkisë janë realizuar takime verbale me menaxherët e lartë dhe me drejtuesit e njësisve të vartësisë, por pavarësisht nga kjo, nuk është provuar se raportohet sipas rregullave dhe procedurave lidhur me proceset kryesore, si dhe me anë të raporteve etj. Gjithashtu, proceset për aktivitetet kryesore nuk janë përfshirë gjatë këtyre takimeve, me qëllim nxjerrjen e përgjegjësisë, si edhe nuk mbahen minuta takimi etj.

Sa më sipër është në kundërshtim me Ligjin Nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 9, pika 4 shkronja (f).

Nga ana e GMS janë realizuar takime në lidhje me planifikimin dhe monitorimin e PBA, për të cilat janë mbajtur procesverbalet përkatëse.

Nga auditimi, nuk ka takime të tjera të dokumentuara të aktivitetit të tij, nuk ka plan vjetor pune dhe grafik takimesh rrjedhimisht as vendime, raporte vjetore të aktivitetit të tij, të përcaktuara në Ligjin nr. 10296/2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, dhe Manualin e MFK Kap. II/2.2.6 ku citohet: “Vendimet e GMS duhet të merren në mënyrë kolegjiale dhe objektive, duke pasur në vëmendje interesin publik”.

Këto vendime duhet të pasqyrohen në dokumente dhe tu vihen në dispozicion menaxhimit të njësisë.

GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë.

Menaxhimi i Riskut nuk funksionon mjaftueshëm.

Nëpunësi Autorizues nuk ka krijuar Grupin e Menaxhimit të Riskut, d.m.th emërimin e personave përgjegjës, për krijimin e regjistrit të riskut.

Nga auditimi, nuk ka një praktikë komunikimi për risqet e identifikuar dhe aktivitetet e ndërmarrja në përgjigje të risqeve. Nga ana tjetër, nuk rezulton të jenë kryer analiza për rishikimin e risqeve nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik.

Menaxhimi i riskut duhet të mundësojë vendimmarrjen cilësore, parashikimin më të mirë dhe optimizimin e burimeve në dispozicion, që kanë të bëjnë me prioritetet dhe shmangien e problemeve të ardhshme, që mund të shfaqen gjatë punës për arritjen e objektivave të vendosura.

Gjatë hartimit të Regjistrit të Riskut, risqet e brendshme nuk lidhen shumë me planifikimin, proceset operacionale, burimet njerëzore, anën ligjore të mbikëqyrjes (ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive për punën e secilit punonjës etj.).

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10 296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar, neni 11 pika 2, neni 20, neni 21, neni 24 pika 1, si dhe me nenin 27, si edhe Manualit të MFK miratuar me Urdhrin Nr.108, datë 17.11.2016, pika 2.2.6 dhe pika 3.1.

*Aktivitetet e kontrollit* nuk kuptohen mjaftueshëm dhe për pasojë një pjesë e mirë e tyre mungojnë, si p.sh. mungon një rregullore risku, apo rregullore për aksesin në aplikacione të ndryshme si p.sh. GIS etj.

Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve. Titullarët e njësive të sektorit publik miratojnë veprimtaritë e kontrollit, përfshirë procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut. Në zbatim të ligjit nr. 10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 22 “Veprimtaritë e Kontrollit” përfshijnë: procedurat dhe politikat e shkruara, të përgatitura për të dhënë siguri të arsyeshme, që risqet janë kufizuar brenda kufijve të pranueshëm, të përcaktuar gjatë procesit të menaxhimit të riskut.

Nga auditimi, rezultojnë procedura kontrolli vetëm për të dhënat financiare, pasi nga përgjegjësitet e kontabilitetit realizohen kontrole dhe rregullime në lidhje me veprimet e kryera nga specialistët përkatës të kontabilitetit dhe mbajtjen e ditarëve, hartimin e listë pagesave, urdhër-shpenzimeve e veprime të tjera.

Aktivitetet e kontrollit nuk kuptohen mjaftueshëm dhe për pasojë një pjesë e mirë e tyre mungojnë, si p.sh. mungon një rregullore risku, apo rregullore për aksesin në aplikacione të ndryshme si p.sh. GIS etj.

Gjithashtu, mungojnë gjurmët e auditimit për aktivitetet apo operacionet kryesore, të cilat duhet të jenë të protokolluara.

Mungesa e gjurmëve të auditimit, sipas strukturës së miratuar, ka sjellë një proces monitorimi jo efektiv ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore, për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 9, pika 4 shkronja (f), neni 11 pika 2, neni 16, neni 21, neni 22, neni 24 pika 1, si dhe me nenin 27, si edhe Manualit të MFK miratuar me urdhrin Nr.108, datë 17.11.2016, pika 2.2.6 dhe pika 3.1.

Shkaku kryesor për gjendjen e krijuar është mungesa e krijimit të një sistemi të plotë të MFK, mungesa e funksionimit të sistemeve të MFK-së, të cilat sjellin për pasojë që këto sisteme të mos kuptohen nga njësia publike dhe mungesën e reagimit ndaj risqeve të mundëshme.

**Për sa më sipër, kanë përgjegjësi: z. M. D,** Kryetar i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e NA;  
**z. E. S,** Zv. Kryetar i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e mbulimit të funksioneve sipas organogramës; **z. B. P,** Sekretari i Përgjithshëm, me cilësinë e NA të deleguar me cilësinë e

menaxhimit të lartë dhe Koordinatorit të Riskut.

**Pretendimet e subjektit:** Përsa është trajtuar në këtë pjesë të Projekt Raportit të Auditimit nga subjekti i audituar Bashkia Librazhd është paraqitur observacion me shkresë nr.6651/1 prot, datë 29.09.2025 nga Drejtoria e Zhvillimit Bujqësisë dhe Turizmit për ish-Drejtorinë e Pyjeve dhe kullotave ku janë shprehur kundërshtimet si më poshtë:

**1.** Ish-Drejtoria e Pyjeve dhe kullotave sot Sektori i Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave pranë Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik të Bujqësisë dhe Turizmit, është institucion që merret vetëm me menaxhimin, administrimin dhe planifikimin për mirëmenaxhimin e fondit pyjor/kullor të listës së ngastrave të kaluar në pronësi me VKM 684 datë 01.09.2020 "Për kalimin në pronësi..." Sa i përket Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit në të cilën z. A.B. përfshihet, bazuar në ligjin e pyjeve 57/2020 datë 30.04.2020 për personat që punojnë në sektorin e pyjeve dhe kullotave të cilët duhet të jenë inxhinier ose teknikë pyjesh, përfshirja në grupin e MFK-s në pikën 2.1 nuk e shikojmë të arsyeshëm, pasi nuk përfshihet në arsimimin profesional për të realizuar detyrat e projekt raportit. Kërkojmë nga ana Juaj që të rishikohet pika 2.1 mbi emrat e personave të ngarkuar me përgjegjësi.

**2.** Shkaku kryesor për gjendjen e krijuar është mungesa e krijimit të një sistemi të plotë të MFK, mungesa e funksionimit të sistemeve të MFK-së,...është cilësuar Drejtoria e Taksave dhe Tregjeve sipas konstatimit Nr.1 i cili nuk është për Drejtorinë e taksave vendore.

Për Drejtorinë e Taksave Vendore është administruar Akt Konstatimi Nr. 4, datë 11.07.2025 dhe jo Akt Konstatimi Nr.1 datë 11.

**Qëndrimi i Grupit të Auditimit të KLSH –së:** Në përgjigje të kundërshtimeve tuaja sqarojmë se, në Urdhrin Nr.32 datë 11/01/2024 “Mbi ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik (GMS)”, jeni pjesë e GMS-së. Sjellim në vëmendje se, GMS duhet të kuptojë sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë dhe të garantojë se komponentët e MFK-së dhe të menaxhimit efektiv të riskut janë të pranishëm dhe se funksionojnë me efektivitet brenda njësisë, dhe si rrjedhojë ky fakt nuk ju përjashton nga përgjegjësia, përsa kohë jeni pjesë përbërse e GMS. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr.10296/2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 9, pika 4 shkronja (f), neni 11 pika 2, neni 16, neni 21, neni 22, neni 24 pika 1, si dhe me nenin 27, si edhe Manualit të MFK miratuar me urdhrin Nr.108, datë 17.11.2016, pika 2.2.6 dhe pika 3.1. Për këtë arsye, observacioni juaj merret pjesërisht në konsideratë.

#### **Nënpika 2.1.2. Organizimi i njësisë së auditit të brendshëm.**

#### **Nënpika 2.1.3 Vlerësimi mbi veprimtarinë e njësisë së auditit të brendshëm.**

Njësia e auditit të brendshëm në Bashkinë Librazhd është organizuar si Drejtori sipas strukturës organizative të miratuar nga Titullari i Bashkisë me Urdhër nr. 747 datë 07.07.2023, ndryshuar me Urdhër nr. 783 datë 30.08.2024 dhe Urdhër nr. 1068 datë 18.11.2024 “Për disa ndryshime në strukturën e bashkisë Librazhd të miratuar me urdhër të Kryetarit të Bashkisë nr. 783 datë 30.08.2024”, nga ku njësia e auditit të brendshëm, është e përbërë me 4 (katër) audites, 1 drejtor dhe 3 specialistë.

Struktura e përgjithshme NJAB, në Bashkinë Librazhd për vitin 2024 paraqitet në tabelën si më poshtë:

Nr.	Nga data e krijimit deri me 31.12.2024	Funksioni	Arsimimi	Vjetërsi në punë	Vjetërsi në auditim/vite	Çertifikimi	Trajnime të vijueshme
1	R M	Drejtor	I lartë	37	2.6	-	-
2	D H	Auditues	I lartë	20	0.6	-	-
3	I H	Audituese	I lartë	8	1.9	-	-
4	A I	Auditues	I lartë	1	1	-	-
5	S A	Audituese	I lartë	0.9	0.9	-	-
6	O G	Audituese	I lartë	0.6	0.2	-	-

Në zbatim të planit vjetor të auditimit nr. 6669/1Prot., datë 17/10/2023 të Kryetarit të bashkisë, për vitin 2024, objekti i aktivitetit të AB është mbështetur në drejtimet kryesore si më poshtë:

- Vlerësimi mbi funksionimin e sistemit në lidhje me zbatimin e rekomandimeve që janë lënë në auditimet e mëparshme, nga audituesit e brendshëm, deri në fund të vitit 2023.
- Vlerësimi i situatës mbi detyrimet e prapambetura, për Bashkinë Librazhd, deri në fund të vitit 2023.
- Vlerësimi i hartimit të buxhetit, veprimtaria financiare e Njesisë, menaxhimi i burimeve njerëzore, vlerësimi i kontrollit të brendshëm, etj., për veprimtarinë e vitit 2023.
- Karta e Auditimit të Brendshëm është miratuar nga Titullari i Bashkisë Librazhd, me Nr.63/1 datë 08/01/2024.
- Kodi Etik i Auditimit të Brendshëm është miratuar me Vendimin nr.12 datë 02.05.2024, i Kryetarit të Bashkisë.

Nga auditimi, kostatohet se janë dhënë 56 rekomandime. Këto rekomandime janë pranuar të gjitha, prej të cilave janë zbatuar 12, gjithashtu 32 rekomandime janë në proces zbatimi, ndërsa 12 rekomandime rezultojnë të pa zbatuara.

Drejtuesi i NJAB në Bashkinë Librazhd nuk është emëruar në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, i ndryshuar, nenit 11, pika 2 germa “b”, sipas të cilës drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm duhet të ketë përvojë pune 5 vjet në profesion, nga të cilat jo më pak se 3 vjet në fushën e auditimit, dhe të jetë i certifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik”.

***Për sa konstatohet sa sipër, ngarkohen me përgjegjësi: Znj. N. B. Drejtor i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbështetëse, në cilësinë e hartuesit të praktikës së emërimit të drejtorit të AB.***

*Nga auditimi është konstatuar se:*

Për periudhën objekt auditimi Drejtoria e Auditit të Brendshëm për veprimtarinë e sajë nuk ka raportuar në KB, në zbatim të nenit 4, pika 19, dhe nenit 10, pika 2, të Ligjit 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Gjithashtu, në kuptim të Manualit të MFK, miratuar me urdhrin Nr. 4, datë 26.01.2024 të MF, pika 2.3.3 “Auditi i Brendshëm” citohet ..... Auditimi i Brendshëm është një aktivitet i pavarur (nuk lejohet të kryejë funksione menaxhimi operacional), objektiv, që jep siguri dhe këshilla dhe është i projektuar për t’i shtuar vlerë dhe përmirësuar operacionet e njësisë. Përveç kësaj, linja e tretë ka një linjë primare të raportimit ndaj Titullarit. Si e tillë, linja e tretë është një siguri dhe jo një funksion menaxhimi, e cila e ndan atë nga linja e dytë e mbrojtjes.

Për sa më sipër Drejtoria e Auditit të Brendshëm është funksion i pamvarur nga NA i njësisë publike.

## **Pika 2.2. Auditim mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.**

### **2.1. Programimi PBA-së 2024-2026 dhe programimi i buxhetit vjetor për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024:**

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2024-2026, rezultoi se janë realizuar fazat e përgatitjes, duke filluar që nga ngritja e Grupit të Menaxhimit Strategjik (GMS) me Urdhrin nr. 32 datë 11.01.2024 dhe nr. 193 prot., datë 11.01.2024 dhe të Grupit të punës për hartimin e e Projekt Buxhetit /Ekipeve të Menaxhimit të Programeve (EMP); miratimin e tavanëve buxhetore me; miratimin e PBA 2024-2026 me VKB nr. 72 datë 31.07.2023 dhe konfirmim për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 883 prot., datë 04.08.2023; me shkresën nr. 4065 prot., date 30.11.2023 është dërguar në Këshillin Bashkiak për njohje dhe miratim PBA 2024-2026 dhe projekt plani vjetor 2024; VKB nr. 119 datë 29.12.2023 “Mbi miratimin e PBA

2024-2026” ku është përfshirë dhe Plani vjetor i buxhetit 2024; shkresa nr. 83 prot., datë 11.01.2024 dërguar Degës së Thesarit Librazhd për regjistrimin e buxhetit të vitit 2024 të miratuar. Rezulton se të gjitha aktet e mësipërme janë verifikuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 35/1 datë 12.01.2024.

Nga analiza e informacionit dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion, **rezultoi se**, nga 20 programe buxhetore të miratuara nga MF për përgatitjen e PBA 2024-2026 nga DFB /Bashkia Librazhd janë planifikuar për buxhetim vetëm 14 programe; dhe ka funksione/nënfunksiione të cilat nuk kanë asnjë program buxhetimi, si: F- “Funksionet e bashkive në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike” (neni 23): “Transportin publik vendor” dhe “Ndërtimin, rehabilitimin dhe mirëmbajtjen e ndërtesave të shërbimit parësor shëndetësor dhe zhvillimin e aktiviteteve edukuese e promovuese në nivel vendor, të cilat lidhen me mbrojtjen e shëndetit, si dhe administrimin e qendrave e të kujdesit të shëndeti publik”; F- “në fushën e mbrojtjes së mjedisit” (neni 26); N/f- “Mbrojtjen e natyrës e të biodiversitetit, sipas legjisllacionit në fuqi” etj; N/f-“Transporti publik”, :turizmi” etj,. Çdo funksion i përcaktuar në Ligjin 139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” përfshihet në një program të caktuar buxhetor të përcaktuar në Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1. Pra vihet re se nuk ka një harmonizim të planifikimit buxhetor të atyre nënfunksiioneve që edhe pse u përkasin funksioneve të ndryshme, me një studim dhe analizë profesionale do të mbështesnin apo plotësonin njëra tjetrën, me qëllim realizimin në tërësi të shërbimeve ndaj komunitetit në territorin që mbulon bashkia Librazhd.

Programimi i shpenzimeve në PBA 2024-2026 dhe i detajuar për çdo program, sipas PBA (shpërndarja e fondeve sipas programeve), është paraqitur në tabelën nr. 2.1 dhe Aneksin 2.2.1, bashkëlidhur PRA.

Në mënyrë të përmbledhur, informacioni pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

*Tabela nr.2/Në mijë lekë*

Përmbledhëse informacionit të tabelave nr.2.1 dhe nr. 2.2									
Planifikimi buxhetor i shpenzimeve sipas çdo viti në PBA 2023-2025/2024-2026									
Nr.	Kodet e programeve	Shpenzimet Viti 2023		Shpenzimet Viti 2024		Shpenzimet Viti 2025		Shpenzimet Viti 2026	
		000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot	000/lekë	% ndaj/tot
<b>TOTALI (I)</b>				x		x		x	
<b>PBA 2023-2025</b>		<b>621,011</b>	<b>100</b>	<b>637,551</b>	<b>100</b>	<b>667,713</b>	<b>100</b>	-	-
<b>Diferenca</b>			<b>16,540</b>		<b>30,162</b>		-		-
<b>TOTALI (II)</b>									
<b>PBA 2024-2026</b>		-		<b>684,326</b>	<b>100</b>	<b>710,339</b>	<b>100</b>	<b>741,212</b>	<b>100</b>
<b>Diferenca</b>		-		<b>26,013</b>		<b>30,873</b>			
<b>Diferenca (II-I)/trendi</b>		-	-	<b>46,775</b>		<b>42,626</b>			-

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën 2 (përmbledhëse) dhe në Aneksin 2.2.1, rezulton se:

- Në [PBA 2023-2025] dhe [PBA 2024-2026], planifikimi i fondeve në buxhet në total ka ardhur në rritje nga viti në vit: me 16,540 mijë lekë nga 2023 në vitin 2024 dhe me 30,162 mijë lekë nga viti 2024 në vitin 2025 në [PBA 2023-2025]; me 26,013 mijë lekë nga viti 2024 në vitin 2025 dhe me 30,873 mijë lekë nga viti 2025 në vitin 2026 në [PBA 2024-2026];
- Për vitin 2024 në [PBA 2023-2025] është parashikuar në vlerën 637,551 mijë lekë dhe në [PBA 2024-2026] në vlerën 684,326 mijë lekë, ose (-)551,783 mijë lekë më pak;
- Për vitin 2025 në PBA 2023-2025 është parashikuar në vlerën 864,459 mijë lekë dhe në PBA 2024-2026 në vlerën 333,037 mijë ose 26,013 mijë lekë më shumë;
- Nga 16 programet e buxhetuara për vitin 2024 në [PBA 2023-2025] dhe [PBA 2024-2026], rezulton se programi 01110 është programi me fondet më të larta të planifikuara dhe se ka

ardhur në rritje me 12,382 mijë lekë; programet 04240 dhe 09120 kanë ardhur me fonde në rënie, ndërsa programet e tjera janë planifikuar me vlera të njëjta;

▪ Ndërsa programet buxhetore e përzgjedhura në Bashkinë Librazhd për buxhetin e vitit 2024 si viti i parë në PBA 2024-2026, krahasuar me programet e miratuara nga MF për tu patur në konsideratë nga NJVQV gjatë përgatitjes së PBA 2024-2026, pasqyrohen në Aneksin 2.2.2 bashkëlidhur PRA.

Programet afatmesme janë hartuar duke u bazuar në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjin nr. 115/2014 “Për ndarjen administrativo-territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin nr. 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar me Ligjin nr. 57 datë 02.06.2016 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9936 datë 26.06.2008”, Ligjin nr. 9652/2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Udhëzimin e MF nr. 7 datë 28.02.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së buxhetit”, Udhëzimin e MF nr. 9 datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimi plotësues i MF nr. 2 datë 19.01.2018 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2018”, Udhëzimin plotësues nr.6/1 datë 28.02.2018 “Për përgatitjen e buxhetit vendor”, Udhëzimin nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 22 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1, Udhëzimi MF nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026”, si dhe VKB “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore për Bashkinë e Librazhd për vitin 2024”. Është marrë në konsideratë Instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

**Pretendimi i Subjektit:** Me shkresën nr. 6809 prot., datë 03.10.2025 protokulluar në KLSH me nr 407/7, date 08.10.2025, Drejtoria e buxhetit, menaxhimit financiar dhe shërbimeve sociale ka shprehur pretendimet e veta lidhur me konstatimet që grupi i auditimit ka përcjellë në Akt Konstatimin nr. 3 dt.11.07.2025 dhe në PRA, si më poshtë vijon:

Duke qenë se Bashkia Librazhd është bashki e vogël, nuk i përdor të 22 programet dhe për këtë arsye janë grupuar sipas natyrës në 16 programe buxhetore.

**Qendrimi i grupit të auditimit:** Ju sjellim në vëmendjen tuaj se Udhëzimet e MF “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” kanë marrë parasysh buxhetin e secilës bashki dhe përcaktimi i numrit të programeve dhe përzgjedhja e cilësuar e tyre janë në raport të drejtë. Nëse GMS dhe Drejtoria e Buxhetit pranë Bashkisë Librazhd në takimet e tyre kanë dakortësuar grupimin e programeve, duhet që në një relacion të argumentojë pikërisht kjo vendimmarrje e juaja, duke prezantuar edhe programet e përfshira në programet e grupuara. Për sa pretendoni nuk merret parasysh nga grupi i auditimit.

**Konstatim:** Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në Aneksin 2.2.2, në Aneksin 2.2.3 dhe në Aneksin 2.2.1 të funksioneve të bashkisë dhe 22 programeve buxhetore të caktuara në udhëzimet e MF për PBA 2024-2026, rezultoi se: programet [04130], [04220], [04570], [07220], [10910], nuk janë marrë në konsideratë nga Bashkia Librazhd për të parashikuar fonde në buxhet, në moszbatim të Udhëzimit nr. 7 datë 25.05.2022 “Për një ndryshim në Udhëzimin nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së Programit Buxhetor Afatmesëm të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore” shtojca 1 dhe Udhëzimit

nr. 6 datë 28.02.2023 “Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2024-2026” shtojca 4.

- Programe që kanë parashikuar fonde për zërin “investime” në PBA 2024-2026 dhe në Planin Vjetor 2024, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.3/në lekë

Kodi standard	Emërtimi
01110	Planifikim e menaxhim
09120	Arsimi parashkollor/arsimi bazë
	Kujdesi social
09230	Arsimi i mesëm i përgjithshëm
03280	Mbrojtja nga zjarri dhe mbrojtja civile
04240	Administrimi i pyjeve dhe kullotave
04520	Menaxhimi i infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit
06260	Shërbimet publike vendore

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd/Punoi:Grupi i auditimit

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën 3, rezulton se nga 18 programe buxhetore, 7 prej tyre kanë planifikuar fonde për zërin “investime”.

- Ndarja e shpenzimeve sipas zërave buxhetorë parashikuar në PBA 2024-2026, është paraqitur në Aneksin 2.2.3 bashkëlidhur PRA.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në Aneksin 2.2.3, rezulton se:

- Nga planifikimi i fondeve në PBA 2024-2026, zëri "paga" ka vlerën më të lartë për të 3 vitet, vlerë e cila vjen në rritje nga viti në vit, duke zënë nga 44% deri në 41% të buxhetit vjetor respektiv;

Zëri "shpenzime operative", parashikuar rreth të njëjtës vlerë për të tre vitet e PBA-së;

Zëri “investime” parashikuar me fonde në rritje nga viti në vit duke zënë nga 24% deri në 28% të totalit të buxhetit;

Zëri “Rezervat” është parashikuar në të njëjtat vlera duke zënë 1% të totalit të buxhetit.

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave në Aneksin 2.2.3 rezulton se planifikimi bëhet mbi nevojat reale të bashkisë.

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave në Aneksin 2.2.4, rezulton se:

- Realizimin më të lartë e ka llog.604 “Transferime korente të brendshme” në masën 99.2%; dhe llog.606 “transferta familjare e individ” në masën 98.2%;

- Ndërsa me mosrealizimin më të lartë e ka llog 602 “shpenzime operative” në masën 74.4%.

- Sipas PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026 tendenca e të ardhurave paraqitet Aneksin 2.3.5, ku nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në të rezulton se:

- Të “ardhurat e veta” janë planifikuar me vlera në rritje nga viti në vit; për vitin 2024 në PBA 2024-2026 janë në vlerën 176,133 mijë lekë ose 3,000 mijë më shumë se planifikimi i vitit 2024 në PBA 2023-2025 paraardhës 2023;

-“Nga transferat” për vitin 2024 në PBA 2024-2026 janë planifikuar në vlerën totale 508,193 mijë lekë ose 44,000 mijë lekë më shumë se viti 2024 e PBA 2023-2025;

Paketa fiskale për vitin 2024 është miratuar me VKB nr. 108, datë 30.11.2023.

Nga auditimi dhe analiza e të dhënave, rezulton se planifikimi bëhet mbi nevojat reale të bashkisë.

Grupi i auditimit duke analizuar këtë fakt, arrin në konkluzionin se diferencat mes planifikimit të të ardhurave me realizimit faktik të tyre, ka ardhur si rezultat i *mungesës së një analize të mirëfilltë të realizimit apo mosrealizimit të çdo takse e tarife vendore.*

- Nga auditimi rezultoi se Bashkia Librazhd për PBA 2024-2026 dhe Projekt buxhetin e vitit 2024, ka zhvilluar takime konsultative me grupet e interesit në komunitet, konform Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; ndërsa prezantimi i PBA

2024-2026 dhe Projekt buxheti vjetor 2024 nga ana e bashkisë Librazhd është publikuar në faqen Zyrtare të Bashkisë në formatin e përshtatur për publikun.

Tabela nr.4

Datat e konsultimeve publike	PBA 2024-2026	P.Buxheti 2024
		Nr.6590 prot., date 12.10.2023 NJA Lunik Nr.6713 prot., date 19.10.2023 NJA Polis Nr.6714 prot., date 19.10.2023 Njësia Orenj,Floq Nr 6865 prot., datë 26.10.2023 NJA Steblevë Nr.6866 prot., date 26.10.2023 NJA Hotolisht Nr.7074 prot., date 07.11.2023 NJA Qëndër Nr.7075 prot., date 07.11.2023 Qyteti Librazhd
<b>Numri i takimeve</b>		<b>7</b>

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd

Procesi konsultativ me komunitetin është realizuar nëpërmjet njoftimit zyrtar në stenda, web-in e Bashkisë, rrjetet sociale etj., me anë të të cilave njoftohet komuniteti mbi takimin, objektin, platformën dhe adresën/linkun etj., vërtetuar kjo nga proces verbalet e mbajtura në secilin takim, konform kuadrit ligjor në fuqi: Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, Kreu I neni 5 pika ç; Ligjit nr. 146/2014 “Për Njoftimin dhe Konsultimin Publik” Kreu IV, neni 11-20;

- Buxhetet janë hartuar mbi bazën e nevojave të njësive shpenzuese: Njësitë administrative, drejtori/sectorë të aparatit të Bashkisë Librazhd, drejtorive të shkollave, kopshteve, etj, vërtetuar kjo nga kërkesat e dokumentuara.

- Hartimi i PBA 2024-2026 rezulton të ketë kaluar të gjitha fazat e përgatitjes, konform kuadrit ligjor;

Tabela nr.5/ Në mijë lekë

Qarku Elbasan	Bashkia Librazhd	PBA 2024-2026	Plani Buxhetit 2024
		VKB Nr. 72 dt.29.09.2023	VKB Nr. 119 dt. 29.12.2023
		<b>Vlera</b>	
		684,326	910,330

Punoi: Grupi i auditimit.

- PBA 2024-2026 dhe Buxheti vjetor për vitin 2024 kanë pësuar këto ndryshime dhe janë miratuar në Këshillin Bashkiak si më poshtë:

Tabela nr.5

Ndryshimet në buxhetin e vitit 2024		
Nr.	PBA 2024-2026	P. Buxheti 2024
1		Nr.119 dt.29.12.2023
2		VKB Nr. 04 datë 30.01.2024
3		VKB Nr. 18 datë 28.02.2024
4		VKB nr. 31 datë 29.03.2024
5		VKB nr. 38 datë 29.03.2024
6		VKB nr. 48 datë 28.05.2024
7		VKB nr. 51 datë 28.05.2024
8		VKB nr. 60 datë 28.06.2024
9		V. Kr nr. 77 datë 30.08.2024
10		VKB nr. 95 datë 18.10.2024
	<b>1</b>	<b>10</b>

Burimi: DFB/ Bashkia Librazhd

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit në tabelën nr. 5, rezulton se buxheti vjetor 2024 ka pësuar 9 ndryshime të cilat janë miratuar me VKB. Për këto ndryshime, është zbatuar kuadri ligjor në fuqi për buxhetin.

- Një informacion i detajuar mbi vlerën e fondeve të transferuara, pasqyrohet në Aneksin 2.2.9; Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, rezultoi se:

a. Bashkia Librazhd ka hartuar “Kalendarin e Programit Buxhetor Afatmesëm dhe të Buxhetit vjetor” për Bashkinë Librazhd dhe njësive administrative për vitin 2024 dhe miratuar me VKB nr. 99 datë 18.12.2023, në zbatim të Ligjit nr. 68/2017 “Për Financat e Vetëqeverisjes Vendore” neni 33;

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe dërgon për miratim në Këshillin e Njësisë kalendarin e programit buxhetor afatmesëm dhe të buxhetit vjetor, bazuar në

Udhëzimin e Ministrit të Financave për procedurat standarde për përgatitjen e kërkesave buxhetore të programit buxhetor afatmesëm qendror e vendor.(është paraqitur për miratim së bashku me PBA 2024-2026);

**b.** PBA 2024-2026 miratuar me VKB nr. 72 datë 31.07.2023 dhe Plani vjetor i buxhetit për vitin 2024, janë; Buxheti fillestar i miratuar për vitin 2024 me VKB Nr. 119 datë 29.12.2023, ka pësuar ndryshime, të cilat janë miratuar sipas VKB për shtesa/pakësime apo përdorim fondesh të trashëguara nga viti paraardhës 2023 për tu përdorur në buxhetin e vitit 2024;

Ndryshimet e propozuara dhe të miratuara në buxhetin e bashkisë për vitin 2024 me Vendim të Këshillit Bashkiak, kanë pasqyruar lëvizjet në buxhet sipas kodeve të programit, kapitullit, artikullit e vlerës, të cilat janë shoqëruar edhe me relacionet përkatëse, konform Ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008 “*Për sistemin buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, nenet 26,27,28 e 29; neni 44 paragrafi për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe neni 47;

**c.** Vendimeve të Këshillit Bashkiak për miratimin e PBA 2024-2026 dhe Planit vjetor 2024 dhe ndryshimeve të bëra, iu janë bashkëngjitur relacionet përkatëse, në të cilat janë dhënë argumentet e nevojshme ku mbështeten këto ndryshime.

**d.** VKB-të për PBA/ Buxhetin vjetor dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit ushtrimor, janë konfirmuar për ligjshmëri nga Prefekti i Qarkut Elbasan, si dhe janë dërguar në Degën e Thesarit Librazhd.

- Planifikimet fillestare sipas PBA-së dhe planit vjetor 2024, pasqyrohen në *Aneksin 2.2.6*. Referuar të dhënave të pasqyruara në *Aneksin 2.2.6*, **konstatohet se** Bashkia Librazhd ka planifikuar në PBA që me të ardhurat e veta të mbulojë 19.3% të shpenzimeve të planifikuara *për vitin 2024*. Ndërkohë që nga tabela rezulton se të ardhurat e veta të trashëguara nga viti paraardhës 2023 janë 35,019 mijë lekë. Të ardhurat e veta në total për vitin 2024 janë 210,525 mijë lekë ose në masën 23.1% të planit vjetor të miratuar.

- Referuar Akt Rakordimit me Degën e Thesarit “mbi të ardhurën e trashëguar” mbajtur në datën 26.01.2025 dhe të dhënave të pasqyruara në *Aneks 2.2.4* dhe në *Aneks 2.2.5*, **rezulton se**, shpenzimet me burim të “ardhurat e veta” nga taksat e tarifat vendore *për vitin 2024* janë planifikuar në vlerën totale 195,129 mijë lekë dhe janë shpenzuar në vlerën 129,019 mijë lekë ose në masën 66.1% e tyre; Nga fondet e “pakushtëzuara” janë planifikuar 429,288 mijë lekë dhe shpenzuar 385,061 mijë lekë ose në masën 89.7% e tyre; nga fondet “e pakushtëzuar sektoriale” janë planifikuar 181,291 mijë lekë dhe shpenzuar 157,179 mijë lekë ose në masën 86.7% e tyre; si dhe nga fondet "transferta e kushtëzuara" janë planifikuar 747,269 mijë dhe shpenzuar 730,705 mijë lekë ose në masën 97.8% e tyre.

- Gjithashtu nga auditimi i buxhetit vjetor dhe ndryshimeve, rezulton se të ardhurat për shpenzime të planifikuara në vitin 2024 bashkë me ato të trashëguara nga viti paraardhës 2023, janë 1,728,528 mijë lekë.

Ndërsa buxheti fillestar *për vitin 2024* është planifikuar në vlerën e 910,330 mijë lekë, me fondet e trashëguara nga viti 2023 prej 175,551 mijë lekë (nga të ardhurat e veta & transfertat e pakushtëzuar + tr.specifike e sektoriale) dhe transfertat shtesë nga granti arrin në vlerën progresive e 1,728,528 mijë lekë. Krahasuar me planin fillestar buxheti vjetor progresiv i planifikuar është 818,198 mijë lekë më shumë se ai fillestar dhe realizimi i tij është në vlerën e 1,510,260 mijë lekë.

Planifikimi i Buxheteve të Bashkisë Librazhd për vitin 2024 është bërë në zbatim të kërkesave të Ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*” pika 4 dhe 5, i ndryshuar me ligjin nr. 30/2015, germa “dh” të nenit 32, i ndryshuar, ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 “*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë*” i ndryshuar, Udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe UMFE nr. 23, datë 30.07.2018 “*Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit të njësitë të vetëqeverisjes vendore*”, i ndryshuar, me UMFE nr. 3, datë 16.01.2021, si dhe në vendimet përkatëse të Këshillit të Bashkiak Librazhd.

Detajimi i shpenzimeve dhe të ardhurave është bërë në përputhje me strukturën buxhetore. Programet buxhetore dhe detajimet e tyre, janë miratuar nga Këshilli Bashkiak me vendimet përkatëse. Plani buxhetor është detajuar dhe ndarë në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli për çdo vit buxhetor. Treguesit e buxhetit janë mbajtur tek llogaria e thesarit e cila pasqyron veprimtarinë përkatëse sipas klasifikimit buxhetor. Janë kryer akt-rakordimet periodike dhe vjetore me degën e thesarit. Planifikimi dhe realizimi i buxhetit të vitit 2024, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Planifikimi i buxhetit është bërë në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit të njësisve vendore. Janë zbatuar kriteret në çeljen e buxhetit, është bërë detajimi i planit fillestar bazuar në kompetencat që i lejon ligji për lëvizjet në buxhet.

- Struktura organizative për vitin 2024, është miratuar me Urdhër të Kryetarit nr. 9, datë 04.01.2024, Konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me shkresën nr. 16/1 prot., datë 10.01.2024. Ndërsa numri i punonjësve është miratuar me VKB nr. 116 datë 29.12.2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan nr. 328/1 prot., datë 15.01.2024. Në tabelën më poshtë pasqyrohen të dhënat e numrit të punonjësve sipas strukturës së miratuar në Aneks 2.2.8:

Niveli i pagave është miratuar me VKB nr 117, datë 29.12.2023, në zbatim të VKM nr. 328, datë 31.05.2023, “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page, dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur dhe të emëruar, të nëpunësve civilë dhe punonjësve administrativë të njësisve të vetëqeverisjes vendore”, VKM nr. 113 datë 01.03.2023, “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, VKM 175 datë 08.03.2017 i ndryshuar, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimorë në Arsimin Parauniversitar”, VKM 350 datë 19.04.2017 i ndryshuar, “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë për punonjësit e shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimi”. “Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendim nr. 165 dt. 02.03.2016, "për grupin e njësisve të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksioneve”.

Paketa fiskale për vitin 2024 është miratuar me VKB nr. 108, datë 30.11.2023.

## 2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Informacion i detajuar mbi planifikimin, çeljet dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit 2024 në buxhetin e vitit 2024 të miratuar, janë pasqyruar në tabelën 2 dhe tabelën 3 të PRA.

Nga analiza e vlerave të pasqyruara në tabelën 14 dhe informacionit në tabelën 1, tabelën 2 dhe tabelën 3, rezulton se ka diferenca në programe të ndryshme buxhetore, ku veç atyre programeve për të cilat Bashkia Librazhd nuk mund të bëjë planifikim të saktë të fondeve që do të shpenzohen (investime të reja gjatë vitit buxhetor me fonde të Ministrisë së linjës/FZHR), ka programe si: 04570- “Transporti publik”, 04130- “Mbështetje e zhvillimit ekonomik”, 07220- “Kujdesi Parësor Shëndetsor”, 036-“Marrëdhëniet në komunitet”, 056-

“Ndërgjegjësimi mjedisor”,062/1 “programe zhvillimi”, rezultojnë të jenë programe pa fonde buxhetore apo me fonde të papërfillshme; gjë për të cilat tregon se Bashkia Librazhd nuk ka pritshmëri për alokim të fondeve shtesë. Mungesa e planifikimit të fondeve apo planifikim me fonde të papërfillshme nga ana e bashkisë të këtyre programeve, tregon për një shërbim ku është cënuar efektiviteti në aktivitetin e funksioneve të saj që i ofron komunitetit, të përcaktuara në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 23-30.

Diferencat e vlerave të PBA-ve në gjykimin e grupit të auditimit tregojnë jo vetëm për planifikim jo të studiuar të fondeve buxhetore në PBA, por edhe paqartësi në përcaktimin dhe vlerësimin e programeve prioritare si dhe mungesë harmonizimi ndërmjet atyre programeve që i përkasin të njëjtit funksion apo funksioneve të ndryshme, por që mbështesin apo plotësojnë njëri - tjetrin, të cilat lidhen ngushtësisht me planin strategjik dhe politikat institucionale

- Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/pakësime), në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të Këshillit Bashkiak, të pasqyruara në tabelat respektive.

Për hartimin e projekt buxhetit vjetor 2024, janë marrë në konsideratë kryesisht realizimi i artikujve buxhetorë për vitin buxhetor paraardhës dhe drejtpërdrejtë kërkesat buxhetore sipas nevojave të çdo njësie të strukturës së bashkisë, konform nenit 40 pika 3/ç të ligjit nr. 67/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”.

- Nga auditimi i dokumentacionit rezultoi gjithashtu, se është bërë analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nën artikuj; gjatë vitit 2024 është bërë raportimi periodik shkresor 4, 8 dhe 12-mujor (zyrtar shkresor dhe elektronik) i realizimit të buxhetit në MF<sup>3</sup>.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktura sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë. Ky informacion paraqitet i detajuar në Aneksin 2.2.10 bashkëlidhur PRA.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për vitin 2024 rezultoi se PBA 2024-2026 të jetë realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë periudhës nën auditim, buxheti i Bashkisë Librazhd ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

Nga auditimi rezultoi se Kryetari i Bashkisë ka raportuar në Këshillin Bashkiak për gjendjen ekonomiko-financiare të vitit të mbyllur ushtrimor 2024, dhe miratuar me VKB nr. 14 datë 26.02.2025 me nr. 1199 prot., datë 28.02.2025, në zbatim të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44.

Për sa më sipër, një informacion i përmbledhur pasqyrohet në tabelën nr. 6 dhe i detajuar pasqyrohet në Aneksin 2.3.10. Në tabelën e mëposhtme nuk janë përfshirë shpenzimet me fonde nga transfertat e kushtëzuar.


Tabela nr. 6/në mijë lekë

Bashkia Librazhd. Vetëm me të ardhurat e veta vendore + transfertat e pakushtëzuar. Viti 2024									
Art	Emertimi	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)=(6)-(5)	% e realizimit
		Fakti i vitit para ardhës Viti 2023	PBA Plan Viti 2024	Buxheti Vjetor Plan Fillestar Viti 2024 (sipas VKB .)	Buxheti Vjetor Plan i Rishikuar Viti 2024	Çelja në thesar	Fakti i 12-mujorit	Diferenca	
Totali (korrente + kapitale)		1,409,886	684,326	1,255,998	1,728,528	1,255,998	1,510,260	218,268	87.4

<sup>3</sup> Informacioni i detajuar pasqyrohet mëposhtë në rubrikën Monitorimi i buxhetit

**2.3 Auditim mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetorë bazuar në nivelin e fondeve të çelura, sipas burimeve të financimit e krahasuar me akt rakordimin me Thesarin, analiza e mosrealizimit të shpenzimeve dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.**

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Librazhd si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nën artikull sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar janë respektuar të gjitha procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Librazhd, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar të vitit, të miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak ose të diktura nga transfertat e deleguar nga pushteti qendror. Për rishikimet e buxhetit dhe rritjet e limitit nga të ardhurat e realizuara, rezulton se është respektuar disiplina buxhetore, si në planifikim ashtu edhe në realizim.



**Buxhetit Bashkia Librazhd**

- Realizimit i treguesve të buxhetit për vitin 2024 referuar akt-rakordimeve me thesarin, paraqitet në Aneksi B10, bashkëngjitur PRA.

Referuar të dhënave të pasqyruara në Aneksin 2.2.10, rezulton se për vitin 2024 niveli i realizimit të treguesve të buxhetit varion në masën nga 77.1% deri në 99.2%; **rezultoi se**, llog. 604 "transferime korente të brendshme" ka realizimin më të lartë në masën 99.2% dhe llog.602 "shpenzime operative" ka mosrealizimin më të lartë në masën 77.1%.

Tabela nr. 7/në mijë lekë

Artikulli	2023			2024		
	Plan	Fakt	Dif.	Plan	Fakt	Dif.
<b>Totali</b>	<b>1,663,137</b>	<b>1,422,309</b>	<b>(-)240,828</b>	<b>1,728,528</b>	<b>1,510,260</b>	<b>(-)218,268</b>
Diferenca plan (2024-2023)				65,391	↗	
Diferenca fakt (2024-2023)				87,951	↗	
Trendi i realizimit vjetor		85.5%			87.4%	1.9% ↗

Nga informacioni i pasqyruar në Aneksin 2.2.10 dhe Aneksin 2.2.11 bashkëlidhur PRA dhe në mënyrë të përmbledhur në tabelën nr.7, **rezulton se**:

- Niveli i planifikimit buxhetor vjen në rritje nga viti 2023 në vitin 2024 me një diferencë prej 65,391 mijë lekë;
- Niveli i realizimit (ndaj planit) në total dhe për çdo zë buxhetor vjen në rritje nga viti 2023 në vitin 2024, gjë e cila tregon se treguesit e buxhetit planifikohen mbi nevojat që ka Bashkia Librazhd dhe se realizimi faktik nuk i përgjigjet në çdo rast zbatimit të tij sipas afateve kohore të përcaktuara;
- Referuar vlerave të mosrealizimit të buxhetit në tërësi dhe për çdo zë buxhetor, rezulton se ka ardhur në rënie nga viti 2023 në vitin 2024 me 87,951 mijë lekë në total;

Realizimin trendin e përmirësimit më të lartë e ka llog.606 dhe mosrealizimin me trendin e përkeqësuar e ka llog.600.

▪ **Sipas burimeve të financimit:**

Për përdorimin e të ardhurave treguesit e buxhetit për vitin 2024, sipas burimeve të financimit: transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta, janë planifikuar si në tabelën të Aneksit 2.2.12, bashkëlidhur PRA.

- Sipas burimeve të financimit: transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta, treguesit e buxhetit në mënyrë të përmbledhur janë planifikuar si më poshtë:

Tabela nr. 8/në lekë

Nr.	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit					% të ardhura të veta ndaj totalit për zë	% të ardhura të veta ndaj totalit për lloj
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike/sectoriale	Të Ardhura të veta	Transferta e kushtëzuar	Transferta te huaja		
<b>TOTALI</b>		<b>1,700,124,692</b>	<b>522,336,688</b>	<b>200,380,940</b>	<b>227,134,128</b>	<b>747,268,902</b>	<b>-</b>	<b>100</b>	<b>13.4</b>
në %		100	30.7	11.8	13.4	44.1	0		

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në Aneksin 2.2./13.2, **rezulton se:**

- Vlera e buxhetit progresiv në total për vitin 2024 është planifikuar 1,700,124,692 lekë, ku peshën më të madhe e kanë fondet nga “transferta e kushtëzuar” në vlerën 747,268,902 lekë ose në masën 44.1% të vlerës totale; dhe më të ulët fondet nga “transferta specifike/sectoriale” në vlerën 200,380,940 lekë ose në masën 11.8% të vlerës;

- Nga fondet me burim financimi “të ardhurat e veta” peshën më të madhe e zënë “investimet” në vlerën 151,968,503 lekë ose në masën 33.5% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 33.5% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

Vlerën më të ulët prej 500,000 lekë e ka zëri “transferta buxhete familjare /individe” ose në masën 0.2% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 0.08% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

“Pagat” janë në vlerën 9,093,093 lekë dhe zënë 3.5% të vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 2.5% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

- Sipas burimeve të financimit: transferta e pakushtëzuar, transferta specifike, të ardhura të veta, treguesit e buxhetit në mënyrë të përmbledhur janë realizuar si më poshtë:

Tabela nr. 9/në lekë

Nr	Emërtimi	Totali	Burimi i financimit					% nga të ardhurat e veta ndaj totalit	% të ardhura të veta ndaj totalit për lloj
			Transferta pakushtëzuara	Transferta e specifike/sectoriale	Të Ardhura të veta	Transferta e kushtëzuar	Transferta te huaja		
<b>TOTALI</b>		<b>1,502,698,532</b>	<b>442,787,231</b>	<b>185,747,883</b>	<b>152,165,330</b>	<b>730,256,196</b>	<b>-</b>	<b>100</b>	<b>10.1</b>
në %		100	29.5	11.7	10.1	48.7	0		

Burimi: Bashkia Librazhd

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në Aneksin 2.2.13.2 bashkëlidhur PRA, rezulton se:

- Vlera e shpenzimeve faktike në total për vitin 2024 është 1,502,698,532 lekë, ku peshën më të madhe e kanë fondet nga “transferta e kushtëzuar” në vlerën 730,256,196 lekë ose në masën

48.7% të vlerës totale dhe në vlerën më të ulët janë shpenzimet nga “të ardhurat e veta” në vlerën 152,165,330 lekë ose në masën 10.1% të vlerës totale;

- Nga fondet e shpenzuara me burim financimi “**të ardhurat e veta**” peshën më të madhe e zënë “*investimet*” në vlerën 96,848,757 lekë ose në masën 63.6% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 26.4% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”; Në vlerën 632,566 lekë janë zëri “*paga*” ose në masën 0.4% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 0.2% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

Peshën më të vogël e ka zëri “*Trans.Buxhet. Familjare e individ*” në vlerën 500,000 lekë ose në masën 0.3% ndaj vlerës totale për të njëjtin zë buxhetor dhe 0.08% ndaj vlerës totale të fondeve me burim “të ardhurat e veta”;

▪ Realizimi faktik i buxheteve sipas periudhave ushtrimore.

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në Aneksin 2.2.10 dhe Aneksin 2.2.10, rezulton se realizimi i Buxhetit është: për vitin 2023 është 1,409,886 mijë lekë; për vitin 2024 buxheti faktik është në vlerën e 1,510,260 mijë lekë; buxheti i planifikuar i vitit 2024 është 1,728,528 mijë lekë ose 65,391 mijë lekë më shumë se ai në vitin 2023; gjithashtu trendi i shpenzimeve ka ardhur në rritje si në planifikim ashtu edhe në realizimin e tyre.

Tabela nr. 10/në mijë lekë

Nr.	Emërtimi	Viti 2023	Viti 2024	Diferenca	Trendi i mosrealizimit
1	Shpenzimet e planifikuara	1,663,137	1,728,528	65,391	↘
2	Shpenzimet faktike	1,422,309	1,510,260	87,951	↘
	Diferenca	(-)240,828	(-)218,268	22,560	↘

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

Nga analiza e informacionit të pasqyruar në Aneksin 2.2.10 dhe Aneksin 2.2.12, tabelën nr. 10 dhe tabelën nr.11, **u konstatua** se, ka diferenca të dukshme midis treguesve në hartimin e planifikimit në fillim të vitit dhe zbatimit të buxhetit, përse i përket pjesës së të ardhurave dhe shpenzimeve të tyre, kështu nga të ardhurat të planifikuara dhe të realizuara, e këto të fundit të alokuara në buxhetet respektive, ka diferenca të dukshme duke bërë që buxheti për vitet 2023 dhe 2024 të ketë mosrealizime, pavarësisht faktit që vlera e të cilëve ka trend në rritje dhe në mënyrë të përmbledhur paraqitet në pasqyrën si më poshtë:

Tabela nr. 11/në mijë lekë

Emërtimi	2023		2024		Diferenca ndaj faktit (I)	Diferenca ndaj planit (II)	Trendi i mosrealizimit (I)
	Fakt	Plan	Fakt	Plan			
Shpenzime	1,422,309	1,728,528	1,510,260				↗
Të Ardhura							↗

Burimi: Bashkia Librazhd/ Punoi: Grupi i auditimit

- Nga auditimi rezultoi se: Bashkia Librazhd nuk ka patur financime të huaja për vitin 2024;
- Bashkia Librazhd nuk ka aplikuar për kredi në vitin 2024;
- Bashkia Librazhd nuk ka patur subvencione nga shteti;
- Bashkia Librazhd ka patur donacione për vitin 2024.

- Miratimi i buxhetit faktik:

Bashkia Librazhd ka miratuar Raportin vjetor të monitorimit dhe realizimit të buxhetit faktik për vitin 2024, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 44; ndërsa për vitin u mbyllur ushtrimor 2024 është brenda afatit ligjor.

- Monitorimi i buxhetit dhe raportimi 4 mujor në Këshillin Bashkiak:

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjit organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, Udhëzimit nr. 22

dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, rezulton se nga DFB/Bashkia Librazhd janë bërë raportimet 4, 8 dhe 12-mujore në MF sipas formateve të miratuara:

- Realizimi i buxhetit për periudhën 12-mujore Janar–Dhjetor 2024, shkresa për në MF nr. 1101 prot., datë 25.02.2025

Rezultoni se raportimet janë dërguar në MF në rrugë elektronike nga adresa zyrtare institucionale dhe ajo postare brenda afatit ligjor.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion Raportet e Monitorimit të buxhetit të vitit 2024 janë miratuar në Këshillin Bashkiak dhe janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës:

Me miratimin e buxheteve parashikohen dhe Fondi Rezervë [FR], Fondi i kontigjencës [FK], Fondi i Emergjencës [FE] dhe Mbrojtja civile [MC] (nga AKMC), vlerat e planifikimit dhe përdorimit të tyre pasqyrohen në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 12/Në mijë lekë

Emërtimi	Plan 2024	Fakt 2024	
Fond Rezervë	18,258	17,388	
Fond Emergjence	7,348	1,407	
Fond Kontigjence	2,000	2,000	
Mbrojtja Civile	24,213	23,181	
<b>Totali</b>	<b>51,819</b>	<b>43,976</b>	<b>Dif. 7,843</b>

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd

Përdorimi i këtyre fondeve është realizuar me miratimin e Këshillit Bashkiak.

- Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile:

Referuar kritereve të përgjithshme të ndarjes së fondit të kushtëzuar, të akorduar nga buxheti qendror dhe dokumentet orientuese për përdorimin e këtij fondi, nga ana e tyre, Pushteti Vendor/Bashkitë kanë për detyrim të miratojnë a) strategjinë vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë; b) vlerësimin vendor të riskut; c) planin vendor të emergjencave civile; ç) planin e zhvillimit urban, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile”.

Fondi që bashkitë duhet të kenë është në masën 4% të shpenzimeve buxhetore të fondeve të kushtëzuara nga buxheti i shtetit, në zbatim të Ligjit nr. 45/2019 “Për mbrojtjen civile” neni 65/1.

- Realizimi i Investimeve:

Planifikimi dhe realizimi i investimeve për vitin 2024 për Bashkinë Librazhd, me burim "financimi nga të ardhurat e veta" [AV] dhe "transfera e pakushtëzuara" [TP], pasqyrohet në tabelën më poshtë:

Tabela nr.13/ në mijë lekë

230-231	2023	2024			
	Fakt	Plan	Fakt	Diferenca ndaj planifikimit	Diferenca ndaj faktit
	399,628	454,017	367,600	(-)86,417	(-)32,028

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr.13, rezulton se për vitin 2024 realizimi i buxhetit ndaj planifikimit është me (-)86,417 mijë lekë më pak dhe se realizimi i tij në vitin 2024 krahasuar me vitin 2023 është me (-)32,028 mijë lekë më pak;

- Duke iu referuar të dhënave në tabelën nr. 14, një pasqyrim i përmblodhur i të dhënave për zërin “investime”, pasqyrohen si më poshtë vijon:

Tabela nr. 14/në mijë lekë

230-231	Burimet e Financimit	Viti 2024		%
		Plan	Fakt	
	Të ardhurat e veta	151,968,503	96,848,757	63.7
	Transfera specifike/sectoriale	13,367,423	12,024,886	89.9

	Transferata e pakushtëzuar	146,924,020	123,812,901	84.3
	Transferata e kushtëzuar	141,757,731	134,913,876	95.2
	Transferata e huaj	0	0	0
	<b>Totali</b>	<b>454,017,677</b>	<b>367,600,420</b>	<b>81</b>

*Burimi: Bashkia Librazhd*

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 14, rezulton se nga të ardhurat e veta zëri “investime” është realizuar në masën 63.7%, nga transferata specifike/sectoriale në masën 89.9%, nga transferata e pakushtëzuar në masën 84.3%, nga transferata e kushtëzuar në masën 95.2%.

Një informacion i detajuar i investimeve para dhe gjatë vitit 2024 sipas burimeve të financimit, paraqitet në Aneksin 2.2.14 bashkëlidhur PRA.

Nga informacioni i pasqyruar në Aneksin 2.2.14, rezulton se:

Investime me burim nga buxheti i shtetit/ministri linje janë 10 projekte investimi në vlerën totale 304,653 mijë lekë, planifikuar në buxhetin e viti 2024 në vlerën 141,758 mijë lekë nga të cilët deri në 31.12.2024 janë përfunduar 8 në vlerën e paguar 106,543 mijë lekë ndaj planifikimit në vlerën 111,894 mijë lekë dhe 2 të tjera janë në proces në vlerën e mbetur prej 1,493 mijë lekë;

Investime me burim nga të ardhurat e veta/bashkia janë në vlerën totale të planifikuar 155,578 mijë lekë, të cilat janë paguar në vlerë të plotë.

**Konkluzion:** Mosrealizimi i buxhetit në arsyetimin e grupit të auditimit, vjen nga planifikimi i tyre në raport me planin e të ardhurave dhe jo me faktin e viteve paraardhëse, pavarësisht faktit që të ardhurat veçanërisht të ardhurat e veta, kanë ardhur në rritje nga viti në vit, veprime këto që bien ndesh me ligjet e buxhetit, Ligji nr. 67 datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” neni 36, pasi bashkia nuk duhet të planifikojë dhe realizojë procedura (investime/shërbime/blerje malli), në raport me nivelin e planifikimit të ardhurave, por mbi bazën e realizimit faktik të tyre në vitet paraardhëse.

- Përsa i përket situatës së pandemisë, nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion rezultoi se Bashkia Librazhd gjatë vitit 2024 nuk ka patur fonde të planifikuara dhe rrjedhimisht as të shpenzuara për nevoja specifike të situatës.

2.4.Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të pa likuiduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve; (Faturat e pa likuiduara të shoqërohen me listë analitike, të detajuara me numër fature dhe datë krijimi etj., sipas raportimit në MF, ku të evidentohen detyrimet nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si Ministrinë e linjës etj.).

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet duhet të kenë detyrimet e papaguara të vitit paraardhës (progresive). Me fondet e vitit buxhetor ushtrimor apo me fondet e trashëguara, janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të pa likuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale sipas çeljeve të fondeve nga rritja e limitit nga të ardhurat për shpenzimet e përballuara me fondet e veta, ndërsa për investimet e financuara nga Ministrinë e linjës apo FZHR dhe nga fondet e vet Bashkisë Librazhd, është raportuar se në mbyllje të vitit 2024 ka detyrime të prapambetura në shumën 6,123,679 lekë.

Në PBA 2024-2026 dhe Planin vjetor 2024, Bashkia Librazhd nuk ka planifikuar fonde në programin e dedikuar për detyrimet e prapambetura 04960, me qëllim mos lënien jashtë buxhetimit programin “likujdimi i detyrimeve të prapambetura”<sup>4</sup>.

<sup>4</sup> Sic është përmendur edhe më lart, në PBA 2023-2025, nuk është planifikuar veçmas fond në buxhet për programin 04960 “detyrime të parametria”, referuar Udhëzimit të MF

- Situata e detyrimeve të papaguara nga vitet paraardhëse në buxhetet respektive për vitin 2024, paraqitet në pasqyrën e mëposhtme:

Tabela nr. 15/Në lekë

Detyrime e NJQV	Detyrimi në fillim të vitit i mbartur 31.12.2023	Detyrimi i krijuar gjatë vitit 2024	Total detyrime	Pagesa gjate vitit 2024	Mbetja në fund të vitit 2024
a	1	2	3=1+2	4	5=3-4
a. Investime nga Ministrinë e linjës					
b. Investime nga Bashkia	1,752,449	6,023,679	7,776,128	1,752,449	6,023,679
<b>Investime</b>					
Mallra dhe shërbime	283,300	100,000	383,300	283,300	100,000
Vendime gjyqësore	7,754,561	-	7,754,561	5,664,011	2,090,550
Të tjera ...					
<b>Totali</b>	<b>2,035,749</b>	<b>6,123,679</b>	<b>8,159,428</b>	<b>2,035,749</b>	<b>6,123,679</b>

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në *tabelën nr.15*, **rezulton se:**

- Për zërin "investime" viti 2023 është mbyllur me vlerën totale të detyrimit të prapambetur prej 1,752,449 lekë, të cilat në masën 100% janë detyrime për investime nga fondet e Bashkisë; Gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën totale 6,123,679 lekë e cila i përket investimeve & mallra e shërbime nga të ardhurat e bashkisë, duke e çuar vlerën totale të detyrimeve të prapambetura në shumën 8,159,428 lekë;

Gjatë vitit 2024 janë shlyer në total 2,035,749 lekë për detyrimet e prapambetura progresive ose në masën 25% të totalit të detyrimeve të prapambetura;

- Detyrimet e prapambetura që kanë si *burim financimi buxhetin e bashkisë* deri në 31.12.2023 janë në vlerën 9,790,530 lekë dhe përbëhet nga: detyrime për "procese gjyqësore" në vlerën 7,754,561 lekë, detyrime për "investime" 1,752,449 lekë, detyrime për "mallra" në vlerën 283,300 lekë;

- Gjatë vitit 2024 janë paguar 7,699,760 lekë, duke e likuiduar në masë të plotë detyrimin progresiv të vitit 2023 ose 100% të fondit të planifikuar për likuidim ndaj detyrimeve "për investime" dhe për "mallra", ndërsa në masën 73% nga detyrimet "për proceset gjyqësore";

- Gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja në vlerën totale 6,123,679 lekë që përfshin: detyrime për "investime" 6,023,679 lekë dhe detyrime për "mallra" në vlerën 100,000 lekë;

- Detyrime të prapambetura që kanë si *burim financimi buxhetin e shtetit/granti* Bashkia Librazhd nuk ka.

Informacion i përmbledhur mbi detyrimet nga Vendimet gjyqësore të likuiduara gjatë viti 2024 si në tabelat e mëposhtme:

Tabela nr. 17/në lekë

Emri i kreditorit	Vendim Gjykatë nr. datë	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit te Gjykatës	Gjendja e palikujduara 31/12/2023	Vendime të ardhura gjatë vitit 2024		Likujduar gjate vitit 2024	Mbetja date 31.12.2024
					Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit		
1	2	3	4	5	6	7	8	9=5+7-8
Ruzhdije Alla	Nr.874 dt 14.04.2020	Pushim nga puna	Ne proces Gjyqsore				1,000,000	
Petrit Gega	Nr.(82-2023-47) 52 dt 14.02.2023	Pushim nga puna	64,800				64,800	
<b>Totali</b>			<b>1,064,800</b>				<b>1,064,800</b>	

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd

Tabela nr. 18/në lekë

Emri i kreditorit	Vendim Gjykatë nr. datë	Objekti i Vendimit	Vlera e detyrimit sipas Vendimit te Gjykatës	Gjendja e palikujduara 31/12/2023	Vendime të ardhura gjatë vitit 2024		Likujduar gjate vitit 2024	Mbetja date 31.12.2024
					Nr dhe data e vendimit	Vlera e vendimit		
1	2	3	4	5	6	7	8	9=5+7-8
Rrahman Gjeta	Nr.521 dt 02.03.2010	Kompesim pasurie	3,344,881				3,344,881	-

Lumturie Koçi	Nr.521 dt 02.03.2010	Kompesim pasurie	1,114,960			975,590	139,370
Shpetim Dosku	Nr.521 dt 02.03.2010	Kompesim pasurie	1,114,960			278,740	836,220
Sami Gjeta	Nr.521 dt 02.03.2010	Kompesim pasurie	1,114,960				1,114,960
<b>Totali</b>	<b>4</b>		<b>6,689,761</b>		<b>-</b>	<b>4,599,211</b>	<b>2,090,550</b>

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd

Nga analiza e detajuar e informacionit të pasqyruar në tabelat e mëposhtme, rezultoi se:

- Vlera totale e detyrimit të prapambetur për "pushimet nga puna" është 1,064,800 lekë për 2 raste dhe likuiduar në masë të plotë gjatë vitit 2024, në zbatim të Vendimit të Gjykatës;
- Vlera totale e detyrimit të prapambetur për "kompesim pasurie" është 6,689,761 lekë për 4 raste, paguar në vitin 2024 vlera 4,599,211 lekë ose në masën 68.8% dhe mbetur për likuidim vlera 2,090,550 lekë ose 31.2% e totalit.

- Mbi pagesat e vendimeve gjyqësore për dëmshpërblim page punonjësve të larguar nga puna

Tabela nr.19/Në lekë

Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2024	Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2024	Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura gjatë vitit 2024	Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura gjatë vitit 2024	Pagesa të kryera gjatë vitit 2024	Detyrimi deri më 31.12.2024
<b>2</b>	<b>1,064,800</b>	-	-	<b>1,064,800</b>	<b>0</b>

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

- Mbi pagesat e vendimeve gjyqësore për çështje të tjera të ndryshme (kompesim pronësie)

Tabela nr.20/Në lekë

Numri i vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2024	Vlera e vendimeve gjyqësore si çelje më 01.01.2024	Numri i vendimeve gjyqësore të ardhura gjatë vitit 2024	Vlera e vendimeve gjyqësore të ardhura gjatë vitit 2024	Pagesa të kryera gjatë vitit 2024	Detyrimi deri më 31.12.2024
<b>4</b>	<b>6,689,761</b>	-	-	<b>4,599,211</b>	<b>2,090,550</b>

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

Bashkia Librazhd për zbatimin e vendimeve gjyqësore gjatë vitit 2024 ka shpenzuar vlerën 5,664,011 lekë, nga e cila vlera prej 1,064,800 lekë i përket vendimeve gjyqësore me objekt "dëmshpërblim page" për largime nga puna të punonjësve për 2 raste, ndërsa vlera prej 4,599,211 lekë për 4 raste i përket vendimeve për çështje të tjera gjyqësore "kompesim pasurie", si konstatim i pavlefshmërisë absolute të procesit të pushimit nga puna, shpronësimi, etj.

Vlera totale **7,754,561 lekë** e planifikuar dhe e shpenzuar për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 në masën 73% nga buxheti i Bashkisë Librazhd për zbatimin e vendimeve gjyqësore, **u konstatua se** nuk është raportuar në MF si detyrim i prapambetur për asnjë vit buxhetor të mbyllur dhe **konsiderohet efekt financiar negativ në buxhet**.

**Konstatim:** Likuiditeti i detyrimeve të prapambetura për vendimet gjyqësore në raport me vlerën e detyrimit është i vogël dhe me hapa të ngadaltë përmirësimi, pasi shumica janë vendime për procese të nisura herët (në vitin 2010).

**Konkluzion:** Bashkia Librazhd ka detyrime të prapambetura në mbyllje të vitit 2023 në vlerën totale progresive prej 9,790,530 lekë, të cilat janë me burim financimi nga fondet e veta ose në masën 100% të vlerës totale progresive të detyrimeve;

Në mbyllje të vitit 2024 detyrimet e prapambetura janë në vlerën totale progresive 8,214,229 lekë, të cilat janë me burim financimi nga fondet e veta ose në masën 100% të vlerës totale progresive të detyrimeve;

Detyrimet e pa likuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave edhe në rrugë elektronike.

Raportimi në MF është bërë sipas udhëzimit nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, pika 106, ku citohet:

“Njësitë e vetëqeverisjes vendore janë të detyruara që **jo më vonë se data 10 Prill 2020** për tremujorin e parë, 10 Korrik 2020 për tremujorin e dytë, 10 Tetor 2020 për tremujorin e tretë dhe 30 Janar 2021 për tremujorin e katërt, të dërgojnë në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë informacionin me shkrim dhe në rrugë elektronike për detyrimet e prapambetura sipas Shtojcës 5, “Raportimi periodik për detyrimet e prapambetura” bashkëlidhur këtij udhëzimi.”<sup>5</sup>

Raportimi në Degën e Thesarit është bërë sipas Udhëzimit nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

**Konkluzion:** Bashkia Librazhd ka detyrime të prapambetura nga vitit i mbyllur ushtrimor 2024 për tu likuiduar në vitin 2025 në shumën totale 8,214,229 lekë, të ndara si më poshtë vijon:

- Bashkia Librazhd nuk ka detyrime të prapambetura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “investime” nga ministritë e linjës;
- Ka detyrime të prapambetura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “vendime gjyqësore” nga të ardhurat e veta në vlerën 2,090,550 lekë;
- Ka detyrime të prapambetura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “Investime” nga të ardhurat e veta në vlerën 6,023,679 lekë;
- Ka detyrime të prapambetura nga viti 2024 dhe trashëguar për tu likuiduar në vitin 2025 për “mallra” në vlerën 100,000 lekë;

- Programimi i fondeve për faturat e pa likuiduara në fund të periudhave ushtrimore:

Nga auditimi i PBA 2024-2026 plani vjetor 2024, referuar edhe tabelës së programeve buxhetore të planifikuara, rezultoi se nuk është planifikuar veçmas fondi në programin 04960 “planifikim për detyrimet e prapambetura”.

Nga auditimi i likuiditeteve dhe informacionit të pasqyruar në tabelën nr.25, rezulton se kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2024 në shumën 6,123,679 lekë, krahas vlerës së trashëguar nga viti 2023 në shumën totale progresive 15,914,209 lekë për “investime” dhe “mallra”. Gjatë vitit 2024 janë paguar 7,699,760 lekë duke e mbyllur vitin 2024 me një vlerë të detyrimit progresiv prej 8,214,229 lekë. Bashkia Librazhd ka dërguar rregullisht në MF “Raportet të vetëvlerësimit financiar dhe treguesit fiskalë”;

Situata e detyrimeve të prapambetura në fund të vitit ushtrimor 2024 dhe klasifikimi i bashkisë mbi shkallën e vështirësisë financiare sipas raportit vjetor të monitorimit dorëzuar në MF me shkresën nr. 1101 prot., datë 25.02.2025, është si në tabelat më poshtë:

Tabela nr. 21/në lekë

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv) 31 Dhjetor 2024	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan i rishikuar) 2024
<b>I</b>	<b>Të ardhurat e Pushtetit Vendor</b>	<b>161,575,968</b>	<b>175,506,000</b>
<b>1</b>	<b>Taksat e veta vendore</b>	32,472,641	34,322,000
a.	Taksa mbi pasurinë	19,895,221	20,171,000
b.	Biznesi i vogel	240,976	320,000
c.	Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	11,683,294	13,302,000
d.	Taksa të tjera vendore	653,150	529,000
<b>2</b>	<b>Të ardhura jotatimore</b>	99,673,340	116,616,000
a.	Tarifat e shërbimeve publike	73,343,101	102,716,000
b.	Tarifa administrative	0	0
c.	Të tjera jo tatimore	26,330,239	13,900,000
<b>3</b>	<b>Taksa të ndara</b>	29,429,987	24,568,000
a.	Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme	340,037	200,000
b.	Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura	15,320,971	14,000,000
c.	Renta minerare	139,225	368,000

<sup>5</sup> Në raportimet e bëra respektohet viti ushtrimor në të cilin realizohen shpenzimet vjetore të planifikuara në PBA

Nr.	E M E R T I M I	Vlera për periudhën e raportimit (Fakt progresiv) 31 Dhjetor 2024	Vlera e Buxhetit vjetor (Plan i rishikuar) 2024
d.	Tatim mbi të ardhurat personale	13,629,754	10,000,000
e.	Të tjera	0	0
<b>II</b>	<b>Shpenzime te Buxhetit Vendor</b>	<b>671,256,820</b>	<b>822,390,640</b>
<b>1</b>	<b>Shpenzime Korrente</b>	<b>486,067,622</b>	<b>572,132,960</b>
a.	Paga dhe fond i veçantë për paga	293,785,024	333,841,158
b.	Kontributi për Sigurime Shoqërore	47,101,728	51,605,907
d.	Shpenzime Operative	119,017,657	158,385,543
e.	Të tjera korrente	26,163,213	28,300,352
<b>2</b>	<b>Shpenzime Kapitale</b>	<b>185,189,198</b>	<b>250,257,680</b>
<b>3</b>	<b>Burimet e Financimit</b>	<b>671,256,820</b>	<b>822,390,640</b>
a.	Të ardhurat e veta vendore	127,274,759	175,506,000
b.	Transferata e pakushtëzuar	385,060,784	445,979,994
c.	Transferata specifike/transferata e pakushtëzuar sektoriale	157,179,385	181,291,409
d.	Të ardhurat e pa-planifikuara (jashtë limit)	1,741,892	19,613,237
f.	Financimi i huaj		
g.	Huamarrja Vendore Vjetore		

Burimi: Bashkia Librazhd.

Ndërsa niveli i vështirësisë financiare i Bashkisë Librazhd është në tabelën 23, si më poshtë:

Tabela nr.22/Në lekë

N.R	Emërtimi	Stoku në vlerë	Shpenzime vjetore faktike për NJVQV-në	Stoku/Shpenzime vjetore faktike të NJVQV-së
<b>I</b>	<b>Borxhe (a+b)</b>	<b>0</b>		
<b>a</b>	<b>Hua afatgjatë</b>	<b>0</b>		
a,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
a,2	Tituj të emetuar			
a,3	Garanci për të tretë			
<b>b</b>	<b>Hua afatshkurtër</b>	<b>0</b>		
b,1	Marrëveshje financimi (kredi, qira financiare, overdraft etj)			
b,2	Tituj të emetuar			
b,3	Garanci për të tretë			
<b>II</b>	<b>Detyrimet e prapambetura</b>	<b>6,123,679</b>		<b>1.06%</b>
<b>Llogaria ekonomike</b>	<b>Emërtimi</b>			
4864100	Vendime Gjyqesore	2,090,550		
4864200	Det.Prap. Sherbime	100,000		
4864201	D.P.EneriElektrike			
4864300	Det.Prap.Mirembajtje			
4864400	Det.Prap. Investime	6,023,679		
4864500	Det.Prap.Rimbursi.TVSH			
4864600	Mallra			
4864900	Det.Prap.Te Tjera			
4864601	Det.Prap.Sig.Shoqerore			
4864602	Det.Prap.Sig.Shendet			
4864603	Det.Prap.Ardh.Personal			
4864604	Det.Prap.Tatime Tjera			
4864901	Paga			
4864902	Shpronosime			
4864903	Trans.indiv			
4864904	Trans.Subjektet			
<b>III</b>	<b>Totali (I+II)</b>	<b>8,214,229</b>	<b>777,175,540</b>	<b>1.06%</b>

Ndërsa për ministrinë e linjës vlera e detyrimit të prapambetur, e raportuar në Raportin e monitorimit në MF nga bashkia Librazhd është në tabelën 26, si më poshtë vijon:

Tabela nr. 23/Në lekë

Detyrime Pushteti qendror		Llogaria ekonomike	Vlera
Ministri linje 06		4864400	-
Ministri linje 16		4864903	-
Ministri linje 11		4864400	-
<b>Totali</b>			<b>0</b>

Tabela nr. 24

Rasti i vështirësisë ku ndodhet njësia e vetëqeverisjes vendore 2024						
Situata Normale e gjendjes fiannciare	Probleme financiare		Vështirësi financiare		Vështirësi serioze financiare	Paaftësi paguese
		Stoku detyrimeve/Shpenzime > 15%		Stoku detyrimeve/Shpenzime > 25%		Stoku i borxhit afatgjat dhe detyrimeve/Shpenzime > 80%
<b>1.06% normale</b>						

Burimi: Bashkia Librazhd

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën 24 dhe i raportuar në MFE, rezulton se Bashkia Librazhd paraqet një situatë normale të vështirësisë financiare.

Nr.	Bashkia Librazhd	Detyrimi i mbetur deri në dhjetor 2024	Shuma e parashikuar për shlyerje përgjatë tre viteve			Diferencë (Fakt-Plan)	Shënime
			Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027		
1	Ndertim I shkolles se mesme Polis	5,960,007	5,960,007	0	0	0	
2	Pyllëzime në sipërfaqet pyjore	63,672	63,672				
3	Plan studimor tregu	100,000	100,000				
4	Likuidim për V.Gjyqësore	2,090,550	2,090,550				pa raportuar
	<b>Totali</b>	<b>8,214,229</b>	<b>8,214,229</b>				

Tabela nr. 25

- Nga dokumentet e pagesave të bankës u kërkuan dhe u verifikuan disa Urdhër Shpenzime.

Nga auditimi rezultoi se dokumentacioni justifikues bashkëlidhur Urdhër Shpenzimit, ishte i plotë.

Detyrimet e palikuiduara janë raportuar në mënyrë periodike pranë Ministrisë së Financave, të cilat referuar edhe të dhënave të MF me shkresën nr. nr. 1101 prot., datë 25.02.2025 rubrika “Detyrimet e prapambetura”, sipas viteve dhe llojeve të detyrimeve të grupuara në raportet vjetore të detyrimeve të prapambetura, janë paraqitur në Tabelat /21, 22; Në mënyrë të detajuar paraqiten në Aneksin 2.2.15.

Për sa më sipër trajtuar, përgjegjësi kryesorë për veprimet apo mosveprimet i ngarkohet Titullarit të bashkisë, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues, Koordinatorit të MFK dhe Koordinatorit të Riskut, GMS dhe Koordinatorit GMS dhe Drejtorit të Financës dhe Buxhetit, përgjegjësit të SB, përcaktuar në Ligjin nr. 10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, neni 8; neni 10, neni 11, neni 12; Udhëzim nr. 16, datë 20.7.2016 për “Përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Udhëzim nr. 21, datë.25.10.2016 për “Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”, “Rregullore e Brendshme e Funkcionimit të Bashkisë Librazhd dhe Njësisve Administrative”.

**Nënpika 2.2.5. Burimi i krijimit të të ardhurave. Planifikimi dhe realizimi i të ardhurave. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifrat, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Evidentimi i detyrimeve të pa arkëtuara progresive dhe për secilin vit buxhetor sipas programit të auditimit.**

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- Vendimi i Këshillit Bashkiak nr.108 datë 30.11.2023 “Për miratimin e taksave dhe tarifave vendore, për vitin 2024”;
- Urdhri i Kryetarit nr. 9 datë 04.01.2024 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Librazhd” i ndryshuar;
- Vendimi i Këshillit Bashkiak nr. 119 prot., datë 29.12.2023 "Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm PBA 2024-2026 dhe buxhetin e vitit 2024".
- Konfirmimet për përputhshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Elbasan;
- Dokumentacioni i Sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së sistemit të taksave;
- Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifave vendore;
- Pasqyrat financiare për vitin 2024.
- Miratimet e buxheteve në lidhje me planifikimin e të ardhurave për vitin 2024;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacioni në lidhje me agjentët tatimorë, rakordimet me ta, me thesarin, etj.;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e të Ardhurave Vendore/tatim-taksave.
- Struktura/t organizative e miratuar gjatë periudhës 01.01.2024-31.12.2024;
- Rregullore e brendshme institucionale e miratuar;

Bashkia Librazhd - Viti 2024						
Qarku	Qendra e Bashkisë	Nr.	NJ Administrative	Fshatrat Nr.	Nr. Banorë	Klasifikim taksapagues
Elbasan	Librazhd	1	Librazhd	-	44,181	661 BV
		2	Qendër Librazhd	14		
		2	Lunik	7		149 BM
		4	Orenjë	11		
		5	Stëblevë	7		36 Insitucione
		6	Hotolisht	8		
		7	Polis	6		6102 familje
<b>Totali</b>		<b>7</b>		<b>53</b>		

Punoi: Grupi i auditimit

## **2.6/1 Burimi i Krijimit të të Ardhurave**

- *Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore*

Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024, struktura organizative është miratuar me Urdhrin nr. 9 datë 04.01.2024 “Për miratimin e Strukturës Organizative të Bashkisë Librazhd”. Me VKB nr. 108 datë 30.11.2023 është miratuar Paketa Fiskale 2024 dhe konfirmuar për përputhshmëri ligjore nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 1296/1 prot., datë 15.12.2023, konform kuadrit ligjor në fuqi.

Si njësi përbërëse e strukturës organizative të Bashkisë Librazhd është edhe struktura e të Ardhurave Vendore e organizuar në nivel Drejtorie/DFBTT/Sektori i Tatim Taksave, i cili është konfiguruar si në tabelën e mëposhtme (tabela 1). Ky sektor në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave, bashkëpunon edhe me sektorë të tjerë pranë bashkisë, si: Drejtoria e Planifikimit Territorit dhe Urbanistikës [DPTU], MZSH, Policia Bashkiake [PB], Sektori i Aseteve etj, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, ndërsa roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim dhe gjobat e vendosura, dokument i cili i shërben taksapaguesve për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtimit/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

Tabela nr. 1

Drejtoria e Taksa e Tarifa Vendore – viti 2024					
Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni në strukturë	Profili Arsimit	Niveli	Periudha në pozicionin e punës
1	L Sh	Drejtor	Ekonomik	Lartë	
2	E K	Përgjegjës	Administrim biznes	-/-	02.05.2028

Drejtoria e Taksa e Tarifa Vendore – viti 2024					
Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni në strukturë	Profili Arsimit	Niveli	Periudha në pozicionin e punës
3	M G	Specialist	Ekonomik	-/-	18.01.2019
4	E F	Specialist	Menaxhim agrobiznes	-/-	01.01.2023
5	E C	Specialist	Ekonomi dhe e drejta	-/-	30.01.2019
6	A T	Specialist	Administrim biznes	-/-	18.10.2021
7	G H	Specialist	Inxhinieri Mbrojtje mjedisi	-/-	23.11.2023
8	G T	Specialist	Marketing	-/-	01.08.2019
	Për NJA				
1	A Q	Specialist NJA Hotolisht	mesem	mesëm	20.02.2017
2	H Sh	Specialist NJA Lunik	Ekonomik	Lartë	26.10.2015
3	I Gj	Specialist NJA Qender	Mesem ekonomik	mesëm	01.07.2020
4	H H	Specialist NJA Stëblevë			
5	E G	Specialist NJA Orenjë			
6	A C	Specialist NJA Polis			

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

- Drejtoria e Taksave Vendore dhe tregjeve/Bashkia Librazhd, për vitin 2024 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore. Veç Sektorit të Taksave vendore dhe tregjeve, në Bashkinë Librazhd janë të angazhuara edhe struktura të tjera për faturimin dhe/ose mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, të miratuara me VKB e Paketës Fiskale 2024, sipas specifikave si më poshtë vijon:

Tabela nr. 2

Struktura	Lloji i të ardhurës
Drejtoria/Sektori i Tatimeve dhe Taksave Vendore dhe tregje	Taksat dhe tarifave vendore për biznesin dhe familjarët Leje e licencat Rakordimet për taksat e ndara
Specialist i tregjeve	Taksat dhe tarifave ne treg
Drejtoria e Urbanistikës	Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale
	Taksën e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi
	Certifikatë përdorimi etj
Sektori i Bujqësisë,	Qira e tokës Bujqësore
	Taksa nga Toka bujqësore
Sektori Aseteve	Kontratave e qirasë
Drejtoria e Pyjeve e Kullotave	Kontratave e kullotave verore e dimërore
IMTV	Gjoha për ndërtime pa leje etj
MZSH	Tarifa shërbimesh
Policia Bashkiake	Gjoha kundërvajtjeje

Burimi: Bashkia Librazhd/ Punoi: Grupi i auditimit

Në tabelën/Aneks TA/I pasqyrohen të gjitha kategoritë e taksave dhe tarifave vendore si dhe strukturat përgjegjëse të përlllogaritjes dhe vjeljes së tyre në Bashkinë Librazhd. Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën/Aneks TA/I rezultojnë se:

- Bashkia Librazhd në paketën fiskale 2024 me VKB ka miratuar 8 gruptaksash dhe 12 gruptarifash; 28 lloje Gjobash dhe 4 lloje TA jotatimore;
- Afati fundor i pagesës së taksave dhe tarifave të vitit ushtrimor për biznesin dhe për familjarët është e përcaktuar në paketën fiskale të vitit 2024 të miratuar.
- DTTV Bashkia Librazhd informacionin tatimor e përpunon në paketën në programin e taksave vendore dhe në *Microsoft Office 2013* - programi *Excel*.
- Rezultojnë se nga ana e DTTV çdo fillim viti me Urdhër të Kryetarit bëhen verifikime në terren, lidhur me veprimtarinë e subjekteve që ushtrojnë biznes mbi hapësirën e lejuar publike, tabelën apo reklamën për të cilat paguan edhe tarifë të detyrueshme vjetore, shpërndan fletë njoftimit mbi detyrimet etj.,.

Për vitin 2024 ka disa urdhra për verifikimin në terren si :

- Urdhri Nr. .17, datë 08.01.2024 “ Për caktimin e personave përgjegjës sipas zonave të biznesit”
- Urdhri Nr. 18, date 08.01.2024 “Për matjen e hapësirave publike “
- Urdhri Nr. 19, date 08.01.2024 “Për verifikimin në terren për popullimin e (Kadastrës Fiskale )

- Urdhri Nr. 26, date 10.01.2024 “ Për matjen e tabelave dhe shërbimit Hotelier për subjektet private .

Për rastet e konstatimit të ndryshimeve mbahen akt konstatime/verifikime dhe përditëson dokumentacionin e subjekteve taksapagues të taksave dhe tarifave vendore, rillogaritje e vlerës së tarifës/taksës së re dhe klasifikimin në nivel tjetër detyrimesh. Kjo praktikë realizohet nga DTTV. Për vitin 2024 nuk ka raste rivlerësimi tatimor.

### **2.6/2 Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llojeve**

“Paketa fiskale 2024” është miratuar me VKB nr. 108 datë 30.11.2023 dhe konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan me nr. 1296/1 prot., datë 15.12.2023, konform kuadrit ligjor në fuqi. Referuar VKB nr. 119 datë 29.12.2023 dhe me nr. 34/4 prot., datë 04.01.2024, plani i të ardhurave në PBA 2024-2026 është miratuar sipas informacionit të pasqyruar në tabelë:

*Tabela nr.3*

<b>Plani i të Ardhurave në Bashkinë Librazhd sipas PBA 2024-2026</b>			
Emërtimi i të Ardhurave	Viti 2024	Viti 2025	Viti 2026
<b>Të ardhura nga taksat e tarifa vendore</b>	<b>175,506,000</b>	179,420,000	187,559,000
- tatimore	58,890,000	60,982,000	67,302,000
- jo tatimore	116,616,000	118,438,000	120,257,000
Grant i pashpërndarë nga viti 2023	45,086,025		
Të ardhura të trashëguara nga viti 2023	2,934,278		
Të ardhura nga transferta e pakushtëzuar	388,802,215	330,723,278	330,723,278
Transferta sektoriale	170,471,582	157,075,162	157,075,162
<b>Totali i të ardhurave</b>	<b>782,800,100</b>	<b>667,218,440</b>	<b>675,357,440</b>

*Burimi: Bashkia Librazhd*

Nga të dhënat e pasqyrës përmbledhëse/ Aneks 2.2.5.2, rezulton se rezulton se për vitin 2023 të ardhurat nga taksat dhe tarifatat (pa përfshirë grantin e qeverisë dhe sponsorizimet) janë realizuar në vlerën 143,226 mijë lekë ose në masën 84.4%; për vitin 2024 janë realizuar në vlerën 149,931 mijë lekë ose në masën 85.4%. Rezulton se nga viti 2023 në vitin 2024 ka patur një rritje të të ardhurave në total prej 6,705 mijë lekë ose me 105%, ku përjashtim bëjnë të ardhurat nga “tarifat vendore” [TTV] që kanë rënie me (-)677 mijë lekë dhe të ardhurat nga “tarifat e sektorit të pyjeve e kullotave” [TTPK] me (-)11,954 mijë lekë.

Nga analiza e të dhënave në Aneks 2.2/5.2, rezulton se:

- Për vitin 2024, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 175,506 mijë lekë ose 5,745 mijë lekë më shumë se të viti 2023 dhe janë realizuar në vlerën 149,930 mijë lekë ose 6,705 mijë lekë më shumë se viti 2023 dhe 25,575 mijë lekë më pak se planifikimi i tyre në vitin 2024;

Realizimi i të ardhurave të veta në total për vitin 2023 është në masën 84.4%; ndërsa për vitin 2024 është në masën 85.4%;

#### **➤ Analizë e planifikimit të të ardhurave dhe e realizimit të tyre për vitin 2024**

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë, vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksat/tarifatat të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk është planifikuar vlerë për t'u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën përmbledhëse rezulton si mëposhtë vijon:

#### **Kategoria I**

- TNI (ndërtimet e reja) për vitin 2024 është parashikuar në vlerën 10,302 mijë lekë dhe është realizuar 9,145.4 mijë lekë ose 89% e vlerës së planifikimit, me 6,455 mijë lekë më shumë se në vitin 2023;

- TNI (nga legalizimet) për vitin 2024 është parashikuar në vlerën 3,000 mijë lekë dhe është realizuar 2,537 mijë lekë ose 85% e vlerës së planifikimit, me (-)1,172 mijë lekë më pak se në vitin 2023;
- Taksë e ndërtesës është parashikuar në shumën 14,000 mijë lekë dhe është vjelë 16,609 mijë lekë ose në masën 118.6% të saj, vlera e së cilës ka ardhur në rritje me 26,095 mijë lekë më shumë se në vitin 2023 ,duhet theksuar fakti që planifikimi i kësaj takse në vitin 2024 është 20,000 mijë më pak se ajo e vitit 2023;
- Taksa e tokës bujqësore është parashikuar në vlerën 5,559 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 2,663 mijë lekë ose në masën 48%, krahasuar me vitin 2023 ka një rritje prej 66 mijë lekë ;
- Taksë trualli është parashikuar në vlerën 612 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 623 mijë lekë ose në masën 102%, me një rënie të ardhurash prej (-)32 mijë lekë nga viti 2023;
- Taksë tabele është parashikuar në vlerën 355 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 485 mijë lekë ose në masën 137%, krahasuar me vitin 2023 rezulton me rritje në vlerën 155 mijë lekë;
- Taksë e mjeteve në qarkullim është parashikuar në vlerën 14,000 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 15,321 mijë lekë ose në masën 109%, krahasuar me vitin 2023 është rritur me 1,963 mijë lekë më shumë;
- Taksë fjetje në hotel për vitin 2024 është planifikuar 174 mijë lekë dhe është vjelë 168 mijë lekë ose në masën 104%, krahasuar me vitin 2023 është rritur me 63 mijë lekë më shumë ;
- Taksë e kalimit të të drejtës së pronësisë për vitin 2024 është planifikuar 200 mijë lekë dhe është vjelë 340 mijë lekë ose në masën 170%, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie prej (-)616 mijë lekë;
- Taksë e rentës minerare për vitin 2024 është në planifikuar 368 mijë lekë dhe është vjelë 139 mijë lekë ose në masën 37.8%, krahasuar me vitin 2023 është rritur me 29 mijë lekë;

#### **Kategoria II**

- Të ardhura nga tarifa e pastrimit për vitin 2024 janë planifikuar 19,500 mijë lekë dhe janë realizuar 22,174 mijë lekë ose në masën 126%, krahasuar me vitin 2023 ka një rritje në realizimin e të ardhurave me 4,623 mijë lekë ;
- Tarifë e tregut të organizuar për vitin 2024 është planifikuar 1,250 mijë lekë dhe janë realizuar 1,038 mijë lekë ose në masën 83%, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie në realizimin e të ardhurave me (-)43 mijë lekë më pak;
- Tarifë parkimi për vitin 2024 është planifikuar 1,326 mijë lekë dhe realizuar 1,311 mijë lekë ose në masën 98.9%, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie me (-)142 mijë lekë më pak;
- Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës për vitin 2024 është planifikuar 370 mijë lekë dhe realizuar 252 mijë lekë ose në masën 68%, krahasuar me vitin 2023 është rritur me 120 mijë lekë ose me 47.6%;
- Tarifë urbanistike për vitin 2024 është planifikuar 1,683 mijë lekë dhe është realizuar 573 mijë lekë ose në masën 34%, krahasuar me vitin 2023 ka ardhur në rritje prej 19 mijë lekë;
- Të ardhura nga tarifa e ndriçimit dhe e gjelbërimit janë planifikuar 3,570 mijë lekë dhe janë realizuar 3,777 mijë lekë ose 144%, krahasuar me vitin 2023 ka një rritje 1,153 mijë lekë;

#### **Kategoria III**

- Të ardhura nga tarifa në sektorin e pyjeve për vitin 2024 është planifikuar 23,000 mijë lekë dhe realizuar 15,763 mijë lekë ose në masën 68.5%, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie të të ardhurave me (-)1,057 mijë lekë;
- Të ardhura nga tarifa shfrytëzimi i materialit drusor nga subjektet për vitin 2024 është planifikuar 10,000 mijë lekë dhe realizuar 4,317 mijë lekë ose në masën 43.2%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-)10,173 mijë lekë;

- Të ardhura nga tarifa shfrytëzimi i druve të zjarrit nga fshatarësia për vitin 2024 është planifikuar 5,600 mijë lekë dhe realizuar 1,565 mijë lekë ose në masën 28%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-)1,018 mijë lekë;
- Të ardhura nga tarifa shfrytëzimi i prodhimeve te dyta pyjore, te tjera është planifikuar 300 mijë lekë dhe realizuar 97 mijë lekë ose në masën 32.4%, krahasuar me vitin 2023 ka ardhur në rënie me 154 mijë lekë;
- Të ardhura nga përdorimi vërtetimeve të transportit dok. Ankandi rap teknik etj, për vitin 2024 është planifikuar 620 mijë lekë dhe realizuar 257 mijë lekë ose në masën 58%, krahasuar me vitin 2023 ka ardhur në rënie me (-)188 mijë lekë;
- Të ardhura nga shitja e materialit drusor që dalin nga rrallimet për vitin 2024 është planifikuar 200 mijë lekë (sa edhe viti paraardhës 2023) dhe realizuar 0 lekë si dhe viti 2023;

#### **Kategoria IV**

- Të ardhura nga qira e shitje trualli për vitin 2024 nuk janë planifikuar vlera dhe nuk janë realizuar të ardhura, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie të ardhurave me (-)357 mijë lekë ;
- Të ardhura nga qera ndërtese janë planifikuar 467 mijë lekë dhe realizuar 467 mijë lekë ose në masën 99.5%, krahasuar me vitin 2023 ka rënë me (-)2 mijë lekë më pak;
- Të ardhura nga pagesa e prindërve çerdhe për vitin 2024 është planifikuar 2,190 lekë dhe realizuar 1483 mijë lekë ose në masën 67.7%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-)32 mijë lekë;
- Të ardhura nga pagesa e prindërve kopsht për vitin 2024 është planifikuar 7,744 mijë lekë dhe realizuar 4,857 mijë lekë ose në masën 62.7%, krahasuar me vitin 2023 ka rënie me (-)175 mijë lekë;
- Nga detyrime të prapamb kopshte/ çerdhe/qendra ditore janë planifikuar 1,849 mijë lekë dhe realizuar 801 mijë lekë ose në masën 43.3%, krahasuar me vitin 2023 ka rritje me 484 ,ijë lekë;
- Të ardhura nga sponsora, dhurata janë realizuar 18,645 mijë lekë ose 10,629 mijë lekë më shumë se viti 2023;

Mungesa e një analize të mirëfilltë për të ardhurat e (mos)realizuara në vitin 2023, ka sjellë mungesën e planifikimit të tyre ose planifikimin në vlera jo reale të pastuduara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë.

- Gjithashtu, nga auditimi *rezulton se* procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore realizohet jo vetëm në analizën e të dhënave dhe trendi i realizimit të të ardhurave nga vitet paraardhëse, por edhe nga kërkesat që DTTV dhe DFB iu ka përcjellë për informacion njëjësive të strukturës së Bashkisë që sigurojnë të ardhura, për të grumbulluar një informacion sipas, realizimit të të ardhurave të 2 viteve të fundit për hartimin e paketës fiskale për vitin 2023.

Mungesa e një analize të mirëfilltë për të ardhurat e mosrealizuara në vitin 2023, ka sjellë mungesën e planifikimit të tyre ose planifikimin në vlera jo reale të pastuduara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë për vitin pasardhës (objekt auditimi) 2024.

- Gjithashtu, nga auditimi *rezulton se*, procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore realizohet jo vetëm në analizën e të dhënave dhe trendi i realizimit të të ardhurave nga vitet paraardhëse, por edhe nga kërkesat që DTTV dhe SFB iu ka përcjellë për informacion njëjësive të strukturës së Bashkisë që sigurojnë të ardhura, për të grumbulluar një informacion sipas, realizimit të të ardhurave të 2 viteve të fundit për hartimin e paketës fiskale për vitin 2023.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit *konstatoi se*, metodologjia e përdorur nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmërinë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Veprime këto në mospërputhje me Rregulloren e

brendshme të institucionit, neni - "detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit të taksa, tarifa, tregje", "detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit të sektorit të taksa, tarifa, tregje" dhe "detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të taksa, tarifa, tregje".

➤ **Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:**

Konstatohet se në Rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar, në strukturën e STTV apo në atë të SF, nuk është caktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët tatimorë dhe mbajtjen e aktrakordimeve me agjentët tatimorë, si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët.

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor/DRSHTRR Elbasan", për llogari të Bashkisë Librazhd. Akt rakordimi me DPSHTRR është i përmuajshëm dhe realizohet nëpërmjet komunikimit elektronik dhe verifikimit në Degën e Thesarit Librazhd, referuar dhe në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar dhe në mbështetje të germës "b", të pikës 2, në nenin 25 "Të ardhurat nga taksat e ndara" të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njërive përkatëse i kalojnë 25% e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura.

2. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Elbasan". Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 "Për tatimin e thjeshtuar të biznesit të vogël" Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtorive Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qendrore, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Në Bashkinë Librazhd rakordimet bëhen nga Sektori i Financës dhe buxhetit. Me ndryshimet në kuadrin ligjor Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin nuk vilet, shfuqizuar me Ligjin nr. 29/2023, datë 30.03.2023.

3. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mblidhet nga Agjenti Tatimor "Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme" (ZVRPP) tani ASHK Vendore. ASHK Vendore ka patur bashkëpunim me STTV/Bashkinë Librazhd, për dërgim informacioni mbi numrin e kalimeve të pronësisë, vlerën totale të tyre me qëllim rakordimin e vlerës së derdhur nëpërmjet Degës së Thesarit Librazhd me vlerën e përlllogaritur. Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme tani ASHK Rajonale, janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 3% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë jo me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogari të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria.

Nga auditimi rezulton se deri në 31.12.2024 rakordimet me DPSHTRR dhe ASHK Vendore, janë kryer sipas formateve të miratuara nga MFE.

4. Grupi i auditimit verifikoi në Regjistrin e lejeve minerare aktive të AKBN-së (Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore)<sup>6</sup>, dhe rezultoi se janë dhënë leje shfrytëzimi minerar në territorin e Bashkisë Librazhd si në tabelën/ Aneks TA3.

<sup>6</sup> <http://ëëë.akbn.gov.al/regjistri-i-lejeve-minerare-aktive-shkurt-2023>

Nga auditimi *rezulton* se:

- Në territorin e Bashkisë Librazhd janë dhënë 16 leje minerare, nga të cilat janë aktive vetëm 13 subjekte<sup>7</sup>;

- Nga Bashkia Librazhd *rezulton* se nuk bëhen rakordimet mujore për vjeljen e rentës minerare me DPD dhe DPT, por informacioni mbi arkëtimet e saj merret nëpërmjet Degës së Thesarit.

Për vitin 2024 të ardhurat nga renta minerare janë në shumën 139,225 lekë

5. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) rezultojnë se Bashkia Librazhd ka lidhur marrëveshje me Shoqërinë Rajonale Ujësjellës Kanalizime-sha Elbasan [SHRUK] me nr. 1731 prot., date 09.04.2024 për Bashkinë Librazhd dhe me nr. 886 prot., date 08.04.2024 për SHRUK Elbasan sha, për të luajtur rolin e agjentit tatimor miratuar me VKB nr. 33 datë 29.03.2024 dhe me nr. 1626/4 prot., date 03.04.2024, në zbatim të ligjit nr. 9632/2006 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” të ndryshuar.

*Rezulton* se:

- Vendimet e Këshillit Bashkiak janë konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Elbasan;

- Janë mbajtur Akt rakordimet me SHRUK Elbasan për Bashkinë Librazhd nga drejtore e DTT dhe për SHUKE nga përfaqësuesi ligjor i saj.

Tabela nr. 4

Të ardhurat nga taksat e ndara sipas VKM-ve për vitin 2024				Realizimi
Nr.	Emërtimi	Plan 000/lekë	Fakti 000/lekë	%
1	Tatimi mbi të ardhurat personale	10,000	13,630	136%
2	Takse nga Renta	368	139	37.8%
3	Taksa e regjistrimit përvitshëm të automjeteve	14,000	15,321	109%
4	Taksa e kalim të drejtës së pronësisë	200	340	170%
Shuma		24,568	29,430	

Burimi: Bashkia Librazhd/DTTV

### ➤ Detyrimet e familjarëve

#### ▪ Njoftimet e bëra për familjarët, masat e marra dhe masat shtrënguese

Shërbimi për familjet lidhur me pagesën e taksave e tarifave vendore në qytet mblidhen nga UK Rajonale Elbasan –sha ndërsa për fshatrat ofrohet në Njësitë Administrative respektive nga specialisti i ngarkuar për taksat dhe tarifave vendore për abonentët familjarë.

Për vitin 2024 është lidhur akt marrëveshja me UKR Elbasan –sha me nr. 1731 prot., datë 09.04.2024 për Bashkinë Librazhd dhe me nr. 886 prot., datë 08.04.2024 për UKR Elbasan –sha, referuar dhe në zbatim të VKB nr. 33 datë 29.03.2024 “Për caktimin e agjentit tatimor për vitin 2024”. Bashkëngjitur është lista emërore e 2545 familjeve taksapaguese me vlerën totale 7,743,600 lekë.

Paketa Fiskale e bashkisë publikohet në faqen zyrtare të saj, ku të gjithë personat e interesuar mund të marrin informacion të gjerë, në lidhje me taksat dhe tarifave vendore, nivelin e tyre, afatet e pagesave, përjashtimet përkatëse etj, por edhe në stendat e bashkisë apo Njësitë Administrative.

Shpërndarja e faturave dhe njoftimi i familjeve për detyrimet vendore, kryesisht është bërë në rrugë zyrtare me anë të shërbimit postar, por edhe dorazi nëpërmjet punonjësve të terrenit, me qëllim njoftimin e taksapaguesve për të paguar në kohë detyrimin. Për vjeljen e detyrimeve të familjarëve (taksa e ndërtesës, ndriçim, gjelbërim, pastrim) Bashkia Librazhd ka lidhur marrëveshje me UK sha për të luajtur rolin e agjentit tatimor vetëm për në qytet, në Njësitë Administrative vjelja e taksa e tarifave sigurohet nga specialistët e taksave të vet NJA.

Për shërbimet që qytetarët kërkojnë të kryejnë në bashki, në çdo rast kërkohet vërtetimi i shlyerjes së detyrimeve, nëpërmjet librezës së taksave vendore, me synim ndërgjegjësimin e tyre për pagesën e taksave dhe tarifave vendore në mënyrë vullnetare. Sa më sipër kjo nuk

<sup>7</sup> Tre subjektet me nr. 323,nr. 328 dhe nr. 375 janë pezulluar

është e vetmja masë shtrënguese e aplikuar për vjeljen e detyrimeve të papaguara nga komuniteti, pasi janë bërë njoftimet në bankat e nivelit të dytë.

- Pasqyra e familjeve të regjistruara si tatimpagues në territorin e Bashkisë Librazhd për vitin 2024 dhe detyrimi vjetor, pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 5/në lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Familje/ taksapagues 31.12.2023		Planifikimi për vitin 2024	Pagesat për vitin 2024		Familje/ taksapagues 31.12.2024	
		Nr.	Vlere		Nr.	Vlere	Nr.	Vlere
	Qyteti Librazhd	2,545	7,743,600					
1	Njësia Adm. Hotolisht	1,179	6,166,052	2,319,155	1,440,211	885	7,044,996	
2	Njësia Adm. Lunik	305	1,642,522	1,301,497	598,890	403	2,345,129	
3	Njësia Adm. Orenje	482	4,744,863	666,238	300,060	464	5,111,041	
4	Njësia Adm. Polis	620	5,514,063	2,183,933	1,160,467	742	6,537,529	
5	Njësia Adm. Stebleve	635	5,082,848	894,000	307,579	657	5,669,269	
6	Njësia Adm. Qender	1,913	16,376,000	3,957,943	2,499,634	2,518	17,834,309	
	<b>Totali</b>	<b>5,134</b>	<b>39,526,348</b>	<b>11,322,766</b>	<b>6,306,841</b>	<b>5,669</b>	<b>44,542,273</b>	

Burimi: DTTV/Bashkia Librazhd

Nga analiza e informacionit të pasqyruar në tabelën nr.5 dhe në tabelën/Aneks TA5 (bashkëlidhur aktit), **rezulton se:**

- Për vitin 2024 numrin më të lartë të abonentëve e ka qyteti Librazhd me 2545 abonentë me vlerë maturimi vjetor 7,743,600 lekë;

NJA Q. Librazhd me 2,518 taksapagues në vlerën vjetore të detyrimit (maturimit) 17,834,309 lekë ose me 605 abonentë në vlerën 1,458,309 lekë më shumë se deri në 31.12.2023;

Numrin më të vogël të taksapaguesve e ka NJA Lunik me 403 në vlerën vjetore të detyrimit (maturimit) 2,345,129 lekë ose me 98 abonentë në vlerën 702,607 lekë më shumë se deri në 31.12.2023;

- Gjatë vitit 2024 arkëtimin më të lartë e ka patur NJA Q. Librazhd në vlerën 2,499,634 lekë dhe më të ulët e ka patur NJA Orenjë në vlerën 300,060 lekë;

Deri në 31.12.2024 regjistrohen në total 5669 abonentë familjarë në vlerën totale të taksa e tarifave vendore 44,542,273 lekë ose 535 abonentë familjarë në vlerën totale 5,015,925 lekë më shumë se në 31.12.2023.

- Situata e debitorëve familjarë për vitin 2024, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 6/në lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Debia vjetore për taksat e tarifat VITI 2024									
		Ndërtesa		Pastrim		Ndrëçim		Gjellbërim		TOTALI TTV	
		Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera		Vlera totale
1	Familjaret në qytet	50	78,721	31	54,150	31	14,850	30	8,450		156,171
	Njësi Administrative Hotolisht	445	685,244	183	91,500	0	0	0	0		776,744
3	Njësi Administrative Lunik	19	254,560	11	5,500	0	0	0	0		260,060
4	Njësi Administrative Orenje	464	35,600	16	8,000	0	0	0	0		43,600
5	Njësi Administrative Polis	858	1,326,113	303	151,200	0	0	0	0		1,477,313
6	Njësi Administrative Stebleve	571	411,114	0	0	0	0	0	0		411,114
7	Njësi Administrative Qender	1,074	1,377,543	135	67,500	0	0	0	0		1,445,043
	<b>Totali</b>	<b>3,481</b>	<b>4,168,895</b>	<b>679</b>	<b>377,850</b>	<b>31</b>	<b>14,850</b>	<b>30</b>	<b>8,450</b>		<b>4,570,045</b>

Burimi: DTTV/Bashkia Librazhd

Meqenëse taksat dhe tarifat vendore vilen nga UK Sha, për shkak të mënyrën së mbledhjes së tyre në grup, deri më tani nga ana e UK sha dhe specialistëve të taksave akt rakordimi mujor bëhet po në grup dhe jo i klasifikuar sipas llojit të taksës që paguhet nga abonentët në sportelet e UK sha.

Nga analiza e informacionit të pasqyruar në tabelën 6, **rezulton se:**

- Numrin më të lartë të taksapaguesve familjarë pas qytetit Librazhd me 2545, e ka NJA Q. Librazhd me 2518 taksapagues në vlerën vjetore të detyrimit 17,834,309 lekë dhe numrin më të vogël të taksapaguesve e ka NJA Lunik me 403 në vlerën vjetore të detyrimit 2,345,129;

Nga analiza e informacionit të pasqyruar në tabelën 7, **rezulton se:**

- Numrin më të lartë të debitorëve e ka NJA Qendër me 1209 në vlerën e debisë 1,445,043 lekë dhe numrin më të vogël të debitorëve e ka NJA Lunik me 30 në vlerën e debisë 260,060 lekë, ndërsa NJA Orenjë ka vlerën më të vogël të debisë prej 43,600 lekë;

Vlera totale prej 4,570,045 lekë e 1875 debitorëve familjarë, është kontabilizuar.

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreut XI- “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, të neneve 88 deri 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, i ndryshuar.

➤ *Taksa e tokës bujqësore*

Bashkia Librazhd ka tokë bujqësore të ndarë me Ligjin 7503 /1991 datë 19.07.1991 “Për tokën” i ndryshuar, sipas regjistrave kadastralë të së cilës rezulton si në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.8/Në lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Nr.	Vlera
		Familjeve	31.12.2024
1	Njësi Administrative Hotolisht	117	779,470
2	Njësi Administrative Lunik	103	585,787
3	Njësi Administrative Orenje	464	519,220
4	Njësi Administrative Polis	883	437,997
5	Njësi Administrative Stebleve	657	373,457
6	Njësi Administrative Qender	1,915	1,319,428
<b>Totali</b>		<b>4,139</b>	<b>4,015,359</b>

Burimi: Bashkia Librazhd.

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 8 rezulton se numrin më të lartë të familjeve me tokë bujqësore e ka NJA Qendër me 1915 familje dhe vlerën totale vjetore të taksës 1,319,428 lekë dhe numrin më ulët e ka NJA Lunik me 103 familje dhe vlerën totale vjetore të taksës 585,787 lekë; ndërsa vlerën totale më të vogël të Taksës së tokës bujqësore e ka NJA Stëblevë me 373,457 lekë.

- Më poshtë janë paraqitur të përmbledhura vlera debitorë e biznesit, familjarëve dhe institucioneve për taksat dhe tarifatat vendore si më poshtë vijon:

Tabela nr. 9/në lekë

E m ë r t i m i	Në fillim të vitit 2024 (trashëguar nga vitet e mëparshme 2011-2023)		Krijuar brenda vitit 2024		Arkëtuar debitorë për periudhën 2011-2023		Në fund të vitit 31.12.2024	
	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere
Biznesi i Madh	91	23,731,228	68	12,458,814	38	7,562,703	81	28,235,942
Biznesi Vogël	283	14,606,819	118	1,649,683	74	2,631,322	302	13,625,180
<b>Në totali I</b>	<b>374</b>	<b>38,338,047</b>	<b>186</b>	<b>14,108,497</b>	<b>112</b>	<b>10,193,025</b>	<b>383</b>	<b>41,861,122</b>
Institucione	2						2	391,397
<b>Nën totali II</b>							<b>2</b>	<b>391,397</b>
Ndërtesat social ekonomike	66	3,029,351	81	4,029,853	25	566,073	91	6,493,131
Legalizimet	213	9,049,334	5	769,707	44	1,441,630	177	8,377,411
Familjet qytet	428	2,819,814	57	156,171	300	1,175,210	185	6,083,077
Familjet ne 6 NJA	5,134	39,526,348	1,780	7,810,957	1,726	2,561,718	5,669	44,542,273
<b>Nën totali III</b>	<b>5,841</b>	<b>54,424,847</b>	<b>1,923</b>	<b>12,766,688</b>	<b>2,095</b>	<b>5,745,631</b>	<b>6,122</b>	<b>66,495,892</b>
<b>SHUMA</b>	<b>6,215</b>	<b>92,762,894</b>	<b>2,109</b>	<b>26,875,185</b>	<b>2,207</b>	<b>15,938,656</b>	<b>6,507</b>	<b>107,748,411</b>

Burimi: DTTV/Bashkia Librazhd

Nga Informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 9, u konstatua se:

- Vlera progresive e debisë për kategorinë “biznes” deri në 31.12.2024 është 41,861,122 lekë ose 3,523,075 lekë më shumë se deri në 31.12.2023;

- Vlera progresive e debisë për “kategorinë institucione” deri në 31.12.2024 është 391,397 lekë

- Vlera progresive e debisë deri në 31.12.2024 për kategorinë “familjare” & “legalizimet” & “ndërtesat sociale” është 66,495,892 lekë ose 12,071,045 lekë më shumë se deri në 31.12.2023”;

- Vlera totale e borxhit tatimor në Bashkinë Librazhd nga të ardhurat vendore është 109,139,808 lekë për 6,507 taksapagues.

➤ **Bizneset, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

▪ Situata mbi numrin e bizneseve të vogla e të mëdha, regjistruar për herë të parë, çregjistruar apo pezulluar (për bizneset me aktivitet sezonal) për vitin 2024 në Bashkinë Librazhd, është si mëposhtë:

Tabela nr.10

Nr.	Lloji Biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime reja	Mbyllur aktiviteti	Gjendja në fund të vitit
1	Biznesi i Madh	2024	70	1	3	68
2	Biznesi i Vogël	2024	366	78	26	418
3	Institucione	2024	35	2	1	36
(1+2)	Gjithsej	2024	436	79	29	486

Burimi: DTTV/Bashkia Librazhd

- Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacionit të pasqyruar në tabelën nr. 10, rezulton se Bashkia Librazhd e ka mbyllur vitin 2023 me **436** biznese aktive në total, prej të cilëve: 70 BM, 366 BV dhe 23 Institucione;

- Janë **79** regjistrime të reja, nga të cilat **1** regjistrim i ri klasifikuar si BM dhe **78** klasifikuar si BV;

- Kanë mbyllur aktivitetin **29** subjekte, nga të i cilat **3** janë BM dhe **26** janë BV;

- Bashkia Librazhd në fund të vitit 2024 ka në total **486** biznese aktive ose 50 biznese më shumë se në mbyllje të vitit 2023.

Pra rezulton se numri total i subjekteve që ushtrojnë aktivitet privat, paraqitet me rritje nga viti 2023 në vitin 2024 me një numër prej 50 biznesesh.

▪ Subjekte fizike që kanë mbyllur aktivitetin gjatë vitit 2024 në Bashkinë Librazhd, për periudhën 2023-2024 nuk kanë detyrime;

Nga ana e DTTV në bashkëpunim me Policinë Bashkiake janë bërë verifikime në terren subjekteve që kanë “pezulluar” apo “çregjistruar” aktivitetin, për të cilat në çdo rast janë mbajtur procesverbalet përkatëse Nga verifikimi i tyre rezulton se nuk ka asnjë rast të kundërligjshëm.

Rezulton se nga ana e DTTV dhe QKB për periudhën 2024 e në vijim ka një bashkëpunim për mos veprim pezullimi pa vërtetimin e lëshuar nga ana DTTV Bashkia Librazhd.

Tabela nr. 11

Subjekte të pezulluara gjatë vitit 2023	<b>40</b>
Subjekte të çregjistruara gjatë vitit 2023	
Subjekte të pezulluara gjatë vitit 2024	<b>45</b>
Subjekte të çregjistruara gjatë vitit 2024	

Nga informacioni i pasqyruar edhe në tabelën nr. 12, rezulton se numri i aktiviteteve të pezulluara/çregjistruara ka ardhur në rritje nga viti 2023 në vitin 2024 me 5 subjekte.

**2.6/3 Evidentimi i detyrimeve tatimore të paarkëtuara progresive dhe për vitin buxhetor 2024**

➤ **Debitorët sipas kategorive të tyre.**

**1. Biznesi dhe Institucionet**

Bazuar në evidencat e vëna në dispozicion nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, ecuria e debitorëve vetëm përgjatë vitit 2024, për tarifën e shërbimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, etj, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë.

Tabela nr.12/në lekë

Nr.	Subjektet	Planifikimi për vitin 2024		Realizimi për vitin 2024		Gjendje debitorë më 31.12.2024	
		Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë	Nr.	Vlerë
1	Biznesi madh	214	59,662,432	169	47,203,618	68	12,458,814
2	Biznesi i vogël	693	15,237,744	609	13,588,061	118	1,649,683
	<b>Nën totali I</b>	<b>907</b>	<b>74,900,176</b>	<b>778</b>	<b>60,791,679</b>	<b>186</b>	<b>14,108,497</b>
3	Ndërtesat me qira	237	7,826,579	166	3,796,727	81	4,029,852
	<b>Totali</b>	<b>1,144</b>	<b>82,726,755</b>	<b>944</b>	<b>64,588,406</b>	<b>267</b>	<b>18,138,349</b>
4	Instucione					2	391,397

Burimi: DTTV/Bashkia Librazhd

- Ndërsa informacion i përmbledhur për gjithë debitorët klasifikuar sipas kategorive, pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.13/në lekë

E m ë r t i m i	Në fillim të vitit 2024 (trashëguar 2011-2023)		Krijuar brenda vitit 2024		Arkëtuar debitorë për periudhën 2011-2023		Në fund të vitit 31.12.2024	
	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere
Biznesi i Madh	91	23,731,228	68	12,458,814	38	7,562,703	81	28,235,942
Biznesi Vogël	283	14,606,819	118	1,649,683	74	2,631,322	302	13,625,180
<b>Nën totali I</b>	<b>374</b>	<b>38,338,047</b>	<b>186</b>	<b>14,108,497</b>	<b>112</b>	<b>10,194,025</b>	<b>385</b>	<b>41,861,122</b>
Ndërtesat social ekonomike	66	3,029,351	81	4,029,853	25	566,073	91	6,493,131
Legalizimet	213	9,049,334	5	769,707	44	1,441,630	177	8,377,411
Familjet qytet	428	2,819,814	57	156,171	300	1,175,210	185	6,083,077
Familjet ne 6 njësitë administrative	5134	39,526,348	1780	7,810,957	1726	2,561,718	5669	44,542,273
<b>Nën totali II</b>	<b>5,841</b>	<b>54,424,847</b>	<b>1,923</b>	<b>12,766,688</b>	<b>2,095</b>	<b>5,744,631</b>	<b>6,122</b>	<b>65,495,892</b>
<b>Institucione</b>							<b>2</b>	<b>391,397</b>
<b>Totali</b>	<b>6,215</b>	<b>92,762,894</b>	<b>2,109</b>	<b>26,875,185</b>	<b>2,207</b>	<b>15,938,656</b>	<b>6,509</b>	<b>107,748,411</b>

Burimi: DTTV/Bashkia Librazhd

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 13, **konstatohet se** vlera totale e debisë është 107,748,411 lekë e ndarë si më poshtë vijon:

a. deri në 31.12.2023 vlera totale e debisë për kategorinë biznes është 38,338,047 lekë për 374 debitorë, ku peshën më të madhe e zë debia e biznesit të madh [BM] me 23,731,228 lekë për 91 debitorë ose 62% dhe në vlerë më të vogël debia e biznesit të vogël [BV] me 14,606,819 lekë për 283 debitorë ose 38% të totalit të debisë për kategorinë “biznes”;

- gjatë vitit 2024 janë arkëtuar për këtë kategori 10,194,025 lekë nga 112 debitorë nga debia progresive e vitit 2023, ku peshën më madhe e zë arkëtimi nga [BM] në vlerën 7,562,703 lekë ose 74% dhe [BV] në vlerën 2,631,322 lekë ose në masën 16% të totalit të debisë për kategorinë “biznes”;

- gjatë vitit 2024 janë krijuar detyrime të reja nga mos arkëtimi në kohë i taksave dhe tarifave debia në vlerën 14,108,497 lekë për 186 taksapagues, ku peshën më të madhe e [BM] me 12,458,814 lekë ose në masën 88.3% të debisë për këtë kategori dhe 1,649,683 lekë nga [BV] për 118 taksapagues ose në masën 11.7% të debisë për këtë kategori;

- deri në 31.12.2024 debia progresive për kategorinë biznes është në vlerën 42,252,519 lekë, ku peshën më të madhe e zë [BM] me 28,627,339 lekë ose 67.7% të debisë totale progresive dhe 13,625,180 lekë nga [BV] ose në masën 32.3% të debisë totale progresive;

b. deri në 31.12.2024 vlera e debisë për kategorinë institucione është 391,397 lekë për 2 institucione: SHRUK Elbasan –sha dhe OSHEE;

Për të gjitha detyrimet e pa arkëtuara të prapambetura për biznesin e madh, biznesin e vogël, për legalizimet, ndërtesat social ekonomike, ambulante, OJF etj., janë ndjekur këto hapa:

▪ Janë dërguar njoftim vlerësimi për detyrimin e papaguar gjithë subjekteve debitorë të biznesit të madh me Nr. .3539. Prot., datë 25.07.2024 për 116 subjekte me vlerën 36,365 mije lekë, për "leje legalizimet" me shkresën Nr. 4827 Prot , datë 08.10.2024 për 197 subjekte me vlerën 9,236 mije lekë, për subjektet me "kontratë në treg" me shkresën Nr. 5386, datë

05.11.2024 për 106 subjekte me vlerë 3,813 mijë lekë, njoftim vlerësimi për biznesin e vogël, ndërtesat me qira, ambulantë, OJF etj., me shkresën Nr. 5790 Prot., datë 25.11.2024 për 441 subjekte me vlerë 23,092 mijë lekë;

▪ Procedura e bllokimit të llogarisë bankare. Me shkresën nr. 1596 Prot., datë 29.03.2024, kërkesë bankave të nivelit të dytë për bllokimin e llogarive të subjekteve që rezultojnë debitorë për taksa e tarifa vendore ndaj Bashkisë Librazhd (progresive 2011-2023); është rikërkuar (2) bllokim llogarish sipas shkresës nr. 1872. Prot., datë 16.04.2024, për biznesin e madh, për biznesin e vogël, ambulantë, ndërtesa etj., për 348 subjekte me vlerë 29,211 mijë lekë. Është rikërkuar (3) procedura e bllokimit të llogarive bankare me shkresën nr. 4074/1 Prot., datë 27.08.2024 për 109 subjekte të biznesit të madh me vlerën 31,944 mijë lekë. Në zbatim të Ligjit Nr.9920, datë 19.5.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar, neni 88, neni 89, neni 90, neni 91;

▪ Bllokim të pasurisë dhe të drejtave pasurore në QKB me shkresën Nr. 1867 Prot., datë 16.04.2024 për 348 subjekte të biznesit të vogël me vlerën 29,263 mijë lekë, me shkresën Nr. 4113 Prot., datë 29.08.2024 për 109 subjekte të biznesit të madh me vlerën 31,944 mijë lekë;

▪ Vendosje Barre hipotekore të pasurisë së paluajtshme pranë ASHK –së me shkresën nr.1865 Prot., datë 16.04.2024 për 348 subjekte të biznesit të vogël me vlerën 29,263 mijë lekë, me shkresën Nr. 4112 Prot., datë 29.08.2024 për 109 subjekte biznesi madh me vlerën 31,944 mijë lekë;

▪ Vendosje Barrë siguresë e mjeteve të transportit më shkresën nr. 1866 Prot, datë 16.04.2024 për 348 subjekte të biznesit të vogël me vlerën 29,263 mijë lekë, me shkresën nr.4129 Prot., datë 30.08.2024 për 109 subjekte biznesi madh me vlerën 31,944 mijë lekë;

▪ Në vitin 2024 ka dalë Urdhri Nr. 1165 ,datë 13.12.2024 “Për mos lejim të ushtrimit të aktivitetit për subjektet debitorë dhe pa licencë” për të gjitha subjektet debitorë në bashkëpunim me Policinë Bashkiake;

Për subjektet të cilët nuk kanë paguar në kohë detyrimin , brenda afatit ligjor, është përlllogaritur kamatë vonesa ne masën 0.06% në ditë , por jo më shumë se 365 ditë , bazuar në nenin 114 të Ligjit. Nr.9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë“ i ndryshuar;

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore **rezultoi se**, për më tej nuk është vazhduar në marrjen e masave të tjera shtrënguese si: bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve etj., deri në kallëzim penal. Veprime apo mosveprime të DTTV në kundërshtim me:

- Neni 76, neni 114, i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 në nenin 4, neni 9, pikat 1 dhe 2 në nenin 20, pika 1 në nenin 22, neni 22/5, nenin 24, shkronjën “c” të pikës 3 në nenin 27, neni 34 dhe neni 35 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Pikën 1.3 në pikën 1 në nenin 9, pikën 2 në nenin 27, neni 35, neni 64 në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;

Shkronjën “a” të nenit 5, pikën 2 të nenit 7, pikën 1 të nenit 12, nenin 14, neni 40, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

-VKB nr. 108 prot., datë 30.11.2023.

**Pretendimi i subjektit:** Me shkresën nr. 6651 prot., dt. 29.09.2025 dhe regjistruar në KLSH me nr. 407/6 prot., dt.01.10.2025, nga ana e DAV është dërguar observacioni me nr. 6167 prot., dt. 15.09.2025, për saktësimin e vlerës së debisë progresive të biznesit të madh, i cili ka ndikuar edhe në vlerën e debisë progresive totale. Biznesit të madh i zbritet vlera e debisë së institucioneve dhe nga 28,628,339 lekë duhet 28,235,942 lekë për 81 debitorë, pasi vlera debitorëve e institucioneve është pasqyruar veçmas në tabelën përmbledhëse nr. 13.

**Qendrimi i Grupit të Auditimit:** Referuar përmbajtjes së observacionit tuaj, pas verifikimeve të informacionit statistikor të dokumentuar, rezultoi se është bërë lapsus duke u mbivendosur vlera e institucioneve edhe te vlera debitore e biznesit të madh. Pra pretendimi juaj merret në konsideratë.

➤ Një klasifikim i llojit të aktiviteteve referuar klasifikimit të subjekteve bashkë me detyrimin vjetor /debinë për vitin 2023, pasqyrohen në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 14/në lekë

LLOJI I SUBJEKTIT	NUMRI	LLOJI I AKTIVITETIT	MATURIMI VJETOR 2024	DEBI NË FUND 2024
BIZNESI I MADH		Fasoneri		-
	37	Firme projektim Ndërtimi & konstruksione		4,880,040
		Karburante		1,083,191
		TVSH		
		Ushqimore		1,438,114
	2	Fondacion /OJF		13,000
	23	kontrata		2,682,533.0
		Treg Privat		
		Shoqëri import-eksport		917,101
	9	Transport mallra		
	9	Shoqëri Transporti udhëtarë		
		Tragetit dhe Shërbime		
		Hotele		
	8	Farmaci		
		Prodhim		
		Lende drusore		2,138,625
		Shfrytëzim minerale		3,653,571
		Lojëra fati		1,090,012
		HEC		251,994
		232	Ndërtesa	
				<b>14,204,993.4</b>
BIZNESI I VOGËL		Artizane		
		Industriale		
		Prodhim		
		Profesione te Lira		
		Shërbime		
		Bar kafe		
		Transport		
		Ushqim Social		
		Ushqimore		
		Vendore /ambulant		
		Ndërtese		
		Inpute bujqësore		
INSTITUCION	2	Institucione		<b>391,397</b>
<b>TOTALI</b>	<b>1344</b>			<b>27,295,866.2</b>

Burimi: DTTV /Bashkia Librazhd

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr.14, rezulton se aktivitetet sipas llojit që ushtrohen në territorin e Bashkisë Librazhd, janë parashikuar dhe miratuar në Paketën Fiskale të vitit 2024. Informacioni i detajuar pasqyrohet në tabelën/ Aneks TA 5

➤ Një klasifikim i debitorëve të biznesit, sipas riskut të shlyerjes së detyrimit të mbartur është si më poshtë vijon:

Debitorë pa shpresë arkëtimi janë **189** subjekte në vlerën e debisë 25,286,687 lekë (sipas Aneks TA6), bashkëlidhur aktit;

Debitorë nga 3 deri në 5 vjet janë **35** subjekte në vlerën e debisë 2,256,450 lekë (sipas Aneks TA7), bashkëlidhur aktit;

Debitorë nga 2 deri në 3 vjet janë **252** subjekte në vlerën e debisë 21,182,395 lekë (sipas Aneks TA8), bashkëlidhur aktit;

$\Sigma=48,725,532$  lekë

Në total janë 476 debitorë problematikë në vlerën totale të debisë 48,725,532 lekë.

Nga verifikimi i dosjeve të subjekteve debitorë, rezultoi se, nga ana e DTTV është bërë verifikimi në sistemin e QKB mbi statusin e tyre dhe ekstraktet e QKB-së janë bërë pjesë e dosjes.

Gjithashtu konstatohet se:

**1.** Në Bashkinë Librazhd janë zhvilluar takime të GMS ku trajtohen problematikat për (pa)mundësinë e vjeljes së detyrimeve të debitorëve problematikë, por **rezulton se këto takime nuk janë dokumentuar**; si dhe nga mungesa e një analize të mirëfilltë nga ana e strukturave përgjegjëse (GMS dhe DTTV), nuk është hartuar një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

**2.** Njoftimi i subjekteve debitorë dhe familjare kryhet nëpërmjet punonjësve të mbledhjes së taksave në terren verbalisht dhe shkresë-njoftimeve, si edhe me njoftimet në stendat e bashkisë dhe në qendrat e NJA.

- Deri në 31.12.2024 në territorin e Bashkisë Librazhd *nuk rezultojnë* subjekte me më shumë se 1 aktivitete në të njëjtin territor dhe me një Nipt:

- Nisur nga kushtet specifike të komunitetit që përbën këtë bashki, nga ana e DTTV na u komunikua se vështirësia e vjeljes së taksave dhe arkëtimi i detyrimeve të prapambetura vjen nga fakti se popullata është një pjesë emigratore dhe një pjesë jo rezidentë.

Nga sa trajtuam më sipër arrihet në *konkluzionin* se, nga struktura tatimore e Bashkisë Librazhd, për asnjë nga subjektet, që janë debitorë në vite, pasi janë njoftuar për pagesën e detyrimeve si dhe janë zbatuar një pjesë e procedurave për to, nuk është kërkuar *kallëzim penal*, bazuar në nenin 181, “Mos pagimi i taksave dhe tatimeve”, të Kodit Penal të RSH, miratuar me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 me ndryshime, ku përcaktohet se:

“Mospagimi i taksave dhe tatimeve brenda afatit të caktuar, me gjithë mundësinë e pagimit të tyre, nga personi ndaj të cilit janë marrë më parë masa administrative për këtë qëllim, dënohet me gjobë ose me burgim gjer në tre vjet.”

Këto veprime janë në kundërshtim me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë” pika 1.3., ku përcaktohet se:

“1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:  
1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe bërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:  
a) krijojnë, mbledhin të ardhura dhe bëjnë shpenzime për përmbushjen e funksioneve të tyre;  
b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi; c) hartojnë, miratojnë dhe zbatojnë buxhetin e tyre; ç) mbajnë llogaritë, në përputhje me legjislacionin në fuqi, dhe ofrojnë informacione ose raporte financiare për hartimin dhe zbatimin e buxhetit për qeverisjen qendrore ose shtetasit.”

Neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10, si dhe me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, Kreu II, Kreu IV, Kreu V, Kreu VII, etj.; Rregullore e Bashkisë Librazhd miratuar nga Kryetari i Bashkisë Librazhd me Vendimin nr. 1 datë 30.01.2024 dhe me nr. 639 prot., datë 01.02.2024.

**2. Debitorët familjar:** Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet ecuria e debitorëve familjar për tarifën e shërbimit: gjelbërim<sup>8</sup>, pastrim, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, TNI si dhe nga qiraja.

Tabela nr. 15/në lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Debitorët për Detyrimin vjetor të taksa e tarifave vendore									
		Ndërtesa		Pastrim		Ndriçim		Gjelbërim		Totali	
		Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr. Famil	Vlera	Nr.	Vlera
1	Familjaret në qytet	50	78,721	31	54,150	31	14,850	30	8,450	50 / 142	156,171
	Njësi Administrative Hotolisht	445	685,244	183	91,500	0	0	0	0	445 / 628	776,744
3	Njësi Administrative	19	254,560	11	5,500	0	0	0	0	19 / 30	260,060

<sup>8</sup> Vetëm në qytet

	Lunik										
4	Njësi Administrative Orenje	464	35,600	16	8,000	0	0	0	0	464 / 480	43,600
5	Njësi Administrative Polis	858	1,326,113	303	151,200	0	0	0	0	858	1,477,313
6	Njësi Administrative Stebleve	571	411,114	0	0	0	0	0	0		411,114
7	Njësi Administrative Qender	1,074	1,377,543	135	67,500	0	0	0	0		1,445,043
	<b>Totali</b>	<b>3,481</b>	<b>4,168,895</b>	<b>679</b>	<b>377,850</b>	<b>31</b>	<b>14,850</b>	<b>30</b>	<b>8,450</b>		<b>4,570,045</b>

Burimi: STTV/Bashkia Librazhd

- Numri më i lartë i debitorëve është për “taksën e ndërtesës” prej 3481 në vlerën e debisë 4,168,895 lekë; ku NJA Qendër ka numrin më të lartë me 1074 debitorë në vlerën e debisë 1,377,543 lekë ose 33% dhe numrin më të ulët e ka NJA Lunik me 19 debitorë dhe vlerë të debisë 254,560 lekë ose 17.3%;

- Numrin më të lartë për “taksë familjare/ pastrimi” e ka NJA Polis me 303 debitorë me vlerë 151,200 lekë ose 40% të vlerë totale të debisë për këtë lloj dhe numrin më të ulët e ka NJA Lunik me 11 debitorë dhe me vlerë të debisë 5,500 lekë;

- Për “taksë familjare/ndriçimi” 31 debitorë ka vetëm në qytetin Librazhd me vlerë 14,850 lekë ose 100% të vlerë totale të debisë për këtë lloj;

- Për “taksë familjare/gjelbërimi” 30 debitorë ka vetëm në qytetin Librazhd me vlerë 8,450 lekë ose 100% të vlerë totale të debisë për këtë lloj;

Nga 6 Njësitë Administrative *rezulton* të mos mblidhen të ardhura për këto 2 kategori takse familjare, pasi nuk ofrohet shërbim për komunitetin e tyre nga Bashkia Librazhd;

▪ Një informacion i përmbledhur i debisë progresive për çdo kategori pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.16/Në lekë

Debitorët nga viti 2011 deri në vitin 2024/ Gjendja 31.12.2024							
Nr.	Bashkia Librazhd	Taksë			Tarifa	Totali	Numri i familjeve
		Toke	Ndërtese	Trualli	Vendore	Taksa & Tarifa	
1	Familje Qytet	-	693,559	-	1,107,196	1,800,755	185
2	Nj.Admin.Hotolisht	3,063,676	3,040,220	540,500	400,600	7,044,996	885
3	Nj.Admin.Lunik	1,580,339	731,290	33,500	-	2,345,129	403
4	Nj.Admin.Orenjë	4,971,841	92,800	46,400	-	5,111,041	464
5	Nj.Admin.Polis	1,307,506	3,922,517	523,002	784,503	6,537,529	742
6	Nj.Admin.Steblevë	4,137,840	1,442,562	88,867	-	5,669,269	657
7	Nj.Admin.Lib.Qendër	12,241,946	5,167,579	222,284	202,500	17,834,309	2,518
	Shuma totale	<b>27,303,148</b>	<b>15,090,527</b>	<b>1,454,553</b>	<b>2,494,799</b>	<b>46,343,028</b>	<b>5,854</b>

Burimi: Bashkia Librazhd

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë, *rezulton se*:

- Vlera më e madhe e debisë është nga ‘taksa e tokës’ në shumën prej 27,303,148 lekë, ku debia e NJA Qendër ka vlerën më të lartë prej 12,241,946 lekë ose 44.8% e totalit për këtë kategori dhe NJA Polis ka vlerën më të vogël të debisë prej 1,307,506 lekë ose 4.8%;

- Vlera e debisë nga ‘taksa e ndërtesës’ është prej 27,303,148 lekë, ku debia e NJA Qendër ka vlerën më të lartë prej 5,167,579 lekë ose 34.2% e totalit për këtë kategori dhe NJA Orenjë ka vlerën më të vogël të debisë prej 92,800 lekë ose 0.68%;

- Vlera më e vogël e debisë është nga ‘taksa e truallit’ në shumën prej 1,454,553 lekë, ku debia e NJA Hotolisht ka vlerën më të lartë prej 540,500 lekë ose 37.2% e totalit për këtë kategori dhe NJA Orenjë ka vlerën më të vogël të debisë prej 33,500 lekë ose 2.3%;

- Vlera e debisë nga ‘tarifat/pastrim, gjelbërim, ndriçim’ është 2,494,799 lekë, ku debia e Bashkisë Librazhd/Qyteti ka vlerën më të lartë prej 1,107,196 lekë ose 44.4% e totalit për këtë kategori dhe NJA Qendër ka vlerën më të vogël të debisë prej 202,500 lekë ose 8.1%; NJA Lunik, NJA Orenjë dhe NJA Stëblevë nuk ka debitorë, pasi nuk iu ofrohet ky shërbim.

- Vlera totale e debisë progresive për taksa e tarifa vendore për familjarët është 46,343,028 lekë, ku NJA Qendër ka vlerën më të lartë të debisë totale progresive prej 17,834,309 lekë ose

38.5% dhe Qyteti i Librazhdit ka vlerën më të vogël të debisë 1,800,755 lekë ose 3.9% e vlerës totale progresive; Pra vlera totale progresive nga taksa e tarifa familjare është 46,343,028 lekë për 5,854 familje debitorë dhe konsiderohet e ardhur e munguar për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Për sa më lart mosveprimet janë në kundërshtim me VKB nr. 108 datë 30.11.2023 "Për nivelin e taksave dhe tarifave vendore, administrimin e tyre në Bashkinë Librazhd, penalitetet apo kundërvajtjet administrative për vitin 2024".

➤ **Familje debitorë për taksën e tokës bujqësore.**

Referuar informacionit të pasqyruar në tabelën nr.16 , **rezulton se**, Bashkia Librazhd ka 6598 familje taksapaguese për tokën bujqësore në vlerën e detyrimit vjetor 2024 prej 5,559,000 lekë, ku numrin më të lartë e ka NJA Qendër me 2518 familje taksapaguese në vlerën e detyrimit vjetor 2,094,400 lekë dhe numrin më të vogël e ka NJA Lunik me 654 familje taksapaguese në vlerën e detyrimit vjetor prej 870,700 lekë; ndërsa referuar detyrimit vjetor më të ulët e kanë NJA Stëblevë dhe NJA Orenjë përkatësisht me 715 dhe 711 familje taksapaguese për 'tokën bujqësore';

Theksojmë se, sipërfaqja e mësipërme e tokës bujqësore të taksuar, është bërë mbi bazën e regjistrave kadastralë. Ndonëse nga titullari me Urdhrin Nr. 19, datë 08.01.2024 "Për verifikimin ne terren për popullimin e (Kadastrës Fiskale ) është rritur angazhimi i strukturave përgjegjëse DTTV, DBV dhe 6 NJA, nuk është mundur të përmirësohet arkëtimi i të ardhurave nga kjo taksë, përkundrazi vlera e debisë ka ardhur në rritje nga viti në vit. Nga ana e administratorëve të njësive nuk janë bërë riverifikime në terren me qëllim sigurimin e të dhënave të sakta dhe krijimin/përditësimin e kadastrës vendore të tokës bujqësore. Mangësi konstatohen edhe në organizimin e strukturave për ndjekjen e kësaj takse, mos përditësimi i regjistrave të familjeve fermerë që disponojnë toke si dhe niveli i ulët i realizimit të taksës së tokës bujqësore, duke u evidentuar një numri të madh i familjeve debitorë në vlera të konsiderueshme debitorë.. Njoftim detyrimet për të gjithë fermerët e evidentuar në regjistra, bëhen në kohë, por emigrimi i tyre, ka sjellë vonesa dhe është shfrytëzuar rasti kur fermerët janë paraqitur pranë Bashkisë për shërbime të ndryshme dhe shërbimi i kërkuar është ofruar pasi iu janë prerë faturat dhe janë bërë arkëtimet.

Tabela nr.17/në lekë

Nr.	Njësitë Administrative	Nr. Familjeve me toke bujqësore 2024	Vlera e taksës për vitin 2024	Nr. Familjeve debitorë vetëm për vitin 2024	Vlera e debisë vetëm për vitin 2024	%e debisë ndaj detyrimit
1	Librazhd					
2	Qendër Librazhd	2,518	2,094,400	1,925	1,896,314	90.5
3	Lunik	654	870,700	403	709,270	81.5
4	Orenjë	711	599,836	464	519,220	86.6
5	Stëblevë	715	509,000	657	458,139	90.0
6	Hotolesh	1,117	802,064	786	705,687	88.0
7	Polis	883	683,000	663	467,309	68.4
	<b>Totali</b>	<b>6,598</b>	<b>5,559,000</b>	<b>4,898</b>	<b>4,755,939</b>	<b>85.6</b>

Burimi: Bashkia Librazhd/DTTV

**Konstatim:** Gjatë vitit 2024 numri i familjeve debitorë nga mospagimi i taksës së tokës bujqësore është 4,898 debitorë në vlerën totale të debisë 4,755,939 lekë ose 85.6% ; numrin më të lartë të debitorëve e ka NJA Qendër 1,925 me vlerën e debisë 1,896,314 lekë ose mosarkëtim në masën 90.5% dhe numrin më të vogël të debitorëve e ka NJA Lunik me 403 familje, por vlerën më të vogël të debisë vjetore e ka NJA Stëblevë 458,139 lekë ose mospagim të taksës në masën 90%;. NJA Polis ka vlerën e mosarkëtimit më të vogël në masën 68.4%.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB nr. 108 prot., datë 30.11.2023, "Për miratimin e paketës fiskale 2024" dhe "Rregulloren e Brendshme të funksionimit" miratuar me Vendimin e Kryetarit nr. 1 datë 30.01.2024 dhe me nr. 639 prot., datë 01.02.2024, nenet- "Detyrat dhe funksionet e Drejtorisë së Taksave e tarifave, treg", "detyrat dhe përgjegjësitë e drejtorit",

"detyrat dhe përgjegjësitë e përgjegjësit", "detyrat dhe përgjegjësit e specialistit të taksave", "detyrat dhe përgjegjësitë e administratorit të NJA", "detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të taksave në NJA", "detyrat dhe përgjegjësitë e specialistit të tregut" etj.

- Sipas bonitetit sipërfaqja e tokës bujqësore në territorin e Bashkisë Librazhd pasqyrohet e klasifikuar si në tabelën mëposhtë:

Tabela nr.18/në lekë

Kategoria e Tokës	Sipërfaqe e tokës bujqësore në ha							Lekë ha/vit sipas VKB	Pritshmëria në lekë	Plani vjetor 2024	Arkëtuar 2024
	Sipërfaqe Total	Qendër Librazhd	Lunik	Orenjë	Stëblevë	Hotolisht	Polis				
Kategoria I	0	0	0	0	0	0	0	2,800	0		
Kategoria II	-	-	-	-	-	-	-	2,100	0		
Kategoria III	-	-	-	-	-	-	-	1,400	0		
Kategoria e IV	516	191	-	-	-	-	325	1,350	696,600		
Kategoria e V	1,606	1,105	267	234	-	-	-	1,250	2,007,500		
Kategoria e VI	202	3	199	-	-	-	-	1,200	242,400		
Kategoria e VII-X	3,348	605	259	816	463	909	296	1,100	3,682,800		
<b>TOTALI</b>	<b>5,672</b>	<b>1,904</b>	<b>725</b>	<b>1,050</b>	<b>463</b>	<b>909</b>	<b>621</b>		<b>6,629,300</b>		
<b>Arkëtuar</b>	<b>2,717</b>	<b>946,144</b>	<b>347,503</b>	<b>266,591</b>	<b>422,747</b>	<b>237,173</b>	<b>442,634</b>			<b>5,559,000</b>	<b>2,662,792</b>
<b>% e realizimit</b>									<b>40.2</b>	<b>48</b>	

Burimi: DBV/Bashkia Librazhd

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 6 dhe tabelën nr. 18, rezultoi se, në territorin e Bashkisë Librazhd janë shpërndarë në total 5672 ha tokë bujqësore për 6598 familje që sipas bonitetit klasifikohen: “kategoria IV” në 2 NJA në sipërfaqen totale prej 516 ha; “kategoria V” në 3 NJA në sipërfaqen totale 1,606 ha; “kategoria VI” në 2 NJA në sipërfaqe totale 202 ha; “kategoria VII-X” në 6 NJA në sipërfaqe totale 3,348 ha; referuar tarifave të miratuara me VKB nr. 108 datë 30.11.2023 në paketën fiskale të vitit 2024, pritshmëria e të ardhurave nga taksa e tokës bujqësore për vitin 2024 duhet të jetë 6,629,300 lekë, por nisur nga mundësia e arkëtimeve sipas vitit të mëparshëm 2023, është planifikuar 5,559,000 lekë ose 1,070,300 lekë më pak se pritshmëria dhe 2,896,208 lekë më shumë se realizimi faktik i vitit 2024. **U konstatua se** edhe pse vlera e taksës për vitin 2024 është modeste, vlera totale progresive e arkëtuar në mbyllje të vitit 2024 është e ulët: 40.2% ndaj vlerës së pritshmërisë vjetore dhe 48% ndaj vlerës së planifikimit vjetor.

➤ **Taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtesat informale, objekt legalizimi.**

Në lidhje me realizimin e të ardhurave të Bashkisë nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimi, urbanizimi dhe integrimi i ndërtimeve pa leje, bazuar në dokumentet e shkresave të dërguara nga zyra e vendore e ASHK Librazhd, u auditua i gjithë dokumentacioni për periudhën e vitit 2024, i paraqitur nga Drejtoria i Planifikimit, Zhvillimit dhe Kontrollit të Territorit.

Në Bashkinë Librazhd deri në 31.12.2024, disponohen shkresat përcjellëse dhe listat me emrat përkatës që iu janë miratuar Lejet e Legalizimit për ndërtimet pa leje ndërtimi brenda territorit të Bashkisë Librazhd. Nga ZVASHK, janë dërguar informacioni dokumentar për çdo person që ka ndërtuar objekt banimi apo social ekonomik në territorin e Bashkisë Librazhd. Nga auditimi mbi vjeljen e detyrimeve për taksën e ndikimit në infrastrukturë, rezulton se Bashkia Librazhd, ka detyrime të prapambetura të trashëguara ndër vite për TNI.

Në vijim paraqiten pasqyra e personave të cilët janë pajisur me Leje Legalizimi, sipërfaqet ndërtimore sipas objekteve, funksioni, vendndodhja e objektit, sipërfaqja e objektit, detyrimi sipas personave që duhet të paguanin, për periudhën e vitit 2024 dhe statusi.

Tabela përmbledhëse - Taksa e Ndikimit në Infrastrukturë (TNI) për legalizimin e objekteve informale deri në 31.12.2024, pasqyrohet në tabelën /Aneks 2.2.5.11

Vlera debitorë nga TNI është kontabilizuar nga DFB/SF në pasqyrat financiare të njësisë.

Një përmbledhje e informacionit mbi TNI gjatë periudhës deri në 31.12.2024, pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 19/në mijë lekë

Nr.	Gjendja me 31.12.2023		Dosje të hyra Janar – Dhjetor 2024		Pagesa të kryera Janar – Dhjetor 2024		Gjendje me 31.12.2024 Subjekte debitorë	
	Nr. dosje	Vlera /000	Nr. dosje	Vlera /000	Nr. dosje	Vlera /000	Nr. dosje	Vlera /000
1								
2	213	9,049	25	1,916	67	2,588	171	8,377

Burimi: DUMT/Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr.19, rezultoi se: deri në 31.12.2023 janë 213 dosje përfituesish nga legalizimi i objekteve në ASHK me vlerë të detyrimit progresiv për TNI prej 9,049 mijë lekë;

- gjatë vitit 2024 nga ASHK kanë ardhur 25 përfitues, vlera e TNI për objektet e të cilëve është 1,916 mijë lekë;

- gjatë vitit 2024 kanë kryer pagesën e TNI-së 67 përfitues në vlerën totale 2,588 mijë lekë;

- deri në 31.12.2024 nga pagesat e kryera për TNI është ulur numri i debitorëve në 171 dhe vlera totale e debisë është 8,377 mijë lekë.

Një informacion i përmbledhur mbi historikun e debisë të TNI në Bashkinë Librazhd pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Tabela nr.20/Në mijë lekë

Nr.	Gjendja më 31.12.2023			Dosje të ardhura gjatë vitit 2024		Pagesa të bëra gjatë vitit 2024		Subjekte debitorë më 31.12.2024	
	Viti	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera	Nr.	Vlera
1	2016	56	2,428			9	179	47	2,249
2	2017	33	1,427			11	386	22	1,041
3	2018	2	131			-	-	2	131
4	2019	16	445			3	82	13	363
5	2020	15	552			3	69	12	483
6	2021	46	1,603			9	292	37	1,311
7	2022	28	1,055			5	127	23	928
8	2023	17	1,408			7	308	10	1,100
9	2024			25	1,916	20	1,145	5	771
<b>Totali</b>		<b>213</b>	<b>9,049</b>	<b>25</b>	<b>1,916</b>	<b>67</b>	<b>2,588</b>	<b>171</b>	<b>8,377</b>

Burimi: DTTV/Bashkia Librazhd

Nga informacioni i detajuar në tabelën nr.20 rezultoi se:

- viti 2018 ka numrin më të vogël të debitorëve (2) me vlerën e TNI-së prej 131 mijë lekë; viti 2016 ka numrin më të lartë të debitorëve (56) me vlerën totale të TNI-së prej 2,428 mijë lekë;

- gjatë viti 2024 janë arkëtuar për TNI nga 67 debitorë në vlerën totale 2,588 mijë lekë, nga të cilët numrin më të lartë e kanë arkëtimet nga debi e vitit 2017 e 11 debitorëve në vlerën totale 386 mijë lekë dhe nga viti 2018 janë 2 debitorë në vlerën totale 131 mijë lekë, të cilët vazhdojnë të jenë të tillë deri në 31.12.2024;

- gjatë vitit 2024 ka lindur detyrimi për 25 përfitues në vlerën totale të TNI-së 1,916 mijë lekë, nga të cilët kanë paguar 20 në vlerë totale 1,145 mijë lekë dhe janë debitorë 5 përfitues në vlerën totale të TNI-së prej 771 mijë lekë;

**Konkluzion:** Nga auditimi dhe informacioni i vënë në dispozicion **u konstatua se** debitorët e TNI nga leje legalizimi janë krijuar në periudhën para vitit 2023 dhe se nga Drejtoria e Urbanistikës nuk është bërë një analizë e mirëfilltë, me qëllim hartimin një plan masash si për arkëtimin e vlerës debitorë nga TNI e akumuluar prej shumë vitesh, por edhe parandalimin e krijimit të debitorëve të rinj dhe konkretisht në vitin 2024.

▪ Lidhur me lejet e ndërtimit të dhëna për ndërtimet e reja nga SUMT/Bashkia Librazhd, rezulton se në vitin 2024 nga TNI janë arkëtuar 9,145,362 lekë

Vlera debitorë prej 8,377,411 lekë për 213 debitorë, përbën të ardhura të munguara për buxhetin e bashkisë.

Mbajnë përgjegjësi Sektori i Urbanistikës/Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

### III. Burimi i krijimit të të ardhurave jo tatimore.

#### ➤ *Detyrimet nga qiratë e sipërfaqeve pyjore/kullosore/tokave bujqësore*

Nga Sektori i Bujqësisë, është marrë ky informacion lidhur me sipërfaqet e tokës bujqësore në pronësi të ndarë me Ligjin 7501 /1991 i ndryshuar, si më poshtë:

Tabela nr.21

Njësi Administrative/Institucion	Sipërfaqja në ha			
	Të ndara	Të ndara		Të pandara
		Me origjinë nga ish.Koop.bujqësore	Me origjinë nga ish.Nb. bujqësore	
Bashkia Librazhd		5672		

Burimi: DBV/Bashkia Librazhd

-Tokat bujqësore të Bashkisë Librazhd sipas ndarjes (llojit) pasqyrohen si më poshtë:

Tabela nr. 22

Nr.	Emërtimi i asetit	Sip. në ha
1	Pyje	25,089.68
2	Kullotë	9,430.76
3	Toka joproductive (shkëmbore)	3,282.51
4	Shkëmbore e ujore	-
5	Djerrë	-
6	Bimësi Pyjore	-
7	Sipërfaqe boshe	-
<b>Totali</b>		<b>37,802.95</b>

Burimi: DBV/Bashkia Librazhd

Bazuar në VKM nr. 433 datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe të kullotave publike, sipas listës së inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish komunave/bashkive” i ndryshuar me VKM nr. 684 datë 02.09.2020, Bashkisë Librazhd i kanë kaluar në pronësi sipas listës së inventarit/shtojcës 18;

Referuar informacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria e Bujqësisë, rezulton se ka dërguar çdo vit në Këshillin e Qarkut Elbasan, informacionin mbi treguesit kadastral të përditësuar për ndryshimet në nivel vendor të fondit pyjor e kullosor, sipas formularëve të miratuar Formular 1, 2, 3 dhe 4.

▪ Tokë bujqësore e pandarë e dhënë me qira:

Tabela nr. 23/në lekë

Nipt	Subjekti	Adminstratori	Aktiviteti	Vendndodhja	Kontrata		
					Nr.	Date	Vleftha
M.....A	N. I shpk	M. Sh.	Toke buqesore	Nj.A.Q ,Dorez	495	01.02.2022	74,538
G.....M	R. R.	R. R.	Toke buqesore	Nj.A,Hotolisht	904	15.02.2017	4,160
H.....D	R. B.	R. B.	Toke buqesore	Nj.A.Polis	7330	27.12.2016	16,720
<b>Totali</b>							<b>95,418</b>

Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 23, rezulton se janë lidhur 3 kontrata për dhënie me qira të tokës bujqësore, në vlerën totale të detyrimit 95,418 lekë, konform VKM nr. 373, datë 20.6.2018 “Për përcaktimin e kriterëve, të rregullave, procedurave dhe kontratës tip për dhënie me qira të tokave bujqësore në pronësi të shtetit“;

▪ **Sipërfaqe pyjore e kullosore e dhënë me qira:**

Sipërfaqet pyjore e kullosore në pronësi të NJVQV/bashkive jepen në përdorim me kontratë qiraje në zbatim të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar”, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, i ndryshuar dhe Udhëzimit nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullosor publik“ i ndryshuar.

Nga Drejtoria e menaxhimit dhe administrimit të pyjeve dhe kullotave në Bashkinë Librazhd janë lidhur 77 kontrata për dhënie me qera të pyje në vlerën totale 17,608,975 lekë, nga të cilat:

62 kontrata janë me afat 10 vjeçar, 12 kontrata janë me afat 9 vjeçar, 1 kontratë është me afat 5 vjeçar dhe 2 kontrata janë me afat 1 vjeçar;

- Vetëm për vitin 2024 janë 18 debitorë në vlerën totale 2,638,842 lekë, nga të cilët 16 janë nga kontratat me afat 10 vjeçar, 1 nga kontrata 5 vjeçare dhe 1 nga kontrata 1 vjeçare<sup>9</sup>;

- Deri në 31.12.2024 janë 19 debitorë progresiv në vlerën totale 4,438,493 lekë, nga të cilët 17 janë nga kontratat me afat 10 vjeçar, 1 nga kontrata 5 vjeçare dhe 1 nga kontrata 1 vjeçare; Informacion i detajuar pasqyrohet në tabelën/Aneks TA9.

**Konstatohet se:-** shuma prej 218,418 lekë që i përket vlerës së kontratës 1 vjeçare, duhej të ishte arkëtuar para nënshkrimit të saj, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 1 datë 09.06.2016 “Për rregullat, procedurat e kërkimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik” pika 20;

- Shuma prej 2,638,842 lekë që i përket debisë së krijuar nga mospagesa e 18 kontraktuesve, përbën të ardhur të munguar në buxhetin e Bashkisë Librazhd.

Bashkia Librazhd ka sipërfaqe pyjore në pronësi sipas VKM-së nr. 398 datë 13.05.2020 “Për disa ndryshime në VKM-në nr.433 datë 08.05.2016 “Për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve e kullotave publike”;

▪ **Sipërfaqe kullorë të dhëna me gira nga Bashkia Librazhd:**

- Në Bashkinë Librazhd Drejtoria e menaxhimit dhe administrimit të pyjeve dhe kullotave gjatë vitit 2024 ka lidhur 16 kontrata për kullota verore me sipërfaqe totale 492.4 ha dhe me vlerë totale 402,760 lekë me afat 1 vjeçar. Informacion i detajuar në Aneks TA10.1;

- Në Bashkinë Librazhd Drejtoria e menaxhimit dhe administrimit të pyjeve dhe kullotave gjatë vitit 2024 ka lidhur 15 kontrata për kullota verore në zonat e mbrojtura me sipërfaqe totale 435 ha dhe me vlerë totale 442,550 lekë me afat 1 vjeçar. Informacion i detajuar në Aneks TA10.2; Rezulton se për këto kontrata nuk ka debitorë, pasi pagesa e detyrimit kryhet para nënshkrimit të kontratës, vërtetuar nga mandat arkëtimi i secilës kontratë pasqyruar në Aneks TA10.1 dhe TA10.2.

▪ Të Ardhura nga privatizimi i banesave sociale

Tabela nr.24 /në lekë

Nr.	Përfituesi	Nr. rep. nr kolek.data	Detyrimi total	Likuiduar 31.12.2024	Për te likuiduar
1	P SH	1023/573 datë 09.07.2020	1,011,156	1,011,156	-
2	H Q	1615/898 datë 18.09.2020	669,439	669,439	-
3	M B	953/527 datë 02.07.2020	769,289	396,849	372,440
4	A B	1022/572 datë 09.07.2020	805,813	232,485	573,328
5	H B	859/473 datë 19.06.2020	979,310	306,608	672,702
6	K J	706/394 datë 02.06.2020	1,700,020	529,342	1,170,678
7	XH K	858/472 datë 19.06.2020	1,229,123	655,190	573,933
Totali			7,164,150	3,801,069	3,363,081

Burimi: Bashkia Librazhd

Nga informacioni dokumentar dhe i pasqyruar në tabelën 24 rezulton se me procedurë privatizimi deri në 31.12.2024 i janë nënshtruar në total 7 banesa në vlerën totale të privatizimit 7,164,150 lekë, nga të cilat:

- Për 2 banesa është likuiduar vlera totale plotësisht prej 1,680,595 lekë;

- Për 5 banesa në vlerë totale plotësisht prej 1,680,595 lekë;

- Për 5 banesa në vlerë totale të kontratës 5,483,555 lekë deri në 31.12.2024 janë paguar 2,120,474 lekë;

- Vlera e mbetur për tu likuiduar për 5 banesat sociale sipas kontratave respektive është 3,363,081 lekë.

▪ **Tarifa e pastrim, gjelbërim, ndriçim etj. (sipas rastit), për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike.**

<sup>9</sup> Është brenda afatit deri në date 31.07.2025

Nga auditimi lidhur me tarifën e pastrim, ndriçimit, gjelbërim etj., për subjektet që kanë kryer punime ndërtimi me fonde publike, rezultoi se gjatë viti 2024 kanë kryer punime me procedura prokurimi. Informacioni i detajuar pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr.25/Në lekë

Nr.	Subjekti	NIPT	Vl.kont. (pa TVSh)	Afati i kontratës	Lloji i taksave dhe tarifave vendore						
					Taksë mjedisi	Taksë Tabele	Tarifë Pastr.	Tarifë Nd.rrug	Tatifë Gjelh.	Paguar	Debitor
1	E Shpk	K.....P		6 Muaj			55,000		7,500	62,500	-
2	A Shpk	J.....O		2 Muaj			18,333		2,500	20,833	-
3	L.T.E	L.....F		6 Muaj			55,000		7,500	-	62,500
4	K.M.K	L.....E		10 Muaj			91,667		12,500	-	104,167
5	A-B.	J.....C		8 Muaj			73,334		10,000	83,334	-
6	Z -shpk	J.....K		5 Muaj			45,833		6,250	-	52,083
<b>Totali</b>							<b>339,167</b>		<b>46,250</b>	<b>166,667</b>	<b>218,750</b>

Burimi: Bashkia Librazhd

Nga verifikimi i dokumentacionit dhe informacionit në tabelën nr. 25, rezulton se gjatë vitit 2024 janë 6 OE që kanë fituar procedurat e prokurimit për 6 punë publike me fondet e Bashkisë Librazhd dhe se kanë paguar detyrimin në masë të plotë mbi taksat vendore në vlerën totale 166,667 lekë vetëm 3 OE dhe **u konstatua se** 3 OE janë debitorë në vlerën totale 218,750 lekë.

➤ **Debitor nga gjoba të vendosura nga Policia Bashkiake.**

Nga auditimi, rezulton se gjatë vitit 2024 Policia Bashkiake ka regjistruar 38 gjoba për kundërvajtje administrative në territorin e Bashkisë Librazhd në vlerën totale 39,000 lekë, të cilat janë arkëtuar në masë të plotë.

➤ **Nga gjobat e IMTV**

Nga auditimi dhe relacioni i inspektorit të IMTV Bashkia Librazhd, rezulton se gjatë vitit 2024 nga kontrollet periodike të ushtruara në territorin e Bashkisë Librazhd, janë konstatuar ndërtime të jashtëligjshme dhe kundërvajtje administrative për të cilat janë vendosur 3 gjoba me vlerë totale 850,000 lekë, nga të cilat janë arkëtuar 350,000 për 2 gjoba dhe vlera 500,000 lekë e papaguar nga kundërvajtësi.<sup>10</sup>

➤ **Nga aktiviteti i MZSH**

Nga relacioni i përgjegjës të MZSH-së Bashkia Librazhd, rezulton se gjatë vitit 2024 nga aktiviteti i kësaj strukturë janë arkëtuar 107,000 lekë në buxhetin e Bashkisë Librazhd.

➤ **Shlyerja e detyrimeve të prapambetura/ me këste**

Bashkia Librazhd referuar kuadrit ligjor në fuqi, ka aplikuar lidhjen e marrëveshjeve me debitorët për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura prej tyre, në favor të buxhetit të Bashkisë Librazhd. Një informacion i detajuar në tabelën më poshtë:

Tabela nr.26 /Në lekë

Nr.	Akt-marrëveshja	Subjekti	Detyrimi total	Pagesa deri ose mbi në 20%	Detyrimi në marrëveshje	Shuma e paguar	%	Shuma e mbetur 31.12.2024
1	Nr. 6104/1, datë 12.12.2024	P A	132,144	26,429	132,144	26,429	20	105,715
2	Nr. 2791/1, datë 11.06.2024	E L	312,820	72,000	312,820	312,820	100	0
3	Nr. 1839/1, datë 15.04.2024	N P	295,356	59,071	295,356	142,247	48	153,109
4	Nr. 1897/1, datë 17.04.2024	R M	47,014	8,000	47,014	47,014	100	0
5	Nr. 3942/1, datë 23.08.2024	“V” shpk	1,033,939	206,788	1,033,939	206,888	20	827,051
6	Nr. 3706/1, datë 06.08.2024	“D” Bulqize	3,504,720	632,391	3,504,720	2,068,599	59	1,436,121
<b>Totali</b>			<b>5,325,993</b>	<b>1,004,679</b>	<b>5,325,993</b>	<b>2,803,997</b>		<b>2,521,996</b>

Burimi: Bashkia Librazhd

Gjatë vitit 2024 Bashkia Librazhd ka lidhur 6 akt marrëveshje për likuidimin e detyrimeve progresive nga taksat e tarifave vendore. *Rezultoni se* deri në 31.12.2024 nga detyrimi total prej 5,325,993 lekë, është likuiduar në masë të plotë nga 2 debitorë në shumën 359,834 lekë, në masën 20% vetëm 2 debitorë në shumën 233,317 lekë dhe në masën mbi 20% kanë paguar 2

<sup>10</sup> Trajtuar më gjerësisht në Akt Konstatimi nr. 22 për pikën 7 të programit të auditimit Aktiviteti i IMT-së në Bashkinë Librazhd

debitorë në shumën 2,210,846 lekë, sipas kushteve të Akt Marrëveshjes. Për periudhën në vijim mbeten për tu arkëtuar në buxhetin e bashkisë shuma prej 2,521,996 lekë sipas afateve dhe kushteve të përcaktuara në akt marrëveshje.

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre:**

Për vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Librazhd mbi arkëtimin e taksës së licencimit për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të karburanteve për konsumatorët fundor, u shqyrtua dokumentacioni si vijon:

-Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Ligj nr. 9920, datë 19.5.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar;

-Ligji nr. 8450, datë 24.2.1999 “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar

-VKM nr. 970, datë 2.12.2015 “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” i ndryshuar, me VKM nr.344, datë 19.04.2017;

-VKM nr. 212, datë 16.3.2016 “Për përcaktimin e kushteve dhe të rregullave teknike për përpunimin e bombolave të mbushura me gaz të lëngshëm të naftës (GLN)”

- VKB nr.108 datë 30.11.2023 "Për miratimin e paketave fiskale për vitin 2024", në të cilat është përcaktuar tarifa e licencimit, si dhe sektori përgjegjës për lëshimin e licencës, faturës së arkëtimit;

Pasqyra e subjekteve që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë në Bashkisë Librazhd në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 27/në lekë

Nr.	Subjekti	Nipt	Adresa	Autorizime	Niveli tarifës sipas VKM nr. 344	Pagesë deri në vitin	Pagesë gjatë vitit 2024	Detyrime për t'u paguar për autorizimin
				fillon-mbaron		31.12.2023		
1	S-G "P. K"	K.....V	Rruga nacionale Librazhd-Elbasan	31.05.2018-31.05.2023&01.06.2023-01.06.2028	1,000,000	1,000,000	1,000,000	0
2	K.sh.p.k. Sh.K.	J.....P	Axhensia	10.11.2023-10.11.2028	1,000,000	1,000,000	0	0
3	S-G B	K.....V	Rruga nacionale Librazhd-Prenjas	03.04.2019-03.04.2024&04.04.2024-04.04.2029	1,000,000	1,000,000	1,000,000	0
4	M. O Sh.p.k "E G."	L.....H	Unaza e Korces	02.04.2019-02.04.2024	1,000,000	1,000,000	0	0
5	H. Shpk "I. H."	K.....U	Rruga nacionale Elbasan-Librazhd	03.09.2019-03.09.2024&04.09.2024-04.09.2025	1,000,000	1,000,000	200,000	0
6	D. M.	L.....R	Zgosht	19.06.2020--19.06.2025	1,000,000	1,000,000	0	0
7	H.-2021 "L.C."	M.....P	Rruga Hotolisht-Prenjas	06.07.2022-06.07.2027	1,000,000	500,000	0	500,000

Burimi: Bashkia Librazhd

Nga informacioni i evidencave dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pasqyruar në tabelën nr. 27, **rezulton** se në Bashkinë Librazhd ushtrojnë aktivitetin 7 subjekte, të cilët janë pajisur me Autorizim 5 vjeçar. Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 30, rezulton se nga 7 subjekte aktive, 1 subjekt (“H” shpk) i ka mbaruar afati i autorizimit në shtator të vitit 2024 me 0 detyrime ndaj bashkisë. Nga komunikimi me subjektin rezulton se pas përfundimit të afatit të autorizimit, ky subjekt është pajisur me leje (afat 1 vjeçar) e vlefshme deri në datën 04.09.2025 për të cilën ka paguar dhe detyrimin prej 200,000 lekë; Subjekti “H 2021” ShPK është pajisur me autorizim (5 vjeçar) për periudhën 06.07.2022-

06.07.2027 dhe rezulton të ketë paguar gjysmën e detyrimit prej 500,000 lekë, duke i mbetur për të paguar vlera prej 500,000 lekë deri në përfundim të afatit.

➤ **Tarifë e tregut të organizuar.**

Drejtoria e taksave dhe tarifave vendore e Bashkisë Librazhd siguron të ardhura edhe nga tregu i qytetit, nëpërmjet (1) kontratave që lidh me subjekte që ushtrojnë aktivitetin e tyre tregtar me mallra industrial apo ushqimor në territorin e tregut si dhe (2) atyre ambulantë (ditor).

1. Tregu është i ndarë në poste [2mx1m], ku për çdo post të shfrytëzueshëm me aktivitet tregtar është caktuar tarifa prej 1,200 lekë në muaj. Kontratat kanë afat 1 vjeçar dhe detyrimi vilet çdo muaj. Specialisti i tregut mbledh çdo fillim viti (dhe jo vetëm) kërkesat e tregtareve për tu regjistruar. Dokumentacioni (kërkesa, karta e identitetit, nr. kontakti etj.) i marrë në dorëzim nga specialisti i tregut, dorëzohet për tu shqyrtuar për çdo rast nga përgjegjësi dhe drejtori i DTTV. Kontrata lidhet nga palët dhe detyrimi fillon nga momenti i lidhjes së saj. Nëse një tregtar paraqet kërkesë për 2 poste të njëpasnjëshëm, lidhet vetëm një kontratë dhe detyrimet arkëtohen nëpërmjet një fature të vetme, me qëllim garantimin e vjeljes së detyrimit Brenda afatit. Për vitin 2024 rezulton kjo situatë:

Tabela nr.28/Në lekë

Numri i posteve të disponueshëm në treg	Numri I kontratave 2023	Numri I kontratave /posteve 2024	Detyrimi vjetor 2024	Paguar deri në 31.12.2024	Poste të pezulluar /numri muaj	Debitorë deri në 31.12.2024	Debi deri në 31.12.2024	Paguar në 2025 nga debia e 2024	Debi e mbetur nga 2024
40+	23	21 / 22	302,400	261,000	12	18	41,400	32,400	9,000

Burimi:DTTV/Bashkia Librazhd

Nga shqyrtimi i informacionit dokumentar i pasqyruar edhe në tabelën/Aneks TA 12, rezultoi se:

- Numri i kontratave ka ardhur në rënie (me -1) nga viti 2023 në vitin 2024 e në vijim;
- Nga kontratat e lidhura në vitin 2024, 1 është e dyfishtë, 1 është pezulluar në katër mujorin e tretë të vitit 2024;
- Deri në 31.12.2024 janë paguar 261,000 lekë nga të cilët: 3 tregtarë kanë paguar në masë të plotë detyrimin vjetor në vlerën 43,200 lekë, 10 tregtarë kanë vetëm detyrimin e muajit dhjetor në vlerën 13,200 lekë dhe 8 tregtarë kanë më shumë se 1 muaj detyrim të papaguar të viti 2024 në vlerën 28,200 lekë;
- Deri në 31.12.2024 debia e krijuar e cila trashëgohet për tu arkëtuar në janar 2025 është 41,400 lekë për 18 tregtarë, nga e cila: në muajin janar është arkëtuar vlere prej 27,000 lekë nga 12 tregtarë, në muajin shkurt 3,000 lekë nga 2 tregtarë, në muajin prill dhe maj 2,400 lekë nga 2 tregtarë, duke e lënë vlerën e debisë së vitit 2024 prej 9,000 lekë.
- Nga subjekti na u komunikua se 2 prej debitorëve në vlerën totale 7,800 lekë, janë klasifikuar në pamundësi arkëtimi, pasi kanë “ndërruar jetë”;

Nga auditimi **rezultoi se** nga ana e DTTV nuk është bërë një analizë e mirëfilltë mbi risqet e mundshme që mbart ushtrimi i funksioneve të vet strukturës së taksave, në çdo hallkë të proceseve të punës, dhe si rrjedhojë nuk është hartuar një plan masash për parandalimin apo zgjidhjen e problematikave të dala. Kjo ka sjellë krijimin e borxhit tatimor për tarifa modeste dhe lehtësisht të parandalueshme.

2. Për ambulantët, specialisti i tregut pret faturën dhe tregtari ambulant e kryen pagesën ditore manualisht pranë sporteleve të Bashkisë Librazhd.

Çdo javë e muaj kryen rakordimet mes specialistit të tregut dhe specialistit të sportelit ku arkëtohen detyrimet e tregtareve ambulant. Sasia monetare e grumbulluar nga arkëtimet derdhet në bankat e nivelit të dytë, duke zbatuar kuadrin ligjor për të mos kaluar vlerën limit të

arkës, konform Udhëzimit nr. 30 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

#### IV. Përfshirjet nga Taksat dhe reduktimet nga Tarifat/Kategoritë sociale përfituese

Tabela nr. 29/Në lekë

Përfshirjet nga Taksat dhe reduktimet nga Tarifat Vendore 2024											
Nr.	Kategoria sociale	Tarife Pastrimi		Tarife Ndriçimi		Tarife Gjellbërimi		Takse Ndërtese		Totali	
		Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlere	Nr.	Vlerë
1	Familjarë qytet	619	371,400	619	123,800	0	0	234	284,808	234	284,808
2	Familjarët në 6 NJA	0	0	0	0	0	0	1,013	1,659,489	1,013	1,659,489
<b>Totali</b>		<b>619</b>	<b>371,400</b>	<b>619</b>	<b>123,800</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>1,247</b>	<b>1,944,297</b>	<b>1,247</b>	<b>1,944,297</b>

Burimi: DTTV/Bashkia Librazhd

Në Paketën Fiskale 2024, janë parashikuar nga DTTV dhe miratuar me VKB nr. 108 datë 30.11.2023 edhe disa kategori sociale për tre lloj taksash: Taksë Ndërtese, Tarifë ndriçimi dhe tarifë pastrimi, të cilat në mënyrë të detajuar pasqyrohen në tabelën e mësipërme. Nga informacioni i pasqyruar në tabelën nr. 31 rezulton se për 4 kategoritë sociale përfituese janë në total 1247 përfitues në vlerën 1,944,297 lekë.

DTTV ka evidencë të hartuar mbi vlerën e vjelë të tyre dhe vlerën e plotë të taksave që duhej të arkëtohej në rast se nuk do përfshihej në paketën e lehtësisë fiskale.

#### ➤ Komisioni i Apelit Administrativ.

Bashkia Librazhd ka ngritur Komisionin e Hetimit Tatimor [KHT] me Urdhrin e Kryetarit të Bashkisë nr. 526 datë 24.05.2024 dhe me nr. 2497 prot., datë 24.05.2024, në zbatim të Ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 7 i tij; KHT për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 është i përbërë si më poshtë vijon:

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni në strukturë	Formimi profesional/arsimor
1	B P	Sekretar i Përgjithshëm	Kryetar Komisioni/
2	E F		anëtar
3	KI LI		-//-

Burimi: Bashkia Librazhd

Nga auditimi rezultoi se gjatë vitit 2024, ka patur raste të ankimeve nga subjekte apo familjarë, lidhur me detyrimet tatimore ndaj Bashkisë Librazhd, si në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 30/ Në lekë

Nr.	Subjekti	Nipti	Aktiviteti	Detyrimi në lekë	Kërkesa e subjektit		Vendimi Komisionit Hetimit Tatimor		Shuma e zbritur lekë	Shuma për tu paguar
					Nr.	Datë	Nr.	Datë		
1	B Q	K.....G	Ushqimore	103,000	3536	24.07.2024	3536/1	21.08.2024	90,000	13,000
2	S L	K.....H	Bar- kafë	29,233	3100	28.06.2024	3100/1	05.07.2024	22,684	6,549
3	V B	K.....L	Zdrukthtar	48,392	681	05.02.2024	681/1	20.02.2024	8,000	40,392
4	R B	K.....S	Ushqimore	23,956	3261	08.07.2024	3261/1	16.09.2024	11,000	12,956
5	H Rr	L.....V	Ndërtese	81,560	506	29.01.2024	506/1	20.02.2024	43,457	38,103
	<b>Shuma</b>			<b>286,141</b>					<b>175,141</b>	<b>111,000</b>

Burimi: Bashkia Librazhd

Nga informacioni i pasqyruar në tabelë **rezulton se:**

- gjatë vitit 2024 janë paraqitur ankesa nga 5 subjekte taksapaguesish në vlerën totale të detyrimit 286,141 lekë;
- nga KHT janë marrë në shqyrtim 5 kërkesat e paraqitura;
- KHT ka dale me vendim për të 5 rastet, duke ndryshuar masën e detyrimit me (-)175,141 lekë;
- vlera e detyrimit nga procedura e vlerësimit për tu paguar është 111,000 lekë;

*U konstatua se me përfundimin e procedurës së shqyrtimit të ankesave dhe vendimmarrjes, nga KHT nuk është përpiluar asnjë dokument përmbledhës në të cilin të përshkruhen arsyet e zbritjes së vlerës së detyrimit tatimor të pretenduar si dhe personat përgjegjës.*

Përgjegjësi për (mos)vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 42 “Administrimi i mjeteve monetare”, pika 2.

**Pika 2.3. Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.**

▪ **Hartimi i pasqyrave financiare për vitin 2024**

Bashkia Librazhd për vitin ushtrimor 2023 ka plotësuar pasqyrat financiare të vetat sipas formateve nga 1-8 për çdo njësi përbërëse të aparati i bashkisë të cilat i ka dorëzuar në Degën e Thesarit Librazhd me nr. 1041 prot., datë 21.03.2025 dhe konfirmuar në datën 25.03.2025.

Pasqyrat e llogaridhënies vjetore kanë të plotësuar pasqyrat si vijon:

Format 1 - Pasqyra e Pozicionit Financiar,

Format 2 - Pasqyra e Performancës Financiare,

Format 3 - Pasqyra e Flukseve Monetare,

Format 4 - Pasqyra e Ndryshimeve në Aktivitet Neto/Fondet Neto,

Format 5 – Pyetëtori dhe Shënime Shpjeguese,

Format 6 - Pasqyra Investimet dhe Burimet e Financimit,

Format 7/a - Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me kosto historike,

Format 7/b – Pasqyra Gjendje dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata me vlera neto,

Format 8 - Pasqyra Numri i Punonjësve dhe Fondi i Pagave.

Veprimet janë mbartur nga dokumentacioni bazë në ditarët përkatës, në librin e madh dhe më tej në bilanc. Përgatitja e të dhënave për pasqyrat financiare të vitit ushtrimor 2024 janë bërë duke kryer paraprakisht manualisht regjistrimin në mënyrë kronologjike sipas natyrës të të gjitha veprimeve financiare të realizuara gjatë secilit vit ushtrimor; kontabiliteti mbahet në regjistra manual dhe pjesërisht në programin Microsoft Excel;

▪ **Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat Financiare	Administrata me NJA	Data e miratimit në Degën e Thesarit Librazhd
Bashkia Librazhd Nr. 53 prot., datë 24.02.2025	Bashkia Librazhd	Dorëzuar/Datë 24.02.2025 Miratuar/Datë 24.02.2025

Rezulton se Pasqyrat financiare të Bashkisë Librazhd janë përgatitur nga Sektori i financës dhe janë nënshkruar nga NA dhe NZ; janë dërguar në Degën e Thesarit Librazhd dhe miratuar datë 24.02.2025 prej saj, *brenda afatit ligjor*;

- *Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit:*

Për vitin ushtrimor 2024 rezulton verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë të ekstrakteve të bankës (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total, mujor e vjetor, rezultoi se nuk ka diferenca. Për këtë janë përdorur ditar i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi i fondeve sipas llojit të shpenzimeve.

- Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.

Për tu siguruar nëse regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi, u kryen teste në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të vërtetuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike, deri në mbyllje të ushtrimit të mëparshëm;

Nëse informacioni kontabël mundëson në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazim i lëvizjes së ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Bashkisë Librazhd

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e informacionit bazë dhe justifikues;
- Në këtë njësi publike, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë manuale dhe më pak informatike në programin "Microsoft Excel";
- Përditësimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj. Është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletëkontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundur nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vërtetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje daljet, mandat arkëtimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, aktmarrëveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si: faturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar, Pohimet mbi saktësinë e përgatitjes së zërave të pasqyrave financiare.

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të njësisë për aktivitetin ekonomik –financiar të vitit 2024. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e menaxhimit financiar. Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatuan se janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2024 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 223,010,201 lekë.

### **1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)**

Aktiviteti neto janë të barabarta me Aktivitet-Pasivitet

	Viti 2023	Viti 2024
Aktivitet	2,397,248,198 lekë	2,343,314,132 lekë
Pasivitet	209,652,194 lekë	251,132,865 lekë
Aktivitet neto	2,187,596,004 lekë	2,092,181,267 lekë

#### ▪ **Aktivitet afatshkurtra**

Aktivitet afatshkurtra më datë 31.12.2024 paraqiten në vlerën 531,346,670 lekë dhe përbëhen nga:

Llogaritë e Klasës 5 “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 222,462,620 lekë;

Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 84,183,710 lekë;

Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 218,576,661 lekë lekë;

Të tjera aktive aftashkurtra në shumën 6,123,679 lekë.

**Llogaritë e Klasës 5** “Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre” sipas bilancit në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën e 222,462,620 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 223,010,201 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V “Teprica në fillim të vitit ushtrimor” dhe rubrikën VI “Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor” të Formatit nr. 3 “Pasqyra e Flukseve Monetare”(cash-floë), që sipas metodës direkte. përbëhet nga: Llogaria 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 222,343,352 lekë dhe llogaria 532 “Vlera të tjera” në shumën 119,268 lekë, pasqyruar në tabelë si më poshtë:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca (2023-2022)
531	Mjete monetare në arkë	0	0	0
512, 56	Mjete monetare në bankë	0	0	0
520	Disponibilitete në thesar	222,343,352	222,891,593	
50	Letra me vlerë	0	0	0
532	Vlera të tjera	119,268	118,608	6,500
54	Akredeitiva dhe paradhënie	0	0	0
59	Provizione zhvlerësimi	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>222,462,620</b>	<b>223,010,201</b>	<b>6,500</b>

**Llogaria 520** “Disponibilitete në thesar” në shumën 222,343,352 lekë, përbëhet nga: llogaria 85” Rezultati i veprimtarisë ushtrimore (Kredi) dhe gjendja e llogarisë 466 “mjete në ruajtje” në shumën 58,464,274 lekë që përbën 5% garanci kontrate. *Rezulton se* llog. 520 nuk kuadron me shumën e llog. 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” e cila paraqitet në vlerën 77,753,417 lekë dhe llog.466 “kreditorë për mjete në ruajtje”. Pra llog. 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” duhet të kuadrojë me mbartjen e të ardhurave dhe transfertave të vitit 2024 për vitin 2025.

Janë rakorduar me Degën e Thesarit Librazhd, mbartjet e të ardhurave dhe transfertave të vitit 2024 si mëposhtëm:

1. Të ardhura të trashëguara të paçelura në shumën 10,401,962 lekë;

2. Të trashëguara nga granti i papërdorur në shumën 126,346,975 lekë;  
 3. Të ardhura të çelura të papërdorura 14,113,594 lekë;  
 4. Të ardhura jashtë limiti të papërdorura 13,016,547 lekë  
 $\Sigma = 163,879,078$  lekë
- 5- Vlera 5% e palikuiduar në shumën 58,464,274 lekë.

Pra llogaria 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” është nënvlerësuar për shumën 86,125,661 lekë.

**Llogaria 532** “Vlera të tjera” përbëhet nga biletat e tregut, që në mbyllje të viti 2023 janë paraqitur në shumën 118,608 dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 119,268 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Diferenca
Gjendje në 01.01.2024	118,608	660
Hyrje gjatë vitit 2024		
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024		
Gjendja në 31.12.2024	119,268	

Nga proces verbalet e mbajtura në dt. 31.12.2024 dhe Akt rakordimi dt.31.12.2024 nga DF me specialistin e magazinës dhe me specialistin e tregut, rezulton se numri dhe vlera e blloqeve të tregut të hyra dhe të dala nga magazina, të marra në dorëzim dhe përdorur nga specialisti i tregut, *kuadrojnë* me gjendjen në datë 31.12.2024.

Llogaritë e klasës 5 funksionojnë duke u debituar për shtesat në kredi të llogarive përkatëse për të ardhurat dhe grante të ndryshme, si dhe duke u kredituar për pakësimet në debi të llogarive përkatëse të klasës 4.

**Llogaritë e Klasës 3** “Gjendje inventari qarkullues”, përbëhet nga:

Llogaritë kontabël	Emërtimi i llogarive	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
				(2024-2023)
31	Materiale	27,479,272	13,643,293	13,835,979
32	Objekte inventari/Inventar imët	56,704,438	57,315,599	(-)611,161
33	Prodhime, punime e shërbime ne proces	0	0	0
34	Produkte	0	0	0
35	Mallra	0	0	0
36	Gjë e gjalle ne rritje e majmëri	0	0	0
37	Gjendje te pambrojtura ose pranë të trentëve	0	0	0
38	Diferenca nga çmimet e magazinimit	0	0	0
39	Provigjone për zhvlerësim e inventarit(-)	0	0	0
<b>Totali</b>		<b>84,183,710</b>	<b>70,958,892</b>	<b>13,224,818</b>

Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar Librazhd në 31.12.2024 paraqiten në vlerën 84,183,710 lekë dhe përbëhet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në shumën 27,479,272 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte/inventari imët” në shumën 56,704,438 lekë. Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit, vlerë e cila *kuadron* me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” në shumën 13,224,818 lekë.

**Llogaria 312** “Materiale”, në fillim të vitit 2024 ka vlerën 13,643,293 lekë dhe në mbyllje të vitit ka vlerën 27,479,272 lekë, është shtuar me vlerën 13,835,979 lekë, për vlerën e materialeve të blera gjatë vitit 2024 gjendje në magazinë. Lëvizjet e kësaj llogarie për vitin 2024 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Diferenca
Gjendje në 01.01.2024	13,643,293	13,835,979
Hyrje gjatë vitit 2024		
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024		
Gjendja në 31.12.2024	27,479,272	

**Llogaria 327** “Objekte inventari”, në fund të vitit 2023 ka vlerën 57,315,599 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 56,704,438 lekë, është pakësuar në vlerën 611,161 lekë, për vlerën e inventarit të imët hyrje gjatë vitit 2024. Kjo vlerë përputhet me rezultatin e

inventarizimit vjetor. Lëvizjet e llogarisë 32 “Objekte inventari” paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Diferenca
Gjendja në 01.01.2024	57,315,599	(-)611,161
Hyrje gjatë vitit 2024		
Dalje nga magazina gjatë vitit 2024		
Gjendja në 31.12.2024	56,704,438	

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve, llog 63 evidentuar në pasqyrën e performancës financiare. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Llogaritë e klasës 3 funksionojnë duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”. Titullari i ka nxjerrë Urdhrat për ngritjen e komisioneve të inventarizimit të aktiveve për vitin 2024.<sup>11</sup>

**Llogaritë e Klasës 4** “Llogari të arkëtueshme”&“Të tjera aktive afatshkurtra” pasqyrohen në *Aneks PF/1*

- “**Llogari të arkëtueshme**” për vitin 2024 është në shumën 218,576,661 lekë dhe në vitin 2023 është 160,157,421 lekë me një diferencë prej 58,419,240 lekë. Kjo shtesë ka ardhur si rezultat i rritjes së vlerës së llog. 468 “debitorë të ndryshëm” me shumën 13,210,150 lekë për mospagesa ndaj kreditorëve dhe rritjes së llog. 4342 “të tjera operacione me shtetin (debitor)” me shumën 45,209,090 lekë;

- “**Të tjera aktive afatshkurtra**” për vitin 2024 paraqitet në shumën 6,123,679 lekë dhe për vitin 2023 është në shumën 2,035,749 lekë, që përfaqëson detyrimet e prapambetura.

**Llogaria 466** “kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 47,340,416 lekë dhe në vitin 2024 në vlerën 58,464,274 lekë, me një diferencë në rritje prej 11,123,858 lekë. Llog 466 përbëhet nga garanci 5% e investimeve të pasqyruara në tabelë..

Është konfirmuar nga Dega e Thesarit Librazhd me DFB rakordimi i llog.466 dhe analiza e saj është si më poshtë:

Në lekë

Njësi Administrative	Numri i investimeve	Gjendje deri më 31.12.2023	Shtesa 2024	Pakësimi 2024	Gjendje 31.12.2024	Numri
Bashkia Librazhd	71	44,517,634	18,235,510	7,111,626	55,641,518	74
NJA Hotolisht		1,384,299	-	-	1,384,299	
NJA Polis		53,900	-	-	53,900	
NJA Qendër		665,808	-	-	665,808	
NJA Lunik		121,837	-	-	121,837	
NJA Orenjë		370,412	-	-	370,412	
NJA Stëblevë		226,500	-	-	226,500	
<b>Totali</b>	<b>71+</b>	<b>47,340,390</b>	<b>18,235,510</b>	<b>7,111,626</b>	<b>58,464,274</b>	<b>74+</b>

Analiza e detajuar e llog.466 “kreditorë për mjete në ruajtje” pasqyrohet në tabelën *Aneks PF/2*.

**Llogaria 468** “Debitorë të ndryshëm”, e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, në fund të vitit 2023 është 115,544,560 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 128,754,710 lekë.

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë	Debitor në numër
Gjendja në 01.01.2024	115,544,560	
Shtesa gjatë vitit 2024		
Pakësime gjatë vitit 2024		
Gjendja në 31.12.2024	128,754,710	

<sup>11</sup> Trajtuar gjerësisht në nënpikën 3.4 të programit të auditimit.

Llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” ka si kundërparti llog. 470 “të ardhura për tu marrë” ku u konstatua se kjo llogari paraqitet pa vlerë, duke e nënvlerësuar për shumën 128,754,710 lekë. Nga analiza rezulton se vlera e kësaj llogarie ka ardhur në rritje me 13,210,150 lekë në vlerë, për arsye të mospagesave të taksa e tarifa vendore nga biznese e nga familjarë<sup>12</sup>. Kjo llogari përbëhet nga: detyrimet për kuotën ushqimore të kopshteve dhe çerdhen, vlera e blloqeve të tregut të paekzekutuara ngarkuar personave përkatës, vlera e detyrimit të paarkëtuar nga taksat e tarifat vendore në shumën mbi 107,748,411 lekë, vlera e pullave të gjendjes civile të shpërndarë nëpunësve të GJC dhe të paarkëtuar deri në 31.12.2024, si dhe debitorët e 6 Njësive Administrative që i janë bashkuar Bashkisë Librazhd. Shuma e detyrimeve debitohet në llog. 468 “debitorë të ndryshëm” dhe kreditohet në llog. 4341 “të tjera operacione me shtetin (kreditor)”.

Në tabelën e mësipërme në grupin “taksa” është përfshirë vlera debitorë e subjekteve të krijuara nga viti 2015 e deri në 31.12.2024.<sup>13</sup>

Analiza e Llog.468 “Debitorë të ndryshëm paraqitet në *tabelën/Aneks PF3*.

**U konstatua** se nga SFB gjatë vitit 2024 nuk është shtruar për diskutim në takimet e GMS, mbi hartimin e një plani masash për të mundësuar arkëtimin e shumës progresive të deri 31.12.2024 prej 30,450,900 lekë për 383 subjekte debitor në buxhetin e bashkisë.

**Llogaria 4342** “Të tjera operacione me shtetin (debitor)”, në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 44,612,861 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 89,821,951 lekë, vlerë e cila *nuk kuadron* me llog.7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”. Vlera e llog. 4342 përfaqëson llogaritë e klasës 4 “llogari të pagueshme” në pasiv të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar, që përbëhet si në tabelë:

Emërtimi i llogarive	Vlera		
	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
Llogari 401-408	31,417,211	16,567,853	14,849,358
Detyrime personelit llog.42	26,604,475	20,115,974	6,488,501
Tatim mbi të ardhurat llog. 431	2,213,791	1,159,748	1,054,043
Sigurime shoqërore llog.435	5,413,706	4,009,234	1,404,472
Sigurime shëndetësore llog.436	3,724,647	2,760,052	964,595
Organizma të tjerë shtetërorë	-	-	-
Kreditorë të ndryshëm llog.467	6,123,679	2,035,749	4,087,930
<b>Totali</b>	<b>75,497,509</b>	<b>46,648,610</b>	<b>26,796,718</b>

Nga analiza e llog.4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor)” u konstatua se shuma 89,821,951 lekë *nuk kuadron* me shumën e llogarive të pagueshme 75,497,509 lekë (pa përfshirë vlerën e llog.466) duke e nënvlerësuar për shumën 14,324,442 lekë;

**Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”**, në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën 117,171,082 lekë, ndërsa në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 115,663,168 lekë.

Analiza e kësaj llogarie është paraqitur në tabelën më poshtë:

Emërtimi i llogarive	Vlera		
	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
Llog. 411 “klientë e llogari të ngjashme”	-	-	0
Llog. 423,429 “personeli, paradhënie, deficite,gjoha”	-	-	0
Llog. 468 “debitorë të ndryshëm”	128,754,710	115,544,560	13,210,150
<b>Totali</b>	<b>128,754,710</b>	<b>115,544,560</b>	<b>13,210,150</b>

Nga analiza e të dhënave në tabelë dhe e llogarisë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, u konstatua se vlerat e tyre *nuk kuadrojnë* për shumën 10,583,628 lekë.

- *Llogaritë e Marrëdhënieve me shtetin*

Në marrëdhëniet e institucioneve me shtetin përdoren dy llogari specifike dhe karakteristike

<sup>12</sup> Në mënyrë të detajuar te pika 2.6 e programit, rubrika e debitorëve

<sup>13</sup> Në mënyrë të detajuar në aneks të Akt Konstatimit.

për sektorin publik buxhetor. Referuar dhe në zbatim të Udhëzimit nr.5 datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në udhëzimin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.8, datë 09.03.2018 për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, për llogarinë 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” dhe llogarinë 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” citohet:

**Llogaria 4342** “Operacione me shtetin (të drejta)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore, apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabile në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi:

Debitohen llogaritë respektive të klasës 6 “Shpenzime sipas natyrës”;

Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42,43,40,e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi:

Debitohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”;

Kreditohet llogaria 7206 “Financim i pritshëm nga buxheti”.

c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi:

Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4);

Kreditohet llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.

d) Paralel me veprimin e mësipërm artikullohet veprimi tjetër:

Debitohet llogaria 476 “Të ardhura të caktuara për tu përdorur”;

Kreditohet llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)”.

**Llogaria 4341** “Operacione me shtetin (detyrime)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimet që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Veprimet kontabël janë si më poshtë:

a) Pasi ka ndodhur situata dhe është bërë veprimi kontabël:

Debitohet llogaria 411/468, klientë apo debitorë të ndryshëm, për konstatimin e një të ardhure;

Kreditohen llogaritë respektive të klasës 7 për të ardhurën e konstatuar.

b) E ardhura në fund të periudhës ushtrimore nuk është arkëtuar dhe për pjesën që i takon buxhetit, duhet të konstatohet detyrimi:

Debitohet llogaria 8424 “transferime buxheti për debitorë e të ngjashëm”;

Kreditohet llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

c) Në momentin kur arkëtohet e ardhura bëhet veprimi:

Debitohet llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”;

Kreditohen llogaritë 411/468 klientë apo debitorë të ndryshëm.

d) Meqenëse e drejta u arkëtuar dhe llogaria 520 është e thesarit, në fund të periudhave përkatëse bëhet veprimi përkatës:

Debitohet llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”;

Kreditohet llogaria 520 “Disponibilitete në thesar”.

**Llogaria 486** “Shpenzime të periudhave të ardhshme” në fund të vitit 2023 paraqitet në shumën 2,035,749 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet në shumën 6,123,679 lekë, Nga auditimi dhe dokumentacioni raportues nga ana e DFB Bashkia Librazhd në MFE me nr. 1077 prot., datë 23.02.2024, rezulton se: vlera e llog. 486 është 811,918 lekë që përbën detyrimet e prapambetura që bashkia u ka të tretëve për investimet e shërbime etj.<sup>14</sup>

<sup>14</sup> Në mënyrë të detajuar trajtuar në Akt konstatimin për pikën 2.5 të programit të auditimit /detyrimet e prapambetura”

Kjo llogari përfshihet në grupin e llogarive rregulluese. Vlera e kësaj llogarie, përfaqëson detyrime për shpenzime të kryera, por të pa financuara në vitin ushtrimor. Evidentimi i tyre në Pasqyrat Financiare të vitit 2023, është kryer veçmas në përputhje me Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2019 i ndryshuar, pika 42 ku cilësohet: "Të gjitha Njësitet e qeverisjes së përgjithshme duhet të evidentojnë veçmas detyrimet e prapambetura të tyre ndaj të tretëve për shpenzime, "shërbime" apo "investime" të kryera, por të pa financuara".

Llogaritë e klasës 4, funksionojnë duke u debituar për njohjen e të drejtave për tu arkëtuar në kredi të llogarive të klasës 7 dhe duke u kredituar për arkëtimin e të drejtave në debi të llogarive financiare të klasës 5.

## **II. Aktivet afatgjata**

Objektivat e auditimit janë që të sigurohemi se: Aktivet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet e subjektit janë të plota dhe korrekte.

Në Formatin 1 "Pozicioni Financiar", "Aktivet afatgjata" paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet (gjendjen e Ilog.231). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,941,085,935 lekë dhe në fund të vitit 2024 është në vlerën 1,811,967,462 lekë, që përbëhet nga shuma 25,943,363 lekë të AAJM dhe shuma 1,786,024,099 lekë të AAM;

Nr. Reference Llogarije	EMERTIMI	Gjendje ne Fillim vit te vitit	Shtesa gjate vitit ushtrimor, Kosto Historike					Pakësimi gjate vitit , Kosto Historike				Gjendja mbyllje te ushtrimit
			Blerje e krijuar me pagese	Shtesa pa pagese		Lëvizje brenda aktiveve	Gjithsej	Shitje	Nx.jasht përdor	Pakësimi te Tjera	Gjithsej	
				Jashte sistemit	Brenda sistemit							
b	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
20	I. AAGJ/JM	18,426,216	12,000,317	0	0	0	12,000,317	0	0	0	0	25,943,363
21- 28	II. AAGJ/JM	1,922,659,719	220,536,310	699,962			221,236,272	0	0	4,662,464	4,662,464	1,786,024,099
	TOTALI (I + II)	1,941,085,935	232,536,627	699,962	0	0	233,236,589	0	0	4,662,464	4,662,464	1,811,967,462

Burimi: Bashkia Librazhd0

Analiza e secilës llogari të klasës 20 dhe 21 pasqyrohet në Aneks PF/4.

### **Aktivt Afatgjata jomateriale (AAJM)**

**Llogaritë e Klasës 20** "Aktivet Afatgjata Jo materiale", për vitin 2023 janë në shumën 18,426,216 lekë dhe për vitin 2024 janë 25,943,363 lekë dhe përbëhet nga llogaria 202 "studime e kërkime". Ndërsa sipas Formatit 7/a "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" (kosto historike), paraqitet e analizuar si vijon:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	32,361,069
Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	12,000,317
Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	0
Gjendja në 31.12.2024 (D)	44,361,386

Në Formatin 7/b "Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata" (vlera neto), Ilog.202 "studime e kërkime" paraqitet si më poshtë:

Emërtimi i Aktivit Llog. 202	Gjendja më 31.12.2023	Shtesa gjate vitit 2024	Pakësimi gjatë vitit 2024	Amortiz. Akum.	Gjendja më 31.12.2024
Studime e projekte	18,426,216	12,000,317	0	18,418,023	25,943,363

Analiza e llogarisë 202 "studime e kërkime" pasqyrohet në Aneks PF5.

Grupimi sipas viteve të krijimit të aktivit:

Bashkia Librazhd+ 6 NJA	Vitet	2011-2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	totali
	Numri		4	4	-	11	9	1	4	1	1	9
Vlera		1,066,880	4,565,066	-	6,531,936	11,5795,338	1,419,600	3,104,202	72,000	5,402,031	10,604,333	44,361,386

Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë rezultoi se në llog.202 “studime e projekte” janë 44 projekte investimesh të grupuara sipas viteve të krijimit si në tabelë. Nga këto janë 8 projekte të hershme në vlerën totale 5,631,946 lekë, për të cilat u konstatua se **nga SF** nuk është bërë analizë e mirëfilltë e llog. 202 “studime e kërkime” për verifikimin e situatës së projekteve të hershme me qëllim transferimin e vlerës së tyre në llogaritë respektive të klasës 21 “AAM”.

- **Aktivet e afatgjata materiale (AAM)**

**Llogaritë e Klasës 21** “Aktivet Afatgjata Materiale” në Formatin 1 (Aktivi i bilancit), paraqiten me vlerën neto për vitin ushtrimor 2024 në shumën 1,786,024,099 lekë; në vitin paraardhës 2023 vlera totale e AAM-ve paraqitet në shumën 14,922,659,719 lekë, me një pakësim të AAM-ve me (-)136,635,620 lekë.

Kjo Llogari sintetike e analizuar paraqitet nga pakësimi i: llog.211 “Pyje e plantacione” me (-)4,662,464 lekë; llog. 212 “ndërtesa e konstruksione” me (-)93,921,936 lekë; llog. 213 “rrugë, rrjete, vepra ujore” me (-)33,400,878 lekë; llog, 214 “instalime,makineri e pajisje” në shumën (-)2,183,397 lekë; llog. 215 me (-)2,894,449 lekë dhe shtim në llog.218 në shumën totale 427,504 lekë.

21	2.Aktive Afatgjata materiale	Viti 2024	Viti 2023	Diferenca
210	Toka, Troje, Terrene	18,475,912	18,475,912	0
211	Pyje, Plantacione	0	4,662,464	(-)4,662,464
212	Ndërtesa e Konstruksione	559,422,867	653,344,803	(-)93,921,936
213	Rruge, rrjete, vepra ujore	1,132,195,853	1,165,596,731	(-)33,400,878
214	Instalime teknike, makineri e pajisje	18,413,053	20,596,450	(-)2,183,397
215	Mjete Transporti	28,674,584	31,569,033	(-)2,894,449
216	Rezerva Shtetërore			
217	Kafshe pune e prodhimi			
218	Inventar ekonomik	28,841,830	28,414,326	427,504
24	Aktive afatgjata te dëmtuara			
28	Caktime te Aktiveve Afatgjata			
<b>TOTALI AAM</b>		<b>1,786,024,099</b>	<b>1,922,659,719</b>	<b>(-)136,635,620</b>

Sipas Formatit 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,922,659,719 lekë dhe në fund të vitit 2024 në vlerën 1,786,024,099 lekë.

**Llogari 210** “Toka, troje, terrene” paraqitet në mbyllje të viteve 2023 e 2024 në vlerën 18,475,912 lekë; si dhe në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” paraqitet në të njëjtën vlerë.

nr.	Emërtimi i Aktiveve – llog. 210	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësimi gjatë vitit 2024	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Toka, troje, terrene	18,475,912	0	0	18,475,912

Analiza e detajuar e llog. 210 “Toka, troje, terrene” pasqyrohet si në tabelën/Aneks PF5

Një grupim sipas vitit të krijimit pasqyrohet si më poshtë:

Bashkia Librazhd+ 6 NJA	Vitet	Deri në 2010	2010-2020	2020 e në vijim	totali
	Numri	6	3	-	9
Vlera	14,239,917			18,475,912	

**Llogaria 211** “Pyje, plantacione” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në shumën 4,662,464 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 0 lekë dhe kuadron me llog.211 në Formatin 7/a e 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata”. Analiza e llog.211 “Pyje, plantacione” si më poshtë:

nr.	Emërtimi i Aktiveve – llog. 211	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësimi gjatë vitit 2024	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Pyje, Plantacione	4,662,464	0	4,662,464	0

Pakësimi i kësaj llogarie ka ardhur si rezultat i sistemimit të vlerës 4,662,464 lekë në llogarinë 212 “Ndërtesa Konstruksiione” sipas rekomandimit të KLSH-së.

**Llogaria 212** “Ndërtesa Konstruksiione” në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në vlerën neto 653,344,803 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 559,422,867 lekë, me një pakësim prej (-)93,921,936 lekë. Ndërsa në Formatin 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 941,277,988 lekë dhe në fund të vitit 2024 në vlerën 946,072,285 lekë, me një vlerë të shtuar në shumën 4,794,297 lekë që përfaqëson vlerën e investimeve të përfunduara;

Në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto) 653,344,803 lekë; Diferenca 93,921,936 lekë përfaqëson vlerën e shtesës vjetore duke zbritur vlerën e amortizimit (4,794,297-98,716,233). Llog.212 në pasqyrën F1 kuadron me llog.212 në pasqyrën F7/a e F7/b. Analiza e llog.212 paraqitet si më poshtë:

nr.	Emërtimi i Aktiveve – llog.212	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësimi gjatë vitit 2024	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Ndërtim e Konstruksiione	653,344,803	4,794,297	0	386,649,418
					559,422,867

Nga verifikimi i llogaritjes së vlerave të llog.212 “Ndërtesa Konstruksiione” paraqitur në pasqyrën Format 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto), konkretisht vlerës së amortizimit, *rezultoi se* nuk është llogaritur saktë pasi sipas koeficientit të amortizimit për këtë kategori duhet të jetë 32,894,969 lekë në vitin 2024 dhe vlera e amortizimit të akumuluar duhet të ishte 320,828,154 lekë. Në regjistrin e inventarit të llog.212 “Ndërtesa Konstruksiione”, nga verifikimi rezulton se objektet inventarë të regjistruara në këtë llogari, janë konform klasifikimit të Nomenklaturës së llogarive kontabël.

Në mënyrë analitike llog. 212 pasqyrohet në tabelën/Aneks PF 6

Një grupim i aktiveve të llog.212 sipas vitit të krijimit pasqyrohet si më poshtë:

Bashkia Librazhd+ 6 NJA	Grupi	GR.1	GR.2	GR.3	GR.4	GR.5	GR.6	Totali
	Vitet	Deri në 1990	1991-2000	2001-2010	2011-2020	2021-2023	2024	
	Numri	59	17	43	56	15	0	
	Vlera							

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelë u konstatua se:

- Për godinat e GR.1 dhe GR.2 si aktive të ndërtuara shumë herët, nga ana e bashkisë nuk janë ngritur komisione rivlerësimi, me qëllim pasqyrimin në vlerë reale të tyre në kontabilitet;
- Ujësja në vlerën kontabël 5,199 lekë, si aktiv nuk i përket kësaj llogarie, por referuar Nomenklaturës së llogarive kontabël i përket llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”; gjithashtu ky aktiv *nuk është transferuar* në Shoqërinë Rajonale UK Elbasan, referuar dhe në zbatim të Marrëveshjes së lidhur nga kryetarët e 6 bashkive të Qarkut Elbasan 2022.<sup>15</sup>

Nga sa më lart, në regjistrin e inventarit të llog.212 “Ndërtesa Konstruksiione”, rezultoi se objektet inventarë të regjistruara në këtë llogari, nuk janë konform klasifikimit të Nomenklaturës së llogarive kontabël.

**- Hyrjet e AAGJ dokumentohen:**

- Për blerjet, ku si dokumente shërbejnë: kontrata, fatura e furnitorit dhe akti i marrjes në dorëzim ose fletë-hyrja (nëse janë aktive të magazinueshme).
- Për hyrjet në cilësinë e kontributeve në natyrë të kapitalit/fondeve, ku si dokument shërben akt-marrëveshja dhe akti i marrjes në dorëzim të aktivitetit.
- Për prodhimin nga vetë njësia, ku si dokument shërben situacioni përfundimtar dhe akti i marrjes në dorëzim.
- Për rivlerësimet, si dokument shërbejnë aktet ligjore ose nënligjore që autorizojnë një gjë të tillë dhe pasqyrat përkatëse të llogaritjeve.

<sup>15</sup> Marrëveshje mes MIE, AKUM, dhe 6 Bashkitë e Qarkut Elbasan nr. 1630 prot., 27.07.2022 (AKUM)

**Llogaria 213** “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në fund të vitit 2023 në vlerën neto të saj 1,165,596,731 lekë dhe në fund të vitit 2024 paraqitet në vlerën neto 1,132,195,853 lekë me një pakësim në vlerën (-)33,400,878 lekë; Ndërsa në Formatin 7/a “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (kosto historike) paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 3,509,000,652 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 3,715,076,090 lekë, ku diferenca prej 206,075,438 lekë përbëhet nga vlera e investimeve të bëra në vitin 2024 dhe e amortizimeve;

Në Formatin 7/b “Gjendja dhe Ndryshimet e Aktiveve Afatgjata” (vlera neto) paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,165,596,731 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,132,195,853 lekë kuadron me paraqitjen e të dhënave të llog. 213 në pasqyrën Format 1 “Pozicioni financiar”. Diferenca 33,400,878 lekë përfaqëson shtesën duke zbritur vlerën e amortizimit (51,192,760-91,408,845-(-)19103,588). Analiza e llog. 213 është si më poshtë:

nr.	Emërtimi i Aktiveve – llog. 213	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësimi gjatë vitit 2024	Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Rrugë, rrjete, vepra ujore	1,165,596,731	206,075,438	0	2,582,880,237
					1,132,195,853

Analiza e detajuar e llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në tabelën/Aneks PF7  
Në regjistrin e inventarit të llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, nga verifikimi rezulton se 5 objekte të kësaj llogarie janë “ujësjellës”, të cilët referuar dhe në zbatim të VKM nr. 302 datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për organizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” dhe Marrëveshjes së lidhur mes 6 bashkive të Qarkut Elbasan për krijimin e “Shoqërisë Rajonale Ujësjellës Kanalizime Elbasan” –sha, nr. 1650 prot., datë 27.07.2022 (i AKUM), duhet të shkarkohen nga kontabiliteti i njësisë publike/bashkia pas lidhjes së marrëveshjes dhe transferimit të tyre në Shoqërinë Rajonale të Ujësjellës Kanalizimeve Elbasan -sh.a.

Nr.	Emërtimi	viti	çmimi	njësia	Vlera kontabël	
1	Ujësjellësi Semes	2004	3,976,000	1	3,976,000	
2	Mbik. Furn. ujë fshatrat gizavesh dorez	15.09.022	479,206	1	479,206	
3	Ndërtim ujësjellës Polis gostim	27.7.22	9,500,000	1	9,500,000	
4	Ndërtim ujësjellësi Polis -Gostime	18.04.23	49,223,163	1	49,223,163	58,223,163
5	Ndërtim KUZ dhe KUB ne qendër te Komunës Stebleve	2006	4,649,645	1	4,649,645	
6	Ndërtim KUZ dhe KUB ne lagjen e Tupajve dhe Postbllokut ne fshatin Llange dhe blerje tubash	2007	2,196,900	1	2,196,900	
			<b>70,024,914</b>	<b>6</b>	<b>70,024,914</b>	

Nga auditimi dhe informacionit të pasqyruar në tabelën e analizës së llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” **u konstatua se:**

- vlera e investimeve për “ujësjellës e kanalizime” duhet të përfshihen në objektin respektiv dhe jo si inventar më vete; dhe këto objekte duhet të transferoheshin në SHRUK Elbasan –sha dhe shkarkohen nga kontabiliteti i njësisë;

- Gjithashtu rikonstruksione rrugësh, blerje tubash, riparim rrugësh apo kanalesh vaditëse, sistemime etj. janë regjistruar më vete dhe jo duke iu shtuar objektit bazë të investimit, në kundërshtim me SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe jo materiale” pika 43 “*Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme i shtohen kostos së AAM-së vetëm nëse ato përmbushin kriteret e përkufizimit të AAM-së dhe kriteret për njohjen e aktiveve në pasqyrën e pozicionit financiar (duke përfshirë këtu aftësinë e tyre për të marrë pjesë në gjenerimin e përfitimeve të ardhshme ekonomike). Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparimet e vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor*”.

Një grupim i aktiveve të llog. 213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore”, pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

Bashkia Librazhd+ 6 NJA	Grupi	GR.1	GR.2	GR.3	GR.4	GR.5	GR.6	Totali
	Vitet	Deri në 1990	1991-2000	2001-2010	2011-2020	2021-2023	2024	
	Numri							
	Vlera							

Kapitalizimi për vitin 2024 është në vlerën 146,636,971 lekë.

**Llogaria 214** “Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune” në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 20,596,450 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 18,413,053 lekë me një diferencë prej (-)2,183,397 lekë; Ndërsa në formatin 7/a paraqitet në vlerën bruto në mbyllje të vitit 2023 prej 43,544,650 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 45,461,550 lekë. Diferenca prej 1,916,900 lekë përfaqëson vlerën e aktiveve të shtuara nga blerje me pagesë. Të dhënat e llog.214 në pasqyrën format 1 “Pozicioni financiar” kuadrojnë me atë në pasqyrën Format 7/b. Analiza e gjendjes së llog. 214 me ndryshimet nga viti 2023 në 2024 paraqitet si vijon:

nr.	Emërtimi i Aktiveve – llog. 214	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësim gjatë vitit 2024		Autorizim i akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Instalime teknike, makineri, pajisje	20,596,450	1,916,900	0	27,048,497	18,413,053

Në regjistrin e inventarit të llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje”, nga verifikimi rezulton se objektet inventarë të regjistruara në këtë llogari, nuk janë konform klasifikimit të Nomenklaturës së llogarive kontabël. Nga auditimi rezultoi se në llog.214 janë përfshirë aktive të cilat referuar Nomenklaturës së llogarive kontabël i përkasin llog.218 “inventar ekonomik”, artikulli 2184, 2185 dhe 2186, të pasqyruara si në tabelën/ Aneks PF8 (me ngjyrë) dhe të përmbledhur si më poshtë:

**Artikulli 2184 – Fotokopje – 2 copë**

**Artikulli 2185 – Fakse – 1 copë**

**Artikulli 2186 – Pajisje kompjuterike – 108 aktive (copë)**

$\Sigma = 8,140,428$  lekë për 111 aktive të klasifikuara gabim në llog.214

Llogaria 214 është mbivlerësuar për shumën 8,140,428 lekë, shumë e cila ka nënvlerësuar llog.218;

Analiza e detajuar e llog.214 “Instalime teknike, makineri, pajisje” është në tabelën/Aneks PF8.

Një përmbledhëse e grupuar sipas vitit të krijimit pasqyrohet si më poshtë vijon:

Bashkia Librazhd+ 6 NJA	Vitet	2011-2015	2016	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	totali	
	Numri												
	Vlera												

**Llogaria 215** “Mjete transporti”. Kjo llogari paraqet vlerën e mjeteve të transportit në pronësi të Bashkisë Librazhd më datë 31.12.2023 në shumën 31,569,033 lekë dhe në 31.12.2024 në shumën 28,674,584 lekë, ku diferenca (-)2,894,449 lekë (pakësim) është e përbërë nga diferenca e shtesave me vlerën e amortizimit vjetor [2,980,800 + 699,692-67,734,167]. Ndërsa në formatin 7/a lëvizjet e llogarisë janë si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	92,727,989
Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	3,680,762
Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	0
Gjendja në 31.12.2024 (D)	96,408,751

Bashkia Librazhd ka në pronësi të saj 36 mjete në vlerën kontabël 96,408,751 lekë dhe në gjendje aktive 36 mjete transporti<sup>16</sup>, si në tabelën/Aneks PF9

Në pasqyrën Format 7/a llog.215 “Mjete transporti” gjatë vitit 2024 është si në tabelë:

nr.	Emërtimi i Aktiveve - llog. 215	Gjendja 31.12.2023	Shtesa dhe pakësim Gjatë vitit 2024	Amortizim akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Mjete transporti	92,727,989	3,680,762	-	6,575,211

<sup>16</sup> të vlerësuar sipas procesverbaleve nga komisionet e vlerësimit dhe trajtuar në nënpikën 3.4

Gjatë vitit 2024 janë blerë 4 mjete transporti në vlerën totale 3,497,800 lekë, ku **u konstatua** një diferencë prej 182,962 lekë mes vlerës të paraqitur në pasqyrat financiare dhe asaj të regjistrit të aseteve/magazinës.

Një përmbledhëse e mjeteve të transportit të grupuara sipas vitit të krijimit, pasqyrohet si më poshtë:

Bashkia Librazhd+ 6 NJA	Vitet	Deri në 2010	2011-2020	2021	2022	2023	2024	Pa caktuar	totali
	Numri	2	9	2	2	3	4	14	36
	Vlera						3,497,800		96,408,751

**Llogaria 218** “Inventar ekonomik”. Kjo llogari përfaqëson inventarin ekonomik në përdorim nga Bashkia Librazhd. Sipas pasqyrave financiare Format 1 dhe Format 7/b, gjendja e llogarisë 218 më datë 31.12.2023 paraqitet në vlerën 28,414,326 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është në vlerën 28,841,830 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 427,504 lekë, e cila përbëhet: nga blerjet në shumën 4,768,875 lekë me amortizim vjetor prej (-)2,203,526 lekë. Lëvizjet në llog. 218 sipas Formatit 7/a janë si më poshtë:

Lëvizjet e llogarisë	Vlera në lekë
Gjendja në 01.01.2024	82,058,557
Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	4,768,875
Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	-
Gjendja në 31.12.2024 (D)	86,827,432

Analiza e detajuar e llog. 218 “inventar ekonomik” pasqyrohet në tabelën/Aneks PF10.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, **u konstatua se:**

- ka një diferencë në vlerën e shtesës dhe gjendjes në fund të vitit ushtrimor dt.31.12.2024, pasi në regjistrin e aktiveve të bashkisë për vitin 2024 është 86,797,332 lekë ose 30,100 lekë më pak se vlera e llogarisë 218 e paraqitur pasqyrat financiare;

- kategoria “pajisje kompjuterike”, “fakse” dhe “nuk është pjesë e kësaj llogarie dhe e ndarë si nënkategori më vete [2186], [2185] dhe [2184]<sup>17</sup>, duke mos pasqyruar veçmas vlerën kontabël të saj për të saktësuar mënyrën e llogaritjes dhe vlerën e amortizimit. Por nga verifikimi i analizës së llogarisë dhe regjistrit të inventarëve rezultoi se llogaritja e amortizimit për “pajisjet kompjuterike “ është llogaritur saktë prej 25% të vlerës së mbetur.

Në pasqyrën Format 7/b llog. 218 inventar ekonomik pasqyrohet si më poshtë:

nr.	Emërtimi i Aktiveve - llog. 218	Gjendja 31.12.2023	Shtesa gjatë vitit 2024	Pakësimi gjatë vitit 2024	Amortizim akumuluar	Gjendja 31.12.2024
1	Inventar ekonomik	28,414,326	4,768,875	-	57,985,602	28,841,830

Referuar Pasqyrës F7/b vlera neto e AAM në fund të vitit 2023 është 28,414,326 lekë dhe në fund të vitit 2024 është 28,841,830 lekë, ku diferenca prej 4,768,875 lekë, përfaqëson vlerën e blerjeve. Analiza e detajuar e llogarisë 218 pasqyrohet në tabelën/Aneks PF10.

**U konstatua se** ka një diferencë mes shumës së pasqyruar llog.218 në Pasqyrat financiare dhe librit të magazinës me 30,100 lekë;

**Llog 209 & 219** “Amortizimi i AAGJM & AAJM” rezultoi se është llogaritur për çdo aktiv sipas koeficientit të amortizimit. Informacion i detajuar mbi amortizimin vjetor pasqyrohet në tabelën/Aneks PF11.

Nga auditimi i dokumentacionit dhe informacion të paraqitur në tabelat e amortizimit të çdo llogarie, rezultoi se:

Amortizimi është llogaritur sipas normave të çdo llogarie kontabël dhe grupimi, por u **konstatua se** për llog.212 për vitin 2024, është llogaritur me normë të gabuar prej 15%, duke rezultuar se vlera e mbetur e dobishme e secilit aktiv të mos jetë pasqyruar në vlerën e tij reale;

<sup>17</sup> Trajtuar te llog.214 “instalime teknike, makineri, pajisje e vegla pune”

amortizimi për llog.212 e pasqyruar në pasqyrën format 7/b është llogaritur në shumën 98,716,233 lekë ose 65,821,264 lekë më shumë nga vlera reale e tij prej 32,894,969 lekë.

- Grupi i pajisjeve kompjuterike është klasifikuar në llog. 214, por referuar nomenklaturës së llogarive kontabël i përket llog. 218/6. Nga verifikimi për çdo aktiv të këtij grupi, *rezultoi* se amortizimi ishte llogaritur drejt me normën prej 25% të amortizimit.

- Nga auditimi i analizës së llogarive të klasës 2 (për AAGJM) në regjistrin e aktiveve *rezultoi* se amortizimi është llogaritur për çdo aktiv, duke patur kështu informacion mbi aktivet që e kanë vlerën e mbetur të papërfillshme ose zero dhe si rrjedhojë patjen nën kontroll të nevojës për rivlerësimin e atyre që janë në gjendje pune, konform udhëzimit nr. 30/2011 “Menaxhimi i aktiveve në njësitë publike” Kreu II pika 23/d.

- Në llog. 210, llog.211, llog. 212 dhe llog.213 *nuk janë përfshirë asetet e transferuara me VKM* për Bashkinë Librazhd, pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK. *Rezulton* se këto asete janë të pa kontabilizuara.

Një informacion përmbledhës i aktiveve të llogarive të klasës 2 pasqyrohet në *tabelën/Aneks PF12*

**25-26 Aktive Afatgjata Financiare** në pasqyrat financiare pasqyrohet në vlerën zero dhe përbëhet nga:

**Llog. 25** “huadhënie e nënhuadhënie” në vlerën zero;

**Llog.26** “pjesëmarrje në kapitalin e vet” e cila paraqitet në vlerën 0 lekë.

Bashkia Librazhd referuar Ekstraktit të QKB -së **nga viti i krijimit 1999 deri në vitin 2022**<sup>18</sup> **ka qenë** aksionere me 57.92% të pjesëmarrjes në kapitalin e Shoqërisë “Ujësjetës Kanalizime Librazhd Përrenjas” Sha me Nipt- J68122606V, ose me 240,772 aksione me vlerë nominale 1,000 lekë/copa. Nga Bashkia Librazhd në pasqyrat financiare llog. 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” për asnjë vit nuk është pasqyruar pjesa takuese e kapitalit në UK –sha.

Kjo vlerë është përcaktuar referuar Marrëveshjes “Për krijimin e subjektit të kompetencave të përbashkëta të Ujësjetës Kanalizime [SKPUK]” mes 6 Bashkive të Qarkut Elbasan dhe MIE, me nr. Prot., 2298 datë 22.07.2022 për Bashkinë Librazhd. Referuar Ekstraktit QKB të UKR Elbasan-sha themeluar në dt.22.09.2022, Bashkia Librazhd është aksionere me 3.13% të kapitalit të përgjithshëm, ku 51% i takon MIE. DFB në llog. 26 ‘pjesëmarrje në kapitalin e vet’ të pasqyrave kontabël nuk ka regjistruar as vlerën e pjesës takuese të kapitalit të UK Librazhd-Përrenjas dhe as atë të të Shoqërisë Rajonale UK Elbasan- Sha.

Për sa më lart, nga ana e DFB për asnjë vit ushtrimor, nuk është paraqitur në llog.26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” të pasqyrave financiare të vitit 2024, vlera e pjesës takuese të kapitalit në UK-sha e Bashkisë Librazhd në shumën 240,772 mijë lekë.

**Pasqyra statistikore nr. 7/b “Aktivet afatgjata me vlerë neto”**

Përlllogaritja e amortizimit të AAGJM-ve është bërë në përputhje me normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të përcaktuar në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2019 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore, në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar, pika 36.

Normat e amortizimit sipas llojit të aktivitetit të llogaritura nga Bashkia Librazhd, janë si më poshtë:

*ndërtesat dhe konstruksionet, linja teknologjike, makineri e pajisje	5%
*inventarin ekonomik (aktive të tjera afatgjata materiale mbi baze grupimi)	20%
*për pajisjet kompjuterike, informatike (mbi bazë grupimi)	25%
*për mjetet e transportit	20%
*për aktivet afatgjata jomateriale (metoda lineare)	15%

<sup>18</sup> Me nënshkrimin e marrëveshjes për krijimin e “Shoqërisë Rajonale UK Elbasan” Sha

**Llogaria 230 dhe 231 "Investime"** për aktive afatgjata jo materiale dhe materiale sipas të dhënave të paraqitura në Pasqyrën e Pozicionit Financiar për vitin 2023, paraqiten në shumën 0 lekë dhe për vitin 2024 në shumën 0 lekë,

Nr.	Emërtimi i Llog	Gjendja fillim viti 2023	Debi	Kredi	Gjendja me 31.12.2024	Diferenca
1	Aktive Afatgjata jomateriale	0			0	0
2	Aktive Afatgjata materiale	0			0	0
<b>Totali</b>						<b>0</b>

Në Pasqyrën statistikore nr. 6 "Investimet dhe burimi i financimit" shpenzimet për investime paraqiten si më poshtë:

Nr. reshti	Nr. Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Teprica ne Fillim te Vitit	Transaksionet e vitit		Teprica ne Fund
				Debi	Kredi	
a	b	c	d	e	f	g
1	I.	SHPENZIMET PER INVESTIME	4,935,924,00 9		233,236,589	5,169,160,59 8
2	230	Shpenzime për Aktive Afatgjata jo materiale				0
3	231	Shpenzime për Aktive Afatgjata materiale				0
4	25,26	Shpenzime për Aktive Afatgjata Financiare	0			0
5	25	Huadhënie dhe nenhuadhënie				0
6	26	Pjesëmarrje në kapitalin e vet				0
7	II.	BURIMET PER INVESTIME	4,935,924,00 9		233,236,589	5,169,160,59 8
	105	I.Grante Të Brendshme Kapitale				
	1050	Grante Kapitale nga Buxheti	2,338,330,35 5		232,536,627	2,570,866,98 2
	1051	Grante Kapitale nga nivele të tjera	85,745,998		699,962	86,445,960
	1059	Grante të brendshme Kapitale në natyrë	2,511,847,65 6			2,511,847,65 6
29	III.	BALANCA (II-I)				
30		(Burimet për Investime minus Shpenzimet për Investime)	0	0	0	0

Investimet e kryera gjatë vitit 2024 që janë në proces referuar Udhëzimit të MFE nr. 8 dt.09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022, veprimet kontabël ndjekin këto hapa: me çeljen e fondeve - debitohet llog. 520 dhe kreditohet llog. 476; me konstatimin e shpenzimit - debitohet llog. 231 dhe kreditohet llog. 404; në momentin e pagesave- debitohet llog. 404 dhe kreditohet llog. 520; në fund të vitit ushtrimor për fondet e përdorura për investimet në proces debitohet llog. 476 dhe kreditohen llog. 720 dhe llog. 4342 për pjesën e fondeve të përdorura gjatë vitit ushtrimor për llogari të shpenzimeve të realizuara vitin e mëparshëm, por të financuara me fondet buxhetore të vitit ushtrimor raportues; me përfundimin e investimit të konfirmuar me aktin e marrjes në dorëzim të investimit dhe likuidimin total të vlerës së kontratës bëhet kapitalizmi i aktivitetit në debiti llog. 21 (përcaktohet artikulli kontabël) dhe kredi të llog. 231; me kapitalizimin e aktivitetit - debitohet llog. 476 dhe kreditohet llog. 105; kreditohet llog. 1011 dhe debitohet llog.105. Pra të drejtat duhet të evidentohen në kohën e lindjes së tyre dhe detyrimet të evidentohen në pasqyrat financiare në çastin e ndodhjes si shpenzim pavarësisht nga data e pagesës. Në mënyrë analitike aktivitet afatgjata materiale në proces paraqiten në tabelën e llog.466 në aneks të PRA dhe në tabelën/ Aneks PF13.

**Pretendimi i Subjektit:** Me shkresën nr. 6809 prot., datë 03.10.2025, protokolluar në KLSH me nr. 407/7, datë 08.10.2025, nga Drejtoria e Buxhetit, menaxhimit financiar dhe mbështetjes sociale janë paraqitur observacionet si më poshtë vijon:

1. Gjetja mbi plotësimin dhe saktësimin e informacionit të llogarive kontabël në pasqyrat financiare të vitit 2024 dhe konkretisht mbi llogarinë 215. Gjatë plotësimi të pasqyrave

financiare për vitin 2024 është bërë një lapsus në regjistrin e asetëve/magazines është shtuar gabimisht vlera 182,962 lekë , e cila do të sistemohet në vitin aktual. Vlera e saktë është 3,497,800 lekë;

2. Gjetja mbi plotësimin dhe saktësimin e informacionit të llogarive kontabël në pasqyrat financiare të vitit 2024 dhe konkretisht mbi llogarinë 218, pasi në hedhjen e shifrave është bërë një invers. Vlera e saktë është vlera e cila paraqitet në regjistrin e aktiveve në shumën 86,797,332 lekë.

**Qendrimi i grupit të auditimit:** Informacioni i përcjellë nga ana e DBMFMS pranë Bashkisë Librazhd, konfirmon konstatimin e grupit të auditimit. Pra mbetet në fuqi gjetja dhe rekomandimi i dhënë.

## PASIVET (DETYRIMET)

### Pasivet Afatshkurtra

**Llogaritë e klasës 4**, në Pasiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar, janë llogari të pagueshme dhe paraqesin detyrimet deri më 31.12.2024, kundrejt furnitorëve, pagat e punonjësve të muajit dhjetor 2023, detyrimet kundrejt tatimeve, sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore të muajit dhjetor 2024, kreditorë për mjete në ruajtje të cilat kryesisht kanë të bëjnë me garancitë e kontratave, kreditorë të ndryshëm etj., pasqyrohen në tabelën/Aneks PF14.

**Llogaria 401-408** “Furnitorë e llogari të lidhura me to”, në fund të vitit 2023 është 16,567,853 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 është 31,417,211 lekë me një diferencë 14,849,358 lekë; ndërsa gjendja e llog. 401-408 paraqet faturat e palikuiduara ndaj të tretëve nga Bashkia Librazhd deri më 31.12.2024.

**Llogaria 42**, “Detyrime ndaj personelit”, sipas pasqyrave financiare të paraqitura nga Bashkia Librazhd, paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 20,115,974 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 26,604,475 lekë me një diferencë (shtim) në vlerën 6,488,501 lekë. Vlera e llog.42 përfaqëson vlerën e pagave të muajit dhjetor për t’u paguar në muajin janar të vitit pasardhës.

**Llogaria 431**, “Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa”, paraqitet në vitin 2023 në vlerën 1,159,748 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 2,213,791 lekë me një diferencë (shtim) prej 1,054,043 lekë; vlera e llog. 431 përfaqëson vlerën për t’u paguar për taksa e tatime ndaj shtetit për muajin dhjetor dhe e paguar në Janar të vitit pasardhës. Vlera rakordon me vlerën sipas listëpagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2023 për detyrimet tatimi mbi pagën.

**Llogaria 435**, “Sigurime shoqërore” dhe **llogaria 436** “Sigurime shëndetësore” paraqiten në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 4,009,234 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 5,413,706 lekë për sig. Shoq; në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 2,760,052 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 3,724,647 lekë dhe përbën vlerën e papaguar për sigurime shoqërore e shëndetësore për pagat e muajit dhjetor që paguhen në muajin janar të vitit pasardhës. Rezulton se llogaritë janë plotësuar në vlera të sakta dhe se ka informacion analitik për çdo llogari.

Nr.	Pagat Dhjetor 2024	Paga	Sig.shoq&sig shend	Tatimi mbi page
1	Punonjësit e Bashkisë në total	26,604,475	5,413,706 / 3,724,647	2,213,791

Shuma e llog.42, llog.431, llog 435 dhe llog.436 kuadrojnë me pagesat e bëra në bankë në muajin janar 2025, ku sipas Urdhër Shpenzimeve respektive rezultoi si në tabelën/Aneks PF 15.

**Llog. 466** “Kreditorë për mjete në ruajtje” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në shumën 47,340,416 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në shumën 58,464,274 lekë, gjendje e cila përfaqëson vlerën e garancisë 5% kontrate të cilat rakordojnë me Akt rakordimin me Degën e Thesarit Librazhd.

**Llogaria 467** “Kreditorë të ndryshëm”, përfshin faturat e palikuiduara si detyrime ndaj të tretëve për shpenzime, shërbime apo investime të kryera, por të papaguara për mungesë fondesh.

Lëvizjet e llogarisë 467	
Gjendja në 01.01.2024	-
Shtesa gjatë vitit 2024 (D)	
Pakësimi gjatë vitit 2024 (K)	
Gjendja në 31.12.2024	6,123,679

Analiza e llogarisë 467 “Kreditorë të ndryshëm”, pasqyrohet në *tabelën/Aneks PF16*.

**Llogaria 85** “Rezultati i ushtrimit”, paraqitet me tepricë kreditore në vlerën 77,753,417 lekë në mbyllje të vitit 2024 dhe në vlerën 175,551,177 lekë në mbyllje të vitit 2023 me një diferencë (pakësim) në vlerën (-)97,797,760 lekë; dhe paraqet rezultatin nga funksionimi. Vlëra e saj është e barabartë me diferencën e të ardhurave me shpenzimet, që Bashkia Librazhd trashëgon për t’u përdorur në vitin pasardhës sipas dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me akt-rakordimin e mbajtur me Degën e thesarit Librazhd mbi fondet që trashëgohen dhe kuadron me llog. 85 "teprica ose deficiti i periudhës" në pasqyrën format 2 "Performanca Financiare".

- *Pasqyra Format 2 “Performanca financiare” dhe analiza e llogarive të të “Ardhurat” dhe “Shpenzimet”*

Kjo pasqyrë ka rubrikën A – Të Ardhurat dhe Rubrikën B- Shpenzimet.

Nga pasqyra në *Aneks PF/ 17.1* rezulton se rubrika e të “Ardhurave” paraqitet në mbyllje të vitit 2023 në vlerën 1,184,388,923 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 1,199,629,121 lekë me një diferencë (shtim) në shumën 15,240,198 lekë që tregon për përmirësim të vjeljes së taksave e tarifave. Analiza e llogarive të të Ardhurave paraqitet si më poshtë vijon:

- **Llogaria 70** “të ardhura nga taksa e tatime” paraqitet në bilanc të vitit 2023 në vlerën 74,537,529 lekë dhe në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 83,698,217 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me thesarin; llog. 70 përbëhet nga:

- Llogaria 700 “Tatim mbi të ardhurat” në shumën 13,910,730 lekë, që përfshin nënlllog. 7000 “Tatim mbi të ardhurat personale” në shumën 13,629,754 lekë dhe nënlllog. “Tatim mbi biznesin e vogël” në shumën 280,976 lekë;

- Llogaria 702 “Tatim mbi pasurinë” paraqitet në bilanc të vitit 2024 në vlerën 22,722,243 lekë dhe përfshin nënlllog. 7020 “Tatim mbi pasurinë e paluajtshme” në shumën 22,382,206 lekë dhe nënlllog. 7029 ”të tjera tatime mbi pasurinë” paraqitet në vlerën 340,037 lekë;

- Llogaria 703 ”Tatime mbi mallrat dhe shërbimet brenda vendit” paraqitet në shumën 47,041,670 lekë dhe përfaqëson taksën e pastrimit, ndriçimit, ndërtesës, zënie hapësire publike, etj., dhe përbëhet nga: llog. 7033 ”taksë mbi përdorimin e mallrave dhe lejim veprimtarie” në shumën 15,320,971 lekë dhe llog.7035 “taksa vendore mbi përdorimin e mallrave e lejim veprimtarie” në shumën 31,720,699 lekë;

- Llogaria 708 “të tjera tatime e taksa kombëtare” paraqitet në shumën 23,574 lekë, krahasuar me vitin 2023 është 2,676 lekë. Kjo llogari përfaqëson pullat e gjendjes civile;

- **Llogaria 71** “të ardhurat jo tatimore” paraqitet në bilanc të vitit 2024 në vlerën 59,093,347 lekë, e cila kuadron me akt-rakordimin me thesarin;

- Llogaria 710 “të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia” paraqitet në vlerën 22,282,199 lekë dhe përfshin vlerën e nënlllog. 7109 "të tjera nga ndërmarrjet dhe pronësia" dhe përbëhet qiraja e aseteve;

- Llogaria 711 “shërbimet administrative dhe të ardhura sekondare” në vlerën 36,605,148 lekë, që përbëhet nga: nënlllog. 7110 "Tarifa administrative dhe rregullatore" në vlerën e 26,212,192 lekë;

nënlllog. 7111 "të ardhura sekondare dhe pagesa shërbimesh" në vlerën 8,665,445 lekë;

nënlllog. 7113 "të ardhura nga shitja e mallrave dhe shërbimeve" në vlerën 143,500 lekë;

nënlllog. 7115 "gjyba, kamatëvonesa dhe zhdëmtime" në vlerën 1,584,011 lekë;

- **Llogaria 72** “Grante korrente” në bilancin e vitit 2024 paraqitet në shumën 1,056,837,557 lekë dhe përbëhet nga:
    - llogaria 720 “Grant korrent i brendshëm” paraqitet në vitin 2024 në shumën 1,056,837,557 lekë në të cilën përfshihen:
      - nënlllog. 7200 "Nga buxheti për NJQP (qendrore)" në vlerën 595,342,320 lekë;
      - nënlllog. 7201 "Nga buxheti për NJQP (vendore)" në vlerën 436,587,154 lekë
      - nënlllog. 7204 "Pjesëmarrje në institucione në tatime nacionale" në vlerën 139,225 lekë;
      - nënlllog. 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" në vlerën 6,123,679 lekë, e cila nuk kuadron me shumën e gjendjes së llog. 4342 “operacione me shtetin (të drejta)”, e nënvlerësuar për 83,698,272 lekë;
      - nënlllog 7207 "sponsorizime të brendshme (nga të tretë)" në vlerën 18,645,179 lekë;
  - **Të Ardhura të tjera** në pasqyrat e bilancit të vitit 2024 paraqitet në shumën 0 lekë;
- Llogaria 73** “Ndryshim i gjendjes së inventarit të produkteve” paraqitet në shumën 0 lekë.  
Të Ardhurat rakordojnë me Seksionin e të Ardhurave në Degën e Thesarit Librazhd.

### **Rubrika B -SHPENZIMET**

Referuar të dhënave në pasqyrën Aneks PF/17.2, kategoria “Shpenzimet“ Kategoria “Shpenzimet“ për vitin 2023 paraqitet në shumën 1,008,837,746 lekë dhe në vitin 2024 paraqitet në shumën 1,121,875,704 lekë, dhe përbëhet si më poshtë vijon:

- **Llogaria 600** “paga dhe përfitime e punonjësve” paraqitet në mbyllje të vitit 2024 në vlerën 323,700,309 lekë, dhe rakordon me akt rakordimin me thesarin; vlera e kësaj llogarie përfshin nënlllog. 6001 “paga personeli i përhershëm” në shumën 323,700,309 lekë;
- **Llogaria 601** “kontribute të sigurimeve” në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 53,209,106 lekë , ku dhe përmban llogarinë/nënlllog. 6010 “kontribut i sigurimeve shoqërore” në shumën 47,792,610 lekë dhe nënlllog. 6011” kontribut i sigurimeve shëndetësorë” në shumën 5,416,496 lekë.
- **Llogaria 602** “blerje mallra e shërbime” në mbyllje të vitit 2024 paraqitet në vlerën 142,864,788 lekë dhe përbëhet nga vlerat e llogarive si më poshtë:
  - nënlllog. 6020 “materiale zyre të përgjithshme” në vlerën 3,624,157 lekë;
  - nënlllog. 6021 “materiale dhe shërbime speciale” në vlerën 17,416,364 lekë;
  - nënlllog. 6022 “shërbime nga të tretë” në vlerën 73,150,086 lekë;
  - nënlllog. 6023 “shpenzime transporti” në vlerën 20,402,949 lekë;
  - nënlllog. 6024 “shpenzime udhëtimi” në vlerën 3,054,246 lekë;
  - nënlllog. 6025 “shpenzime për mirëmbajtje të zakonshme” në vlerën 11,500,000 lekë;
  - nënlllog. 6026 “shpenzime për qiramarrje” në vlerën 1,435,263 lekë;
  - nënlllog. 6027 “Shpenzime për detyrime për kompensile legale” në vlerën 0 lekë;
  - nënlllog. 6029 “shpenzime të tjera operative” në vlerën 12,281,723 lekë.
- **“Transferime korente”** në pasqyrat financiare të bilancit të vitit 2024 paraqiten në vlerën 615,326,319 lekë, dhe përbëhet nga:
  - **Llog. 604** “Transferime korrente të brendshme” paraqitet në shumën 28,910,955 lekë dhe përfshin nënlllog. 6040 “Transferime korente në nivele të tjera të qeverisë” në shumën 28,910,955 lekë;
  - **Llog. 606** “transferime për buxhete familjare e individë” që përfshin nënlllog. 6061 “transferta paguara nga Inst.Tjera e Org.Pushteti. Vendor” në shumën 586,415,364 lekë, për pagesat për PAK, Ndihmë ekonomike, Ndihmë raste emergjente e të ndryshme, ndihmë për fatkeqësi natyrore, etj.,
  - **Llog. 63** “ndryshimi i gjendjes së inventarit” në vlerën (-)13,224,818 lekë, e cila kuadron me diferencën e klasës 3 të formatit 1 të bilancit;
  - **Llog. 85** “teprica ose deficieti i periudhës (rezultati i veprimtarisë së vitit ushtrimor)” është në vlerën 77,753,417 lekë dhe përbëhet nga fondet e papërdorura të cilat trashëgohen për tu

përdorur në vitin 2025. Kjo vlerë rakordon me diferencën mes të ardhurave dhe shpenzimeve dhe kuadron me llog.85 të formatit 1 të bilancit..

- **Formati 5** “shënime shpjeguese” është plotësuar sipas formatit të miratuar;

- **Formati 8** “numri i punonjësve dhe fondi i pagave” është plotësuar saktë, duke dhënë një pasqyrim të plotë të shpërndarjes së fondit të pagave sipas kërkesave të formatit. Pasqyrimi në tabelën/Aneks PF 16.

–Tek Formati 8 i bilancit, Fondi i pagave gjithsej është i barabarte me llog 6001 Paga personeli te Formatit 2 i Bilancit;

-Kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore te Formatit 8 i Bilancit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës ( llog 435+llog 436).

-Tatimi mbi të ardhurat te Formatit 8 i Bilancit është i barabartë me pagesat e kryera për këtë llogari që janë të pasqyruara në evidencën e realizimit të shpenzimeve me thesarin si dhe është pasqyruar në ditarin e bankës (llog. 431).

-U kërkuar dhe u verifikuan borderotë e viti 2024. Rezultuan praktikë e plotë dokumentare dhe me nënshkrimin e personave përgjegjës.

Për pasqyrën Format 8 janë zbatuar drejt Udhëzimi i MFE nr.8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin e MFE nr. 5 datë 21.02.2022, kreu I, II dhe III; Aneks I

### 3.3 Rregullshmëria e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës dhe arkës.

Bashkia Librazhd të ardhurat nga tarifat dhe taksat vendore i vjel nëpërmjet UK Librazhd tani UK Rajonale Elbasan. Përrjashtim bën vetëm tarifa e tregut e cila arkëtimet i realizon në sportelet e bashkisë manualisht si dhe taksat e tarifat e 6 NJA.

1. Veprimet me bankën, u verifikuan disa Urdhër shpenzimi të cilat bashkëngjitur përmbanin praktikën e plotë dokumentare sipas kuadrit ligjor në fuqi: dokumenti autorizues, vërtetues dhe të kontabilitetit.

2. Veprimet me arkën Nga auditimi i dokumentacionit për veprimet me arkën rezultoi se:

- Arkëtimet kryhen në sportelet e bashkisë apo NJA në Librat e arkës;

- Kryhen akt rakordimet ditore/javore/mujore midis arkëtares dhe specialistit të tregut;

Mes specialistes së taksave dhe DTTV;

- Akt rakordim mujor mes Sektorit të financës dhe Sektorit të Taksa e Tarifave vendore me degën e Thesarit.

- Akt rakordim mes Sektorit të të ardhurave dhe UKR Elbasan-sha.

Gjithë dokumentacioni i mësipërm përmban nënshkrimin e personave përgjegjës të secilës procedurë. *Rezultoi se* arkëtimet në sportel bëhen manualisht, nuk operohet me kasë fiskale, në kundërshtim me kuadrin ligjor për fiskalizimin.

Mosveprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” KREU III paragrafi “Dokumentimi i vlerave monetare dhe atyre me vlerë” pika 61-72.; Ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” neni 2 dhe neni 4/c etj.

### - 3.4 Procedura e inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Librazhd.

**I.** Bashkia Librazhd nëpërmjet Urdhrit të Titullarit nr. 329 datë 03.10.2024 dhe me nr. 4742 prot., datë 03.10.2024, është ngritur komisioni i inventarizimit fizik vlerësimit paraprak sipas tabelës/Aneks PF 16.

Nga Auditimi i praktikës dokumentare të inventarizimit **rezultoi se:**

- Komisioni i inventarit fizik dhe ai i vlerësimit të aktiveve është i njëjtë, konform nenit 97 të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar;

- Komisioni i inventarizimit dhe i vlerësimit paraprak të aktiveve ka ndarë në dokumente të veçanta Relacionin për mbylljen e inventarizimit fizik të njësisë dhe Relacionin e vlerësimit paraprak të inventarëve cilësuar si të dëmtuara, konform pikës 82 dhe 99 Kreu IV të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar;

- Komisioni i inventarizimit fizik dhe i vlerësimit paraprak të aktiveve ka përpiluar proces verbalët për çdo njësi të strukturës e përfshirë në procesin e inventarizimit konform pikës 85/a të Udhëzimit nr. 30/2011, ka hartuar Relacionin përmbledhës mbështetur mbi shënimet tek kartela kontabël e vënë në dispozicion nga zyra e financës. Relacioni përmbledhës ka informacionin si më poshtë vijon:

Në lekë

nr.	Emërtimi	Llog.214	Llog. 218	Llog. 327	Shuma totale
1	NJA Polis	-	1,972,521	368,435	<b>2,340,956</b>
2	NJA Hotolisht	11,650	367,397	1,068,434	<b>1,447,481</b>
3	Shkolla 9 vjeçare “Genc Leka”	301,196	1,075,449	160,610	<b>1,537,255</b>

- Nga auditimi u konstatua se nuk është ngritur Komisioni i Vlerësimit të aktiveve të cilësuar të dëmtuara, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar, kreu IV pika 95-99; pika 102; pika104-106;

▪ Vlerësimi i aktiveve bëhet sipas këtyre kritereve:

a) kur është plotësuar koha e shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen;

b) kur riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe kur nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër;

c) kur thyhen ose dëmtohen në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit;

d) kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm;

e) kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formën tjetër;

f) kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;

g) kur janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e fuqisë madhore (tërmet, përmytje, zjarr etj.) ose ndodhive të rastit;

h) kur si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesëm ose afatgjatë nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje

- Në përfundim të procedurës së inventarizimit të njësisë, nuk është hartuar dhe miratuar Regjistri i aktiveve të bashkisë (për vitin 2023 pasi procedura për vitin 2024 është në proces). Nga SFB është hartuar vetëm regjistër elektronik i cili përfshin informacionin e plotë sipas kërkesave ligjore, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26,27,28 të Udhëzimit nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar;

- Me Urdhrin nr. 96 datë 28.01.2025 të Kryetarit dhe nr. 24 prot., datë 28.01.2025 është ngritur komisioni për asgjësimin dhe tjetërsimin e aktiveve në pronësi të Bashkisë të nxjerra jashtë përdorimit”;

- Nga komisioni është miratuar lista e aktiveve për nxjerrje jashtë përdorimit të komisionit të verifikimit dhe vlerësimit paraprak, duke specifikuar gjendjen e çdo aktivi: i thyer, konsumuar etj. **Rezultoi se** nga komisioni për asgjësimin dhe tjetërsimin e aktiveve të dëmtuara, nuk është bërë klasifikimi i tyre sipas procedurës që do ndiqet: për skrap, për groposje, për thyerje/djegje,

në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 107-112;

**Konkluzion:** Mbi procedurën e inventarizimit të aktiveve në Bashkinë Librazhd, rezultoi se nga komisionet e inventarizimit të aktiveve, nuk janë dokumentar të gjitha fazat e ndjekura në mospërmbushje të kërkesave të përcaktuara në Udhëzimin nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar.

**II.** Në Bashkinë Librazhd, çdo vit me Urdhër të Titullarit ngrihen komisionet për vlerësimin e sasisë së karburantit që i duhet secilit mjet të bashkisë të qarkullojë sipas funksioneve të përcaktuara. Referuar kryesisht Udhëzimit nr. 30/2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar, pika 23, janë ngritur këto komisione:

- Urdhri i Kryetarit nr. 90 datë 22.01.2024 është ngritur komisioni i për llogaritjen e normativave të harxhimit të karburantit për vitin 2024 nga mjetet e transportit në pronës të Bashkisë Librazhd:

Nr.	Emër Mbiemër	statusi	Pozicioni në strukturë	Formimi profesional	Proces verbali
1	A H	Kryetare	P. Sektori i Financës	financë	26 copë  Date 22.01.2024 deri në date 30.01.2024
2	E H	anëtar	P. Sektori i Transportit		
3	M M	-//-	Sp. Sektori i Shërbimeve		
4	I Ç	-//-		mekanik	
5	B K	-//-		Inxhinier	

Nga proces verbalet e mbajtura për çdo mjet nga ana e komisionit, rezultoi se mjetet konsumojnë sasi karburanti brenda normave të lejuara të efektivitetit, duke dhënë indirekt një vlerësim të pranueshëm mbi gjendjen e motorrit të mjeteve të transportit.

**Konkluzion:** Nga Bashkia Librazhd ndiqen rregullisht ecuria e performancës së mjeteve të transportit, me qëllim përdorimin me ekonomikitet të fondeve të buxhetit të bashkisë.

#### **Pika 2.4. Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve.**

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit në subjektin Bashkia Librazhd, rezulton se janë hartuar regjistrat e parashikimeve dhe realizimeve për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024, të miratuara në sistem (SPE) nga APP-ja dhe të dërguara pranë Degës së Thesarit Librazhd.

Për kryerjen e auditimit mbi disponimin e fondeve dhe angazhimin e tyre për kryerjen e procedurave të prokurimit publike për periudhën objekt auditimi, nga grupi i auditimit, në lidhje me AK Bashkia Librazhd, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- *Regjistri i parashikimeve dhe realizimeve të prokurimeve publike për vitin 2024;*
- *Dokumentacioni i vënë në dispozicion nëpërmjet dosjeve fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në lidhje zhvillimin e procedurave si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave.*

Në mënyrë të përmbledhur, nga të dhënat mbi procedurat e prokurimeve për periudhën objekt auditimi 01.01.2024 - 31.12.2024, në subjektin Bashkia Librazhd, rezultoi se në total janë realizuar gjithsej **30** procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit prej 576,723 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur pa TVSh prej 479,687 mijë lekë ose 83.17% e fondit të prokuruar.

Pjesëmarrja gjithsej në procedurat e realizuara është prej **106** OE, nga ku janë skualifikuar **25** OE, ku në **7** procedurat janë skualifikuar OE me ofertë ekonomike më të ulët se OE të shpallur fitues me një fond limit 272,798 mijë lekë ose 47.3% e fondit të prokuruar. Janë zhvilluar procedura prokurimi me pjesëmarrje e vetëm 1 (një) OE, gjithsej **7** procedura me fond limit 35,852 mijë lekë ose 6.2% e fondit të prokuruar.

Nga grupi i auditimit mbi bazën e riskut dhe të materialitetit nga **30** procedura prokurimi me vlerë të lartë me fond limit prej 576,723 mijë lekë, ka vlerësuar për auditim **8** procedura me fond limit prej **464,216** mijë lekë ose **80.49%** e fondit të prokuruar. Në procedurat e audituara kanë rezultuar disa parregullsi në shkelje apo mos zbatim të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, si dhe akteve të tjera nënligjore të LPP, si më poshtë vijon:

- Nga 8 procedura prokurimi të audituara, rezultoi se në **8 procedura** me fond limit 464,216 mijë lekë ose 100 % e fondit të audituar (464,216 mijë lekë), janë konstatuar mangësi në specifikimet teknike dhe kriteret e aplikuara, të cilat janë të paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat kanë çuar në mos pjesëmarrje e operatorëve ekonomik në garë dhe ose në skualifikim e operatorëve ekonomik me ofertë më të leverdishme dhe me mundësi për realizimin e kontratës. Sipas të dhënave, rezultoi të jenë zhvilluar procedura me pjesëmarrjen e vetëm të një OE, 7 procedura me fond limit 35,852 mijë lekë ose 6.2% e fondit të prokuruar.

- Nga 8 procedura prokurimi të audituara, rezultoi se në **7 procedura** prokurimi me fond limit 389,216 mijë lekë ose 83.84 % e fondit të audituar (464,216 mijë lekë), nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, janë kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet kur këta të fundit nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, veprime të cilat kanë çuar AK në lidhjen e kontratave të zbatimit të punimeve me OE të cilat nuk plotësojnë të gjitha kërkesat e DST.

- Në disa prej procedurave, kryesisht të procedurave me destinacion investime publike të ndryshme, rezultoi se nuk është bërë pjesë e dosjes së prokurimit në momentin e lidhjes së kontratës “*leje ndërtimi/infrastruktura*”, veprim ky në kundërshtim me nenin 39<sup>19</sup> pika 3<sup>20</sup> të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar. Gjithashtu, për disa nga investimet e realizuara, në dosjen **nuk** rezultoi të jetë kryer *oponenca teknike*, edhe pse objekti i procedurës është një ndërtim publik apo me akses publik, veprime në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6, të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, si dhe pikës 4 të VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e oponencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”.

Në kuptim të Ligjit nr. 107/2014, referuar nenit 52 të tij, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponente teknike dhe lejes së ndërtimit, pavarësisht nëse përbën vepër penale, përbën kundërvajtje administrative të sanksionueshme me gjobë.

Miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një oponente teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit, për të cilën ngarkohet me përgjegjësi Titullari i AK- Bashkia Librazhd dhe Drejtorin e Planifikim Zhvillim, Kontroll Territorit, konkretisht për rastet:

1. Procedura me objekt “Asfaltim i rrugës Lunik-Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik, Bashkia Librazhd”, mungon leje e zhvillimit dhe oponenca teknike;

2. Procedura me objekt “Ndërtim i një qendre rinore ne Bashkinë Librazhd”, mungon oponenca teknike;

---

<sup>19</sup> përcakton se: “Leja e ndërtimit është e nevojshme për çdo ndërtim, riparim, restaurim apo prishje të objekteve ekzistuese, instalim apo ngritje të ndërtimeve të përkohshme, me përjashtim të rasteve të parashikuara nga neni 41 i këtij ligji”

<sup>20</sup> përcakton se: “Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit”.

3. Procedura me objekt "Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefqet Dosku"Librazhd", mungon oponenta teknike;

4. Procedura me objekt "Rikonstruksion i kanalit vaditës te Allanit Dorez-Gizavesh-Librazhd Qendër", mungon leje e zhvillimit.

- Në të gjitha dosjet e audituara të procedurave të prokurimit, konstatohet se dosjet fizike të prokurimit, e cilat ndër të tjera përmban procesverbalet për përgatitjen e procesit të prokurimit, dokumentet e tenderit, procedurat e përcaktimit të fituesit, procesverbalet e mbledhjeve etj., si dhe dosja e cila përmban dokumentet që shoqërojnë ofertën e OE fitues, janë ose jo (në rast të veçanta) të pajisura me inventarin e brendshëm të dosjes për të gjithë përmbajtjen e tyre, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë, konstatohet se fletët e dosjes, nuk janë të numëruara në çdo faqe me laps të zi, në kundërshtim me germën (g), të nenit 8- "Përpunimin tekniko-shkencor i dokumenteve të prapambetura", të Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 "Për miratimin e rregullave të njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH". Gjithashtu, referuar Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", i ndryshuar dhe Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, Veprimtaria e Kontrollit, si një prej pesë komponentëve të MFK, përmban detyrimin e hartimit të procedurave për dokumentimin, arkivimin dhe ruajtjen e informacionit, të cilat duhet të vendosen për të mbështetur kryerjen e operacioneve dhe kontrollimin e proceseve në njësinë publike.

Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara, mbartin riskun, e cënimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit, duke ngarkuar me përgjegjësi personin përgjegjës të procedurës, në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të PP", i ndryshuar, **neni 78, pika 2** e ku përcaktohet se: "Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre..."; **neni 74, pika 3**, ku përcaktohet se: "Personi/at përgjegjës për prokurimin kryen/jnë detyrat e mëposhtme:...Hartimin dhe dërgimin e njoftimeve për publikim, brenda afateve kohore; Administrimin e të gjitha procesverbaleve për dokumentet e tenderit dhe çdo dokument tjetër, që lidhet me procedurat e përcaktimit të fituesit...; Administrimin e dokumentacionit në formë të shkruar, origjinal ose fotokopje të noterizuar të operatorit ekonomik fitues, përpara lidhjes së kontratës nga autoriteti kontraktor"; Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", , i ndryshuar dhe Ligji nr. 9154 datë 06.11.2003 "Për arkivat"; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, **veprime të cilat ngarkojnë me përgjegjësi personin përgjegjës të procedurës dhe titullarin e AK.**

Në mënyrë të detajuar, nga të dhënat mbi procedurat e prokurimeve të audituara për periudhën 01.01.2024 -31.12.2024, për Bashkinë Librazhd, situata paraqitet si më poshtë vijon:

**I- Nga shqyrtimi i dokumentacionit** të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në procedurën me objekt: "**Asfaltim i rrugës Lunik Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik Bashkia Librazhd**", në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave , u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", etj., konkretisht si vijon:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "**Asfaltim i rrugës Lunik Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik Bashkia Librazhd**"

<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-20062-09-17-2024 Urdhri nr. 4363 prot., datë 16.09.2024	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, Urdhri nr. 808 prot., datë 11.09.2024</b> 1. A H 2. A P 3. Xh B	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 820 prot., datë 16.09.2024 1. D B 2. Xh B 3. A H	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 822 prot., datë 16.09.2024. 1.K B 2.E Gj 3.K Ll
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 54,166,663 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 44,216,352 lekë Fitues: OE “P-V-K” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 9,950,310 lekë ose 81.6% e fondit	
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 04.10.2024	<b>8. Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Bashkisë Librazhd</b> VKB nr. 119, datë 29.12.2023 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2024”.	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër <b>3 B/OE</b> b) S’kualifikuar <b>0 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>3 B/OE</b>	
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 6 muaj	<b>11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit (sipas SPE):</b> Data: 11.10.2024 (Paraprak) Data: 05.11.2024 (Përfundimtar)	<b>12.Data e lidhjes së kontratës:</b> Data: 12.11.2024 (lidhja) Data: 12.11.2024 (njoftimi i lidhjes)	
<b>10.Ankimime</b> <b>AK-s’ka/ka; -Jo</b> <b>APP-s’ka/ka;-Jo</b> <b>KPP-s’ka/ka;-Jo</b>			

**- AK në lidhje me “Përlogaritjen e Fondit Limit”:**

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se Projekti, Preventivi i Punimeve dhe Relacioni Teknik, në lidhje me këtë procedurë, janë përgatitur nga shoqëria “S-A” ShPK. Referuar preventivit, ndër të tjera, specifikohet se vlera e objektit të kontratës është përlogaritur 54,166,663 lekë pa TVSh. Pjesë e dosjes së prokurimit ndodhet leja infrastrukturore nr. 5757, datë 21.01.2025.

**- AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin e Specifikimeve Teknike dhe Hartimin e Kritereve”:**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit datë 17.09.2024 “Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4, ku është përcaktuar se:

“Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kritereve”.

E konkretisht:

**Në pikën 2.3.3 të DST, janë kërkuar kategoritë e licencës:**

Kategoria	klasifikimi	Përshkrimi
NP-1	G	Punime gërmimi dheu
NP-2	G	Ndërtime civile dhe industriale
NP-3	G	Rikonstruksion dhe mirëmbajtje objekteve civile dhe industriale, veshje fasade
NP-4	G	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaje, metro, pista aeroporti
NP-5	G	Punime nëntokësore, ura dhe vepra arti
NP-6	A	Diga dhe tunele hidroteknike
NP-7	G	Ujësjellës, gazsjellës, naftësjellës, punime kullimi dhe vaditjeje
NP-8	C	Ndërtimi dhe gërmimi detar dhe punime thellimi në ujë
NP-9	G	Punime dhe mbrojtje lumore, sisteme hidraulike dhe bonifikimi
NP-10	B	Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike
NP-11	F	Konstruksione për nënstacione, kabina transformatorësh të linjave të tensionit të lartë dhe të mesëm dhe shpërndarje të energjisë
NP-12	G	Punime të inxhinierisë së mjedisit
NS-1	D	Punime për prishjen e ndërtimeve
NS-2	D	Impiante hidrosanitare, kuzhine, lavanderi dhe mirëmbajtja e tyre
NS-3	C	Impiante ngritëse dhe transportuese (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
NS-4	F	Punime rifiniture murature dhe të ngjashme, rifiniture me materiale druri,

Kategoria	klasifikimi	Përshkrimi
		plastike, metali dhe qelqi dhe rifinitura te një natyre teknike ndërtimi
NS-5	E	Impiante të sinjaleve të ndriçuara të trafikut
NS-6	G	Sinjalistika Rrugore jo ndricuese
NS-7	G	Barriera dhe mbrojtje rrugore
NS-8	G	Konstruksione parafabrikate prej betoni, konstruksione metalike dhe druri
NS-9	G	Punime strukturore speciale
NS-10	G	Shtresë dhe superstrukturë speciale.
NS-11	E	Punime mbi shina dhe traversa
NS-12	D	Impiante teknologjike, termike dhe klimatizuese
NS-13	E	Impiante dhe linja telefonike dhe telekomunikacioni
NS-14	D	Impiante të brendshme, elektrike, telefonike, radiotelefonike, TV
NS-15	F	Pastrimi i ujërave detare, liqenore dhe lumore
NS-16	G	Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimi i tij.
NS-17	F	Ndërtimi i impianteve të grumbullimit dhe trajtimit të mbetjeve urbane.
NS-18	E	Punime topogjeodezike
NS-19	E	Sisteme kundër zhurmës për infrastrukturën.
NS-20	G	Shpime gjeologo-inxhinierike, puse dhe shpime për ujë.

Kategoritë e mësipërme janë të paargumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, si për zërat e punimeve po ashtu dhe për volumin që ato përfaqësojnë. Një kërkesë e tillë çon padyshim në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë.

**Në pikën 2.3.3, të DT, është kërkuar që OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë : Arkitekt 1 (një) dhe Inxhinier Mjedisi 1 (një).**

*Gjithashtu është kërkuar jo domosdoshmërisht në licencën e shoqërisë: 1 – (1) Inxhinier Gjeomjedis – i cili jo detyrimisht te jete i përfshire ne licence ( staf mbështetës), 2- (1) Inxhinier Ndërtimi - i cili jo detyrimisht te jete i përfshire ne licence ( staf mbështetës), 3- (1) Inxhinier Gjeodet - i cili jo detyrimisht te jete i përfshire ne licence ( staf mbështetës).*

Kërkesat e mësipërme nuk janë të mirëargumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës ose të rënduara, pasi kërkesa për arkitekt dhe ing. Mjedisi janë kërkesa të cilat ezurohen gjatë fazës së hartimit të projektit. Në lidhje me arkitektin, është një kërkesa e panevojshme pasi nuk kemi të bëjmë me ndërtim apartamentesh por objekti është rikonstruksion rrugë. Gjithashtu dhe kërkesat për ing. Gjeomjedis, ing. Ndërtimi dhe ing. Gjeodet, janë kërkesa të rënduara pasi janë kërkuar njëherë kur ato duhet të jetë pjesë e licencës së shoqërisë.

**Në pikën 2.3.4 të DT, është kërkuar që OE pjesëmarrës duhet të disponojnë staf teknik dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë: Arkitekt 1 (një), Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit 1 (një); Hidraulikë 3 (tre), Elektricitistë 3 (tre), Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse 2 (dy), Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashëm 2 (dy), Hidroizolues 4 (katër), Specialist gipsi 3 (tre), Suvatues 4 (katër), Punonjës duro-alumini 1 (një), Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to 2 (dy).**

Kërkesat e mësipërme janë në mos përputhje me tipologjinë e procedurës dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP. Nuk ka asnjë argument shpjegues nga AK, se pse janë kërkuar specialistet e mësipërm, kur nuk përkojnë me zërat e punimeve sipas preventivit.

**Në pikën 2.4.2 të DST, OE për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: 1 (një) ekspert mjedisi i pajisur me certifikatën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedisi i cili duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën 3 (tre) muajt e fundit, vërtetuar me kontratë pune dhe certifikatën përkatëse.**

Ky kriter është i panevojshëm, pasi procesi i vlerësimit të mjedisit është mbyllur gjatë procesit të hartimit të projekt/preventivit dhe nuk është i nevojshëm gjatë fazës së zbatimit, pasi nuk ka punime të cilat kërkojnë këtë lloj eksperti.

**Në pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar që OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës si më poshtë: 1 (një) mjek të përgjithshëm; 1 (një) ekspert zjarrfikës të shoqëruar me certifikatë/dëshmi kualifikimi për ushtrimin e profesionit lëshuar nga PMNZH; 1 (një) Punonjës "Specialist për Vlerësimin e Ndikimit në mjedis", Certifikate kjo e lëshuar nga Ministria e Mjedisit.**

Në lidhje me kërkesën për mjek, rezulton se në Vendimin nr. 632, datë 15.7.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 108, datë 9.2.2011", të KM "Për aftësitë që duhet të plotësojnë punëmarrësit, personat dhe shërbimet e specializuara, që merren me çështjet e sigurisë dhe të shëndetit në punë", pika 1, pika 3, germa "b" dhe pika 4 germa "b", thuhet shprehimisht se: Vendimi nr. 692, datë 13.13.2001, i KM "Për masat e veçanta të sigurimit dhe mbrojtjes së shëndetit në punë", **shfuqizohet**. Në çdo rast, njësia e prokurimit në vendosjen e këtij kriteri duhet të merrte parasysh faktin se në VKM nr. 108, datë 9.2.2011 ndër të tjera përcaktohet se: "shërbimet mjekësore për punëmarrësin, mund të sigurohen jo vetëm me anë të mjekut të punësuar, por edhe me anë të marrëdhënieve kontraktore me persona apo subjekte të specializuara për këtë qëllim". Gjithashtu punësimi i mjekut në listëpagesat e shoqërisë, rezulton të jetë një kriter i pa-argumentuar i cili sjell ngushtime të mëtejshme të konkurrencës, duke favorizuar operatorë të caktuar që kanë mjek në listëpagesës.

Ndërsa në lidhje me kërkesën për një ekspert zjarrfikës, shkon përtej asaj se çfarë është e nevojshme për të arritur synimin, pasi referuar ligjit nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin", roli i ekspertit zjarrfikës nuk është në përpjesëtim me natyrën e kontratës, në kuptim të nenit 46 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", të ndryshuar.

Gjithashtu kërkesa për 1 (një) Punonjës "Specialist për Vlerësimin e Ndikimit në mjedis", Certifikate kjo e lëshuar nga Ministria e Mjedisit është i panevojshëm, pasi procesi i vlerësimit të mjedisit është mbyllur gjatë procesit të hartimit të projekt/preventivit dhe nuk është i nevojshëm gjatë fazës së zbatimit, pasi nuk ka punimeve të cilat kërkojnë këtë lloj inxhinieri.

**Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. D. B,** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, **z. Xh. B,** me detyrë specialist në Sektorin e Projektive dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. A. H,** me detyrë specialiste në Sektorin e Projektive dhe Zbatimin e Kontratave, në cilësinë e anëtarëve të NJHDT-së.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti sudituuar janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 6651, datë 29.9.2025 (prot KLSH nr. 407/6, datë 01.10.2025), mbi "Projekt Raportin e Auditimit ", nga z/zj. D B, A H dhe Xh B në cilësinë e anëtarëve të NJP, ku janë shprehur kundërshtitë si më poshtë:

#### **Pretendim i subjektit përmbledhurazi:**

Mbi mangësitë e konstatuara në procedurën me objekt: "Asfaltim i rruges Lunik Prevalle (Loti 2) Njesia Administrative Lunik Bashkia Librazhd"...

2.3.3. Licensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës .... Argumentim: N.P-I G (Punime gërmimi në tokë). Në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që O.E që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. N.P-4G (Rrugë autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, linja tramvaj, metro, hekurudhe me kavo dhe pista aeroportuale). Në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndertime ...., NP-5-G (Punime nëntokësore, ura e vepra arti). Në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me punime për ndertimin e urave, tombino hidraulike, ndaj është e nevojshme që O.E që do të shpallet fitues të jetë i

licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses. NP-7 G (Ujesjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje); Në preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndertime ..... NP-11 F (Ndertime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë) Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen për ndricimin, ..... NP-12-G (Punime të inxhinierise mjedisore). Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me punime të inxhinierise së mjedisit (Konsiderohen ndertime, mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimi të kompaktësimit të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme) etj, të cilat shtojnë të nevojshme që O.E të jete i licensuar për kategorine N.S-ID Punime për prishjen e ndertimeve Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me punime prishje punime me blloqe, të cilat shtojnë të nevojshme që O.E të jete i licensuar për kategorine. NS-5 E (Implante të stnjalistikes ndricuese të trafikut) Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me Punime për ndricimin e segmetit, të cilat shtojnë të nevojshme që O.E të jete i licensuar për Skanuar me CamScanner egorine. N.S-6 G Sinjalistika rrugore jodriçuese Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me sinjalistikën rrugore jo ndricuese, të cilat shtojnë të nevojshme që O.E të jete i licensuar për kategorine. NS-7-G (Barriera dhe mbrojtja rrugore) Në preventivin e punimeve janë parashikuar zëra pune që kanë të bëjnë me Vendosje guardrail, në jersey, parrake, të cilat shtojnë të nevojshme që O.E të jete i licensuar për kategorine N.S-18 E (Punime topogjeodezike) Duke qene se në projekt e preventiv janë parashikuar punime të natyrës topogjeodezike dhe është e nevojshme zotërimi i kësaj pike license. Në piken 2.3.3, të DT, është kërkuar që OE pjesëmarrës për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, drejtues Teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë: Arkitekt 1 (një) dhe Inxhinier Mjedis 1 (një). Argumentim: Kërkohe inxhinier mjedisi pasi kemi të bëjnë me punime germimi, ndertimi, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth. Gjate zbatimit të projektit, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të ketë mbeturina e inerte të cilat paraqesin rrezikshmeri për komunitetin. Largimi dhe pastrimi i kantierit duhet të realizohet në përpikmeri dhe në kohe reale, prandaj asistencë e një inxhinieri mjedisi do të jete e domosdoshme. Është kërkuar jo detyrimisht në licencën e shoqërisë : 1 (një) Inxhinier Gjeomjedis; 1 (një) Inxhinier Ndertimi; 1 (një) Inxhinier Gjeodet. Argumentim : Ska koment Në piken 2.3.4 të DT, është kërkuar që OE pjesëmarrës duhet të disponojë staf teknik dhe punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë : 1 (një) Arkitekt; 1 (një) Teknik/Specialist të inxhinierise elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit të komunitetit; 3 (tre) Hidraulike ' 3 (tre) Elektricitist; 2 (dy) Instalues dhe riparues të kondicionereve dhe sistemeve ftohese-ngrohese ; 2 (dy) Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të ngjashme; 4 (kater) Hidroizolues; 3 (tre) Specialist gipsi; 4 (kater) Suvatues; 1 (një) Punëtor duro-alumini; 2 (dy) Shtrues pllakashdhe të tjera lidhur me to. Skanuar me CamScanner Argumentim : Ska koment Në piken 2.4.2 të DST, OE për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmerisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë) si më poshtë: -1 (një) Ekspert mjedisi i pajisur me certifikatën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Argumentim: Në bazë të pikës 4, të Nenit të 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6/c), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohe që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht: ..... Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. .... Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e

kontratës. Ne pikën 2.3.5 të DST, është kërkuar që OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës si më poshtë: një mjek të përgjithshëm (një) Ekspert zjarrfikës 1 (një) Punonjes "Specialist për Vlerësimin e Ndikimit në mjedis" Argumentimi: Sipas pikës 2.3.7, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

#### **Qëndrim i grupit të auditimit:**

Për sa kundërshtohet nga subjekti, sqarojmë se nuk është paraqitur asgjë e re nga ato të paraqitura në fazën e observacioneve të akteve. Gjithashtu nga subjekti është bërë një interpretim i licensave, por nuk janë argumentuar kategoritë si dhe jo gjitha janë të liudhra me zërat e prevetivit. **Pretendimet nuk qëndrojnë.**

#### **- Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimin të ofertave nga KVO.**

KVO me procesverbal datë 11.10.2024, për hapjen dhe vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit, rezulton se kanë marrë pjesë 3 B/OE të cilët janë kualifikuar dhe kanë shpallur në vend të parë ofertën e OE "P-V-K" ShPK, sipas tabelës si vijon:

Nr.	B/OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta pa TVSh	Skualifikuar/kualifikuar
1.	P-V-K	K.....M	44,216,353	<u>Kualifikuar-fitues</u>
2.	K	K.....C	53,549,921	Kualifikuar
3.	E	K.....P	54,0260,549	Kualifikuar

Me datë 11.10.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit (Paraparak)", dhe me datë 05.11.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

Në përfundim, KVO-ja me vendim datë 11.10.2024, ka vlerësuar në vend të parë shoqërinë "P-L-K" ShPK, me ofertë 44,216,353 lekë pa TVSh, më të leverdishme se OE e tjerë në garë.

Me shkresën nr. (pa numër) prot., datë 05.11.2024 KVO-ja ka hartuar Raportin Përmbledhës në të cilin, përveç pasqyrimin të situatës së sipërcituar, citohet se: "...nuk ka ankesa".

Me vendimin datë të 05.11.2024 është miratuar nga Titullari i AK, shpallja fitues e OE "P-L-K" ShPK me ofertë 44,216,353 lekë pa TVSh.

Pas paraqitjes së sigurimit të kontratës, është nënshkruar kontrata, me nr. 5576 prot., datë 12.11.2024, në kontratë është përcaktuar mënyra e pagesës për vlerën 53,059,624 lekë me TVSH si më poshtë:

*Për vitin 2024 vlera e financimit 12,574,975 lekë me TVSH;*

*Për vitin 2025 vlera e financimit 19,925,025 lekë me TVSH;*

*Për vitin 2026 vlera e financimit 20,559,624 lekë me TVSH.*

#### **- Vlerësimi i ofertës fituese:**

Nga vlerësimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezulton se shoqëria "P-V-K" ShPK, nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP, pasi nuk plotëson disa nga kriteret e DST të miratuara në AK, si më poshtë vijon:

1- Shoqëria "P-L-K" ShPK, ka OE mbështetës, kjo bie ndesh me DST, pasi referuar pikës 2.15.2 të DST, **nuk lejohen OE mbështetës.**

2- **Nuk plotësohet pika 2.3.3 e DST**, duke mos deklaruar ing. Ndërtimi jo domosdoshmërisht në licensën e shoqërisë.

Nga shoqëria është paraqitur ky staf:

Profesioni	Numëri	Deklaruar nga shoqëria		
Inxhinier Ndërtimi	3 (tre)	<i>S Q</i>	<i>O V</i>	<i>R B,</i>
Inxhinier Mekanik	2 (dy)	<i>M Sh</i>	<i>T K</i>	
Inxhinier Hidroteknik	1 (një)	<i>D C</i>		
Inxhinier Elektrik	1 (një)	<i>E M</i>		
Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder	2 (dy)	<i>D L</i>	<i>G B</i>	
Arkitekt	1 (një)	<i>E P</i>		
Inxhinier Gjeolog	1 (një)	<i>Sh L</i>		
Inxhinier Mjedis	1 (një)	<i>L A</i>		
Inxhinier Gjeomjedis	1 (një)	<i>D L</i>		
Inxhinier Ndërtimi	1 (një)			
Inxhinier Gjeodet	1 (një)	<i>J A</i>		

3- Nuk plotësohet pika 2.3.4 e DST, duke mos deklaruar stafin prej 48 punonjësish, kur në fakt janë paraqitur vetëm 36 punonjës, siç tregohet në tabelën si vijon:

Profesioni	Numëri	Deklaruar nga shoqëria			
Arkitekt	1 (një)				
Specialist/ Teknik Ndërtimi	4 (katër)	<i>G B</i>	<i>A M</i>	<i>K R</i>	<i>M T</i>
Teknik Hidroteknik	1 (një)				
Teknikë/Specialistë të inxhinierisë elektronike dhe/ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit	1 (një)				
Hidraulikë	3 (tre)	<i>V P</i>	<i>O M</i>	<i>P S</i>	
Elektricitë	3 (tre)	<i>A M</i>	<i>K P</i>	<i>A M</i>	
Instalues dhe riparues të kondicionerëve dhe sistemeve ftohëse-ngrohëse	2 (dy)	<i>M S</i>	<i>B P</i>		
Përgatitës të konstruksioneve metalike dhe të		<i>E P</i>	<i>D G</i>		
Hekurkthyes	2 (tre)	<i>K R</i>	<i>S A</i>		
Karpentier	3 (tre)	<i>A L</i>	<i>A I</i>	<i>A D</i>	
Saldator dhe prerës të metaleve	1 (një)	<i>N Sh</i>			
Hidroizolues	4 (katër)	<i>A D</i>	<i>I S</i>	<i>E K</i>	<i>S G</i>
Specialist gipsi	3 (tre)	<i>G B</i>	<i>S Gj</i>		
Muratorë	5 (pese)	<i>N N</i>	<i>Sh G,</i>		
Suvatues	4 (katër)	<i>M T</i>	<i>A T</i>	<i>Sh G,</i>	
Bojaxhi	3 (tre)/	<i>A I</i>	<i>N K</i>	<i>L P</i>	<i>/</i>
Punonjës duro-alumini	1 (një)	<i>G B</i>			
Shtrues pllakash dhe të tjerë që lidhen me to	2 (dy)	<i>I A</i>	<i>T A</i>		
Betonues	1 (një)/				
Saldato	2 (dy)	<i>H D</i>			

3- Nuk plotëson pikën 2.3.12 të DST, duke mos deklaruar një pjesë e mjeteve që kërkohen, konkretisht tabelë:

Mjetet	Sasia	Gjendja
Asfaltoshtruese	1 cope	Pronësi ose me qera
Autobitumatrice	1 copë	Pronësi ose me qera
Autobetoniere	4/5 cope	Pronësi ose me qera
Autopompe betoni	1 cope	Pronësi ose me qera
Ekskavator me goma	2/3 cope	Pronësi ose me qera
Grejder me goma	1 cope	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-hekur me kapacitet 5-8 ton	2 cope	Pronësi ose me qera
Rrul hekur-gome me kapacitet mbi 18 ton	1 cope	Pronësi ose me qira
Rrul asfalti me gomë – gomë	1 copë	Pronësi ose me qira
Fadrome me goma	2/3 copë	Pronësi ose me qira
Tranxhe për perpunimin e hekurit te ndertimit	1 copë	Pronësi ose me qira
Aparat Ngjitje Tubash PE, PVC	1 copë	Pronësi ose me qira

Sipas dosjes së procedurës, nga shoqëria “P-V-K” ShPK, mjetet e mësipërm nuk janë deklaruar, kjo me pretendimin se mbulohen nga OE mbështetës, por siç theksuam në fillim dhe referuar DST, procedura nuk lejohet subjekte mbështetës.

Gjithashtu referuar deklaratës së angazhimit nga subjekti mbështetës, lejohet të mbështetet për burime njerëzore (*një hidroizulues dhe një përgatitës të konstruksioneve matalike dhe të ngjashme*), dhe për mjete (*aparaturë ngjitës tubash PE, PVC*).

➤ Nga vlerësimi i dokumentacionit në sistemin SPE për OE të kualifikuar, rezulton se shoqëria “K” ShPK dhe “E” ShPK, të cilat janë kualifikuar sipas vendimit të KVO, nuk janë në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST dhe në kundërshtim me dispozitat e LPP, pasi: **Nuk plotësojnë kërkesat e pikës 2.3.7** *Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se e zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe menaxhimit të energjisë. Për këtë duhet të paraqesë certifikatat e mëposhtme:*

Certifikatë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “*Sistemet e menaxhimit të cilësisë*” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim; Certifikatë ISO 45001 - 2018 ose ekuivalente mbi “*Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë*” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim; Certifikatë ISO 14001:2015 ose ekuivalente mbi “*Sistemet e menaxhimit të mjedisit*”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim; Certifikatë ISO 27001:2022 ose ekuivalente mbi “*Menaxhimin e sigurisë së informacionit*”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim; EN ISO 15838-2009; SA 8000-2014; ISO 56003-2019; ISO 3100 2018; ISO 3834-2 2005; ISO 7010-2019; ISO 28001-2007; BS EN 13331-1 2002.

Nga shoqëria “K” ShPK në SPE është deklaruar vetëm Certifikatë ISO 9001:2015, ndërsa nga shoqëria “E” ShPK ka deklaruar vetëm Certifikatë ISO 45001 – 2018.

**Si përfundim**, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, nuk ka vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në procedurë, pasi asnjëra nga to nuk plotësojnë kriteret e DST të miratuara nga AK. Në këto kushte, KVO-ja duhet ti propozonte titullarit të AK, anulimin e procedurës dhe zhvillimin e një procedure tjetër me kushte më favorizuese për rritjen e numrit të pjesëmarrësve në garë dhe rritur efikasitetin e fondit të prokuruar nga rritja e konkurrencës, veprime në kundërshtim me: **Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”**, (i ndryshuar), neni 2, ku përcaktohet: “*Qëllimi i këtij ligji është... b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve ...; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik...*”, neni 3 pika 1, “*Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale...*”, neni 76 pika 3/ë dhe 5, “*Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse...ë) ka paraqitur deklaratatë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit; pika 5: “Autoriteti ose enti kontraktor skualifikon çdo kandidat ose ofertues, që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë, deri në momentin e lidhjes së kontratës dhe raportin në Agjencinë e Prokurimit Publik, për qëllimet e parashikuara në nenin 78 të këtij ligji, dhe neni 92 pika 3, “Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”*; **për të cilat ngarkohen me përgjegjësi: z. K. B**, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit Urban dhe i Mbrojtjes së Territorit, **z. E. Gj**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Projektive dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. K. Ll**, me detyrë Specialiste në Sektori Juridik, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti sudituar janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 6651, datë 29.9.2025 (prot KLSH nr. 407/6, datë 01.10.2025), mbi “Projekt Raportin e Auditimit “, nga z/zj. D B, A H dhe Xh B në cilësinë e anëtarëve të NJP, ku janë shprehur kundërshtitë si më poshtë:

**Pretendim i subjektit përmbledhurazi:**

Mbi mangësitë e konstatuara në procedurën me objekt: "Asfaltim i rruges Lunik Prevalle (Loti 2) Njesia Administrative Lunik Bashkia Librazhd", në lidhje me vlerësimin e procedurës.

Nga shoqeria nuk plotesohet pika 2.3.3 e DST, duke mos deklaruar ing.Ndertimi jo domosdoshmerisht ne licencen e shoqerise. Nuk plotesohet pika 2.3.4 e DST, duke mos deklaruar stafin prej 48 punonjesish, kur ne fakt jane paraqitur vetem 36 punonjes. Nuk ploteson piken 2.3.12 te DST, duke mos deklaruar nje pejse te mjeteve qe kerkohen. Pretendimi per mos plotesim te pikave te mesiperme, vjen si rezultat se shoqeria "P-V-K" shpk mbulohet nga OE mbeshtetes. .... Në mbështetje të nenit 84 të Ligjit nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); Nenit 90 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Per Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" O.E, me qëllim plotësimin e kërkesave të përcaktuara nga autoriteti ose enti kontraktor në dokumentet e tenderit, mund të mbështetet në kapacitetet ekonomike e financiare, aftësinë teknike ose profesionale të subjekteve të tjera, pavarësisht natyrës juridike të lidhjeve që ai ka me ta, sipas përcaktimit në nenin 84, të LPP-së.

Ne kriteret e hartuara te DST (sic shihet qarte ne piken 2.16 te DST, Autoriteti Kontraktor nuk specifikon detyra, pune, aspekte kritike per te cilat OE nuk u lejohet mbeshtetja. Si rrjedhoje, OE ne baze te Nenit 84, pikat 2 dhe 3 dhe 6 te Ligjit Nr. 162, date 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" (i ndryshuar); Nenit 90, pika 2 dhe 3 te VKM Nr.285, date 19.05.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, nuk eshte ne kushtet e shkeljes se kriteve....

**Qëndrim i grupit të auditimit:**

Pretendimi juaj nuk qëndron, pasi referuar pikës 2.16 të DST, nuk lejohen OE mbështetës (shiko DST),. **Pretendimet nuk qëndrojnë.**

**II- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në procedurën me objekt: “Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefqet Dosku"Librazhd”, në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave , u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, etj., konkretisht si vijon:**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e mesme e bashkuar Shefqet Dosku ”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-03560-05.02.2024 Urdhri nr. 7009 prot., datë 23.04.2024.	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, Urdhri nr. 1900 prot, datë 17.04.2024</b> 1.A H 2.A P 3.E Q	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 439, datë 23.04.2024  1. D B 2. Xh B 3.A H	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 460, datë 02.05.2024  1. K B 2.E Gj 3.K Ll
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 76,854,050 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 71,473,528 lekë Fitues: OE “E” ShPK		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 5,380,522 lekë ose 93% e fondit
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 21.05.2024	<b>8. Burimi Financimit</b> Buxheti i Bashkia Librazhd dhe Ministria e Arsimit dhe Sportit		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a)Pjesëmarrës në tender Numër 6 B/OE b) S’kualifikuar 3 B/OE, c) Kualifikuar 3 B/OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 6 muaj			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ka; -Jo APP-s’ka/ka;-Jo	<b>11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit (sipas SPE):</b> Data: 08.07.2024 (Paraparak)		<b>12.Data e lidhjes së kontratës:</b> Data: 18.07.2024 (lidhja) Data: 18.07.2024 (njoftimi i lidhjes)

- **AK në lidhje me “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:**

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se Projekti, Preventivi i Punimeve dhe Relacioni Teknik, në lidhje me këtë procedurë, janë përgatitur nga Arkitekt K B me nr. licence A.1355/1, me detyrë Drejtor i DPZHUMT pranë bashkisë Librazhd. Referuar preventivit, ndër të tjera, specifikohet se vlera e objektit të kontratës është përlllogaritur 92,224,859 lekë me TVSh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se ndodhet leja infrastrukturore nr. 3709/3, datë 03.10.2024 për objektin “Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar “Shefqet Dosku”Librazhd”, por nuk rezulton të jetë pjesë e saj **oponenca teknike**, në lidhje me procedurën e sipërcituar, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik, në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”, sipas të cilit “ Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërorë ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtime publike; b)ndërtime jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milion)lekë; c) objektet me akses publik, me VKM nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projekte që duhet t’i nënshtrohen oponencës teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”.

- **AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin e Specifikimeve Teknike dhe Hartimin e Kriteve”:**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit datë 02.05.2024 “Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kriteve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4. E konkretisht:

**Në pikën 2.4.2 të DST, OE për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë: I (një) ekspert mjedisi i pajisur me certifikatën e Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis i cili duhet të rezultojë në listpagesat e shoqërisë të paktën 3 (tre) muajt e fundit, vërtetuar me kontratë pune dhe certifikatën përkatëse.**

Ky kriter është i panevojshëm, pasi procesi i vlerësimit të mjedisit është mbyllur gjatë procesit të hartimit të projekt/preventivit dhe nuk është i nevojshëm gjatë fazës së zbatimit, pasi nuk ka punime të cilat kërkojnë këtë lloj inxhinieri, për për më tepër të bëhet vlerësimi i mjedisit, në një kohë që nuk ka punime në mjedis por kemi të bëjmë me objek ndërtimi arsimor.

**Në pikën 2.7 të DST, operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B.( Grumbullim e transport mbeturina jo të rrezikshme që dalin nga ndërtimi ).**

Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis. Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprakisht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me

pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 “Për vlerësimin në mjedis”, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.

Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezulton se nuk është aktivitet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.

**Në pikën 2.4.1 të DST, operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht 1 (një) Arkitekt.**

Kërkesa për inxhinierët Arkitekt është kërkesa jo mirëargumentuara, pasi referuar tipologjisë së objektit të prokuruar janë kërkesa të cilat referuar zërave të preventivit nuk duhen, kjo për faktin se nuk kemi punime të formatit elektronik, ndërsa në lidhje me arkitektin nuk kemi të bëjmë me ndërtim të ri, por me rikonstruksion objekti. Nëse do kishim ndërtim të ri përsëri pozicioni i arkitekti ezaurohet në fazën e hartimit të projektit .

Gjithashtu, nga NJP duhej të argumentojë ligjërisht dhe teknikisht çdo kriter të vendosur jo thjeshtë të përmend atë që autoriteti kontraktor kërkon. Konkretisht pika 2.3.10 (në procesverbalin e argumentimit) dhe 2.3.8 në DT, në lidhje me mjetet e nevojshme për realizimin e kontratës, nuk janë argumentuar ligjërisht nga grupi i punës.

Nuk është shpjeguar teknikisht nga NJP përlllogaritja e fuqisë punëtore (50 punonjës), ku në bazë të analizave të zërave të preventivit, llogariten orët e punës, në përpjesëtim të drejtë me grafikun e punimeve, për orë punë dhe orë pune për makineritë e nevojshme (nga specialist i fushës).

Në lidhje me pikën 2.3.5 njësia e prokurimit mund të kërkojë **1 (një) punonjës i pajisur me “Certifikatë e Audituesit Energjetik në Ndërtesa”** vetëm atëherë kur autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit paraqet projekt për eficientë energjetikë, çdo herë tjetër është kriter diskriminues. (Nr. 116/2016 për performancën e energjisë së ndërtesave).

**Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. D. B,** me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, **z. Xh. B,** me detyrë specialist në Sektorin e Projektive dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. A. H,** me detyrë specialiste në Sektorin e Projektive dhe Zbatimin e Kontratave, në cilësinë e anëtarëve të NJHDT-së.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti sudituar janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 6651, datë 29.9.2025 (prot KLSH nr. 407/6, datë 01.10.2025), mbi “Projekt Raportin e Auditimit “, nga z/zj. D B, A H dhe Xh B në cilësinë e anëtarëve të NJP, ku janë shprehur kundërshtitë si më poshtë:

#### **Pretendim i subjektit përmbledhurazi:**

*Për auditimin e procedurës së prokurimit publik me objekt: "Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e mesme e bashkuar Shefqet Dosku".*

*Vendosja e kriterit për të disponuar si staf mbështetës jo license të 1 (një) ekspertit mjedisor është kriter i drejtë i domosdoshëm, pasi objekti do të zhvillohet në një terren ku mbrojtur dhe rendesia e ruajtjes së mjedisit natyror nga dëmtimet mundshme është jetike për zonën për banoret e saj si dhe për florën e faunën që rritet aty. .... Gjate zbatimit të projektit, është e pashmangshme që në realizimin e punimeve të këtu mbeturina e inerte të cilat janë në një rrezikshmëri të lartë për mjedisin. Për më tepër ky kriter është i zbutur në maksimum, pasi nuk kërkohej që ekspertit të jete ing.mjedisi që do ta rriste shkallën e vështirësisë si kriter, apo nuk kërkohej që ky ing.mjedisi të ishte i pranishëm në license.*

Referuar preventivit të punimeve dhe natyrës së punimeve që do të kryhen, njësia e prokurimit vlerëson se O.E duhet të disponojnë dhe licencat e nevojshme lëshuar nga Qendra Kombëtare e Liçencimit (QKL) për zbatimin e punimeve objekt kontrate, si më poshtë, argumentojmë: Duke qënë se në kontratën objekt prokurimi kemi kryerjen e punimeve të gërmimeve (dheu), dhe kryerjen e transportit të tyre, bazuar në përcaktimet e nenit 21, 37 e 57 të ligjit nr. 10 463, datë 22.09.2011 "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", .... transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve, njësia e prokurimit vlerëson se O.E duhet të jenë të liçencuar për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve të llojeve të ndryshme (Kodi III.2.B).....

Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve. O.E duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi teknik është përgjegjës për ndërtimin në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij drejtues teknik të cilët kanë një rol të rëndësishëm .....

#### **Qëndrim i grupit të auditimit:**

Për sa kundërshtohet nga subjekti, sqarojmë se nuk është paraqitur asgjë e re nga ato të paraqitura në fazën e observacioneve të akteve. Mangësitë e konstatuara nga grupi mbi kriteret qëndrojnë dhe gjejnë pasqyrim në këtë raport përfundimtar me gjithë shpjegimet pse ato nuk duhej të aplikoheshin nga subjekti. **Pretendimet nuk qëndrojnë.**

#### **- Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.**

KVO me procesverbal datë 08.07.2024, për hapjen, dhe vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 OE për të cilat ka vlerësuar dokumentacionin teknik në sistemin SPE, ka skualifikuar 4 OE dhe kualifikuar 2 OE, të cilët janë kualifikuar dhe kanë shpallur në vend të parë ofertën e OE "E" ShPK, sipas tabelës si vijon:

Nr.	B/OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta pa TVSh	Skualifikuar/kualifikuar
1	A C + Z K	L.....A/ J.....K	55,998,634	Skualifikuar
2	B-I	K.....A	65.661.497	Skualifikuar
3	E	K.....P	<b>71,473,528</b>	<b>Kualifikuar/fitues</b>
4	R G-K + V K	K.....M/ K.....L	72,008,295	Kualifikuar
5	S F + L K	K.....J/ K.....H	62,222,222	Skualifikuar
6	S	J.....Q	0	Skualifikuar

Me datë 08.07.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit (Paraparak)", dhe me datë 17.07.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)". Në përfundim, KVO-ja me vendim datë 08.07.2024, ka vlerësuar të vlefshme ofertat e shoqërive "E" ShPK me ofertë 71,473,528 lekë pa TVSh dhe BOE "R G-K ShPK & V K ShPK".

Me shkresën nr. (pa numër) prot., datë 17.07.2024, KVO-ja ka hartuar Raportin Përmbledhës në të cilin, është shpallur në vend të parë OE "E" ShPK, me ofertë 71,473,528 lekë pa TVSH.

Me vendimin datë të 17.07.2024 është miratuar nga Titullari i AK, shpallja fitues e OE "E" ShPK, me ofertë 71,473,528 lekë pa TVSH.

Pas paraqitjes së sigurimit të kontratës, është nënshkruar kontrata, me nr. 3445 prot., datë 18.07.2024.

## **- Vlerësimi i procedurës**

Janë skualifikuar Operatoret Ekonomike të mëposhtëm:

### **1- Bashkimi i OE “S F & L KONSTRUKSION” ShPK, me oferte ekonomike 62,222,222 lekë pa TVSh, për shkak se :**

*Bashkimi i operatoreve ekonomike S. 2F ShPK dhe L. K. ShPK, nuk kanë bërë ndarjen e sakte të punimeve sipas përqindjes së deklaruar në Kontratën e Bashkëpunimit.*

*Kështu sipas përqindjes së pjesëmarrjes në shoqëria “L K” ShPK ka deklaruar pjesëmarrje në masën 14.55% të volumit të punimeve të përfshira në zërin punime shtresash 2, që të gjitha këto zëra referuar ofertës së paraqitur nga ky bashkim operatorësh është në vlerën 9,056,401 lekë pa TVSh, ndërkohë që kjo vlerë nuk i korrespondon përqindjes së deklaruar në Kontratën e Bashkëpunimit, në të cilën 14.55% i korrespondon vlerës prej 9,053,333 lekë pa TVSh, pra diferencë e prej 3,068 lekë punime shtresa 2, mbetet e përealizuar.*

*Gjithashtu operatorët nuk kanë paraqitur Listepagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit.*

*Nuk kanë paraqitur Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit.*

*Bashkimi i OE ka paraqitur kontratë Furnizimi me Fabrike betoni me distancë më tepër se 35 km nga objekti që prokurohet, ndërkohë kriteri i kërkuar në DST e shpreh qartë që distancë nuk duhet të jete më shumë se 35 km.*

### **2- OE “B-I” ShPK, me oferte ekonomike 65.661.497 pa TVSh për shkak se:**

*Nuk ka deklaruar: Kokore minimum 50 cope, Fikëse zjarri të lëvizshme me kapacitet 5-7 litra secila minimum 5 cope, Komplet i ndihmës së shpejte minimum 5 cope, Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimum 20 cope, Rripa lidhës sigurimi për punime në lartësi minimum 10 cope.*

*Listepagesat e punonjësve sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën 3(tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit.*

*Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e zhvillimit të tenderit.*

### **3- Bashkimi i OE. “A C” & “Z K” ShPK, me oferte ekonomike 55,998,634.64 lekë pa TVSh, për shkak se:**

*Shoqëria “Z K” ShPK ka nënshkruar dhe kanë në proces zbatimi kontratë me Bashkinë Librazhd si më poshtë:*

1. Kontratën nr.2854 prot, date 12.06.2024 “Sistemim asfaltim I rrugës së fshatit Librazhd Katund faza I-re, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”.

2. Kontratën nr.2878 prot, date 13.06.2024 “Rikonstruksion kanali Kturmanit”

3. Kontratën nr.2855 prot, date 12.06.2024 “Tikonstruksion kanali I Allanit Dorez (faza e I-re Hyrja + Skeja e në vazhdim).

*Drejtuësi teknik, inxhinierët, stafit dhe mjetet e deklaruara në kontratat që ka në zbatim në Bashkinë Librazhd janë deklaruar edhe në këtë procedurë prokurimi. Për këtë drejtuësi teknik, inxhinierët, stafit, mjetet/pajisjet/makinëritë e deklaruara në formularin përmbledhës të vetedeklarimit dalin të angazhuara në kontratë në proces punimesh në Bashkinë Librazhd.*

### **4- Shoqëria “S” SHPK me oferte ekonomike 0 lekë për shkak se:**

*Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokument në sistem .*

Nga vlerësimi i dokumentacionit në sistemin SPE dhe dosjen e procedurës, rezultojnë se:

a- Në lidhje me skualifikimin e BOE “S2F” & “L K” ShPK, nga KVO-ja, sqarojmë se ky skualifikimi **nuk është i drejtë dhe është në shkelje me dispozitave të LPP<sup>21</sup>**, pasi AK nuk mund të skualifikojë një OE për mospërputhje prej 3,068 lekë në ndarjen e përqindjes së punimeve, duke zbatuar ligjin e prokurimeve dhe barazinë e OE. Nëse kjo është e vetmja “shkelje”, dhe nuk është rezultat i një gabimi material që ndikon thellësisht në zbatimin e kontratës, atëherë skualifikimi i BOE “S2F” & “L K” ShPK, për një mospërputhje kaq

<sup>21</sup> Ligji nr. 162/2020 datë 23.12.2020 “Prokurimit Publik” (I ndryshuar).

minimale (3,068 lekë) mund të konsiderohet jo proporcional, duke shkelur parimin e proporcionalitetit dhe konkurrencës në tenderat publike.

Vlera e gabimit është minimale (- 3,068 lekë), nga një ofertë mbi 62 milionë lekë pa TVSH, dhe është më pak se **0.005% e ofertës** — një gabim numerik i papërfillshëm. Mospërputhja është rezultat i një rumbullakimi numerik ose një gabimi aritmetik të thjeshtë, jo një mangësi në kapacitet apo përmbajtje.

Gjithashtu, nga KVO-ja nuk është pasur në konsideratë nenin 71, i Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), ku parashikon mundësinë e kërimit të sqarimeve nga operatori, në rast të paqartësive ose gabimeve që nuk janë thelbësore.

Vendime e ndryshme të KPP, kanë theksuar që skualifikimi duhet të përdoret vetëm në rastet kur shkelja është reale, e thelbësore, dhe ndikon në vlerësimin teknik ose ekonomik të ofertës, pasi nuk mund të ketë skualifikim automatik, por duhet të kërkohej sqarim për OE, pasi në zbatim të ligjit të prokurimeve, kjo është oferta më e favorshme bazuar në çmim.

b- Në lidhje me shoqërinë e shpallur fitues “E” ShPK, nga auditimi rezulton se nuk është në kushtet e plotësimit të kërkesave të DT, pasi nuk plotëson disa nga kriteret, si vijon:

- **Nuk plotëson pikën 2.2.2 të DT**, kriter ky i rëndësishëm ku subjektet i garantojnë besueshmëri autoritetit kontraktor sipas parimeve të përgjithshme të kualifikimit **Shtojca 7 pika h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.**

Operatori ekonomik “E” nuk ka paraqitur Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël te Autorizuar, bilancet janë vetëm me firmë, vulë nga drejtoria e përgjithshme Tatimore, Elbasan.

- **Nuk plotëson pikën 2.3.4 të DST**, ku z. Sh. Q, me profil “murator/suvatues”, **nuk është i regjistruar në listpagesat e muajt Janar dhe Mars 2024.**

- **Nuk është paraqitur tabela më të dhënat sipas pikës 2.3.4 të DST**, si më poshtë:

*-Për profesionet si me sipër, operatori ekonomik duhet te plotësojë tabelën si me poshtë:*

Nr.	Emër Mbiemër i punonjësit	Profesioni i punonjësit	Emri i Institucioni publik/privat lëshues i certifikatës/diplomës	Numri identifikues i certifikatës/diplomës	Nr. NIPT - (Ne rast se lëshuesi është institucion privat)
1					
2					
.....					

**Si përfundim**, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, nuk ka vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë, duke shpallur fitues një OE me kriteret të paplotësuar, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), neni 2, neni 3 pika 1, neni 92 pika 3, për të **cilat ngarkohen me përgjegjësi: z. K. B**, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit Urban dhe i Mbrojtjes së Territorit, **z. E. Gj**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Projektive dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. K. Ll**, me detyrë Specialiste në Sektori Juridik, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

**III- Nga shqyrtimi i dokumentacionit** të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në procedurën me objekt: “**Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan, faza e I-re Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd**”, në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave , u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, etj., konkretisht si vijon:

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vehcan ,faza e I-re Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-02040-04.19-2024 Urdhri nr. 1674 prot., datë 04.04.2024 Nr 376, datë 04.04.2024	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, Urdhri nr. 1185 prot., datë 04.03.2024, nr. 279, datë 04.03.2024</b> 1.Xh B 2.A H 3.A P	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 1674 prot., datë 04.04.2024 nr. 376, datë 04.04.2024 1.D B 2.Xh B 3.A H	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 392 datë 09.04.2024. 1.E Gj 2.K Ll 3.K B
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 77,600,000 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 61,211,143 lekë Fitues: OE “L C” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 16,388,857lekë ose 78.8% e fondit	
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 9.5.2024	<b>8. Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Bashkisë Librazhd</b>	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 7 B/OE b) S’kualifikuar 4 B/OE, c) Kualifikuar 3 B/OE	
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 6 muaj			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ka; -po APP-s’ka/ka;-po KPP-s’ka/ka;-po	<b>11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit (sipas SPE):</b> Data: 19.06.2024 (Paraprk) Data: 09.07.2024 (Përfundimtar)	<b>12.Data e lidhjes së kontratës:</b> Data: 15.07.2024 (lidhja) Data: 17.07.2024 (njoftimi i lidhjes)	

**AK në lidhje me “Përlllogaritjen e Fondit Limit”:**

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se Projekti, Preventivi i Punimeve dhe Relacioni Teknik, në lidhje me këtë procedurë, janë përgatitur nga shoqëria “Z & C” ShPK. Referuar preventivit, ndër të tjera, specifikohet se vlera e objektit të kontratës është përlllogaritur 77,600,000 lekë pa TVSh.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se ndodhet leja infrastrukturore nr. 2946/3, datë 18.06.2024 për objektin “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Vehcan ,faza e I-re Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”.

**AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin e Specifikimeve Teknike dhe Hartimin e Kriteve”:**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit datë 19.04.2024 “Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kriteve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4. E konkretisht:

**Në pikën 2.3.2 të DST, është kërkuar që OE pjesëmarrës ndër licencat e kërkuara janë kërkuar dhe licencat: NP 4C- Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvaj, metro, pista aeroportuale; NP 7<sup>a</sup>- dhe NP 11<sup>a</sup>- Ndërtime për N/stacionet, kabinat ....**

Kategoritë e mësipërme janë totalisht të paargumentuara dhe të lidhura me tipologjinë e procedurës, si për zërat e punimeve po ashtu dhe për volumin që ato përfaqësojnë. Një kërkesë e tillë çon padyshim në uljen e numrit të OE pjesëmarrës në procedurë.

**Në pikën 2.3.3 të DST, është kërkuar që OE pjesëmarrës, duhet të disponojë *personelin kryesor, drejtues teknik* në licencën e shoqërisë, si: Inxhinier Ndërtimi profili Transport 1 (një); Inxhinier Gjeodet/Topograf 1 (një); Inxhinier Hidroteknik 1 (një) dhe Inxhinier Elektrik 1 (një) OE duhet të ketë staf mbështetës të paktën: Inxhinier Ndërtimi 1 (një); Inxhinier Mjedisi 1 (një); Inxhinier Gjeodet/Topograf 1 (një)**

Kërkesat e mësipërme janë jo mirëargumentuara, pasi është i panevojshëm prezenca e specialisteve sipas profileve dhe në licencën e shoqërisë dhe jashtë licencës, pasi vetëm pjesa e mësipërme ato që janë në licencën është i mjaftueshëm. Nuk ka pse duhet dy për çdo profil.

Duke marrë shkas nga problematikat e konstatuara në këtë procedurë prokurimi, vlerësojmë se, kriteret në vijim nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pika 1 e nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), dhe nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik” (i ndryshuar), që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cenuar kështu edhe përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

- AK-ja, në hartimin e kriterit për nevojën e punonjësve, duhet t’i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Konkretisht 2.3.6 numri I kërkuar nga autoriteti kontraktor është I ekzagjeruar dhe duke shkelur parimet bazë të ligjit të prokurimit.

- Përsa i përket **kriterit 2.3.8**, AK mund të kish kërkuar një nga licencat e lëshuara nga (QKL). Lejet mjedisore i përkasin kategorive të ndryshme të veprimtarive. Kontrata objekt prokurimi nuk mund të kërkojë leje mjedisore III.2.A, pasi puna e kërkuar nuk ka ndikim të madh në mjedis, sipas zërave të preventivit.

**Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. D. B**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, **z. Xh. B**, me detyrë specialist në Sektorin e Projektive dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. A. H**, me detyrë specialiste në Sektorin e Projektive dhe Zbatimin e Kontratave, në cilësinë e anëtarëve të NJHDT-së.

- Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.

KVO me procesverbal datë 19.06.2024, për hapjen, dhe vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 7 OE për të cilat ka vlerësuar dokumentacionit teknik në sistemin SPE, ka skualifikuar 4 OE dhe kualifikuar 3 OE, dhe kanë shpallur në vend të parë ofertën e OE “L. C” ShPK, sipas tabelës si vijon:

Nr.	B/OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta pa TVSh	Skualifikuar/kualifikuar
1.	L. C	L.....F	61,211,143	<u>Kualifikuar/ fitues</u>
2.	A-A CO + Z K	K.....C/ J.....K	69,543,986	<u>Skualifikuar:</u> Mjetet e kërkuara janë të angazhuara, pasi ka në proces zbatim një kontratë me Bashkinë Librazhd
3.	B	K.....O	61,052,488	<u>Skualifikuar:</u> -Stafi teknik dhe mjetet e kërkuara janë të angazhuara, pasi ka në proces zbatim 2 (dy) kontrata me Bashkinë Librazhd
4	B-I	K.....A	64.687.335	Kualifikuar
5	B-X + B	K.....N	61,101,757	<u>Skualifikuar:</u> Ka deklaruar z.N.G si Eskavatoris, por i ka mbaruar afati i Vleshmerise se Deshmise me daten 20.05.2020. -Nuk posedon 4 (katër) Eskavatoriste të kërkuar -Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës -B SH.P.K nuk ka paraqitur vërtetimin e xhiros për 3 Vitet e fundit -Nuk ka vetëdeklaruar mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit
6	S2F + L K	K.....J/ K.....H	57,777,777	<u>Skualifikuar:</u> L Konstruksion nuk plotëson kriterin 3.8 të DT, konkretisht për makinerit prerëse dhe kthyesa hekuri. S 2F nuk plotëson kriterin për punonjës të kualifikuar për zërin 4 të preventivit me dy ppononjës.
7	V H	K.....C	75,398,295	Kualifikuar

Me datë 19.06.2024 është hartuar dhe publikuar “Formulari i Njoftimit (Paraparak)”.

### **Ankesa:**

Me datë 26.06.2024 BOE “S 2F” SHPK & “L K” SHPK ka bërë ankesë në KPP me nr. *ankimi elektronik A/2024/ 4260* protokolluar me nr. 1705/ 2024 datë 26.04.2024 për kundërshtimin e Vendimit të KVO lidhur me skualifikimin e ofertës. KPP ka marrë në shqyrtim kërkesën për tërheqje dhe ka vendosur përfundimin e procedimit administrative dhe me shkresë nr. 1705/7 prot., datë 28.06.2024 ka dërguar Bashkisë Librazhd këtë vendim.

Me datë 09.07.2024 është hartuar dhe publikuar “Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)”, pas përfundimit të afateve të ankimimit.

Me shkresën nr. (pa numër) prot., datë 09.07.2024, KVO-ja ka hartuar Raportin Përmbledhës në të cilin, ka shpallur në vend të parë OE “L CONSTRUCTION” SHPK me ofertë 61,211,143 lekë pa TVSH.

Me vendimin datë të 09.07.2024 është miratuar nga Titullari i AK, shpallja fitues e OE “L. C” SHPK me ofertë 61,211,143 lekë pa TVSH

Pas paraqitjes së sigurimit të kontratës, është nënshkruar kontrata, me nr. 3390 prot., datë 15.07.2024, ë kontratë është përcaktuar mënyra e pagesës për vlerën 73,453,372 lekë me TVSH si më poshtë:

*Për vitin 2024 vlera e financimit 16,938,855 lekë me TVSH;*

*Për vitin 2025 vlera e financimit 16,647,170 lekë me TVSH;*

*Për vitin 2026 vlera e financimit 39,867,347 lekë me TVSH.*

#### **- Vlerësimi i procedurës nga KVO:**

Në lidhje me shoqërinë “L C” *ShPK* e shpallur fitues nga KVO-ja, rezulton se nga auditimi i dokumentacionit në dosje fizike dhe sistemin SPE, disponon licencat e kategorive *I.2.A, III.2.A dhe III.2.B*, por nuk disponon *III.I.B*, **si rrjedhojë kriteri 2.3.8 nuk plotësohet nga OE dhe shoqëria nuk duhej shpallur fitues.**

Gjithashtu, në seksioni *A-Formularit Përmbledhës të vetëdeklarimit*, **nuk është i plotësuar sipas formatit të miratuar.** Mosplotësimi i sanksioneve të formularit përmbledhës të vedeklarimit në veçanti atyre të detyrueshme, konsiderohet kusht për skualifikim, sipas dispozitave të Ligjit 162/2020 datë 23.12.2020, *përbën bazën për vlerësimin paraprak të procedurës.*

Kriteri sipas **pikës 2.3.10 të DST**, ka mangësi në mjete dhe makineri përkatësisht, minifadrome kërkohen dy copë dhe ka vetëm një, për të cilën nuk ka as nr. e lejes së qarkullimit as targën.

Për auto betonierët nuk ka paraqit numër leje qarkullimi, sepse është një mjet motorik rrugor që qarkullon në rrugë publike.

**Si konkluzion**, në kushtet si më sipër dhe në funksion të zbatimit të LPP-së, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar OE “L C” *ShPK*, duke vijuar procedurat për shpalljen fitues dhe lidhjen e kontratës me operatorin e radhës i cili plotëson të gjitha kriteret e vendosura nga AK, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar, neni 2, neni 92 pika 3, si dhe neni 82 pika 2 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 *Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, për të cilat ngarkohen me **përgjegjësi: z. K. B**, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit Urban dhe i Mbrojtjes së Territorit, **z. E. Gj**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Projektive dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. K. Ll**, me detyrë Specialiste në Sektori Juridik, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

**IV- Nga shqyrtimi i dokumentacionit** të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në procedurën me objekt: “**Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Allanit**”

**Dorez-Gizavesh-Librashd Qendër**, në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave , u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, etj., konkretisht si vijon:

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Allanit Dorez-Gizavesh-Librashd Qendër”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-22296-10-01-2024 Urdhri nr. 4447 prot., datë 19.09.2024 Nr 839,date 19.09.2024	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, Urdhri nr. 4369 prot., datë 17.09.2024 nr. 826, datë 17.09.2024</b> 1.Xh B 2.E Q 3.S T	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 839, datë 19.09.2024 1.D B 2.Xh B 3.A H	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 922 datë 02.10.2024. 1.H H 2.K LI 3.K B
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 52,614,889 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 47,237,996 lekë (pa TVSH) Fitues: BOE “R G K ShPK & V K” sh.p.k	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 5,376,893 lekë ose 89.7% e fondit	
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 17.10.2024	<b>8. Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Bashkisë Librazhd VKB nr. 119, datë 29.12.2024</b> Për vitin 2024 vlera financimit 15,000,000 lekë Për vitin 2025 vlera financimit 19,000,000 lekë Për vitin 2026 vlera financimit 29,137,867 lekë	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 11 B/OE b) S’kualifikuar 5 B/OE, c) Kualifikuar 6 B/OE	
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 6 muaj			
<b>10.Ankimime</b> AK-s’ka/ka; -Jo APP-s’ka/ka;-Jo KPP-s’ka/ka;-Jo	<b>11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit (sipas SPE):</b> Data: 26.11.2024 (Paraparak) Data: 05.11.2024 (Përfundimtar)	<b>12.Data e lidhjes së kontratës:</b> Data12.11.2024 (lidhja) Data: 14.11.2024 (njoftimi i lidhjes)	

**AK në lidhje me “Përlogaritjen e Fondit Limit”:**

Në dosje ndodhet Projekti i hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit nga ING Xh B, A H dhe K B.

Ndërsa Preventivi është hartuar nga Shoqëria “Z & C” ShPK drejtues A. P., sipas VKM nr. 216, datë 13.04.20223, për manualin e çmimeve, në vlerën 52,614,889 lekë pa TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se në dosje nuk ndodhet e depozituar “*leje ndërtimi/infrastruktura*”, në kundërshtim me nenin 39, pika 3<sup>22</sup> e Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar.

**AK (NjP) në lidhje me “Argëntimin e Specifikimeve Teknike dhe Hartimin e Kritereve”:**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit datë 01.10.2024 “Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe zbatim të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4. E konkretisht:

**Në pikën 2.3.10 të DST, operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B.( Grumbullim e transport mbeturina jo te rrezikshme qe dalin nga ndërtimi ).**

Kjo kërkesë është ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis. Nga sa më sipër rezulton se për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve

<sup>22</sup> përcakton se: “Përfituesi i lejes së ndërtimit, pronari i ndërtimit, sipërmarrësi, mbikëqyrësi dhe zbatuesi i punimeve janë përgjegjës solidarisht, sipas nenit 52, shkronjat “e” dhe “ë”, të këtij ligji, për kryerjen e punimeve në përputhje me këtë ligj, me dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit në Republikën e Shqipërisë, me dokumentet e planifikimit në fuqi, si dhe me kushtet dhe kriteret e lejes së ndërtimit”.

nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprkasht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është i paargumentuar, përtej domosdoshmërive dhe jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme, në mospërputhje me pikën (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 “Për vlerësimin në mjedis”, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit.

Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2/B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitetet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezulton se nuk është aktivitetet që plotësoni këto kushte. Nga NJP është përcaktuar baza ligjore ku është mbështetur një kriter i tillë.

Sa më sipër ngarkohen me **përgjegjësi: znj. D. B**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, **z. Xh. B**, me detyrë specialist në Sektorin e Projektimeve dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. A. H**, me detyrë specialiste në Sektorin e Projektimeve dhe Zbatimin e Kontratave, në cilësinë e anëtarëve të NJHDT-së.

Nga subjekti audituar, anëtarët e NJP (D B, A. H. dhe Xh. B.), me shkresën nr. 4937 prot, datë 17.7.2025 (prot KLSH nr. 407/4, dt. 21.7.2025), janë paraqitur kundërshti mbi akt konstatimin nr. 10, datë 11.7.2025, duke kundërshtuar se:

**Pretendim i subjektit përmbledhurazi:**

*Në lidhje me konstatimin se kategoria e licencës (QKL) Kodi III.2.B.( Grumbullim e transport mbeturina jo te rrezikshme qe dalin nga ndërtimi ), është paargumentuar nuk qëndron për faktin se ajo është në përputhje me dispozitat e LPP dhe VKM nr. 538, datë 26.45.2009 Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, si dhe të ligjit nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”, i ndryshuar. Kjo kategori licencë është në përputhje me zërat e punimeve të kësaj kontrate, dhe ku kërkohet që OE disponon licencat/lejet profesionale për kryerjen e proceseve.*

**Qëndrim i grupit të auditimit:**

Në lidhje me pretendimin tuaj se kategoria e licensës (QKL) Kodi III.2.B.( Grumbullim e transport mbeturina jo te rrezikshme qe dalin nga ndërtimi ), është në përputhje me dispozitat e LPP dhe e domosdoshme, sqarohet se pretendimet nuk qëndrojnë për faktin se nga AK Bashkia Librazhd nuk është paraqitur asgjë e re nga ato të ballafaquara në fazën e terrenit. *Kështu në zbatim të pikës (a) e nenit 1 të Ligjit nr. 10440, datë 7.7.2021 “Për vlerësimin në mjedis”, me qëllim sigurimin e një niveli të lartë të mbrojtjes së mjedisit, këto ekspertiza janë ezauruar gjatë fazës së hartimit të projekt/preventivit, relacioneve teknike respektive dhe raporti i vlerësimit në mjedis. Për aq kohë sa subjekti zbatues i punimeve nuk do të ketë lidhje me grumbullimin dhe transportin e mbetjeve nga ujërat e ndotura, kjo pasi siç theksohet edhe në cilësimet e bëra nga ana e Projektuesit, kriteri i propozuar paraprkasht nga NJP dhe i miratuar nga ana e Titullarit të AK është jashtë nevojave duke u bërë kështu shkak për krijimin e kushteve të mungesës së një konkurrence të lirë e të ndershme.*

Gjithashtu e drejta për të marrë kategorinë e licencës III.2.B jepet për shoqëri që kryejnë aktivitetet që kanë ndikim në mjedis, si për shoqërinë që kanë impiante betoni, asfalti apo aktivitete të tjerë që ndikojnë në mjedis. Referuar procedurës së prokurimit rezulton se nuk është aktivitetet që plotësoni këto kushte. **Përfundimisht pretendimet nuk qëndrojnë.**

**- Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.**

KVO me procesverbal datë 25.10.2024, për hapjen, shqyrtimin e ofertave në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 11 OE” për të cilat ka vlerësuar dokumentacionit teknik në sistemin SPE, ka skualifikuar 5 OE dhe kualifikuar 6 B/OE, të cilët janë kualifikuar dhe kanë shpallur në vend të parë ofertën e BOE “R G K ShPK & V K” ShPK, sipas tabelës si vijon:

Nr.	B/OE pjesëmarrës	Oferta pa TVSh	Skualifikuar/kualifikuar
1	C M	34,274,211.30	<u>Skualifikuar:</u> Oferta e tij ekonomike në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët
2	K...	36,028,383.00	<u>Skualifikuar:</u> Oferta e tij ekonomike në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët
3	N.	37,279,311.30	<u>Skualifikuar:</u> -Nuk ka arritur te vetdeklaroje disponimin e një ing drejtuesi teknik profili topograf siç është kërkuar ne piken 2.3.4 te kriterëve te veçanta për kualifikim, pasi në shtojca 8-Formulari i vetdeklarimit, ka deklaruar disponimin e dy ing profili hidroteknik por jo ing drejtues teknik profil topograf. - Ka vetdeklaruar disponimin e një "Punonjës/specialist për punime ne prezence uji me certifikatë kualifikimi te lëshuar ne "R B" ShPK me nipt L.....P. Nga verifikimet e bëra ne www.qkb.gov.al, rezulton se R B nuk është licencuar për ofrimin e kursit Punonjës/specialist për punime ne prezence uji, çka e bën dëshminë e punonjësit Z. N. te pavlefshme, nul, e për rrjedhoje vetdeklarimin për disponim e këtij specialisti te pasakte e te pavlefshëm.
4	D. C.	37,638,403.73	<u>Skualifikuar:</u> - Oferta e tij ekonomike në vlerën prej 37,638,403.73 leke pa TVSh në zbatim të dispozitave ligjore të sipërcituara, rezulton anomalisht e ulët. -"D C" sh.p.k nuk ka arritur te paraqesin dokumentacion te plote e te sakte për te dëshmuar plotësimin e te gjithë Kriterëve te Veçanta për Kualifikim Konkretisht ; -Nuk ka arritur te paraqesë dhe vetdeklaroje disponimin e dokumentacionit te sakte për te dëshmuar plotësimin e pikës 2.3.6 te kriterëve te veçanta për kualifikim Ne ketë pike është kërkuar qe për stafin teknik të kualifikuar duhet te vetdeklarohej qe ky staf te dispononte edhe Dëshmi e sigurimit teknik lëshuar nga Inspektorati Shtetëror Teknik dhe Industrial, ose nga shoqëri të akredituara sipas ligjit 8734 datë 01.02.2001 (i ndryshuar). Operatori ka vetdeklaruar numrin e profilit e stafit te kërkuar por për këta specialiste nuk ka vetdeklaruar disponimin e dëshmime përkatëse te sigurimit teknik
5	K	40,869,750.18	<u>Skualifikuar:</u> Shoqëria "K" ShPK, aktualisht ka ne proces zbatimi 2 (dy) kontrata me Bashkinë Librazhd, konkretisht: kontratën nr.2869 prot, date 13.06.2024 "Ndërtim i një qendre rinore ne Bashkinë Librazhd" ku shoqëria "K" ShPK ka marre përsipër 85% te realizimit te punimeve dhe kontrata nr.4592 prot, date 26.09.2024 me objekt "Përmirësim I banesave ekzistuese për komunitete për komunitete te varfra dhe te pafavorizuara për vitin 2024", ku shoqëria "K" ShPK ka marre përsipër 93 % te realizimit te punimeve. Ne këto kontrata drejtuesi teknik dhe I gjithë stafi drejtues është I angazhuar dhe për ketë nuk mund te jete i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt. Ne ditën e vlerësimit te kësaj procedure prokurimi KVO ka konstatuar se punimet ne zbatim te nuk kane përfunduar.
6	"R G K ShPK & V K"	47,237,966.00	<b>Kualifikuar/fitues</b>
7	V H	49,981,297.00	Kualifikuar
8	E	50,525,279.00	Kualifikuar
9	P - V - K	51,036,463.00	Kualifikuar
10	A A CO	51,567,600.94	Kualifikuar
11	Z K	52,088,591.00	Kualifikuar

Në përfundim, KVO-ja me vendim datë 25.10.2024, ka vlerësuar në vend të parë BOE "R G K ShPK & V K" ShPK, me ofertë 47,237,966 lekë pa TVSh.

Me datë 25.11.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit (Paraparak)", dhe me datë 05.11.2024 është hartuar dhe publikuar "Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)".

KVO ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. (pa numër) prot., datë 05.11.2024 I miratuar nga Titullari AK.

Me vendimin datë të 05.11.2024 është miratuar nga Titullari i AK, shpallja fitues e BOE "R G K ShPK & V K" ShPK me ofertë 47,237,966 lekë pa TVSh.

Pas paraqitjes së sigurimit të kontratës, është nënshkruar kontrata, me nr. 5577 prot., datë 12.11.2023.

- **Vlerësimi i ofertës fituese:**

Në lidhje me BOE "R G K ShPK & V K" ShPK, nga auditimi, rezultoi se nuk është në kushtet e plotësisht të të gjitha kriterëve të DST, e konkretisht:

1- Shoqëria "R G-K" ShPK, nuk plotëson kriteret si vijon:

a- Në licencën e shoqërisë nuk disponohet kategoria e licensës NP-12A;

b- Referuar ndarjes së punimeve kategoria e licensës NS-18A, duhet të jetë e disponueshme për të dy OE.

c- Nga verifikimet e kryera në SPE shoqëria "V K" ShPK, rezultojnë të ketë kontratë aktive për periudhën e objektit prokurimit përkatësisht objektin: "Mbrotjtje lumore në lumin e Gostimes L=171m (vendi midis rrugës dhe hidrocentralit) si dhe segmenti i përroit Sheh nga ura deri tek vendtakimi me lumin e Gostimes (70m+10m) faza e III", me njoftim fitues përfundimtar, 12-09-2024 me kohëzgjatje punimesh 3(tre) muaj. Vihet re se pjesa më e madhe e stafit dhe mjeteve janë të angazhuara në të dyja ofertat, si: z. Gj.B, ing ndërtimi drejtues Teknik, zj. A.(B.)L, ing. Mjedisi, zj. L. Xh ing. Hidroteknik, z. F. G ing. Mekanik etj. Ndërsa pjesa e përkjet mjeteve dhe makinerive: nuk ka asnjë ndryshim midis shtojcës së datës 23.08.2024 dhe asaj të 14.10.2024.

Në lidhje me vlerësimin e ofertave, KVO-ja nuk ka vlerësuar drejt shoqëritë pjesëmarrëse në garë, pasi OE i shpallur fitues nuk është në kushtet e plotësisht të të gjithë kërkesave të DST. Në këto kushte KVO duhet të vijonte me OE të radhës me kriteret e plotësuar, veprime në kundërshtim me: Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, "Për prokurimin publik", (i ndryshuar), neni 2, neni 3 pika 1, neni 76 pika 3/ë dhe 5, neni 92 pika 3, për të cilat ngarkohen me **përgjegjësi: z. K. B**, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit Urban dhe i Mbrotjtjes së Territorit, **z. H. H**, me detyrë Drejtor i Bujqësisë, Administrimit të Ujitjes, Kullimit dhe Mjedisit dhe **znj. K. Ll**, me detyrë Specialiste në Sektori Juridik, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti sudituuar janë paraqitur kundërshtitë me shkresën nr. 6651, datë 29.9.2025 (prot KLSH nr. 407/6, datë 01.10.2025), mbi "Projekt Raportin e Auditimit", nga z/zj. K. B, K.Ll. dhe E. Gj. në cilësinë e anëtarëve të KVO, ku janë shprehur kundërshtitë si më poshtë:

**Pretendim i subjektit përmbledhurazi:**

*Në lidhje me vlerësimin e procedurës me objekt: "Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Allanit Dorez-Gizavesh Librazhd Qendër". ....Rreth pretendimit për mungesë të kategorive të licensës NP 12A dhe NS 18A Audituesit kanë konstatuar se shoqëria "R G K" sh.p.k nuk disponon kategorinë e licensës NP-12A dhe se kategoria NS 18A duhet të jetë e disponueshme nga të dy O.E . Ky konstatim nuk është në përputhje me kuadrin ligjor dhe praktikën e konsoliduar të vendimarrjeve të KPP, për këto arsye: të Licencat NP-12A dhe NS-18A disponohen nga njëri prej anëtarëve të BOE-së, konkretisht "V K" sh.p.k, që është e mjaftueshme për të përmbushur kriterin, për aq kohë sa ndarja e punimeve është e qartë dhe e mbështetur me akt-marrëveshje të dorëzuar në ofertë. Natyra e punimeve që ka marrë përsipër shoqëria "R G-K" sh.p.k, referuar VKM-së nr. 42/2008, nuk kërkon detyrimisht disponimin e këtyre kategorive licence. Audituesit nuk kanë identifikuar konkretisht ndonjë zë punimesh që ka marrë përsipër ta kryejë operatori "R G-K" sh.p.k që kërkon NP-12A apo NS-18A sipas kësaj VKM-je. ....*

*Rreth pretendimit për angazhimin e njëkohshëm të stafit teknik dhe makinerive "V K" sh.p.k, në dy kontrata të ndryshme të pretendimi se stafi teknik dhe makineritë e "V K" janë të deklaruara të angazhuara edhe në një kontratë tjetër (objekti "Mbrotjtje lumore në lumin e Gostimes...") nuk përbën shkak për skualifikim, sepse: Nuk ekziston asnjë dispozitë ligjore që ndalon drejtuesit teknikë të një shoqërie ndërtimi të angazhohen në dy kontrata të ndryshme, për aq kohë sa nuk janë të punësuar njëkohësisht në dy shoqëri të ndryshme dhe për aq kohë sa angazhimi real në objekt është i mundur dhe racional. .... Kjo është konfirmuar edhe nga*

vendimet e KPP, si p.sh. vendimi nr. 459/2021, ku theksohet se ndalimi i "dy punësimit" nuk përkthehet në ndalim të "angazhimit në dy objekte". Konkretisht ne kete vendim shprehimisht thuhet; .....

Mbi rolin dhe garancitë e autoritetit kontraktor, sipas nenit 124 të ligjit nr. 162/2020 dhe nenit 36 e 108 të VKM nr. 285/2021, ka rol qendror në monitorimin e zbatimit të kontratës dhe në marrjen e masave nëse vërehen devijime nga detyrimet e ofertuara. Si i tillë, autoriteti kontraktor është në gjendje të reagojë në kohë nëse zbatimi i kontratës ndikohet negativisht nga angazhime paralele ose mungesë burimesh. Deri në atë moment, çdo vlerësim hipotetik i mosrealizimit mbetet i parakohshëm dhe pa bazë objektive.....

### **Qëndrim i grupit të auditimit:**

Për sa është argumentuar nga KVO-ja mbi konstatimet e grupit të auditimit, sqarohet se pretendimet nuk qëndrojnë dhe nuk merren në konsideratë, pasi nga subjekti nuk është paraqitur asgjë e re nga ato të paraqitura në fazën e PRA. Kështu referuar marrëveshjes së bashkëpunimit midis dy shoqërive, rezultoi se shoqëria "R G K" ShPK, ka marrë përsipër punime që kërkojnë kategoritë NP-12A dhe NP-18A, gjë e cila nga ana juaj nuk është kundërshtuar me analizën e zërave të preventivit. Sipas zërave të preventivit dhe marrëveshjes së bashkëpunimit shoqëria "G-K" sh.p.k ka punime që kërkojnë këto kategori licensash. Gjithashtu dhe nga ana juaj nuk është kundërshtuar fakti se sipas preventivit nga kjo shoqëria nuk kërkojnë këto kategori licensash.

Ndërsa në lidhje me deklarinimin e stafit teknik dhe makinerive në kontrata të tjera, pretendimi nuk qëndron, pasi referuar DST të miratuar nga vetë AK Bashkia Librazhd, thuhet se stafi teknik dhe mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në kontrata të tjera. Pretendimi juaj se drejtuesi teknik nuk duhet të angazhohet në dy shoqëri nuk ka lidhje me konstatimin e grupit të auditimit. **Përfundimisht pretendimi juaj mbi vlerësimin nuk qëndron dhe nuk merret në konsideratë.**

**V- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në procedurën me objekt: "Sistemim asfaltim i rrugës Librazhd- Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd", në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave , u konstatuan disa parregullsi në shkëlqje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", etj., konkretisht si vijon:**

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Sistemim asfaltim i rrugës Librazhd-Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd"</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> "E hapur" REF-01892-04-18-2024 Urdhri nr. 1346 prot., datë 18.03.2024	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, Urdhri nr. 1187 prot., datë 04.03.2024</b> 1. A H 2. A P 3. Xh B	<b>2 Njësia e Prokurimit</b> Urdhri nr. 1346 prot., datë 18.03.2024 1. D B 2.Xh B 3. A H	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. 1345 prot., datë 18.03.2024. 1.K B 2.E Gj 3.K Ll
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 75,000,000 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 59,238,031 lekë Fitues: BOE "Z K" sh.p.k & "A-A CO" ShPK.		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 15,761,969 lekë ose 78.9% e fondit
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 07.05.2024	<b>8. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Librazhd</b> VKB nr. 119, datë 29.12.2023 "Për miratimin e buxhetit të vitit 2024".		<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 6 B/OE b) S'kualifikuar 3 B/OE, c) Kualifikuar 3 B/OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 6 muaj	<b>10. Ankimime</b> AK-s'ka/ka; -Jo APP-s'ka/ka; -Jo KPP-s'ka/ka; -Jo		<b>11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit (sipas SPE):</b> Data: 21.05.2024 (Paraparak) Data: 31.05.2024 (Përfundimtar)
<b>11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit (sipas SPE):</b> Data: 21.05.2024 (Paraparak) Data: 31.05.2024 (Përfundimtar)		<b>12. Data e lidhjes së kontratës:</b> Data: 12.06.2024 (lidhja) Data: 12.06.2024 (njoftimi i lidhjes)	

- **AK në lidhje me “Për llogaritjen e Fondit Limit”:**

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se Projekti, Preventivi i Punimeve dhe Relacioni Teknik, në lidhje me këtë procedurë, janë përgatitur nga shoqëria “Z&Co” ShPK. Referuar preventivit, ndër të tjera, specifikohet se vlera e objektit të kontratës është përlllogaritur 75,000,000 lekë pa TVSh.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit, konstatohet se me procesverbal nr. 1319 pro., datë 13.03.2024 komisioni është shprehur bazuar në çmimet e zërave të punimeve sipas sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve të në ndërtim ka konfirmuar preventivin në vlerën 75,000,000 lekë pa TVSH.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se ndodhet leja infrastrukturore nr. 2691/3, datë 21.06.2025 për objektin “Sistemi asfaltim i rrugës Librazhd-Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”.

- **AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin e Specifikimeve Teknike dhe Hartimin e Kritereve”:**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit datë 18.04.2024 “Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit”, dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, pikës 1, të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, I ndryshuar dhe nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cenuar kështu edhe përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

- Sjellim në vëmendje të AK, që në hartimin e kriterit për nevojën e punonjësve, duhet t’i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës. Konkretisht 2.3.5 numri I kërkuar nga autoriteti kontraktor është i ekzagjeruar dhe duke shkelur parimet bazë të ligjit të prokurimit.

- Përsa i përket pajisjeve të domosdoshme **2.3.12**, procedura e prokurimit sipas zërave të punimeve parashikon shumë më pak mjete se ato që kërkohen në kritere. Referuar zërave të preventivit të miratuar nga sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim, te sistemit e-Albania, janë vendosur mjete dhe pajisje të cilat nuk ndikojnë në zhvillimin e kontratës si: *Ekskavator me Zinxhir me çekiç, Rrul hekur-gome me kapacitet 12 ton, Kompaktor, Fabrike Asfalto betoni e pajisur me QKL, Linje Prodhimi Betoni me QKL, Damber kantieri, Aparat topogjeodezik me GPS, Kulle Ndriçimi, Auto betoniere 5 cope, Kontinier-Zyre lëvizëse, Gjenerator mbi 50 kva*

- Në lidhje me kriterin **2.3.10** sjellim në vëmendje të AK se në momentin e kërkesës së autorizimit nga prodhuesi ose distributor si kusht kualifikimi nuk mund të kërkohet laborator testi i betonit, e cila çon në mënyrë direkt në pabarazi për operatorët ekonomikë duke cenuar kështu edhe përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën, por pa I kaluar kompetencat e objektit të prokurimit. Ky kriter nuk argumentohet ligjërisht me Nenin 77 në asnjë nga pikat e tij.

*Përpara hapjes së procedurës, KVO-ja duhet të kërkonte shpjegim ndaj Njesisë së Prokurimit, specialistit të fushës, ose t' I propozonte titullarit anulimin e procedurës për arsye se kriteret nuk janë të argumentuara teknikisht.*

Sa më sipër ngarkohen me **përgjegjësi: znj. D. B.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, **z. Xh. B.**, me detyrë specialist në Sektorin e Projektive dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. A. H.**, me detyrë specialiste në Sektorin e Projektive dhe Zbatimin e Kontratave, në cilësinë e anëtarëve të NJHDT-së.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti sudituar janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 6651, datë 29.9.2025 (prot KLSH nr. 407/6, datë 01.10.2025), mbi "Projekt Raportin e Auditimit", nga z/zj. D. B, A. H. dhe Xh. B. në cilësinë e anëtarëve të NJP, ku janë shprehur kundërshtitë si më poshtë:

#### **Pretendim i subjektit:**

*Pretendimi i subektit për auditimin e procedurës me objekt: "Sistemim asfaltim i rrugës Librazhd - Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd".*

*Duke mos qenë dakord me konstatimet e përgjegjësive të pretenduara ndaj anëtarëve të njësisë prokurimit, ju paraqesim këtë observacion me kundërshtimet dhe sqarimet tona.*

*Lidhur me përgjegjësitë e anëtarëve të NJP, kam hartuar kriteret e veçanta për kualifikim të kapacitetit teknik, në cilësinë e specialistit të fushës. Grupi i Auditimit të KLSH ka konsideruar disa kërkesa të përcaktuara në procedurën e prokurimit, si kërkesa të paargumentuara e jo në përputhje me natyrën e aftësinë zbatuese të kontratës. Bëj me dije se kërkesat e vendosura janë të argumentuara dhe në raport me fondin limit, përmasat e kantierit, duke patur në fokus rritjen e konkurrencës.*

*Ne **pikën 2.3.5 "Kapaciteti teknik"**, kërkesa për numrin e punonjësve është kërkuar në bazë të portalit e-albania për numrin e kërkuar, por duke ju referuar faktit që terreni, koha dhe disa faktor të tjerë të cilët merren parasysh vetëm nëpërmjet gjëndjes faktike në terren ne kemi kërkuar një numër minimal prej 80 (tetëdhjetë) punonjësish të cilët do garantonin realizimin në kohë të punimeve.*

*Ne **pikën 2.3.7** kërkesa Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se zhvillon aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë, mjedisit dhe menaxhimit të energjisë. NJ.P është shprehur krahas ose ISO 45001:2018 ose ekuivalent duke thënë këtë NJ.P nuk ka lënë vend për konfuzion të OE dhe kjo mbështet dhe nga fakti që nuk kemi patur kërkesa për sqarim në SPE në lidhje me pikën e mësipërme.*

*Në **pikën 2.3.10 "Kapaciteti teknik"** kërkesa për laborator testimi të betonit është në përputhje me zërat e preventivit ku kemi patur të bëjmë me punime të betonit të mureve dhe një OE pjesëmarrës i cili ndodhet në kushtet për të punuar e ka mjaft të thjeshtë për të patur një kontratë me laborator duke ju referuar dhe faktit që testimet nga laborator të akredituar nuk sjellin gjë veçse testime të qarta për punime me cilësi, si dhe nuk kemi patur rekomandime nga APP.*

*Në **pikën 2.3.12 "Kapaciteti teknik"**, kërkesa për eskavator me zinxhir me çekiç është bërë referuar zërave të preventivit specifikisht referuar zërit 3.124/1a Germim shkëmbi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir, Rrul hekur-gome me kapacitet 12 ton është kërkuar referuar zërave të preventivit që kanë të bëjnë me ngjeshjen e shtresave rrugore, Damper kantieri është kërkuar referuar zërave të preventivit që kanë patur të bëjnë me transportin e inerteve të ndryshme të dala nga puna dhe referuar faktit që terreni ka patur veshitirsi manovrimi është kërkuar për garanci teknike damperi kantierit, GPS është kërkuar si pajisje pune për inxhinierin topograf për të bërë të mundur realizimin sa më të mirë dhe me cilësi të punimeve ku specifikisht në një rrugë është e domosdoshme një pajisje e tillë. Autobetonieret janë kërkuar për realizimin e betoneve ku kemi patur të bëjmë me një sasi të*

konsiderueshme, Kontenieri është kërkuar për Inxhinier Drejtues Teknik të punimeve në kantier. Gjeneratori është kërkuar për punimet e ndryshme dhe për mos të penguar ecurinë e punimeve.

Në **piken 2.3.13 “Kapaciteti teknik”**, kërkesa për impantin e asfalto-betonit nuk ka të bëjë me asgjë përveçse garantimin tonë si NJ.P që O.E pjesëmarrës kanë mundësin të garantojnë materialin e kërkuar në Preventiv i cili zë dhe përqindjen më të lartë të punës.

Çdo kriter i vendosur është shoqëruar me argumentimin përkatës dhe çdo kriter është në përputhje me natyrën, përmasat dhe aftësinë zbatuese të kontratës objekt prokurimi, gjë e cila vërtetohet më së miri edhe nga pjesëmarrja e operatorëve ekonomikë në këtë procedurë.

Për më tepër, ritheksoj edhe njëherë se institucioni më i lartë që monitoron procedurat e prokurimit, e që jep rekomandime për vendosjen, heqjen, ndryshimin apo përmirësimin e kriterëve kualifikuese, pra Agjencia e Prokurimit Publik (APP), nuk ka dhënë rekomandime për kriteret e vendosura.

#### **Qëndrim i grupit të auditmit:**

Për sa keni kundërshtuar, grupi vlerëson ato që kishin argumentin e duhur dhe nuk gjejna p[asqyrim në raportit përfundimtar. Ndërsa mangësitë e tjera mbi kriteret, argumentet nuk qëndrojnë duke i reflektuar në këtë RPA së bashku e shpjegimet pse këto kriteret nuk duhet të ishin pjesë e DT.

#### **- Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimin të ofertave nga KVO.**

KVO me procesverbal datë 21.05.2024, për hapjen, dhe vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 6 OE për të cilat ka vlerësuar dokumentacionin teknik në sistemin SPE, nga ku ka skualifikuar 3 OE dhe kualifikuar 3 OE, të cilët janë kualifikuar dhe kanë shpallur në vend të parë ofertën e BOE “Z K” ShPK & “A-A CO” ShPK, sipas tabelës si vijon:

Nr.	B/OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta pa TVSh	Skualifikuar/kualifikuar
1	“Z K & “ASI-2A CO”	J...../ K.....C	59,238,031	<u>Kualifikuar-fitues</u>
2	B N.	K.....O	61,052,488	Kualifikuar
3	S 2F & L K	K...../ K.....H	66,666,666	Kualifikuar
4	“B-I”	K.....A	58,494,657	Skualifikuar
5	C M + K.	L.....O/ L.....E	49,701,516	Skualifikuatr
6	N	K.....I	70,569,465	Skualifikuar

Me datë 21.05.2024 është hartuar dhe publikuar “Formulari i Njoftimit (Paraparak)” dhe me datë 31.05.2024 është hartuar dhe publikuar “Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)”.

KVO-ja ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. (pa numër) prot., datë 31.05.2024 në të cilin, është pasqyruar situatë në lidhje me vlerësimin e procedurës.

Me vendimin datë të 31.05.2024 është miratuar nga Titullari i AK, shpallja fitues e BOE “Z K” & “A-A CO” ShPK me ofertë 59,239,031 lekë pa TVSh.

Pas paraqitjes së sigurimit të kontratës, është nënshkruar kontrata, me nr. 2854 prot., datë 12.06.2024.

#### **- Vlerësimi i ofertave nga KVO:**

OE e skualifikuar dhe arsyet e skualifikimit, paraqiten si më poshtë vijon:

#### **1- Shoqëria “B-I” ShPK me oferte 58.494.657 leke pa TVSh, për shkak se :**

- Nuk plotëson në piken 2.3.4 Punonjës i Deklaruar Teknik Topograf E.A nuk disponon diplomën e shkollës së mesme ose licence profesionale nga institucionet përkatëse ku specifikohet qarte që •Për teknikat e ndërtimit dhe teknikun topograf do të pranohet vetëm diploma e shkollës së mesme/licence profesionale nga institucionet përkatëse.

- Ne piken 2.3.11 për materialin Hekur nuk ka paraqitur katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike.

- Nuk plotëson piken 2.3.12 për mjetin Grejder me goma nuk ka paraqitur targën, leje qarkullimi, nr.shasie ne formularin e vetdeklarimit, për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, Certifikatën e pronësisë, Certifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetëm mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme)

- Nuk plotëson piken 2.3.12 për mjetet Damper 2 cope nuk ka paraqitur targën, leje qarkullimi, nr.shasie ne formularin e vetdeklarimit, për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, Certifikatën e pronësisë, Certifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetëm mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme)

- Nuk plotëson piken 2.3.12 Nuk ka paraqitur Kontrate Furnizimi Noteriale për Fabrike prodhimi te elementeve te betonit me QKL e cila duhet te jete ne Pronësi /me qera/ Kontrate furnizimi noteriale

- Nuk plotëson piken 2.3.13 Për Fabrike Asfalto betoni e pajisur me QKL cila nuk duhet te jete ne distance me te madhe se 35 km nga objekti i prokurimit dhe as Impianti është mobile (i lëvizshëm). Operatori nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor qe vërteton qe pronësinë e tij (fature tatimore/zhdoganimi ose kontrate shitblerjeje si dhe e shoqëruar me foto). Për vërtetimin e realizimit te kësaj pike, impianti i deklaruar prej O.E B-I është statik dhe ka distance prej 104 km.

- Nuk plotëson piken 2.3.14 pasi për Guroren nuk është paraqitur leja IV.1.B.2

Në nenin 77, pikën 5 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: “5. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë në njoftimin e kontratës ose në ftesën për shprehje interesi kriteret e përzgjedhjes, si dhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve”. Ndërsa në nenin 92/3 të LPP-së përcaktohet se: “3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji...”

## 2- Shoqëria “N” ShPK me oferte ekonomike 70,569,465 leke pa TVSh për shkak se :

- Nuk ka Plotësuar Tabelën e Punonjësve.

- Nuk ka Plotësuar 23.11 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet:

Hekur; Tombino me tuba betony; Gabiona; Materiale sinjalistike

Për materialet e kërkuara OE duhet te paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe te paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara ne Specifikimet teknike. Nuk ka asnjë dokumentacion

- Nuk ka Plotësuar Piken 2.3.12 për mjetet. Kamion vetëshkarkues (kapaciteti mbajtës mbi 20 ton) Cope 1; Grejder me goma; Damper kantieri, nuk ka paraqitur targën, leje qarkullimi, nr.shasie ne formularin e vetdeklarimit, për mjetet që regjistrohen ne regjistra publike duhet të paraqitet dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, Certifikatën e pronësisë, Certifikatë për transport mallrash për llogari të vetë (vetëm mjetet e transportit) dhe siguracionin e mjetit (te vlefshme)

- nuk plotëson piken 2.3.13 Për Fabrike Asfalto betoni e pajisur me QKL cila nuk duhet te jete ne distance me te madhe se 35 km nga objekti i prokurimit dhe as Impianti është mobile (i lëvizshëm). Operatori nuk ka paraqitur dokumentacionin ligjor qe vërteton qe pronësinë e tij (fature tatimore/zhdoganimi ose kontrate shitblerjeje si dhe e shoqëruar me foto).

## 3. BOE “C M” & “K” ShPK, me ofertë ekonomike 49,701,516 leke pa TVSh për shkak se është Ofertë Anomalisht e ulët.

➤ Sipas grupit të auditimit, nga auditimi i dokumentacionit në dosjen e procedurës dhe sistemin SPE, rezultoi se dhe bashkimi i OE “Z K ShPK & “A-A CO” ShPK, i cili është shpallur fitues nga KVO, nuk është në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve të DST, konkretisht:

Procedura e prokurimit është shpallur në sistem në datë 19.04.2024, datë e cila përkon me vlerësimin e ofertave të procedurës me objekt prokurimi “Rionstruksion kanali i Kuturmanit”.

Në datën 03.06.2024 bashkimi i OE shpallet fitues për procedurën e prokurimit “Rionstruksion kanali i Kuturmanit”, ku automatikisht e skualifikon nga procedurat objekt prokurimi të shpallura në sistem në të cilat angazhon të njëjtin staf drejtues dhe pajisje, makineri për realizimin e kontratës.

Pajisjet dhe makineritë të cilat figurojnë në Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit me datë 14.05.2024 janë të njëjtat me pajisjet dhe makineritë e Formularit Përmbledhës të vetëdeklarimit me datë 19.04.2024.

Përsa i përket stafit inxhinierik dhe fuqisë punëtore e cila deklarohet në procedurën me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Librazhd-Katund faza e I-rë Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd” , si vijon: E Z, me profesion Inxhinier Ndërtimi; K D, me profesion Inxhinier Ndërtimi; P T, me profesion Inxhinier Gjeomatik; Th G, me profesion Inxhinier Hidroteknik; E. K. me profesion Inxhinier Mjedisi; G. T. me profesion Inxhinier Mekanik; A. Z, me profesion Inxhinier Ndërtimi; Z. Z., me profesion Teknik Ndërtimi; Rr. T., me profesion Teknik Ndërtimi; Xh. T., me profesion Karpentier; Y. C, me profesion Hekurkthyes; F. M., me profesion Saldator; I. A. ,me profesion Hidraulik; F. M,me profesion Betonues etj.

Përsa i përket stafit inxhinierik dhe fuqisë punëtore e cila deklarohet në procedurën me objekt: “Rikonstruksion kanali I Kuturmanit”, si vijon: E. Z., me profesion Inxhinier Ndërtimi; K. D, me profesion Inxhinier Ndërtimi; P T, me profesion Inxhinier Gjeoburimesh; Th G, me profesion Inxhinier Hidroteknik; Y. C, me profesion Hekurkthyes; I. A, me profesion Hidraulik; G. M., me profesion Shofer; E. K, me profesion Ekskavatorist/Manovrator.

Me kualifikimin e bashkimit të OE “Z K & A-A CO” ShPK, në zbatim të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar neni 92 dhe 97, pika 1/b, sipas të cilit “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”.

Në rastin konkret, KVO-ja duhet të bënte propozimin tek Titullari i AK për lidhjen e kontratës me OE të radhës. Ky veprim ka sjellë lidhjen e kontratës me një OE, i cili është shpallur fitues në pajtueshmëri me dispozitat e LPP, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), neni 2, neni 3 pika 1, neni 92 pika 3 dhe 4, dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së: **z. K. B**, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit Urban dhe i Mbrojtjes së Territorit, **z. E. Gj**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Projektive dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. K. Ll**, me detyrë Specialiste në Sektori Juridik, në cilësinë e anëtarit të KVO.

**VI- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në procedurën me objekt: “Sistemim, asfaltim i rrugës Funarës-Zdranjsh, Njësia administrative Orenje, Bashkia Librazhd”, në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave , u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, etj., konkretisht si vijon:**

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Sistemim, asfaltim i rrugës Funarës-Zdranjsh, Njësia administrative Orenje, Bashkia Librazhd”			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “E hapur” REF-13300-07.16-2024 Urdhri nr. 1342 prot., datë 18.03.2024 Nr 304, datë 18.03.2024	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, Urdhri nr. 1186 prot., datë 04.03.2024, nr. 278, datë 04.03.2024</b> 1.Xh B 2.A H 3.A P	<b>2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 1342 prot., datë 18.03.2024 nr. 304, datë 18.03.2024</b> 1.D B 2.Xh B 3.A H	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. 1343 prot., datë 18.03.2024 nr. 305 datë 18.03.2024.</b> 1. K B 2. E Gj 3. K Ll

<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 75,000,000 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 50,937,603 lekë Fitues: BOE "V E" ShPK & "K" ShPK.	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 24,062,397 lekë ose 67.9% e fondit
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 01.08.2024	<b>8. Burimi Financimit</b> <b>Buxheti i Bashkisë Librazhd</b>	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender Numër 8 B/OE b) S'kualifikuar 0 B/OE, c) Kualifikuar 8 B/OE
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 10 muaj		
<b>10. Ankimime</b> AK-s'ka/ka; -po APP-s'ka/ka; -po KPP-s'ka/ka; -po	<b>11. Data e publikimit të njoftimit të fituesit (sipas SPE):</b> Data: 13.08.2024 (Paraparak) Data: 21.08.2024 (Përfundimtar)	<b>12. Data e lidhjes së kontratës:</b> Data: 23.08.2024 (lidhja) Data: 27.08.2024 (njoftimi i lidhjes)

- **AK në lidhje me "Përlogaritjen e Fondit Limit":**

Nga dokumentacioni i paraqitur rezulton se Projekti, Preventivi i Punimeve dhe Relacioni Teknik, në lidhje me këtë procedurë, janë përgatitur nga shoqëria "E C G" ShPK. Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se ndodhet leja infrastrukturore nr. 2734/3, datë 14.06.2024 për objektin "Sistemi, asfaltim I rrugës Funarës-Zdranjsh, Njësia administrative Orenje, Bashkia Librazhd".

- **AK (NjP) në lidhje me "Argumentimin e Specifikimeve Teknike dhe Hartimin e Kritereve":**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit datë 16.07.2024 "Për argumentimin, përcaktimin/hartimin e kritereve të pranimit/kualifikimit", dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se disa nga kriteret nuk janë në përputhje me kushtet e zhvillimit të procedurës dhe nuk përmbushin parashikimet e dispozitave të legjislacionit të zbatueshëm për prokurimin publik, referuar pikës 1, të nenit 77, të Ligjit nr. 162/2020, "Për prokurimin publik" (i ndryshuar), dhe nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për rregullat e prokurimit publik", i ndryshuar, që çdo kriter i veçantë duhet të jetë në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, duke cënuar kështu edhe përcaktimet e nenit 3 të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë dhe për të mos ngushtuar konkurrencën.

Sjellim në vëmendje të AK, që në hartimin e kriterit për nevojën e punonjësve, AK duhet t'i përmbahet përcaktimeve të pikës 1, të nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021. *Konkretisht:*

**Në pikën 2.3.5 të DST, OE pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore minimalisht 70 (shtatëdhjetë) persona.**

Numri i punonjësve nuk është vendosur bazuar në sasi të çdo zëri punimesh në preventiv dhe në natyrën e objektit të kësaj kontrate, pasi nga zërthimi i zërave të preventivit dhe afati i parashikuar i punimeve përlogaritja nuk është 70 në lidhje me (shtatëdhjetë) punonjës.

Përsa i përket pajisjeve të **domosdoshme në pikën 2.3.7 të DST**, procedura e prokurimit sipas zërave të punimeve parashikon shumë më pak mjete se ato që kërkohen në kritere. Referuar zërave të preventivit të miratuar nga sistemi i Integruar për Informatizimin e Manualit të Çmimeve për Zërat e Punimeve në Ndërtim, te sistemit e-Albania, janë vendosur mjete dhe pajisje të cilat janë të panevojshëm në zhvillimin e kontratës si: *Ekshkavator me Zinxhir me*

çekiç, Rrul hekur-gome me kapacitet 12 ton, Kompaktor, Fabrike Asfalto betoni e pajisur me QKL, Linje Prodhimi Betoni me QKL, Dampër kantieri, Aparat topogjeodezik me GPS.

Në lidhje me kriterin në pikat 2.3.9, 2.3.10, 2.3.11 të DST, sjellim në vëmendje të AK se në momentin e kërkesës së autorizimit nga prodhuesi ose distributor si kusht kualifikimi nuk mund të kërkohej fabrikë asfalto betoni, gurore, e cila çon në mënyrë direkt në pabarazi për OE, në papajtueshmëri me nenin 3, të LPP, për të garantuar trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për OE dhe për të mos ngushtuar konkurrencën. Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën, por pa i kaluar kompetencat e objektit të prokurimit.

Sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: znj. D. B, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, z. Xh. B, me detyrë specialist në Sektorin e Projektimeve dhe Zbatimin e Kontratave dhe znj. A. H, me detyrë specialiste në Sektorin e Projektimeve dhe Zbatimin e Kontratave, në cilësinë e anëtarëve të NJHDT-së.

Me shkresën nr. 4938 prot, datë 17.7.2025 (prot KLSH nr. 407/4, dt. 21.7.2025), paraqitu nga anëtarët e NJP Bashkia Librazhd (D. B, A. H. dhe Xh. B), mbi problematikat e konstatuara në akt konstatimin nr. 11, datë 11.7.2025, ku thuhet se:

**Pretendim i subjektit përmbledhurazi:**

*Kërkesa për numrin e punonjësve është kërkuar në bazë të portalit e-albania për numrin e kërkuar, por duke ju referuar faktit që terreni, koha dhe disa faktorë të tjerë të cilët merren parasysh vetëm nëpërmjet gjendjes faktike të terrenit është kërkuar numrit 80;*

*Në lidhje me certifikatës OHSAS 18001/2007, është kërkuar për faktin që OE duhet të vërtetohet se zhvillon aktivitetet e tij në fushën e objekt prokurimi në përpërputhje me standartet e menaxhimit të cilësisë së shëndetit e sigurisë në punë.*

*Kërkesa për laborator testimi të betonit është në përputhje me zërat e preventivit, pasi kemi të bëjmë me punime të betonit të mureve dhe një OE pjesëmarrës i cili ndodhet në kushtet për të punuar e ka mjaft të thjeshtë për të patur një kontratë me laborator, referuar faktit që testimet në laborator të akredituar nuk sjellin gjë veçse teste të qarta për punime me cilësi;*

*Kërkesa për ekskavator me zinxhir me çekiç është bërë referuar zërave të preventivit, respektivisht zërit 3.124/1a;*

*Kërkesa për impiant betoni ka të bëjë me garantimin e cilësisë së materialit të kërkuar në zërat e preventivit i cili zë dhe përqindjen më të lartë të punimeve.*

**Qëndrim i grupit të auditimit:**

Për sa është kundërshtuar nga subjekti në lidhje me disa nga kriteret e paargumentuara, sqarohet se ato qëndrojnë pjesërisht, ku për ato që kishin argument u morën në konsideratë nga grupi dhe nuk gjejnë pasqyrim në këtë fazë të projekt raport auditimit, ndërsa të tjerat nuk kanë dokumentacionin e nevojshëm ligjorë argumentues, si p.sh., si është bërë përcaktimi i numrit 80 të fuqisë punëtorë, etj. **Pretendimet qëndrojnë pjesërisht.**

**- Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.**

KVO me procesverbal datë 13.08.2024, për hapjen dhe vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 8 OE për të cilat ka vlerësuar dokumentacionit teknik në sistemin SPE, ka kualifikuar 8 OE, kanë shpallur në vend të parë ofertën e BOE “V E” ShPK & “K” ShPK, sipas tabelës si vijon:

Nr.	B/OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta pa TVSh	Shkualifikuar/kualifikuar
1.	“A”	J.....O	52,448,051	Kualifikuar
2.	“B-X” & “C M”	K.....N/L.....O	51,868,882	Kualifikuar
3.	“B-I”	K.....A	57,955,448	Kualifikuar
4	“V E” & “K.”	J.....S/ L.....E	50,937,603	<b>Kualifikuar e shpallur fitues</b>

Nr.	B/OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta pa TVSh	Shkualifikuar/kualifikuar
5	“P - V – K”	K.....M	53,317,905	Kualifikuar
6	“S 2F”	K.....J	74,444,444	Kualifikuar
7	“V H”	K.....C	62,477,334	Kualifikuar
8	“K”	K.....C	56,402,808	Kualifikuar

Me datë 13.08.2024 është hartuar dhe publikuar “Formulari i Njoftimit (Paraparak)”, dhe me datë 21.08.2024 është hartuar dhe publikuar “Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)”, pas përfundimit të të afateve të ankimimit.

KVO ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. (pa numër) prot., datë 21.08.2024 në të cilin, ka shpallur në vend të parë BOE “V E” ShPK & “K” ShPK, me ofertë 50,937,603 lekë pa TVSH.

Me vendimin datë të 21.08.2024 është miratuar nga Titullari i AK, shpallja fitues e BOE “V E” ShPK & “K” ShPK, me ofertë 50,937,603 lekë pa TVSH.

Pas paraqitjes së sigurimit të kontratës, është nënshkruar kontrata, me nr. 4033 prot., datë 23.08.2024.

#### - Vlerësimi i procedurës:

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistemin (SPE) dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka vepruar në zbatim të dizpozitave të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar), pasi OE të skualifikuar dhe ato të kualifikuar janë vlersuar drejt, duke shpallur fitues ofertën me vlerë më të leverdisshme

**VII- Nga shqyrtimi i dokumentacionit** të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në procedurën me objekt: **“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2024”**, në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave, u konstatuan disa parregullsi në shkëlqje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, etj., konkretisht si vijon: **Objekti i këtij akt-konstatimi**. Auditim i procedurës me objekt: “, si vijon:

a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2024”			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e Hapur” REF-16707-08-21-2024 Urdhri nr. 3601 prot., datë 29.07.2024 Nr 694, datë 29.07.2024	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, Urdhri nr. ext prot., datë 25.07.2024, nr. 692, datë 25.07.2024</b> 1. A. H. 2. Xh. B. 3. D. H.	<b>2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 3601 prot., datë 29.07.2024</b> Nr 694, datë 29.07.2024 1. D. B. 2. Xh. B. 3. A. H.	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhri nr. ext prot., datë 25.07.2024. Nr 683, datë 25.07.2024.</b> 1. E. Gj. 2. K. Ll. 3. K. B.
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 38,054,282 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 33,961,615 lekë Fitues: BOE “H” & “K” ShPK	<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 4,092,667 lekë	
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 09.09.2024	<b>8. Burimi Financimit</b> Grant	<b>9. Operatorët Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>4 B/OE</b> b) Skualifikuar <b>1 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>3 B/OE</b>	
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 80 ditë			
<b>10. Ankimime</b> AK-s’ka/ka; -Jo APP-s’ka/ka;-Jo KPP-s’ka/ka;-Jo	<b>11. Data e publikimit të njoftimit (paraparak) të fituesit:</b> Data: 17.09.2024 <b>11/1. Data e publikimit të njoftimit (përfundimtar) të fituesit:</b> Data: 25.09.2024	<b>12. Data e lidhjes së kontratës:</b> Data: 29.09.2024	

- **Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:**

Nga verifikimi i dokumentacionit të publikuar në SPE, konstatohet se Projekti, Preventivi i Punimeve dhe Relacioni Teknik, në lidhje me këtë procedure prokurimi, janë përgatitur nga Zyra e Projekteve dhe Investimeve pranë Bashkisë Librazhd.

- **AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Krieteve”:**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe krieteve për kualifikimi” datë 21.08.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se, dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), jo në të gjitha rastet, kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”. Në përgjithësi, për hartimin e krieteve dhe argumentimin e tyre njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos dhënë një argumentim teknik konkret, disa prej krieteve, të përcaktuar nga njësia e prokurimit, përveçse të paargumentuar teknikisht dhe ligjërish, rezultojnë të ekzagjeruar dhe/ose jo në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës, sa vijon:

- **AK në lidhje me “Kapacitetin Teknik”, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin:** -“një punësim mesatar jo më pak se 44 (dyzet e katër) punonjës”; -“një sasi të caktuar mjetesh dhe pajisjesh”.

Në lidhje me këto kriete, konstatohet se AK nuk ka kryer një argumentim të bazuar në një analizë konkrete e cila do të mund të përcaktojë numrin minimal të punonjësve apo pajisjeve të domosdoshme, për realizimin e punimeve objekt kontrate, referuar zërave, volumit dhe grafikut të punimeve.

- **AK në lidhje me “Kapacitetin Teknik”, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:** -“Licenca profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës: N.P-2 B, N.S-1 A dhe N.S-4 B”.

- Në lidhje me këtë kriter konstatohet se Njësia e Prokurimit nuk ka kryer një argumentim teknik në bazë të së cilit të konkludohej se për cilin zë konkret të preventivit kërkohet një licencë e caktuar. Në procesverbalin “Për argumentimin e miratimin e krieteve” citohet se “Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit...”, por grupit të auditimit nuk i është paraqitur një analizë teknike konkrete.

-Kategorizimi i punimeve N.P-2 B, N.S-1 A dhe N.S-4 B, nuk përputhet me volumin apo vlerën e zërave përkatëse të preventivit, pasi në çdo rast rezulton që kategorizimi i kërkuar nga AK është për një vlerë punimesh më të lartë se totali i fondit limit (38,054,282 lekë pa TVSh). Referuar vetën kategorizimit të punimeve N.P-2 B dhe N.S-4 B, njësia e prokurimit ka argumentuar se vlerat përkatëse të tyre janë mbi 21 milion lekë. Në rast se ky argumentim do të ishte i saktë fondi limit do të duhet të ishte minimalisht më i madh se 42 milion lekë.

Për rrjedhojë, grupi i auditimit vlerëson se në rastin konkret kemi të bëjmë me një kriter të paargumentuar, të ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me vlerën e kontratës.

Pra Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se krieteve e sipërcituara dhe mungesa e argumentimit të tyre mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, duke ngarkuar me **përgjegjësi znj. D. B.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, **z. Xh. B.**, me detyrë specialist në Sektorin e Projektiveve dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. A. H.**, me detyrë specialiste në Sektorin e Projektiveve dhe Zbatimin e Kontratave, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, në kundërshtim me Ligjit nr. 162,

datë 23.05.2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2: si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 39 pika 4: dhe neni 78 pika 2.

- **Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.**

KVO me procesverbal datë 17.09.2024, për hapjen dhe vlerësimin e ofertave në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë 4 OE për të cilat ka vlerësuar dokumentacionit teknik në sistemin SPE, ka kualifikuar 3 OE, kanë shpallur në vend të parë ofertën e BOE “H” & “K” ShPK, sipas tabelës si vijon:

Nr.	Shoqëria OE/BOE	Oferta Lekë PA TVSH	Skualifikuar/ Kualifikuar
1	“A”	28,995,780	Skualifikuar
2	“H” & “K”	<b>33,961,615</b>	<b>Kualifikuar/Fituesi</b>
3	“REST. G-K” & “V”	36,148,832	Kualifikuar
4	“V H” ShPK	37,588,932	Kualifikuar

Me datë 17.09.2024 është hartuar dhe publikuar “Formulari i Njoftimit (Paraparak)”, dhe me datë 25.09.2024 është hartuar dhe publikuar “Formulari i Njoftimit të Fituesit (Përfundimtar)”, pas përfundimit të të afateve të ankimimit.

KVO ka hartuar Raportin Përmbledhës nr. (pa numër) prot., datë 25.09.2024 në të cilin, ka shpallur në vend të parë BOE “H” & “K” ShPK, me ofertë 33,961,615 lekë pa TVSH.

Me vendimin datë të 25.09.2024 është miratuar nga Titullari i AK, person i autorizuar Sekretari i Përgjithshëm z. B. P. shpallja fitues e BOE “H” & “K” ShPK, me ofertë 33,961,615 lekë pa TVSH.

Është nënshkruar kontrata, me nr. 4592 prot., datë 26.09.2024, nga përfaqësuesi i Bashkisë Librazhd (personi i autorizuar z. B. P.) dhe përfaqësuesit e BOE “H” ShPK (z. E. H.) dhe “K” ShPK (z. Q. K.).

- **Vlerësimi i procedurës:**

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se **KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime dhe mosveprime të pajustificuara** në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, konkretisht si vijon:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të shoqërisë pjesëmarrëse në garë, në lidhje me ofertën e BOE “H” & “K” ShPK, e cila është vlerësuar si e vlefshme dhe më pas është shpallur fituese, konstatohet se jo të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar, si më poshtë vijon:

- **Në lidhje me OE “H” ShPK:**

**1- Nuk përmbush kriterin e punës së ngjashme** (përvojën e mëparshme) sipas DST-ve. Nga dokumentacioni i paraqitur në sistem, në lidhje me punën e ngjashme të deklaruar “Ndërtim vile banimi...” nga OE **nuk është paraqitur “situacioni përfundimtar”**, si element vlerësimi në kriter.

**2- Nuk disponon asnjë nga 3 (tre) ISO-t e kërkuara nga AK.** Ky kriter, është një kriter që i shërben AK për të vërtetuar nëse OE i përmbushësh kapacitetet teknike. Nisur nga fakti që (referuar preventivit në marrëveshjen e bashkëpunimit), OE “H” ShPK, ka marrë përsipër kryerjen e zërave të preventivit në lidhje me punimet me të cilat është argumentuar edhe kërkesa për pajisjen me certifikata ISO.

Nga dokumentacioni pjesë e dosjes së prokurimit si dhe SPE, konstatohet se KVO-ja, me të njëjtën përbërje për të dy nga anëtarët e saj (znj. K. Ll. dhe znj. K. B.), ka vlerësuar edhe procedurën me objekt: “Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd”, në mënyrë të detajuar sipas tabelës në vijim:

Procedura	<i>“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2024”</i>	<i>“Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd”</i>
Data e hapjes së tenderit:	Data: 09.09.2024	Data: 16.05.2024
Njoftimi paraprak në SPE	Data: 17.09.2024	Data: 03.06.2024
Njoftimi përfundimtar në SPE	Data: 25.09.2024	Data: 12.06.2024
Data e kontratës/afati	Data: 29.09.2024 (80-ditë)	Data: 20.06.2024 ( 6-muaj)
OE i shpallur fitues	“H” & “K” ShPK	“H” & “K” ShPK

Nga sa më sipër, rezulton se, KVO-ja ka shpallur fitues BOE “H” & “K” ShPK edhe pse e ka pasur qartësisht të pasqyruar pamundësinë objektive “ligjore dhe teknike” të BOE në plotësimin e kapaciteteve për realizimin njëkohësisht të dy objekteve të prokurimit, sipas kërkesave të AK.

- **Në deklaratën (D)** “Mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera”, konstatohet se OE ka deklaruar të njëjtin mjet në të dyja procedurat e prokurimit, mjet për të cilin, në të dyja procedurat njëkohësisht ka deklaruar se: *“...do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti dhe nuk janë të angazhuara në kontrata apo procedura të tjera”*, konkretisht mjetin si vijon Kamionçinë targa AA525ZY.

**- Në lidhje me OE “K” ShPK konstatohet se:**

- **Në deklaratën (D)** “Mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera”, konstatohet se OE ka deklaruar të njëjtin staf (një pjesë të tij) në të dyja procedurat e prokurimit (E.B., D.K., I.S., K.K., G.L., Ç.D., A.Gj., S.Sh., A.Q., N.D., A.H., S.Ç., ), staf për të cilin, në të dyja procedurat njëkohësisht ka deklaruar se: *“...do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti”*;

-**Në deklaratën (D)** “Mbi mosangazhimin e kapaciteteve teknike në kontrata të tjera”, konstatohet se OE ka deklaruar përgjithësisht të njëjtit mjete në të dyja procedurat e prokurimit, mjete për të cilat, në të dyja procedurat njëkohësisht ka deklaruar se: *“...do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti dhe nuk janë të angazhuara në kontrata apo procedura të tjera”*, konkretisht, përveç pajisjeve edhe mjetet si vijon:

Kamionçinë targa AA...OR, Kamionçinë targa AA...OV, Kamionçinë targa AA...US.

Në kushtet kur e njëjta KVO (për të dy nga anëtarët e saj), ka kryer vlerësimin në të dy procedurat e prokurimit, kjo e fundit, në lidhje me procedurën e zhvilluar dhe vlerësuar në datën 09.09.2024 (të dytën), duhet të konkludonte se BOE nuk i përmbush kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit duke e skualifikuar këtë të fundit.

KVO nuk ka konstatuar faktin se BOE (ofertues) ka paraqitur deklaram të rremë (që nuk pasqyrojnë realitetin), fakti i cili përbën një kriter detyrues për skualifikim.

Mosveprimi i KVO-së, në rastin konkret, ka shkaktuar një situatë në kundërshtim me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 76, pika 3/ë, i cili përcakton se: *“Çdo operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në procedurën e prokurimit nëse...ë) ka paraqitur deklaratatë të rreme në dhënien e informacionit të kërkuar për të vërtetuar mungesën e arsyeve për skualifikim ose për plotësimin e kriterëve të përzgjedhjes, ka fshehur një informacion të tillë ose nuk është në gjendje të dorëzojë dokumentet provuese sipas kërkesave të përcaktuara në dokumentet e tenderit;”*.

**Si konkluzion**, për sa më sipër, në lidhje me vlerësimin e ofertave të kryer nga KVO-ja, nuk ka vlerësuar drejt shoqërinë pjesëmarrëse në garë, duke shpallur fitues një B/OE me kritere të paplotësuara, veprime të cilat kanë ndikuar negativisht në mirëpërdorimin e fondeve publike, në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2: neni 76 pika 3/ë, neni 78 pika neni 92 pika 3, si dhe neni 82 pika 2 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, **dhe ngarkon me**

**përgjegjësi: z. K. B,** me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit Urban dhe i Mbrojtjes së Territorit, **z. E. Gj,** me detyrë Përgjegjës i Sektorit Projekttimeve dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. K. Ll,** me detyrë Specialiste në Sektori Juridik, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së.

Për sa është trajtuar në këtë pjesë të Raportit Përfundimtar të Auditimit nga subjekti sudituuar janë paraqitur kundërshti me shkresën nr. 6651, datë 29.9.2025 (prot KLSH nr. 407/6, datë 01.10.2025), mbi “*Projekt Raportin e Auditimit*“, nga z. Xh.B. në cilësinë e anëtarëve të KVO, ku janë shprehur kundërshtitë si më poshtë:

**Pretendim i subjektit përmbledhurazi:**

*Në lidhje me konstatimin e grupit të auditimit në procedurën me objekt: "Ndërtim i një qendre rinore ne Bashkine Librazhd", .....duke mos qenë dakord me konstatimet e pergjegjesise e pretenduar ndaj anëtarëve të njësisë së prokurimit dhe komisionit te vleresimit te ofertave, brenda afatit shtatë ditor, ju paraqesim këtë observacion me kundërshtimet dhe sqarimet tona:*

...

*-Persa i perket konstatimit qe nga subjekti "H" shpk nuk është paraqitur situacion prfundimtar, për përmbushjen e kriterit te punes se ngjashme te deklaruar "Ndertim vile animi..." Situacioni perfundimtar kerkohet nga KVO per te percaktuar nga zerat e punimeve nese objekti i paraqitur si pune e ngjashme është ne vlere krahasimisht e ngjashme si dhe ne natyren e punimeve. Gjithashtu qe te jete document i vlefshem i nenshkruar nga palet qe te vertetoj ligjshmerin e ketij dokumenti. Ne rastin konkret është paraqitur nje kontrate noteriale porosie nr. 2990 Rep nr. 1943 Kol dt. 22.12.2021, midis Shoqerise H shpk dhe porositesit z. F Gj, nje banor i theshtë. Perveç Preventivit te punimeve qe është pjese e kontates se bashkpunimit, nga ana e kompanise H është paraqitur fatura tatimore 21/2022 dhe fatura 14/2022. Ne te dyja keto fatura jane te specifikuara ze per ze te gjitha zerat e punimeve, sasia e tyre, njesia e tyre, cmimi per njesi per secilin ze, vlere e punimeve, si dhe vlere totale pa tvsh dhe me tvsh, dhe fatura është elektronike e nenshkruar elektronikisht, e deklaruar ne organet tatimore. Per kontrata te realizuara ne sektorin privat ne DST OE - kur ky dokumentacionleshohet Aktin e kolaudimit; (ne rastet Per objekte me vlere te vogel dhe te sektorit privat jo domosdoshmerisht behet situacion midis paleve dhe as Akt kolaudimi. Pra kjo fature është konsideruar nga KVO si e vlefshme pasi ka elementet e nevojshem per te gjykuar per funksionin per te cilen është kerkuar.*

*- Persa i perket konstatimit se subjekti H nuk disponon asnje nga 3 (tre) ISO- te kerkuara nga AK. Firma H është nje firem shume e vogel me nje numer minimal punonjesish, Pusete shkarikimi 80 x 80 x1.5 m (KUZ) cope 2 36200 72,400.00 Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 10 cm ml 31.5 930 29,295.00 H shpk Shtrese betoni b/a C20/25, dyshemeja m<sup>3</sup> 7 11300 79,100.00 H shpk Beton b/a C20/25 per themele dhe kollona Soleta te plota b/a C 20/25 dhe brezi m 29.9 11300 337,870.00 H shpk m 27.5 22000 605,000.00 H shpk Struktura b/a, C 20/25 (murete rrethimit te oborrit,shkalle, stola etj) m 48 15000 720,000.00 H shpk, jane zerat qe ka marr persiper te kryeje shoqeria H shpk, volume minimale, furnizim vendosje hidrossanitare dhe beton qe pergatitet ne kantier me krahe. Nje firem e vogel e zones qe bashkpunon me nje firem me kapacitete shum te medhaja qe e mbulon me se miri qofte dhe konsulencen me certifikimet 150 te nevojshme, dhe kekron te afirmohet ne fushen e ndertimit. Per nje firem me 7 punonjes qe duke punuar do jet ne gjendje dhe te certifikohet shumë shpejt, me eksperiencen e duhur. .*

**Qëndrim i grupit të auditimit:**

Për sa është argumentuar nga KVO-ja mbi konstatimet e grupit të auditimit, sqarohet se pretendimet nuk qëndrojnë dhe **nuk merren në konsideratë**, pasi nga subjekti nuk është paraqitur asgjë e re nga ato të paraqitura në fazën e PRA. Në referim të dispozitat të LPP dhe kërkesave të DST (si mësipër në material), çdo OE pjesëmarrës si bashkim OE duhet të përmbush kërkesat e DST në raport me përqindjen e marrë përsipër. Gjithashtu në lidhje me

situacion e mos paraqitur nga shoqëria “H” ShPK, argumenti nuk qëndron, pasi situacioni është kërkesë e DST dhe mbi bazën e tij verifikohen nëse janë punë të ngjashme ose jo. Pretendimi juaj se fatura janë të emërtuara me element të zërave nuk vërtetohet me dokumentacion bashkëlidhur. Në lidhje me mangësitë e konstatuara të shoqërisë ‘K’ shpk, nga ana juaj nuk është bërë asnjë kundërshti.

**VIII\_-Nga shqyrtimi i dokumentacionit** të vënë në dispozicion nëpërmjet dosjes fizike, procesverbaleve të vlerësimit të ofertave, njoftimit të fituesit dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), në procedurën me objekt: **“Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd”**, në lidhje zhvillimin e procedurës si dhe me fazën e vlerësimit të ofertave , u konstatuan disa parregullsi në shkelje të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 **“Për prokurimin publik”**, etj., konkretisht si vijon:

<b>a. Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd”</b>			
<b>1. Lloji/Urdhri i Procedurës së Prokurimit</b> “Procedurë e Hapur” REF-03012-04-29-2024 Urdhri nr. 1996 prot., datë 22.04.2024. Nr 436, datë 22.04.2024	<b>1.1 Specialistët e hartimit të specifikimeve teknike dhe fondit limit, Urdhri nr. 1899 prot., datë 17.04.2024, nr. 422, datë 17.04.2024</b> 4. Xh B 5. E Q 6. B K	<b>2 Njësia e Prokurimit Urdhri nr. 1996 prot., datë 22.04.2024</b> <b>Nr 436, datë 22.04.2024</b>  1. D B 2. E Gj 3. A H	<b>3 Komisioni i Vlerësimit Ofertave</b> Urdhri nr. ext prot., datë 29.04.2024. Nr 453, datë 29.04.2024. 1. Xh B 2. K LI 3. K B
<b>4. Fondi Limit (pa TVSh)</b> 14,910,120 lekë	<b>5. Oferta fituese (pa TVSh)</b> 13,021,935 lekë Fitues: BOE “H” & “K” ShPK		<b>6. Diferenca me fondin limit (pa TVSh)</b> 1,888,185 lekë
<b>7/1 Data e hapjes së tenderit:</b> Data 16.05.2024	<b>8. Burimi Financimit</b> Grant + vetëfinancim, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak		<b>9. Operoret Ekonomike</b> a) Pjesëmarrës në tender <b>4 B/OE</b> b) Skualifikuar <b>1 B/OE</b> , c) Kualifikuar <b>3 B/OE</b>
<b>7/2 Kohëzgjatja e kontratës:</b> 6 muaj			
<b>10. Ankimime</b> AK-s’ka/ka; -Jo APP-s’ka/ka; -Jo KPP-s’ka/ka; -Jo	<b>11. Data e publikimit të njoftimit (paraparak) të fituesit:</b> Data: 03.06.2024 <b>11/1. Data e publikimit të njoftimit (përfundimtar) të fituesit:</b> Data: 12.06.2024		<b>12. Data e lidhjes së kontratës:</b> Data: 20.06.2024

- **Në lidhje me fazën paraprake dhe dokumentacionin e nevojshëm për vijimin e procedurës:**

Nga verifikimi i dokumentacionit të publikuar në SPE, konstatohet se Projekti, Preventivi i Punimeve dhe Relacioni Teknik, në lidhje me këtë procedure prokurimi, janë përgatitur nga “S-A” ShPK.

Pjesë e dosjes së prokurimit, rezulton se ndodhet leja ndërtimi nr. 5296/3, datë 10.12.2024 për objektin “Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd”.

Në lidhje me procedurën e sipërcituar, nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, nuk rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një oponencë teknike, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik.

Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezulton të jetë në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 **“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”**, i ndryshuar, Ligjin nr. 120/2020 **“Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”**, sipas të cilit **“ Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve**

kryhet nga institutet shtetërorë ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: a) ndërtime publike; b) ndërtime jopublike, me vlerë të preventivuar së paku 100 (njëqind milion) lekë; c) objektet me akses publik, me VKM nr. 9, datë 11.01.2024 “Për miratimin e rregullave për projekte që duhet t’i nënshtrohen oponentëve teknike sipas secilës fushë projektimi, si dhe procedurat që ndiqen në këto raste”.

**- AK (NjP) në lidhje me “Argumentimin dhe Hartimin e Kritereve”:**

Nga auditimi i dokumenteve të tenderit, dosjes fizike, procesverbalit “për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikimi” datë 29.04.2024 dhe sistemit të prokurimit elektronik (SPE), u konstatua se:

Dokumentet e tenderit, të hartuara dhe miratuara nga AK (NjP), jo në të gjitha rastet, kanë të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në zbatim të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, neni 78, pika 2 “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “...Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”. Në përgjithësi, për hartimin e kritereve dhe argumentimin e tyre njësia e prokurimit (NjP) është mjaftuar vetëm me citimin e bazës ligjore duke mos dhënë një argumentim teknik konkret.

Grupi i auditimit vlerëson se, disa prej kritereve, të përcaktuar nga njësia e prokurimit, përveçse të paargumentuar teknikisht dhe ligjërisht, rezultojnë të ekzagjeruar dhe/ose jo në përpjesëtim apo të lidhura ngushtë me natyrën dhe vlerën e kontratës.

Konkretisht, për sa më sipër, nga grupi i auditimit, është konstatuar sa vijon:

**- AK në lidhje me “Kapacitetin Teknik” dhe konkretisht në pikën 2.3.11, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:** -“Operatori Ekonomik duhet të paraqesë Autorizim/Kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në procedurë të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si: Pajisje elektrike, Pajisje hidraulike, Dyer & Dritare, Materiale hidroizoluese”.

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me mallra të cilat gjenden lehtësisht në treg, si dhe duke ju referuar sasisë së tyre sipas preventivit, kriteri rezulton i ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, çka ndikon negativisht në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve në garë.

Në procesverbalin “për argumentimin e miratimin e kritereve”, nuk ka asnjë argumentim për këtë kriter. Ai i përdorur nga njësia e prokurimit i referohet mjeteve dhe pajisjeve teknike dhe jo kërkesës për “autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/ distributori”.

**AK në lidhje me “Kapacitetin Teknik” dhe konkretisht në pikën 2.3.12, ndër të tjera, ka kërkuar nga OE ofertues disponimin si vijon:** -“Nyje prodhim inertesh e pajisur me QKL (pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi noteriale)”; -“Linjë prodhimi betoni me QKL (pronësi ose me qera ose kontratë furnizimi noteriale)”.

Në rastin konkret, duke qenë se kemi të bëjmë me mallra të cilat gjenden lehtësisht në treg, si dhe duke ju referuar sasisë së tyre sipas preventivit, kriteri rezulton i ekzagjeruar dhe jo në përpjesëtim me natyrën dhe vlerën e kontratës, çka ndikon negativisht në konkurrencën dhe pjesëmarrjen e operatorëve në garë.

**Si konkluzion,** Njësia e prokurimit nuk ka konsideruar faktin se kriteret e sipërcituara dhe mungesa e argumentimit të tyre mund të sjellin kufizimin e pjesëmarrjes së OE ofertues të mundshëm, të cilët eventualisht mund të kenë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, duke ngarkuar me **përgjegjësi znj. D. B.**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Prokurimeve, **z. E. Gj** me detyrë Përgjegjës i Sektorit Projektive dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. A. H.**, me detyrë specialiste në Sektorin e Projektive dhe Zbatimin e Kontratave, në cilësinë e anëtarëve të njësisë së prokurimit, në kundërshtim me Ligjin nr. 162,

datë 23.05.2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, Neni 2, si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Neni 39 pika 4, Neni 78 pika 2:.

**Në lidhje me fazën e hapjes dhe vlerësimit të ofertave nga KVO.**

Në procedurën e prokurimit kanë marrë pjesë në garë 4 OE për të cilët, referuar procesverbalit dhe SPE, KVO-ja ka kryer në datën 30.05.2024 renditjen përfundimtare, në datën 03.06.2024 vlerësimin paraprak dhe në datën 12.06.2024 vlerësimin përfundimtar të pasqyruar në klasifikimin përkatës si më poshtë:

Nr.	B/OE pjesëmarrës	Nipti	Oferta pa TVSh	Shkualifikuar/kualifikuar
1.	“A” ShPK	J.....Q	14,673,478	Kualifikuar
2.	“H” & “K” ShPK	K.....Q K.....C	<b>13,021,935</b>	<b>Kualifikuar/Fituesi</b>
3.	“L BL” & “A-A CO” ShPK	J.....M / K.....C	13,711,026	Kualifikuar
4.	“E” ShPK	K.....P	12,927,906	Skualifikuar

Në lidhje me vlerësimin dhe klasifikimin e pasqyruar në tabelën e mësipërme, referuar procesverbaleve, SPE si dhe Njoftimit të Fituesit, mbi skualifikimin e OE “E” ShPK, KVO-ja ka arsyetuar, në mënyrë të përmbledhur, si vijon:

1. **“E” ShPK:** Operatori ekonomik pjesëmarrës mjetet dhe punëtorinë e deklaruar në sistem i ka të angazhuara në një tjetër procedurë prokurimi që është në proces pune. Për këtë arsye nuk mund të kualifikohet fitues në këtë procedurë prokurimi.

Nga verifikimi i dokumentacionit në sistem (SPE) si dhe në dosjen fizike, në lidhje me këtë procedurë, konstatohet se KVO-ja, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave, ka kryer veprime dhe mosveprime të pajustificuara në kundërshtim me Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, pasi:

**Së pari,** KVO-ja ka shkelur afatet ligjore për vlerësimin e ofertave. Nisur nga fakti se procedura e vlerësimit të ofertave duhet të fillonte në datën 16.05.2023, KVO-ja ka pasur detyrimin ligjor të kryente vlerësimin e tyre brenda datës 31.05.2023 (15 ditëve). Referuar procesverbalit të vlerësimit dhe SPE, rezulton se vlerësimi paraprak i ofertave është kryer në datën 03.06.2023 ose 3 ditë jashtë afatit.

**Së dyti,** nga shqyrtimi i dokumentacionit të vlerësimit të shoqërisë pjesëmarrëse në garë, në lidhje me ofertën e BOE “H” & “K” ShPK, e cila është vlerësuar si e vlefshme dhe më pas është shpallur fituese, konstatohet se jo të gjitha kërkesat e DST janë plotësuar. Mos pasqyrimi i mangësive në rastin konkret, ka shkaktuar shpalljen fitues padrejtësisht të BOE, si vijon:

**- Në lidhje me OE “H” ShPK:**

**1- Nuk përmbush kriterin e punës së ngjashme** (përvojën e mëparshme) sipas pikës 2.3. të DST-ve. Nga dokumentacioni i paraqitur në sistem, në lidhje me punën e ngjashme të deklaruar “Ndërtim vile banimi...” nga OE nuk është paraqitur “formulari i vlerësimit”, “situacioni përfundimtar”, “akti i kolaudimit” si dhe “certifikata e marrjes në dorëzim”.

**2- Nuk disponon asnjë nga 3 (tre) ISO-t e kërkuara nga AK.** Ky kriter, është një kriter që i shërben AK për të vërtetuar nëse OE i përmbushush kapacitetet teknike. Nisur nga fakti që (referuar preventivit në marrëveshjen e bashkëpunimit), OE “H” ShPK, ka marrë përsipër kryerjen e zërave të preventivit në lidhje me punimet me të cilat është argumentuar edhe kërkesa për pajisjen me certifikata ISO.

**Si konkluzion,** në kushtet si më sipër dhe në funksion të zbatimit të LPP-së, KVO-ja duhet të kishte skualifikuar BOE “H” & “K” ShPK, duke vijuar procedurat për shpalljen fitues dhe lidhjen e kontratës me operatorin e radhës i cili plotëson të gjitha kriteret e vendosura nga AK, duke ngarkuar me **përgjegjësi z. K. B.**, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit Urban dhe i

Mbrojtjes së Territorit, **z. Xh B**, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Projekttimeve dhe Zbatimin e Kontratave dhe **znj. K Ll**, me detyrë Specialiste në Sektori Juridik, në cilësinë e anëtarëve të KVO-së, në kundërshtim me Ligji nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2, neni 92 pika 3, si dhe neni 82 pika 2 e VKM-së nr. 258, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me shkresën nr. 4974 prot, datë 18.7.2025 (prot KLSH nr. 407/4, dt. 21.7.2025), paraqitu nga anëtarët e KVO Bashkia Librazhd (K B, Xh B dhe K Ll), mbi problematikat e konstatuara në akt konstatimin nr. 14, datë 11.7.2025, kundërshtohet se:

**Pretendim i subjektit përmbledhurazi:**

*Në lidhje me pretendimin se OE “H” ShPK, nuk është paraqitur situacioni përfundimtar. Për përmbushjen e këtij kriteri të punimeve të ngjashme të deklaruar ndërvite...situacion përfundimtar kërkohet nga KVO për të përcaktuar nga zërat e punimeve nëse objekti i paraqitur është në vlerat krajasimisht të ngjashme si dhe në natyrën e punimeve.*

*Në rastin konkret është paraqitur një kontratë noteriale nr. 2990rep/nr. 1943 kol, datë 22.12.2021, ndërmjet shoqërisë “H” ShPK dhe porositësit F Gj (banor i thjeshtë). Gjithashtu nga shoqëria “H” ShPK është paraqitur fatura tatimor nr. 21/2022 dhe 14/2022, ku janë të specifikuar zë për zë të gjitha zërat e punimeve, sasia e tyre, njësia, çmimi për njësi dhe secilin zë.*

*Për objektet me vlerë të vogël dhe të sektorit privat jo domosdoshmërisht bëhet situacion punimesh midis palëve dhe as akt kolaudim.*

*Në lidhje ke konstatimin se shoqëria “H” ShPK nuk disponon asnjë nga 3 certifikatat ISO. Shoqëria “H” ShPK është e vogël dhe me një numër të kufizuar punonjësish, ku ka marrë përsipër 7% të totalit të punimeve, duke angazhuar vetëm 3 punonjës.*

*Përsa i përket makinerive dhe stafit, gjykohet se objektet e përmendura në akt konstatim i përgjigjen dy grafikëve punime të ndryshme. Gjeografikisht shumë afër dhe që aktualisht janë në territor dhe në bazë të grafikut të punimeve të kombinuara në bazë të kërkesave mund të mbulojnë nevojat për të dy objektet.*

**Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Për sa është sqaruar nga subjekti audituar (anëtarët e KVO), në lidhje me vlerësimin e procedurës, sqarojmë se **pretendimi nuk qëndron** dhe nuk merren në konsideratë, pasi në referim të dispozitat të LPP dhe kërkesave të DST, çdo OE pjesëmarrës si bashkim OE duhet të përmbush kërkesat e DST në raport me përqindjen e marrë përsipër. Gjithashtu në lidhje me situacionin e mos paraqitur nga shoqëria “H” ShPK, argumenti nuk qëndron, pasi situacioni është kërkesë e DST dhe mbi bazën e tij verifikohen nëse janë punë të ngjashme ose jo. Pretendimi juaj se fatura janë të emërtuara me element të zërave nuk vërtetohet me dokumentacion bashkëlidhur.

➤ **Mbi Procedurat e prokurimit për blerje me vlerë të vogël për periudhën 01.01.2024 deri më 31.12.2024.**

Për auditimin e kësaj procedurë, u kërkua ky dokumentacion: Regjistri i Parashikimeve 2024 dhe gjithë ndryshimet e miratuara; Regjistri i Realizimeve 2024; Ditari i bankës 2024.

Bashkia Librazhd çdo vit realizon blerje të punëve, furnizimit me mallrave ose shërbime nëpërmjet edhe procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, në zbatim të Ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e

rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe paketës së Udhëzimeve të MF – APP<sup>23</sup> në periudhën 2021-2022.

Nga auditimi mbi dokumentacionin e kërkuar dhe të vënë në dispozicion nga Njësia e Prokurimit për blerje të vogla dhe Drejtoria e Financës, rezultoi si më poshtë vijon:

- Komisioni i prokurimit me vlerë të vogël për vitin 2024 është ngritur me Urdhrin e Kryetarit nr. 63 prot., datë 17.01.2024 dhe ka këtë përbërje:

Komisioni i Blerjeve e Vlerë të vogël Viti 2024			
Urdhri nr. 63 datë 17.01.2024	Pozicioni në komision	Formimi Arsikor	Njësia në strukturë
K LI	kryetar		NJPVV
A D	anëtar		
D B	anëtar		

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi auditimit

▪ Nga auditimi mbi dokumentacionin e vendosur në dispozicion, nga Njësia e Prokurimit dhe Drejtoria Financës për periudhën raportuese objekt i procesit të auditimit (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2024), lidhur me regjistrin e parashikimeve të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, rezultoi se ky regjistër ka pësuar 6 ndryshime (shtim procedurash) nga regjistri fillestar, si më poshtë:

Tabela nr. 1/në lekë

Nr.	Regjistri i parashikimeve 2023		
	Regjistri i Parashikimeve	Numri i procedurave BVV	Vlera totale e f. Përlogaritur
1	Plani fillestar	57	33,183,999
2	Plani i ndryshuar datë 18.07.2023	63	36,071,225
2	<b>Totali</b>		<b>36,071,225</b>

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

**U konstatua se** Regjistri i parashikimeve të vitit 2024 i miratuar nga titullari, nuk është regjistruar në regjistrin e protokollit të bashkisë, në kundërshtim me “Normat tekniko profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë” neni 19, Vendim nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e “rregullores së njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të Republikës së Shqipërisë” Model 3;

- **U konstatua se** ndryshimet e bëra gjatë vitit në Regjistrin e parashikimeve, nuk janë shoqëruar me relacionet përkatëse, duke konkluduar se hartimi i regjistrit fillestar të planifikimit dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit, janë si rezultat i mungesës së analizave paraprake dhe të një studimi të mirëfilltë të nevojave për mallra, shërbime e punë, në kundërshtim me VKM nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 1/ pika 2, neni 3/pika 2;

- Referuar Regjistrin të parashikimeve dhe Regjistrin të realizimeve të procedurave të blerjeve me vlerë të vogël [BVV], një informacion i përmbledhur pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela nr. 2/në lekë

Tipi i kontratës	Planifikimi 2024		Realizimi 2024		Mbetur nga plani	
	Numri	Fondi limit	Numri	Vlera e kontratës	Numër	vlerë
Mallra	25	12,334,786			2	
Shërbime	30	19,432,547				
Punë	2	1,416,666				
<b>Nëntotali I</b>	<b>57</b>	<b>33,183,999</b>				
Mallra	31	15,222,012				
Shërbime	30	20,849,213				
Punë	2					
<b>Nëntotali II (shtuar)</b>	<b>63</b>	<b>36,071,225</b>				
<b>Totali</b>	<b>63</b>	<b>36,071,225</b>	<b>61</b>	<b>26,526,025</b>		

Burimi: Bashkia Librazhd/KBVV

<sup>23</sup> MF Ministria e Financave  
APP Agjencia e prokurimit publik

Për periudhën objekt auditimi periudha raportuese (nga data 01 janar deri 31 dhjetor 2024), AK ka planifikuar në fillim të vitit **57** procedura me vlerë të fondit limit 33,183,999 lekë; ka ndryshuar regjistrin në **63** procedura në vlerën e fondit limit prej 36,071,225 lekë; më hollësisht procedurat e prokurimit të parashikuara dhe të realizuara me “vlerë e vogël”, sipas urdhër prokurimit pasqyrohen në tabelën/Aneks BVVI- tabelat e parashikimit dhe realizimit.

- Nga auditimi i evidencave dokumentare dhe informacionit të pasqyruar në Aneks BVVI, rezultoi se janë **63** procedura BVV në total me fondin limit 36,071,225 lekë, te të cilat **u konstatua** si më poshtë:

1. Janë parashikuar procedura për mallra/grupmallra e shërbime/grupshërbime të të njëjtës natyrë, funksioni;

▪ Më poshtë po përshkruajmë në mënyrë të detajuar secilin konstatim.

- Nga auditimi i Regjistrin të Parashikimeve dhe atij të realizimeve mbi klasifikimin e fondit limit (sipas vlerës), rezultoi si në tabelën mëposhtë:

Tabela nr.3

Regjistri i Procedurave Blerje me vlerë të vogël (BVV)					
BVV nën 1,000,000		BVV nën 100,000		Vlera e kontratës	
Parashikim	Realizim	Parashikim	Realizim	Fondi limit	Vlera e kontratës
63	61	0	0	37,080,621	28,229,120
Emergjente					
0	0	0	0	0	0

**-1.** Një informacion mbi planifikimin e procedurave për blerje me vlerë të vogël [BVV] për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të të njëjtës natyrë, funksioni apo subjektet në cilësinë e OE me të njëjtën fushë aktiviteti, pasqyrohen në tabelën më poshtë:

Tabela nr.4/në lekë

Nr i grupit	Nr.i regjistrin	Objekti i prokurimit në parashikim	objekti i kontratës	Burimi i financimit	Fondi limit	Totali i fondit për grup
1	5	Blerje materiale hidraulike gjimnazi Ibrahim Muca	mallra	B. shtetit	250,000	2,725,642
	18	Blerje materiale te ndryshme hidraulike dhe elektrike			1,000,000	
	37	Blerje materiale për pajisje speciale (tuba zjarrfikës)			216,666	
	50	Blerje tuba për kanale vaditëse			492,310	
	11	Blerje materiale ndërtimi			766,666	
2	25	Blerje far bari, lule, peme, blerje pleh organik. Kimik, për lulishite dhe fushën e sportit	mallra	-/-	916,666	1,208,332
	29	Blerje lule , kurora natyrale			291,666	
3	14	Dekor i qytetit viti i ri	mallra	-/-	830,750	2,747,415
	32	Dekor i qytetit viti i ri			666,666	
	45	Pakot e vitit te ri			666,666	
	48	Blerje fishekzjarrë			416,667	
	59	Blerje fishekzjarrë			166,666	
4	15	Blerje lende djegëse /naftë për ngrohje shkolla Mirake Plane	mallra	B. shtetit	461,462	1,726,295
	17	Blerje lende djegëse /naftë për ngrohje shkolla Hotolisht			636,500	
	22	Blerje gaz për ngrohje shkolla Ibrahim muca			262,500	
	38	Blerje benzenë e vaj mishell për motor, për korrëse bari,			208,333	
	47	Blerje gaz për gatim kopshte , çerdhe, qendra ditore			157,500	
5	39	Siguracion ndërtesa	shërbim	-/-	500,000	1,500,000
	27	Sigurim, kolaudim dhe taksa automjetesh			600,000	
	6	Sigurim jete për punonjësit e MZSH			400,000	

Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve për blerje me vlerë të vogël pasqyruar në tabelën nr.4, u konstatua se: për mallra/grupmallra dhe shërbime/grupshërbime të njëjta, janë parashikuar me copëzim të fondit në 5 raste, të cilat janë me vlera në tejkallim të vlerës limit

prej 1,000,000 lekë, respektivisht vlera totale të fondit limit pa TVSh për G1 – 2,725,642 lekë, G2 - 1,208,332 lekë, G3 – 2,747,415 lekë, G4 -1,726,295 lekë, G5 – 1,500,000 lekë<sup>24</sup>. Për sa më lart rezulton në kundërshtim me nenin 11 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 56 pika 11, Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik” kreu I pika 1 paragrafi 2; Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”, Udhëzimi nr. 05, datë 29.07.2022 “Për disa ndryshime në manualin teknik që shoqëron Udhëzimin nr. 05, datë 25.06.2021 "Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike".

-2. Mallra apo mallra/shërbime me vlerë të fondit limit prej 1,000,000 lekë, është vetëm një procedurë “marrëveshje kuadër” për blerje materiale elektrike dhe hidraulike. referuar nenit 52 e Ligjit nr. 162 dt. 23.12.2020 “Mbi prokurimin publik” i ndryshuar. **U konstatua se** nga ana e NJP nuk janë dhënë detaje në përshkrimin e procedurës, për të saktësuar arsyet e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit në secilin rast, në moszbatim të VKM nr. 285/2021 datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 2 pika 2/a,b,ç, neni 11 pika 1/c, pika 2, pika 3 dhe neni 12.

-3. Nga auditimi i regjistrit të procedurave BVV të realizuara në vitin 2024 pasqyruar në mënyrë të detajuar në tabelën/Aneks BVV2 dhe të përmbledhur në tabelën nr.5 u konstatua se Autoriteti Kontraktor (*Bashkia Librazhd*) në cilësinë e njësisë shpenzuese publike vendore, ka kryer shpenzime me fonde publike me objekt "blerje mallra, punë dhe shërbime publike" me natyrë të njëjtë në tejkalim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë;

- Gjithashtu referuar informacionit të përmbledhur në tabelën 5, gjatë vitit 2024 rezultoi se:

Tabela nr.5

Subjektet që kanë fituar procedurat BVV (realizuar)			
Emërtimi i OE	Numri i procedurave	Vlera në lekë	Tipologjia
<b>Z</b>	8	4,883,893	E njëjtë
<b>NS</b>	5	2,614,311	E njëjtë
<b>"S-ALB "</b>	5	3,377,714	E njëjtë
<b>R 9</b>	2	1,154,443	E njëjtë
<b>O H</b>	2	353,400	Të ndryshme
<b>S RR</b>	2	815,000	Të ndryshme
<b>M OIL</b>	2		E njëjtë
<b>E Gas</b>	2	400,000	E njëjtë
36 Subjekte	36	14,630,359	-
<b>44 subjekte</b>	<b>61</b>	<b>28,229,120</b>	

Burimi: Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

- Nga Bashkia Librazhd janë zhvilluar në total 61 procedura prokurimi BVV me vlerë 28,229,120 lekë në total, ku: subjekti “Z” ka fituar 8 procedura në vlerën totale të kontratës 4,883,893 lekë; subjekti “N” ka fituar 5 procedura në vlerën totale të kontratës 2,614,311 lekë; subjekti “S Alb” ka fituar 5 procedura në vlerën totale të kontratës 3,377,714 lekë; dhe 5 subjekte që kanë fituar nga 2 procedura me vlerë totale të kontratës 17,353,202 lekë; dhe 36 subjekte që kanë fituar nga 1 procedurë në vlerën totale të kontratave prej 14,630,359 lekë;

- Janë zhvilluar 0 procedura me BVV nën vlerën 100,000 lekë;

- Nuk janë zhvilluar procedura “emergjente” BVV;

- Nga procedurat e planifikuara rezultojnë 2 procedura të parealizuara, në vlerën totale të fondit limit 990,604 lekë, një nga të cilat e anuluar konform VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar kreu I neni 2 pika 2/g.

**4.** Për çdo procedurë prokurimi BVV, nga ana e titullarit kanë dalë urdhrat respektiv për ngritjen e komisionit të përllogaritjes së vlerës limit të kontratës, përcaktimit të specifikimeve

<sup>24</sup> G - numri i grupit referuar kolonës së parë të tabelës;

teknike si dhe grafikun e realizimit të cilësuar sipas natyrës së procedurës, konform nenit 56 pika 4 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Tabela nr.6

Emërtimi i procedurës	Urdhri i kryetarit	Përbërja e komisionit	Statusi	Formimi arsimor/profesional
Furnizim Shërbimi 3D (anuluar)	Nr. 1108 dt. 27.11.2024 nr. 5873 prot., dt.27.11.2024.	1.E K 2.T H 3.E N	Kryetar Anëtar -//-	1.Administrim biznesi 2.Teknik ndërtimi (mesëm) 3.Administrim biznesi
Automjet për ofrimin e shërbimeve	Nr. 1110 dt.30.11.2023 nr. 7557 prot., dt.30.11.2023	1.M D 2.A K 3.Xh M	Kryetar Anëtar -//-	1.Ekonomiks 2.Shkenca politike 3.Gjuhe e huaj/frënge
Blerje lëndë djegëse naftë për ngrohje shkolla Mirake Plane	Nr. 119 dt.26.01.2024 nr. 497 prot., dt.26.01.2024	1.M M 2.A A 3.M Ç	Kryetar Anëtar -//-	1.Informatikë ekonomike 2.Ekonomi financë 3.Mësuesi/edukim qytet-histori
Blerje tuba për kanale vaditës	Nr. 764 dt.21.08.2024 nr. 4019 prot., dt.23.08.2024	1.S T 2.E S 3.E Q	Kryetar Anëtar -//-	1.Inxhinieri gjedezi 2.Inxhinieri agrare 3.Inxhinieri gjeologjike

Burimi: Bashkia Librazhd/punoi grupi i auditimit

5. Referuar regjistrin të realizimeve dhe informacionit të pasqyruar në tabelën përmbledhëse, u përzgjedhën disa procedura me BVV dhe u kërkuan dosjet përkatëse të tyre.

Tabela nr. 7

nr.	Dokumentacioni i dosjes së prokurimit	D-1	D-2	D-3	D-4	D-5	D6	D-7	D-8	D9	Totali dosje me mangësi
1	Kërkesa e njësisë	M	M	M	M	M	M	M	M	M	9
2	Testimi i tregut	M	M	M	M	M	M	M	M	M	9
3	Proces verbali përmbledhës i ofertave të testuar Vendimi i konfirmimit të çmimit/njësi	M	M	M	M	M	M	M	M	M	9
4	Urdhër prokurimi	x	x	x	x	x	x	x	x	x	-
5	Deklarata e konfliktit të interesit shtojca I/ II	x / x	x / x	x / x	x / x	x / x	x / x	x / x	x / M	x / x	-
6	Ftesa për ofertë	x	x	x	x	x	x	x	x	x	-
7	Procesverbali tip i kontratës	x	x	x	x	x	x	x	x	x	-
8	Plotësimi nga AK në faqen e APP	x	x	x	x	x	x	x	x	x	-
9	Lista e operatorëve aplikonte	x	x	x	x	x	x	x	x	x	-
10	Klasifikimi përfundimtar	x	x	x	x	x	x	x	x	x	-
11	Formulari i njoftimit të fituesit	x	x	x	x	x	x	x	x	x	-
12	Refuzim në SPE	-	-	-	x	x	x				
13	Proces verbali për kalim te OE pasardhës	-	-	-	x	x	x				
14	Formulari i njoftimit të fituesit pasardhës	-	-	-	x	x	x				
15	Urdhri për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim	M	M	M	M	M	M	M	M	M	9
16	Praktika dokumentare e OE fitues	x	x	x	x						-
17	Procesverbali i anulimit/formulari	x	-	-	-	-	-	-	-	-	-
18	Monitorimi i zbatimit të kontratës	-	x	x	x	x	x	x	x	x	-

Burimi: Bashkia Librazhd/punoi grupi i auditimit

Nga auditimi u konstatua se:

- Praktikata e procedurave të prokurimit BVV ishin të sistemuara në dosje, por nuk ishin të inventarizuara, në kundërshtim me VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 2;<sup>25</sup>

- Komisioni i përlllogaritjes së fondit limit, i përcaktimit të specifikimeve teknike, kriterëve kualifikuese etj., sipas informacionit në tabelën 6, jo në çdo rast ishin specialistë të fushës referuar tipologjisë së procedurës (mallra , shërbime apo pune), në mospërmushje cilësore të Ligjit nr. 162 datë 20.02.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 4 pika 38, neni 36,

<sup>25</sup> VKM nr.285/2021 është ndryshuar me VKM nr. 498/2024 dt.01.08.2024, botuar në FZ nr. 137 dt.06.08.2024 dhe ka hyrë në fuqi 15 ditë pas saj, pra në dt.21.08.2024

VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74 pika 2;

- Dosjet e përzgjedhura kishin mungesë të dokumentacionit bazë të procedurës si “testimi i tregut”, urdhri i titullarit “për ngritjen e komisionit të marrjes në dorëzim të mallrave, shërbimeve dhe punëve” ishte procedurë që në të shumtën e rasteve nuk zhvillohej, në kundërshtim me nenin 13 dhe neni 15 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Një informacion i përmbledhur pasqyrohet në tabelën 7;

Analiza e dokumentacionit përbërës të dosjeve të verifikuara:

- Dosja 1. Shërbim 3D pesticide, procedure e anuluar

1. U. Prokurimi nr. 1162 date 12.12.2024
2. Urdhri nr. 5873 date 27.11.2024 për ngritjen e komisionit të specifikimeve teknike, përlllogaritjen e fondit.
3. Ftesë për oferte nr. 6374 prot. Date 23.12.2024
4. Dokumentacioni i OE
5. Formulari i njoftimit të anulimit nr. 6431 prot, date 26.12.2024

- Dosja 2. Automjet për ofrimin e shërbimeve

1. U prokurimi nr. 68 date 17.01.2024
2. Urdhri nr. 1110 date 30.11.2023 për ngritjen e komisionit të specifikimeve teknike, përlllogaritjen e fondit.
3. Proces verbal i datës 19.01.2024 për konfirmimin e OE si subjekte në QKB
4. Urdhri nr. 137 date 29.01.2024 për caktimin e personit përzgjedhës për monitorimin e zbatimit të kontratës;
5. Shkresa nr. 532/1 date 29.01.2024 “plani i zbatimit të kontratës”
6. Kontrata publike për furnizimin e mallrave nr. 532 date 29.01.2024

- Dosja 3 blerje tuba për kanale vaditës

1. Urdhër prokurimi nr. 768 date 23.08.2024
2. Urdhër për komisionin e përlllogaritjes së vlerës limit, specifikimet teknike, grafikun e punimeve dhe preventivin e procedurës së prokurimit
3. Ftese për Oferte nr. 4589 date 26.09.2024
4. Proces Verbal i datës 27.09.2024, për konfirmimin e OE si subjekte në QKB;
5. Urdhri nr. 983 date 16.10.2024 për caktimin e personit përgjegjës për monitorimin e zbatimit të kontratës
6. Plani i zbatimit të kontratës nr. 4849/1 date 09.10.2024;
7. Kontrata për furnizimin e mallrave nr. 4849 date 09.10.2024;
8. Praktika dokumentare e OE fitues nr. 4769 date 04.10.2024

- Dosja 4 blerje lëndë djegëse për shkollën Mirake Plane

1. Urdhër Prokurimi nr. 127 date 29.01.2024
2. Urdhër nr. 119 date 26.01.2024 për ngritjen e komisionit për përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, specifikimet teknike, kriteret kualifikuese, grafiku i punimeve dhe preventivi;
3. Proces verbal për konfirmimin e OE si subjekte në QKB;
4. Urdhri nr. 244 date 26.02.2024 “Për caktimin e personit përgjegjës për monitorimin e kontratës”;
5. Kontrata publike për furnizimin e mallrave nr. 4042 date 26.02.2024;
6. Plani i zbatimit të kontratës nr. 1043 date 26.02.2024
7. Praktika dokumentare e OE fitues;

Gjithashtu mbi dokumentacionin përbërës të dosjes u verifikuan:

D5. Dosja e procedurës “shpenzime për riparim dhe mirëmbajtje pajisje elektronike në bashki dhe njësi vartëse” me UP nr. 869 date 26.09.2024

D6. Dosja e procedurës “furnizim me buke për vitin 2024” me UP nr. 66 date 17.01.2024;

D7. Dosja e procedurës “blerje materiale te ndryshme elektrike e hidraulike + shpenzime për mirëmbajtje të pajisjeve të zyrës dhe rrjeti i ndriçimit” nr. UP nr. 254 date 28.02.2024;

D8. Dosja e procedurës “furnizim me bukë për mensën sociale” me UP nr. 318 datë 30.03.2024;

D9. Dosja e procedurës “Shpenzime interneti” me UP nr. 72 date 18.01.2024;

Për sa më lart, parregullsitë e konstatuara apo mangësitë e dokumentacionit të praktikave të procedurave të BVV, ka ardhur si rezultat i mos zbatimit korrekt të akteve ligjore/nënligjore nga: Kryetari i Bashkisë, Personi i autorizuar prej tij me detyrë sekretar i përgjithshëm, Komisionit të blerjeve me vlerë të vogël, Komisionet e ngritura me urdhër të titullarit me detyra specifike në rolin e njësisë së prokurimit për BVV.

#### **Nënpika 2.4.4. Auditim mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike, kolaudimi dhe marrja në dorëzim e punimeve të kryera, sipas kontratave të lidhura me operatorët ekonomikë fitues.**

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit, në Bashkinë Librazhd, nga grupi i auditimit të KLSH-së, u analizuan regjistrat e investimeve të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Bashkia Librazhd për periudhën e auditimit për **9 (nëntë)** investime në shumën **394,469,613 lekë me TVSH**. Nga kjo analizë, u arsyetua që si objekte të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga AK, me risk në realizimin e punimeve, të cilat janë kërkuar për t’u audituar, janë përzgjedhur në bazë të vlerës së kontratës, llojit të punimeve të ndërtimit, zërave të punimeve të ndërtimit me risk të madh në zbatimin e veprave, të rishikimit të projekteve të zbatimit si dhe të shtyrjes së afatit të përfundimit të punimeve për objektet e paraqitura në **Tabelën 1**, si vijon:

**Tabela 1:** Regjistri i kontratave për punë publike të përfunduara dhe të marra në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Librazhd, për periudhën e auditimit 2023 - 2024.

Nr.	Objekti	Kontraktori Sipërmarrës	Kontrata		Data Perfundimit punimeve	Vlera e kontratës me TVSH
			Nr. Prot.	datë		
1	Rikonstruksion i kanalit të Allanit Dorez (Faza e I + Skeja e në Vazhdim)	“Z K”	5270	11.08.2023	Nr. 3228, 05.07.2024	4,844,284
2	Rikonstruksion i rrugëve rurale viti 2024 Bashkia Librazhd	BOE G-T shpk& V K shpk	3155	01.07.2024	Nr. 3658, 01.08.2024	11,399,077
3	Ndërtim Qendra Rinore	BOE K& H	2869	13.06.2024	Nr. 6435 26.12.2024	15,626,322
4	Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit Librazhd katund Faza I NJ/A Qendër	BOE Z K & A-A CO	2854	12.06.2024	Nr. 6327 23.12.2024	71,085,637
5	Ndërtim i shkollës së Mesme Polis+Palestër, NJ/A Polis	E shpk	5271	11.08.2023	Nr. 2201 07.05.2024	104,004,584
	<b>SHUMA në lekë me TVSH</b>					<b>206,959,904</b>

**Burimi: Bashkia Librazhd.**

Mbështetur sa më sipër, për auditimin e zbatimit të punimeve të kontratave për punë publike, për periudhën e auditimit 01.01.2024 – 31.12.2024 u audituan **5 (pesë)** investime në shumën totale **206,959,904 lekë me TVSH ose 52.46 %** të shumës totale të kontratave për punë publike **394,469,613 lekë me TVSH**.

#### **Shënim:**

Për **4 (katër)** raste (Tabela nr. 2) mbi investimet në vlerën **202,115,620 lekë me TVSH** të cilat rezultojnë në proces e sipër pune, pra përfundojnë realizimin e kontratave jashtë periudhës së auditimit (2025), auditimi të realizohet në auditimin e radhës nga KLSH-ja.

sipas tabelës së mëposhtme.

**Tabela 2:** Regjistri i kontratave për punë publike të papërfunduara dhe që nuk janë marrë në dorëzim nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Librazhd, për periudhën e auditimit 2023 - 2024.

Nr.	Objekti	Kontraktori Sipërmarrës	Kontrata		Data Përfundimit punimeve	Vlera e kontratës me TVSH
			Nr. Prot.	datë		
1	Sistemim asfaltim i rrugës fshati Spathar loti I Bashkia Librazhd	“B N”	3462	11.05.2023	Nr. 256, date 16.01.2025	66,858,494
2	Sistemim asfaltim i rrugës së fshatit të Kokreve Faza-I Njësia Administrative Hotolisht	“B N”	5270	11.08.2023	ë17.03.2025	71,747,177
3	Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pafovarizuara viti 2024	BOE “K ” ShPK& “H” shpk	4592,	24.09.2024	Nr. 91, 09.01.2025	40,753,938
4	Rikonstruksion i rrugëve për te Kisha	Z K	4167	03.09.2024	Nr. 512 Date 27.01.2025	8,150,100
<b>Shuman ë lekë me TVSH</b>						<b>202,115,620</b>

**Burimi: Bashkia Librazhd.**

Në përfundim të auditimit të zbatimit të kontratave për punë publike, grupi i auditimit të KLSH, pas vlerësimit të dokumentacionit, dhe shqyrtimit të observacioneve të subjektit të audituar Bashkia Librazhd, **po pasqyrojmë në mënyrë të detajuar problematikat e konstatuara**, si vijon:

**I. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Ndërtim i shkollës së mesme Polis + Palestër, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,**

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtim i shkollës së mesme Polis + Palestër, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”.		
<b>14.Lidhja e kontratës</b> nr. 5271 prot., datë 11.08.2023  OE “E” SHPK	<b>15.Vlera e kontratës</b> Vl e prev ofertues 104,004,5840 lekë me TVSH.	<b>16.Likuiduar:</b> Sit. 1 në vlerën 47,513,038.86 lekë pa TVSH Sit. 2 në vlerën 12,552,050 lekë pa TVSH Sit. 3 në vlerën 18,790,944 lekë pa TVSH
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> - Sit përf në vlerën 25,148,541 lekë pa TVSH	<b>18.Afati i kontratës në dite</b> Fillimi punimeve: 07.12.2023 Përfundimi punimeve: 07.05.2024	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka zgjatje të afatit të punimeve.
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “E C G” SHPK	Licenca MK.3574/2	Kontratë me nr. 3911 prot., datë 05.06.2023
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “S-A” SHPK	Licenca Nr.: MK.4146/1	Kontratë nr. 3947 prot., datë 18.06.2024
<b>22.Akt Kolaudimi.</b> Datë: 25.06.2024	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim:</b> Me nr. 3990 prot., datë 21.08.2024 është mbajtur Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “E” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “E C G” SHPK, kolaudatori i punimeve OE “S-A” SHPK, si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: E Q, E Gj, A H dhe. z. B P..	

### **Përshkrimi i Situatës:**

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të Bashkisë Librazhd, në vlerën **279,357 lekë** pa TVSH, argumentuar në tabelën si vijon:

Nr. Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera

	<b>Punime suvatimi dhe veshje</b>							<b>0</b>
Zëri 3(2.27/3/5)	Shtresë pllaka mermeri t=3 cm, (pragje dritare)	m <sup>2</sup>	5,500	41.27	41.27	Realizuar 2/3	1/3	75,662
Zëri 1 (2.358/b)	Veshje fasade me polisterol kompakt jeshil t=5 cm + rrjetë + suva	m <sup>2</sup>	2,600	650	650	Realizuar jo ne përputhje me ST	-	177,450
	<b>Punime suvatimi dhe veshje (Palestra)</b>							<b>0</b>
Zëri 5(2.27/3/5)	Pragje dritare me mermer t=3cm	m <sup>2</sup>	5,600	14.05	14.05	2/3	1/3	26,245
	Totali në lekë pa TVSH							<b>279,357</b>

Sa më sipër, nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

**Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE “E C G” SHPK** e përfaqësuar nga z. E Ç, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E.Ç**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

**II. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”**, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”.		
14. Lidhja e kontratës nr. 2854 prot., datë 12.06.2024	15. Vlera e kontratës V1 e prev ofertues 71,085,637 lekë me TVSH.	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 20,000,000 lekë me TVSH
BOE “Z K” SHPK & “A-A CO” SHPK		
17. Situacioni Përfundimtar	18. Afati i kontratës në dite	19. Zgjatja e kontratës

- Sit përf në vlerën 51,085,637.20 lekë pa TVSH Vlera e realizuar 71,085,637 lekë me TVSH	Fillimi punimeve: 21.06.2024 Përfundimi punimeve: 21.12.2024	Nuk ka zgjatje të afatit të punimeve.
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "Z" SHPK</b>	Licenca MK.3360/3	Kontratë me nr. 1943 prot., datë 19.04.2024
<b>21. Kolaudatori i punimeve OE "2H S" SHPK</b>	Licenca Nr.: MK.4380/1	Kontratë nr. 1035 prot., datë 20.02.2025
<b>22. Akt Kolaudimi.</b> Datë: 21.02.2025	<b>23. Akt i marrjes në dorëzim:</b> Me datë 27.02.2025 është mbajtur Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE "Z K" SHPK & "A-A CO" SHPK, mbikëqyrësi i punimeve "Z" SHPK, kolaudatori i punimeve OE "2H S" SHPK, si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: A H, Xh B, A P. Z. B.P.	

### **Përshkrimi i Situatës:**

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të Bashkisë Librazhd, në vlerën **237,234.71 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr. Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
<b>Punime për bordurë, kunetë dhe trotuar</b>								-
Zëri 3 (3.620)	Trotuar me 6 cm beton, me pllaka betoni	m <sup>2</sup>	1,513	109	109	Realizuar me çmim 1,198.31 dhe me çmim 1,513	-	34,301.21
<b>Punime për struktura, mure, kanale</b>								-
Zëri 1 (3.396/1)	Mbushje me zhavorr pas mureve	m <sup>3</sup>	1,400	353.4	353.4	234.96	118.44	165,816
Zëri 5 (3.396/2)	Mbushje me argjilë pas mureve	m <sup>3</sup>	500	74.2	74.2	-	74.2	37,117.5
Totali në lekë pa TVSH								<b>237,234.71</b>

### **Konstatim nga auditimi në objekt:**

#### **Punime për trupin e rrugës.**

#### **Zëri 7(3.233/1). Shtresë asfaltobetoni me zall lavatriçe, 4 cm, me makineri.**

Nga auditimi në objekt mbi realizimin e zërit "Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 6 cm, me makineri" dhe të zërit "Shtresë asfaltobetoni me granil gur kave, 4 cm, me makineri" u konstatua se:

- ndërmjet seksionit 42 dhe seksionit 43, rruga ka pësuar dëmtime të shtresës asfaltike binder në sipërfaqen 5 m x 3.5 ml = **17.5 m<sup>2</sup>** x 1,091 lekë = 19,092.5 lekë dhe, të shtresës asfaltike asfalto beton në sipërfaqen 5 m x 3.5 ml = **17.5 m<sup>2</sup>** x 904 lekë = 15,820 lekë.
- ndërmjet seksionit 21 dhe seksionit 22, rruga ka pësuar dëmtime të shtresës asfaltike binder në sipërfaqen 7 m x 3.5 ml = **24.5 m<sup>2</sup>** x 1,091 lekë = 26,729.5 lekë dhe, të shtresës asfaltike asfalto beton në sipërfaqen 7 m x 3.5 ml = 24.5 m<sup>2</sup> x 904 lekë = 22,148 lekë.
- ndërmjet seksionit 55 dhe seksionit 56, rruga ka pësuar dëmtime të shtresës asfaltike binder në sipërfaqen 7 m x 3.5 ml = **24.5 m<sup>2</sup>** x 1,091 lekë = 26,729.5 lekë dhe, të shtresës asfaltike asfalto beton në sipërfaqen 7 m x 3.5 ml = **24.5 m<sup>2</sup>** x 904 lekë = 22,148 lekë.

*Në gjykimin e audituesit, nisur nga fakti që kontrata për punë publike me objekt: "Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër,*

*Bashkia Librazhd” është në periudhë garancie deri me datë 27.02.2026, volumi prej 133 m<sup>2</sup> në vlerën 132,667.5 lekë, për zërin “Shtresë binder me gur kave, 6 cm, me makineri” dhe zërin “Shtresë asfaltobetoni me gur kave, 4 cm, me makineri” duhet të zbatohen në objekt (menjëherë) për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës, (Në rast të kundërt, moskryerja e punimeve sipas PZ dhe specifikimeve teknike për zërin e punimeve të pakryera, do të konsiderohet dëm ekonomik dhe duhet të zhdëmtohet nga sipërmarrësi i punimeve).*

Sa më sipër, nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

**Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE “Z” SHPK** e përfaqësuar nga z. L. H, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. L. H, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.**

### **III. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashki Librazhd”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,**

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashki Librazhd”.		
<b>14. Lidhja e kontratës</b> nr. 2869 prot., datë 13.06.2024  BOE “H” SHPK & “K” SHPK	<b>15. Vlera e kontratës</b> Vl e prev ofertues 15,626,322 lekë me TVSH.	<b>16. Likuiduar:</b> Sit. 1 në vlerën 8,928,000 lekë me TVSH
<b>17- Situacioni Përfundimtar</b> - Sit përf në vlerën 6,698,322 lekë pa TVSH  Vlera e realizuar 15,626,322 lekë me TVSH	<b>18. Afati i kontratës në dite</b> Fillimi punimeve: 25.06.2024 Përfundimi punimeve: 26.12.2024	<b>19. Zgjatja e kontratës</b> Nuk ka zgjatje të afatit të punimeve.
<b>20. Mbikëqyrësi i punimeve</b> OE “R9” SHPK	Licenca MK.1506/11	Kontratë me nr. 3042 prot., datë 25.06.2024
<b>21. Kolaudatori i punimeve</b> OE “2H S” SHPK	Licenca Nr.: MK.4380/1	Kontratë nr. 1423 prot., datë 12.03.2025

<b>22.Akt Kolaudimi.</b> Datë: 17.03.2025	<b>23.Akt i marrjes në dorëzim:</b> Me datë 15.05.2025 është mbajtur Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve BOE "H & K" SHPK , mbikëqyrësi i punimeve "R 9" SHPK, kolaudatori i punimeve OE "2H S" SHPK, si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: E. Gj. D. K, E. Q si dhe Z. B. P.
--	--

### **Përshkrimi i Situatës:**

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të Bashkisë Librazhd, në vlerën **451,390.5 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr. Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
<b>I. Punime dheu dhe prishje.</b>								0
Zëri 4(2.37/5b)	Transport dheu dhe mbeturina me auto deri 10 km	m <sup>3</sup>	450	450.89	450.89	434.28	16.61	7,474.5
<b>III. Punime murature</b>								0
Zëri 1 (2.64/2)	Murë me tullë plota në lartësi deri 3 m me llaç të përzier M25.	m <sup>3</sup>	15,100	94.68	94.68	92.35	2.33	35,183
<b>VI. Punime dritare dhe dyer</b>								0
Zëri 1(2.273/4)	FV Davanciale mermeri t=2cm nën dritare	m <sup>2</sup>	6,300	19.39	19.39	19.39 realizuar me çmim 2,100 lekë dhe jo 6,300	-	81,438
Zëri 4 (2.20388/1)	FV Dyer të brendshme tamburatë të rimesuara	m <sup>2</sup>	13,500	13.26	13.26	13.26 realizuar me çmim 11,760.94 lekë dhe jo 6,300	-	23,072
<b>V. Punime suvatimi, lyrje dhe veshje.</b>								0
Zëri 4 (2.328)	Patinim i mureve brenda me allçi (Stuko)	m <sup>2</sup>	350	401.76	401.76	-	401.76	140,616
<b>VII. Punime hidraulike.</b>								0
Zëri 3 (2.209)	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100 mm	ml	930	30	30	30 ml realizuar me çmim 531.98 lekë dhe jo 930	-	11,941
Zëri 6 (An-N.12)	FV Bolier 80 liter, ujë të ngrohtë	copë	13,500	2	2	-	2	27,000
Zëri 7 (2.494)	FV Mini saraçineska D20 (tek aparatet)	copë	900	6	6	-	6	5,400
<b>X. Punime MKZ</b>								0
Zëri 1 (An. 18)	FV Tabela tregues drejtim dalje	copë	3,500	4	4	-	4	14,000
Zëri 2 (An. 19)	FV Tabela tregues fikse zjarri bombel	copë	1,100	2	2	-	2	2,200
Zëri 3 (An. 20).	FV Fikse zjarri portabel pluhur, 6 kg, tipi 34AA 233BC	copë	12,000	2	2	-	2	24,000
<b>XI. Punime të jashtme</b>								0
Zëri 5 (3.620)	Trotuar me 6 cm me pllaka betoni	m <sup>2</sup>	1,800	251.25	251.25	251.25 m2 realizuar me çmim 1,485.31 lekë dhe jo 1,800	-	79,066
<b>Totali në lekë pa TVSH 275,591.5</b>								<b>451,390.5</b>

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

**Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve OE “R 9” SHPK** e përfaqësuar nga znj. R. N, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

**2.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, nuk rezulton të jetë pjesë e saj apo të jetë kryer një oponencë teknike, në lidhje me projektin e zbatimit me objekt: “**Ndërtimi i një qendre rinore në Bashkin Librazhd**”, edhe pse objekti i procedurës, në rastin konkret, është një ndërtim publik apo me akses publik.

Mungesa e oponencës teknike, në rastin konkret, rezulton të jetë në kundërshtim me pikën 1 të **nenit 6 të ligjit nr. 8402**, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 120/2020** “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”, sipas të cilit: “Oponenca teknike për projektet e ndërtimit të objekteve kryhet nga institutet shtetërore ose ente të tjera të përcaktuara nga ministria që mbulon veprimtarinë e ndërtimit, për të gjitha: **a)** ndërtimet publike; **b)** ndërtimet jopublike, me vlerë të preventuar së paku 100 (njëqind milionë) lekë; **c)** objektet me akses publik”.

Si konkluzion, miratimi i projektit të zbatimit në mungesë të një opoence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit.

Në përfundim, në lidhje me veprimet dhe mosveprimet e konstatuara më sipër, të cilat bien në kundërshtim me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, dhe **VKM Nr. 610**, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësive profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: znj. R. N, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, z. L. H, në cilësinë e kolaudatorit të punimeve (për zërat vizualë).**

**IV. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,**

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd”.		
14. Lidhja e kontratës nr. 3155 prot., datë 01.07.2024  BOE “G-T” SHPK & “V K” SHPK	15. Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 11,398,741 lekë pa TVSH.	16. Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 6,000,000 lekë me TVSH
17. Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 5,398,741 lekë pa TVSH  Vlera e realizuar 11,398,741 lekë me TVSH	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 05.07.2024 Përfundimi punimeve: 01.08.2024	19. Zgjatja e kontratës Nuk ka zgjatje të afatit të punimeve.
20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “Z & Z&CO” SHPK	Licenca MK.1208/15	Kontratë me nr. 3240 prot., datë 05.07.2024
21. Kolaudatori i punimeve OE “S-Alb” SHPK	Licenca Nr.: MK.4146/1	Kontratë nr. 4194 prot., datë 04.09.2024
22. Akt Kolaudimi. Datë: 13.09.2024	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 25.02.2025 është mbajtur Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “G-T” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve “Z” SHPK, kolaudatori i punimeve OE “S-A” SHPK, si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: E Gj, D K, E Q si dhe Z. B P.	

### **Përshkrimi i Situatës:**

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të Bashkisë Librazhd, në vlerën **78,200 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr. Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi i ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +		
							Vol.	Vlera	
6.	<b>Shtrim me beton rruga Mirake-Gjovac, Nj Adm. Polis (l=150 ml)</b>							-	
Zëri 4(3.24 5).	Struktura të holla monolite betoni C 25/30	m <sup>3</sup>	11,500	42.05	42.05	39.05	3	34,500	
11.	<b>Shtrim me beton rruga lagjja Peshtan, Nj. Ad. Hotolisht (l=200 ml)</b>							-	
Zëri 4(3.24 5).	Struktura të holla monolite betoni C 25/30	m <sup>3</sup>	11,500	80.60	80.60	76.80	3.8	43,700	
	Totali në lekë pa TVSH							<b>78,200</b>	

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se:** “ ... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane... ”.

- **Udhëzimin Nr. 2, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se:** “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit... ”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

**Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** BOE “Z” SHPK dhe “Z& CO” SHPK përfaqësuar nga z. L. H, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998** “Për Kontrollin dhe Disiplinin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3, datë 15.2.2001** “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Librezja e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. L. H, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.**

**V. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për objektin: “Rikonstruksion kanali i Allanit Dorez (Faza e parë hyrja + Skeja e në vazhdim”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,**

13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksion kanali i Allanit Dorez (Faza e parë hyrja + Skeja e në vazhdim)”.		
14. Lidhja e kontratës nr. 2855 prot., datë 12.06.2024  OE “Z K” SHPK	15. Vlera e kontratës V1 e prev ofertues 4,844,284 lekë me TVSH.	16. Likuiduar: ----
17. Situacioni Përfundimtar - Sit përf në vlerën 4,844,141 lekë pa TVSH	18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 14.06.2024 Përfundimi punimeve: 05.07.2024	19. Zgjatja e kontratës Afati 3 javë. Nuk ka zgjatje të afatit të punimeve.
20. Mbikëqyrësi i punimeve OE “N S” SHPK	Licenca MK.1847/7	Kontratë me nr. 2872 prot., datë 13.06.2024
21. Kolaudatori i punimeve OE “S A” SHPK	Licenca Nr.: MK.4146/1	Kontratë nr. 3775 prot., datë 08.08.2024
22. Akt Kolaudimi. Datë: 12.08.2024	23. Akt i marrjes në dorëzim: Me nr. 3971 prot., datë 20.08.2024 është mbajtur Akti i marrjes në dorëzim të përkohshëm dhe është firmosur nga sipërmarrësi i punimeve OE “Z K” SHPK, mbikëqyrësi i punimeve OE “N S” SHPK, kolaudatori i punimeve OE “S-A” SHPK, si dhe nga grupi i marrjes në dorëzim me përbërje: A H, xh B, E Q si dhe për Bashkinë Librazhd nga Z. B. P.	

### **Përshkrimi i Situatës:**

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi;

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë **Dëm ekonomik** ndaj buxhetit të Bashkisë Librazhd, në vlerën **117,749 lekë** pa TVSH, argumentuar si vijon:

Nr. Anal	Zëri i punimeve	Njësia	Çmimi ofertës	Situacioni përfundimtar	Libri i masave	Fakti	Diferenca në +	
							Vol.	Vlera
<b>II. Punime betoni, guri, puseta, etj.</b>								
Zëri 1(3.24 3/1).	Struktura të holla monolite betoni C 16/20. Për mure portale dhe veshje kanali.	m <sup>3</sup>	15,096	117.52	117.52	109.72	7.8	117,749
Totali në lekë pa TVSH								<b>117,749</b>

**Nga auditimi mbi zbatimin e zërit 1(3.243/1). Struktura të holla monolite betoni C 16/20. Për mure portale dhe veshje kanali, u konstatua si vijon:**

Situacioni përfundimtar, pasqyron volumin 117.52 m<sup>3</sup>, me çmim 15,096 lekë pa TVSH. Libreza e masave pasqyron volumin 117.52 m<sup>3</sup>, pasqyruar në mënyrë analitike.

Nga auditimi i librezës së masave, konstatohet se janë bërë gabime në llogaritje, dhe konkretisht si vijon:

- Shtresa e betonit për tabanin e kanalit prog 0+000 deri 0+020 m, pasqyrohet në volumin **7.26** m<sup>3</sup>, ndërkohë që nga rillogaritja rezulton në volumin **6.05 m<sup>3</sup>** (18 m x 1.2 m gjerësia x 0.28 m lartësia). Pra keni një diferencë prej **1.21** m<sup>3</sup> beton.
- Shtresa e betonit për tabanin e kanalit prog 0+020 deri 0+100 m, pasqyrohet në volumin **32.26** m<sup>3</sup>, ndërkohë që nga rillogaritja rezulton në volumin **26.88 m<sup>3</sup>** (80 m x 1.2 m gjerësia x 0.28 m lartësia). Pra keni një diferencë prej **5.38** m<sup>3</sup> beton.
- Shtresa e betonit për tabanin e kanalit prog 1+080 deri 1+120 m, pasqyrohet në volumin **4.23** m<sup>3</sup>, ndërkohë që nga rillogaritja rezulton në volumin **3.02 m<sup>3</sup>** (7.7 m x 1.4 m gjerësia x 0.28 m lartësia). Pra keni një diferencë prej **1.21** m<sup>3</sup> beton.

Sa më sipër trajtuar, diferenca prej **8.29** m<sup>3</sup> beton C 16/20 është përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **117,749 lekë pa TVSH** (7.8 m<sup>3</sup> x 15,096 lekë).

Nga ana e zbatuesit të punimeve nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 8, ku përcaktohet se: “... Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose evropiane...”.

- **Udhëzimin Nr. 2**, datë 13.5.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit” Kreu I “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit”, pika 3 ku përcaktohet se: “Sipërmarrësi i punimeve të ndërtimit detyrohet të zbatojë punimet, në përputhje me kërkesat urbanistike, kushtet teknike të projektimit e të zbatimit, normat e kushtet e legjislacionit të ndërtimit e të kontraktimit...”.

Për sa më sipër ngarkohen me përgjegjësi si vijon:

**Nga ana e mbikëqyrësit të punimeve** OE “N S” SHPK e përfaqësuar nga z. E. N, nuk janë zbatuar përcaktimet ligjore sipas:

- **Ligjit nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, ku përcaktohet se: “... Mbikëqyrësi i punimeve është i detyruar të kontrollojë dhe është përgjegjës për zbatimin e punimeve të ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të projektimit, të zbatimit, si dhe destinacionin e objektit. Ai është i detyruar të kontrollojë librin e kantierit dhe është përgjegjës për saktësinë, vërtetësinë e dokumenteve dhe cilësinë e punimeve të ndërtimit”.

- **UKM Nr. 3**, datë 15.2.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, të ndryshuar, pika 3.2 ku citon se: “Libreza e masave për punimet e ndërtimit është dokumentacioni bazë për verifikimin e saktësisë së vëllimeve të punimeve të ndërtimit, të vendosura në situacion. Kjo librezë hartohet nga drejtuesi teknik i objektit dhe firmoset nga ai, nga mbikëqyrësi i punimeve dhe nga përfaqësuesi ligjor i sipërmarrësit, për të cilin është miratuar leja e ndërtimit”.

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. E. N, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.**

## **Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratave për punë publike:**

Nga auditimi i 5 (pesë) kontratave për punë publike për periudhën e auditimit në vlerën totale **206,959,904 lekë me TVSH**, u konstatuan problematikat si vijon:

► Në 5 (pesë) raste, rezultuan zëra pune të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **1,163,931.21 lekë pa TVSH**, në mospërputhje me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, **Kreu III, neni 7**, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit, **respektivisht:**

- **Vlera 279,357 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 5271 prot., datë 11.08.2023 me objekt “Ndërtim i shkollës së mesme Polis + Palestër, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”, me sipërmarrës shoqërinë “E” SHPK.

- **Vlera 237,234.71 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 2854 prot., datë 12.06.2024 me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”, me sipërmarrës BOE “Z K” SHPK & “A-A CO” SHPK.

- **Vlera 451,390.50 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 2869 prot., datë 13.06.2024 me objekt “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashki Librazhd”, me sipërmarrës BOE “H” SHPK & “K” SHPK.

- **Vlera 78,200 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 3155 prot., datë 01.07.2024 me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd”, me sipërmarrës BOE “G-T” SHPK & “V K” SHPK.

- **Vlera 117,749 lekë pa TVSH**, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, për kontratën me nr. 28554 prot., datë 12.06.2024 me objekt “Rikonstruksion kanali i Allanit Dorez (Faza e parë hyrja + Skeja e në vazhdim)”, me sipërmarrës shoqërinë “Z K” SHPK.

► Në 1(një) rast, nga auditimi i zbatimit të kontratës për punë publike me objekt: “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashki Librazhd”, u konstatua se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Librazhd nuk është kryer **Oponencë Teknike**, veprim ky në mospërputhje me **pikën 1 të nenit 6** të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me **Ligjin Nr. 120/2020** “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”, me **Ligjin nr. 107/2014** “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, **neni 52**, me **VKM Nr. 610**, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

► Në 1(një) rast, nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd” Bashkia Librazhd, me vlerë 71,085,637 lekë me TVSH, fituar nga BOE “Z K” SHPK & “A-A CO” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të kryera me cilësi jo të mirë dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, në **volumin prej 133 m<sup>2</sup> në vlerën 132,667.5 lekë**, për zërin “Shtresë binder me gur kave, 6 cm, me makineri” dhe zërin “Shtresë asfaltobetoni me gur kave, 4 cm, me makineri” duhet të zbatohen në objekt (menjëherë) për të garantuar cilësinë dhe qëndrueshmërinë e rrugës. Veprime këto në kundërshtim me **Ligjin nr. 8402**, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e

Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes.

**Pika 2.5. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës Publike (Aseteve dhe Pyje Kullotave) të transferuara sipas VKM.**

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. *Inventarët e asetëve të kaluara me VKM Bashkisë dhe NJA nga Pushteti Qendror.*
2. *Listat e asetëve të kaluara në pronësi të Bashkisë së bashku me certifikatat hipotekore sipas rasti, si dhe lista e asetëve për të cilat janë përgatitur dokumentet tekniko-ligjore të depozituar në ASHK për pajisjen e Bashkisë me certifikatë hipotekore pronësie për këto asetë.*
3. *Kontratat e lidhura për dhënien me qira të fondit pyjor;*

**I. Pasuritë e paluajtshme.**

Sipas ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin.

Për Bashkinë Librazhd kanë dalë këto VKM, si më poshtë vijon:

- VKM nr. 1086 , datë 28.10.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në Bashkinë Librazhd, të Qarkut Elbasan”, i është miratuar lista inventarit me në total 422 prona.
- VKM nr. 366 date 18.05.2016 Bashkisë Librazhd i është transferuar 1 prone sipas listës së inventarit bashkëlidhur, gjithsej një flet, me emërtimin Reparti PMNZZH (Zjarrfikësja) .
- VKM nr. 502 date 30.07.2014 Bashkisë Librazhd i është transferuar 1 prone sipas listës së inventarit bashkëlidhur, gjithsej një flet, me emërtimin “Gjykate e Rrethit Librazhd”, dhe sipërfaqe funksionale.
- VKM nr. 367 date 18.05.2016 Bashkisë Librazhd i është transferuar 1 prone sipas listës se inventarit bashkëlidhur, gjithsej një flete, me emërtimin “Shërbimi Informativ i Shtetit”.
- VKM nr. 915 date 11.11.2015 Bashkisë Librazhd “Për transferimin ne pronësi te rrjetit te rrugëve rurale dhe te Aseteve te luajtshme dhe te paluajtshme te ndërmarrjeve te mirëmbajtjes se këtyre rrugëve ”. Si dhe VKM nr. 661 date 21.09.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime ne vendimin nr.915 date 11.1.2015”, **sipas Aneksit 5.1, bashkangjitur aktit.**
- VKM nr. 1108 date 30.12.2015 “Për transferimin nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural, dhe Administrimit te ujërave te Bashkitë, te Infrastrukturës se Ujitjes dhe Kullimit”, **sipas aneksit 5.2, bashkëlidhur aktit.**
- VKM 847, datë 28.10.2020, **sipas aneksit 5.3, bashkëlidhur aktit.**

➤ **Ish Komunës Orenje sot Njësia Administrative Orenje e Bashkisë Librazhd**, me VKM nr. 1414, datë 28.10.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Orenje, të Qarkut Elbasan”, Lista me 100 flete dhe përfundon me nr. Rendor 744, dhe VKM nr. 741 datë 28.05.2008, për miratimin e listës përfundimtare te pronave “Pyje dhe Kullota’ qe do transferohen ne pronësi është 9 flete, dhe përfundon me nr. rendor 350. I është miratuar lista inventarit me 744 prona total nga të cilat 350 prona në pronësi dhe 394 prona në përdorim. Kjo listë fillon me numër 1 (një) dhe mbaron me nr 350 (treqind e pesëdhjetë).së Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave Publike, transferimin e listës përfundimtare të pronave.

➤ **Ish Komunës Polis sot Njësia Administrative Polis e Bashkisë Librazhd**, me VKM nr. 891, datë 19.08.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore

të Komunës Polis, të Qarkut Elbasan”, Lista me 64 flete dhe përfundon me nr. rendor 405, dhe VKM nr. 806, datë 04.06.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave “Pyje dhe Kullota’ qe do transferohen ne pronësi është 3 flete, dhe përfundon me nr. rendor 90. I është miratuar lista inventarit me 405 prona total nga të cilat 90 prona në pronësi dhe 315 prona në përdorim.

➤ **Ish Komunës Qendër sot Njësia Administrative Qendër e Bashkisë** Librazhd, me VKM nr. 313, datë 25.03.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Qendër, të Qarkut Elbasan”, Lista me 131 flete dhe përfundon me nr. rendor 951, dhe VKM 804 dt . 04.06.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave “Pyje dhe Kullota’ qe do transferohen ne pronësi është 8 flete, dhe përfundon me nr. rendor 309. I është miratuar lista inventarit me 951 prona total nga të cilat 309 prona në pronësi dhe 642 prona në përdorim.

➤ **Ish Komunës Stebleve sot Njësia Administrative Stebleve e Bashkisë** Librazhd, me VKM nr. 377, datë 08.04.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Stebleve, të Qarkut Elbasan”, Lista me 80 flete dhe përfundon me nr. rendor 543, dhe VKM 607 dt 05.09.2012, për miratimin e listës përfundimtare të pronave “Pyje dhe Kullota’ qe do transferohen ne pronësi është 6 flete, dhe përfundon me nr. rendor 209. I është miratuar lista inventarit me 543 prona total nga të cilat 209 prona në pronësi dhe 334 prona në përdorim.

➤ **Ish Komunës Hotolisht sot Njësia Administrative Hotolisht e Bashkisë** Librazhd, me VKM nr. 579, datë 28.05.2009 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Hotolisht, të Qarkut Elbasan”, Lista me 97 flete dhe përfundon me nr. rendor 705, dhe VKM 807 dt 04.06.2008, për miratimin e listës përfundimtare të pronave “Pyje dhe Kullota’ qe do transferohen ne pronësi është 5 flete, dhe përfundon me nr. rendor 185. I është miratuar lista inventarit me 705 prona total nga të cilat 185 prona në pronësi dhe 520 prona në përdorim.

➤ **Ish Komunës Lunik sot Njësia Administrative Lunik e Bashkisë** Librazhd, me VKM nr. 1413, datë 22.10.2008 “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore të Komunës Lunik, të Qarkut Elbasan”, Lista me 83 flete dhe përfundon me nr. rendor 609, dhe VKM 682 dt 21.05.2008, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave “Pyje dhe Kullota’ qe do transferohen ne pronësi është 5 flete, dhe përfundon me nr. rendor 198. është miratuar lista inventarit me 609 prona total nga të cilat 198 prona në pronësi dhe 411 prona në përdorim.

Lista e pronave të transferuar me VKM sipas listës përfundimtare të inventarit dhe regjistrimi i tyre në ASHK.

Nr.		VKM		Në përdorim Në numër	Në pronësi Në numër	Nga këto regjistruar
		Numër	Datë			
1	Bashkia Librazhd	1086	28.10.2009	315	107	57
2	Nj.Adm Qender	804	04.06.2008	642	309	12
3	Nj.Adm Orenje	1414	28.10.2008	394	350	15
4	NJ.Adm Polis	891	19.08.2009	315	90	51
5	Nj.Adm Stebleve	377	08.04.2009	344	209	22
6	NJ.Adm Hotolisht	579	28.05.2009	520	185	75
7	Nj.Adm Lunik	1416	22.10.2008	411	198	
8	Rruget	915	11.11.2015	-	10	
9	Kanalet ujore	847	28.10.2020	-	95	
	<b>Totali</b>			<b>2941</b>	<b>1446</b>	<b>229</b>

Burimi: Bashkia Librazhd

- **Aplikimet e për certifikatë pronësie për vitin 2024.**

Për vitin 2024 janë bërë **81 aplikime** nga të cilat, **18 janë** pajisur me certifikatë pronësie. Sipas VKM nr. 433, datë 08.06.2016 “Për transferimin në pronësi të Bashkive të pyjeve dhe kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të ministrisë së Mjedisit e të Ish-komunave/Bashkive”, Bashkisë Librazhd i janë kaluar në pronësi sipërfaqet si më poshtë:

Kategoria e përdorimit	Sipërfaqja ha
Pyll	25089.68 hs
Kullot	9430.76 ha
Inproduktive + shkëmbore	3282.51 ha
Ujore	0 ha
<b>TOTAL</b>	<b>37802.95 ha</b>

Burimi: Bashkia Librazhd

Bashkia Librazhd ka të miratuar 2 plane mbarështim të cilat janë si më poshtë:

1. *Ekonomia Pyjore Dardhë-Xhyrë, miratuar në vitin 2019*
2. *Ekonomia Pyjore Lugina e Kostenjës, miratuar në vitin 2020*

**Për vitin 2024 Bashkia Librazhd ka lidhur kontratë qiraje për:**

- a. Linjën elektrike te subjektit “V H” ShPK.
- b. Kontratë qiraje për veprimtarinë kërkim zbulimi të mineraleve (kontratë që subjekti nuk ka filluar aktivitetin e tij në terren).
- c. Rinovim kontrate të subjekteve Hec që u ka mbaruar afati 10- vjeçar
  1. Subjekti “L K” ShPK.
  2. Hec “ C & S E” R 3&4.

- **Administrimi dhe menaxhimi i asetëve në pronësi ose në përdorim nga Bashkia**

Janë lidhur **78 kontrata** qiradhënie të parcelave nga fondi pyjor e kullosor, nga fondi pyjor e kullosor sipas veprimtarisë që realizojnë e detajuar në tabelën e mëposhtme, me afat duke filluar nga 1 vit, 3, 5, 9 dhe 10 vjeçare. Përlllogaritja e tarifës së qirasë është bërë në bazë të VKM nr.559 date 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike, si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusorë”. Të dhënat e kontratave dhe pagesat e kryera janë paraqitur **aneksin 5.4, bashkëlidhur aktit.**

Nga verifikimi i pagesave të tarifave të qirasë rezulton se, në fund të vitit 2024 janë debitorë **18 shoqëri qiramarrëse në vlerën 919,011 lekë.**

**Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. M. D, Kryetar; z. J. V, me detyrë Specialist i Aseteve; z. A. B, me detyrë Drejtor i Menaxhimit dhe Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave.**

Për sa është trajtuar në aktet e konstatimit dhe aktet e verifikimit nga subjekti i audituar është paraqitur observacioni me shkresë nr. 407/4, datë 21.07.2025 nga z. A. B, janë shprehur objeksionet si më poshtë:

**Pretendimi i Subjektit:**

*Nga verifikimi i pagesave nr. i debitorëve ë mbylljen e vitit 2024 ka qenë 9 subjekte. Në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave Vendore ky nr. Debitorësh është ulur në 9 debitorë, pasi subjektet janë njoftuar me shkrim dhe kanë bërë likuidimet e detyrimeve të vitit 2024. Për subjektet që nuk kanë likuiduar detyrimet e prapambetura ndaj Bashkisë Librazhd do të veprohet sipas legjislacionit në fuqi.*

### **Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar, sqarojmë se observacioni do të merret parasysh dhe do të behen ndryshimet përkatëse ne Projekt Raport.

### **Pika 2.6. Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit.**

6.1. Auditimi mbi shqyrtimin e kërkesave në zbatimin e procedurave ligjore në dhënien e lejeve zhvillimore, ndërtimore si dhe miratimi i certifikatave të përdorimit.

6.2. Auditimi mbi mandat pagesat dhe ballafaqimi me fletën e përlogaritjes së bërë nga Drejtoria e PZHT, në fazën e marrjes së lejes së ndërtimit dhe rillogaritja e pagesës së bërë në bazë të situacionit përfundimtar të punimeve të miratuar nga Drejtoria Rajonale e Tatim Taksave, etj;

U shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Dokumentacioni në sistemin “E leje”;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e urbanistikës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë e financës;
- Dokumentacioni i disponueshëm në drejtorinë juridike;
- Dokumente të tjera nga arkiva, etj.

Bashkia Librazhd ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor dhe Rregulloren e Planit të Përgjithshëm të Territorit me Vendimin e Këshillit Kombëtar të Territorit (KKT), nr.10, datë 08.02.2017, ku përfshihen Plani i Zhvillimit, Rregullorja e PPV-së, Strategjia Territoriale, Vlerësimi Strategjik Mjedisor, si dhe hartat e përdorimit të tokës sipas kategorive, ndarja e territorit në sisteme, infrastruktura e transportit, fazat e zbatimit të PPV-së, vizioni strategjik, ndarja e territorit në zona dhe njësi. Kjo PPV është ndryshuar sipas Vendimit të KKT nr. 8, datë 28.12.2020 “Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Librazhd”, si dhe Vendimit të KKT nr.1, datë 02.04.2024 “Për miratimin e rishikimit të Planit të Përgjithshëm Vendor, Bashkia Librazhd”.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë.
4. Dhënia e Certifikatës së Përdorimit.

Referuar të dhënave në sistemin elektronik e-lejet për Bashkinë Librazhd, rezulton se për afatin e auditimit 01.01.2024 deri në 31.12.2024 ka pasur **104 aplikime** në sistem për lloje të ndryshme lejesh si: leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m<sup>2</sup>, leje zhvillimi, deklarata për kryerje punimesh, certifikata përdorimi, etj., të evidentuara në tabelën përmbledhëse në **Tabelën nr. 1**

Tabela nr. 1: aplikimet në sistemin e-lejet për periudhën 01.01.2024-31.12.2024

<b>Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 nga sistemi e-lejet</b>					
<b>Nr.</b>	<b>Lloji i lejes</b>	<b>Total</b>	<b>Miratuar</b>	<b>Refuzuar</b>	<b>Në proces</b>
1	Certifikatë përdorimi	3	1	2	-
2	Deklaratë paraprake për kryerje punimesh	29	21	8	-
3	Leje infrastrukture	10	7	3	-
4	Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	9	3	4	2
5	Leje për ndryshim funksioni	8	3	5	-
6	Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit	4	2	2	-

Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2024 – 31.12.2024 nga sistemi e-lejet					
7	Leje zhvillimi	12	7	5	-
8	Njoftim për fillim punimesh	13	9	4	-
9	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m <sup>2</sup>	7	4	3	-
10	Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	4	3	1	-
11	Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m <sup>2</sup>	3	2	1	-
12	Përfundim Punimesh	2	1	1	-

Burimi: DPZHT Bashkia Librazhd

Përpunoi: Grupi i auditimit

Duke u bazuar tek të dhënat e vëna në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (këtu e në vazhdim DPZHT) e Bashkisë Librazhd, si dhe në bazë të analizës së riskut dhe me shqyrtimin rast pas rasti të tipologjive të ndryshme të ndërtimit, janë përzgjedhur për t'u audituar rastet e evidentuara në **Tabelën nr. 2**, bashkëlidhur këtij akt-konstatimi.

Tabela nr. 2 – Rastet e audituara

Nr.	Titulli i objektit	Zhvilluesi	Miratuar	Preventivi
<b>Leje ndërtimi</b>				
1	Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102_2 Librazhd	H	28.06.2024	217,363,581
2	Rikonstrukcion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefqet Dosku"	Bashkia Librazhd	03.10.2024	92,224,859.89
3	Agroturizëm dhe struktura të përkohshme me qëllim pushimi, shoqërore dhe veprimtari turistike e kampingje etj.	S ShPK	18.11.2024	32,601,013
4	Banesë individuale 2 kate + çati	S. A.	08.08.2024	4,663,178.5
5	Shtesë kati deri 250m2 në objekt ekzistues nr. pasurie 9/970	B. Ç.	05.07.2024	1,977,556.9
6	Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190	H. C	09.08.2024	2,559,176.4
<b>Certifikata përdorimi</b>				
7	Shtëpi banimi 2 kat dhe rrethim prone	H. H	07.05.2024	-

Përpunoi: Grupi i auditimit

Në lidhje me auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, vërehen parregullsitë si më poshtë:

➤ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në **të gjitha rastet**, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Në **3 (tre) raste** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në **4 (katër) raste** u konstatua se dokumentet e pasurisë nuk janë ngarkuar e rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi. Më konkretisht, këto shkelje janë konstatuar në rastet në vijim, të cilat shfaqin problematikat e mëposhtme:

**1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024**, për objektin: “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, me adresë Bashkia Librazhd, dhe me zhvillues H, me problematika si më poshtë vijon:

**Dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë**, pasi mungon dokumentacioni shoqërues i projektit konstruktiv, projektit hidraulik, projektit të mbrojtjes kundër zjarrit, projektit elektrik, si dhe projektit mekanik, siç janë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për hartuesit e projekteve,

veprime këto në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

**2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024**, për objektin: “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefqet Dosku”, me adresë Dorëz, Nj.Adm.Qendër, Bashkia Librazhd, me zhvillues Bashkia Librazhd, me problematika si më poshtë vijon:

**Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 33 ditësh pune**, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, si dhe **është miratuar në mungesë të Oponencës Teknike**, veprime jo në përputhshmëri me nenin 6 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar. Oponenca teknike duhet të jetë pjesë e dokumentacionit teknik të projektit në çdo rast për objekte të cilat kryhen nga institucione shtetërore për ndërtime publike.

**3. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 1542/5, datë 18.11.2024**, për objektin: “Agroturizëm dhe struktura të përkohshme me qëllim pushimi, shoqërore dhe veprimtari turistike e kampingje etj.”, me adresë Librazhd, me zhvillues S. ShPK, me problematika si më poshtë vijon:

**Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 143 ditësh pune**, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

**Kartela dhe Harta e pasurisë së paluajtshme nuk është ngarkuar e rifreskuara gjatë tre (3) muajve të fundit.** Vihet re se harta e ngarkuar është rifreskuar në datën 10.11.2022, kartela e pasurisë është rifreskuar në datë 16.11.2022. Aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 23.07.2024.

**Dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë**, pasi mungon dokumentacioni shoqërues i projektit arkitektonik, projektit konstruktiv, projektit hidraulik, projektit të mbrojtjes kundër zjarrit, si dhe projektit mekanik, siç janë vërtetimet e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për hartuesit e projekteve, veprime këto në kundërshtim me nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

**4. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2589/4, datë 08.08.2024**, për objektin: “Banesë individuale 2 kate + çati”, me adresë me adresë Librazhd, me zhvillues Skënder Alliu, me problematika si më poshtë vijon:

**Kjo procedurë është shqyrtuar me afate të tejzgjatura prej 40 ditësh pune**, veprime jo në përputhshmëri me nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”.

**Dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë**, pasi mungon licenca e hartuesit të projektit arkitektonik, kjo jo në përputhje me nenin 15 të VKM-së nr. 408, date 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

**Kartela dhe Harta e pasurisë së paluajtshme nuk është ngarkuar e rifreskuara gjatë tre (3) muajve të fundit.** Vihet re se kartela dhe harta e ngarkuar është rifreskuar në datën 17.08.2021. Aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 29.05.2024.

**5. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2676/5, datë 05.07.2024**, për objektin: “Shtesë kati deri 250m2 në objekt ekzistues nr. pasurie 9/970”, me adresë Librazhd, me zhvillues Besnik Çota, me problematika si më poshtë vijon:

**Kartela dhe Harta e pasurisë së paluajtshme nuk është ngarkuar e rifreskuara gjatë tre (3) muajve të fundit.** Vihet re se kartela dhe harta e ngarkuar është rifreskuar në datën 20.08.2018. Aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 04.06.2024.

**Dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë,** pasi mungon studimi gjeologjik dhe studimi sizmologjik shoqëruar me projektin përkatës për mbrojtjen sizmike, kjo jo në përputhje me nenin 43/1 të Vendimit nr. 8, datë 28.12.2020 të KKT-së “Për miratimin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor Bashkia Librazhd, të miratuar me vendimin nr. 10, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit”.

**6. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024,** për objektin: “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, me adresë Librazhd, me zhvillues H C, me problematika si më poshtë vijon:

**Kartela dhe Harta e pasurisë së paluajtshme nuk është ngarkuar e rifreskuara gjatë tre (3) muajve të fundit.** Vihet re se kartela dhe harta e ngarkuar është rifreskuar në datën 12.02.2024. Aplikimi për pajisje me leje ndërtimi është bërë në datë 12.07.2024.

**Dokumentacioni teknik dhe shoqërues i projektit ndërtimor, si dhe ai i kërkuar me ligj, nuk është i plotë,** pasi mungon studimi gjeologjik dhe studimi sizmologjik shoqëruar me projektin përkatës për mbrojtjen sizmike, kjo jo në përputhje me nenin 43/1 të Vendimit nr. 8, datë 28.12.2020 të KKT-së “Për miratimin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor Bashkia Librazhd, të miratuar me vendimin nr. 10, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit”.

**7. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. 1193/4 , datë 07.05.2024,** për objektin: “Shtëpi banimi 2 kat dhe rrethim prone”, me adresë Spathar, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd, me subjekt zhvillues z. H. H, me problematika si më poshtë vijon:

**Mungojnë aktet përkatëse (procesverbal, akt miratimi, akt kolaudimi, akt teknik etj.) të lëshuar nga shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, si dhe ato për menaxhimin e mbetjeve urbane,** veprime jo në përputhshmëri me nenin 27/2 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë). Nga kontrolli i dokumentacionit në sistemin “E leje”, rezulton i ngarkuar elektronikisht vetëm akti për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me:

- VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika ë); nenin 20; neni 27/2, pika 1, nënpika ë)

- Vendimit nr. 8, datë 28.12.2020 të KKT-së “Për miratimin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor Bashkia Librazhd, të miratuar me vendimin nr. 10, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit ” neni 43/1

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: **z. M. D**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Librazhd (për rastet 1 – 7 ); **z. K. B**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastet 1 – 7); **z. E. Gj**, në cilësinë e përgjegjësit të DPZHT (për rastet 1 – 7 ); **zj. A. H**, në cilësinë e specialistes pranë DPZHT (për rastet 1 - 7 );

**Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 407/6 prot; datë 01.10.2025, është observuar nga funksionarët e Bashkisë Librazhd dhe DPZHT, Bashkia Librazhd, me anë të shkresës nr. 6651 prot; datë 29.09.2025, si më poshtë vijon:**

**1.1 Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me konstatimin se leja e ndërtimit, miratuar me nr.1542/5, datë 18.11.2024 “Agroturizëm dhe struktura...” është shqyrtuar me afate të tejzgjatura, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore,*

*Bashkia Librazhd shprehet se: " Sqarojmë se autoriteti ynë ka tejkeluar afatin ligjor për marrjen e vendimit për shkak të kërkesës për dokumentacion (si urdhri për heqjen nga fondi pyjor), i cili ishte i domosdoshëm. Edhe pse kjo vonesë ka ndodhur për arsye të jashtme dhe të paevitueshme, për të shmangur çdo dëm të mundshëm për qytetarin dhe për të mos e vonuar më tej procedurën, konsideruam të arsyeshme të mos e pezullojmë procedurën dhe të vazhdojmë shqyrtimin e kërkesës për leje ndërtimi sipas legjislacionit."*

### **1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se tejzgjatja e shqyrtimit të kërkesës për leje ndërtimi përtej afatit 60 ditë pune, të përcaktuar në nenin 45, pika 1, të Ligjit nr. 107/2014, nuk është e justifikueshme ligjërisht vetëm mbi bazën e një vonese nga institucione të tjera. Në raste të tilla, autoriteti përgjegjës duhet të veprojë në përputhje me afatet ligjore dhe, nëse dokumentacioni nuk është i plotë apo mungon vendimi i një institucioni tjetër (si p.sh. urdhri për heqje nga fondi pyjor), procedura duhet të pezullohet zyrtarisht dhe aplikimi të ri-paraqitet në një moment të mëvonshëm, me të gjithë dokumentacionin e plotësuar nga institucionet përkatëse. Mospezullimi i procedurës dhe vazhdimi i shqyrtimit përtej afatit ligjor përbën shkelje të parashikimeve të ligjit dhe bie në kundërshtim me parimin e sigurisë juridike dhe respektimit të afateve procedurale.

Për sa më sipër, **argumenti juaj nuk merret në konsideratë.**

### **2.1 Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit shoqërues për objektin : "Banesë individuale 2 kate + çati" , Bashkia Librazhd shprehet se: "Theksojmë se mungesa e dokumenteve të nevojshme ka ndodhur për shkak të arsyeve objektive, të cilat janë jashtë kontrollit të palës kërkuese, përfshirë vonesa teknike dhe administrative që nuk kanë ndikuar në ligjshmërinë e kërkesës. Dokumentacioni është dorëzuar në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe rregulloren përkatëse, pa shkaktuar asnjë mangësi në vlerësimin e kërkesës. Leja është miratuar dhe vënë në zbatim në përputhje me ligjin, duke respektuar të gjitha kërkesat urbanistike."*

### **2.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se legjislacioni në fuqi përcakton qartë se dokumentacioni i plotë duhet të paraqitet paraprakisht, përpara dhënies së lejes së ndërtimit.

Sipas VKM nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"i ndryshuar, neni 15, pika 1, shkronja ë, theksohet se si dokumentacioni i detyrueshëm për pajisjen me leje ndërtimi konsiderohen edhe licencat profesionale të hartuesve të projekteve. Në mungesë të këtyre, kërkesa nuk mund të konsiderohet e plotë.

Për sa më sipër, **argumenti juaj nuk merret në konsideratë.**

### **3.1 Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit shoqërues për objektin : "Shtesë 8 kate në objekt ekzistues..." si dhe për objektin: "Agroturizëm dhe struktura të përkohshme..." , Bashkia Librazhd shprehet se: "Lidhur me mungesën e dokumentacionit që vërteton regjistrimin në QKB, zyra jonë ka kryer verifikim të detajuar në platformën e Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB), ku rezulton se subjektet janë të regjistruara ligjërisht dhe disponojnë licenca aktive. Kjo dëshmon se subjektet operojnë dhe funksionojnë në bazë të legjislacionit në fuqi."*

### **3.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se verifikimi i statusit të subjekteve është një procedurë e thjeshtë, megjithatë VKM 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit"i ndryshuar, parashikon këtë kërkesë, pasi subjekti ndërtues/zhvillues dhe të gjitha subjektet hartues të projektit ndërtimor duhet të gëzojnë të drejtën e ushtrimit të aktivitetit në momentin e aplikimit për leje ndërtimi. Vetëm pasi vërtetohet regjistrimi në QKB dhe statusi aktiv sipas disiplinave përkatëse, Bashkia mund të shqyrtojë dhe miratojë aplikimin. Verifikimi i kryer nga funksionarët e DPZHT, Bashkia Librazhd, provohet vetëm nga prania në sistemin elektronik të lejeve e vërtetimit të regjistrimit në QKB dhe/ose ekstraktit historik të subjektit, dokumente që duhet të jenë të nënshkruara elektronikisht dhe të ngarkuara nga aplikanti.

Për sa më sipër, **argumenti juaj nuk merret në konsideratë.**

### **4.1 Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit shoqëruar **për objektin** : “Shtesë kati deri në 250 m2 objekt ekzistues...” , Bashkia Librazhd shprehet se: “Objekti ekzistues në këtë leje të dhënë është 2 kate mbi tokë. Shtesa është një çati e shfrytëzueshme, me strukturë druri. Kjo shtesë, sipas projektit të strukturës, është brenda normativave për peshën maksimale të lejuar mbi një soletë ekzistuese, e cila është llogaritur edhe në projektin strukturor të shtesës. Duke gjykuar mbi këtë argumentim, shtesa nuk ndikon mbi aftësinë mbajtëse të objektit ekzistues. Gjithashtu, duke marrë në konsideratë se përreth këtij objekti ndodhen ndërtesa ekzistuese deri në 5 kate, si dhe faktin që gjeologjia dhe kushtet sizmike nuk ndryshojnë në distanca kaq të afërta, rezulton se kjo leje shtese është brenda kushteve teknike të ndërtimit”.

**Gjithashtu për objektin:** “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, Bashkia Librazhd shprehet se: “Leja e miratuar për shtesën mbi ndërtimin ekzistues është gjykuar mbi analizën e projektit strukturor mbi objektin ekzistues, i cili ka një sipërfaqe prone të njëjtë me bazën e objektit. Studimi gjeologjik bazohet mbi analizën e provave të realizuara nga shpimet me sondë, gjë që është e pamundur në këto rrethana, pasi sondat nuk mund të realizohen jashtë parcelës ndërtimore. Bazuar në projektin dhe vendimmarrjen e projektit konstruktiv, gjithashtu duke gjykuar që objektet përreth këtij objekti janë më të larta se leja në fjalë, është menduar të ndryshojë në distanca kaq të afërta. Sipas legjislacionit, projektuesi inxhinier konstruktiv, llogaritjet i bën për intensitet sizmik 9 ballë. Duke analizuar këto rrethana, është marrë vendimi që kjo shtesë është e lejueshme.”

#### **4.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se ky argumentim nuk justifikon në mënyrë të vlefshme konstatimin e grupit të auditimit, pasi ky i fundit bazohet në përcaktimet e Planit të Përgjithshëm Vendor, të miratuar me Vendimin e KKT nr. 10, datë 08.02.2017, dhe të ndryshuar me Vendimin e KKT nr. 8, datë 28.12.2020.

Fakti që objektet përreth mund të jenë pajisur me studim sizmik dhe gjeologjik, nuk përbën garanci për qëndrueshmërinë e objektit në fjalë dhe nuk justifikon mungesën e dokumentacionit të detyrueshëm të parashikuar në PPV.

Për sa më sipër, **argumenti juaj nuk merret në konsideratë.**

#### **5.1 Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me konstatimin mbi mungesën e dokumentacionit shoqëruar për certifikatën e përdorimit: “Shtëpi banimi 2 kat...” , Bashkia Librazhd shprehet se: “Aktet përkatëse janë të ngarkuara në sistemin e-Leje (akt-kontrolli përfundimtar, akt-kontrolli për përfundimin e karabinës, akt-kontrolli për përfundimin e themeleve, akt-kontrolli i piketimit të objektit).”

**5.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:** Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se konstatimi i grupit të auditimit lidhet me mungesën e akteve përkatëse, të cilat duhet të lëshohen nga institucionet kompetente, përkatësisht: shoqëria “Ujësjiellës-Kanalizime” sh.a., Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit, si dhe strukturat përgjegjëse për menaxhimin e mbetjeve urbane.

Ky konstatim nuk ka të bëjë me mungesën e akteve të kontrollit të mbikëqyrjes së punimeve, të parashikuara në nenin 27/1 “Mbikëqyrja e punimeve” të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, të ndryshuar.

Për sa më sipër, **argumenti juaj nuk merret në konsideratë.**

➤ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1(një) rast**, për objektin për të cilin është miratuar leja e ndërtimit, mungojnë dokumentet e pronësisë që vërtetojnë të drejtën e zhvilluesit mbi pasurinë përkatëse. Më konkretisht, këto shkelje janë konstatuar në rastin në vijim, i cili shfaq problematikat e mëposhtme:

**Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024**, për objektin: “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefqet Dosku”, me adresë Dorëz, Nj.Adm.Qendër, Bashkia Librazhd, me zhvillues Bashkia Librazhd, me problematika si më poshtë vijon:

**Parcela në zhvillim nuk ka dokumente pronësie**, veprime jo në përputhshmëri me nenin 15 të VKM-së nr. 408, date 13.05.2015 "Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit", i ndryshuar, pika 1, nënpika b).

Çdo aplikues që kërkon të pajiset me leje ndërtimi duhet të ngarkojë në sistemin "e lejet" dokumente që vërtetojnë të drejtat pasurore të pronës/ave që marrin pjesë në zhvillim. Nga auditimi i dokumentacioni të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, nuk konstatohen të ngarkuara dokumente pronësie.

Referuar përcaktimeve të nenit 17, të Ligjit nr. 111/2018 "Për kadastrën", i ndryshuar, pika 2, marrim informacionin se certifikata e pronësisë është dokument unik i papërsëritshëm dhe provon titullin e pronësisë, statusin ligjor dhe kufijtë e pronës. Referuar përcaktimeve të nenit 19 të ligjit të sipërcituar, pika 2, marrim informacionin se vërtetimi i pronësisë është akti zyrtar që lëshohet për të provuar se pronari ka depozituar dokumentet ligjore për regjistrim, por prona ndodhet në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar ende regjistrimit fillestar. Pra, si përfundim, shprehemi se dokumenti i vetëm unik i cili provon titullin e pronësisë është certifikata e pasurisë, shoqëruar me kartelë pasuri dhe hartë kadastrale, si dhe në rastet kur zona nuk i është nënshtruar regjistrimit fillestar, dokumenti ligjor përkatës është vërtetimi i pasurisë. Kjo leje ndërtimi është miratuar në mungesë të dokumenteve të pronësisë.

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 "Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit", i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b);

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: - **z. M. D**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Librazhd (për rastin 1 ); - **z. K. B**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastin 1 ); - **z. E. Gj**, në cilësinë e përgjegjësit të DPZHT (për rastin 1 ); - **zj. A. H**, në cilësinë e specialistes pranë DPZHT (për rastin 1 );

**Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 407/6 prot; datë 01.10.2025, është observuar nga funksionarët e Bashkisë Librazhd dhe DPZHT, Bashkia Librazhd, me anë të shkresës nr. 6651 prot; datë 29.09.2025, si më poshtë vijon:**

#### **1.1 Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me konstatimin se leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të dokumentacionit të pronësisë, shprehen se: *"Theksojmë se kjo është leje rikonstruksioni dhe shtimi i palestrës, e realizuar brenda rrethimit ekzistues të shkollës. Zhvillimi i këtij projekti nuk cenon në asnjë moment pronat kufitare jashtë rrethimit ekzistues. Fondi për rikonstruksionin e shkollës është dhënë nga Ministria e Arsimit, e cila nuk është ndikuar apo nuk ka kërkuar në asnjë moment dokumentin e pronësisë. Duke gjykuar nga këto rrethana dhe në kushtet e tejkallimit të afateve, duke marrë parasysh qëllimin kryesor, i cili lidhet me cilësinë e ambienteve të shkollës dhe rëndësinë thelbësore që kanë nxënësit e saj, ky qëllim tejkallon një procedurë burokratike.*

*Gjithashtu, duke marrë parasysh që nuk ka asnjë ankesë apo procedurë në lidhje me problemin e pronësisë, vendosëm t'i japim përparësi qëllimit kryesor. Rrethimi i kësaj shkolle ka qenë aty prej shumë kohësh dhe është pjesë funksionale e saj. Edhe nëse do të ketë pretendime mbi pronësinë në të ardhmen nga pronarë të tjerë, kjo sigurisht do të trajtohet me procedurë shpronësimi kundrejt pronarëve të tjerë, por kurrsesi nuk do të jetë cenim i këtij rrethimi.*

***Duke u nisur nga kjo indicie, ne si drejtori do të fillojmë procedurat e regjistrimit të pasurisë, jo vetëm për këtë shkollë, por edhe për të gjitha shkollat e Bashkisë Librazhd, në mënyrë që të mos kemi pengesa të tilla procedurale në të ardhmen.***

*Prona e kësaj shkolle ndodhet në një zonë kadastrale që nuk i është nënshtruar ende regjistrimit fillestar. Shkollat, bashkë me rrethimet e tyre, nuk mund të tjetërsohen. Edhe nëse pas regjistrimit përfundimtar do të konstatohet ndryshe për pronësinë brenda këtij rrethimi, kjo do të trajtohet me procedurë shpronësimi dhe kompensimi ndaj pronarëve të mundshëm privatë".*

#### **1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me argumentimin tuaj, theksojmë se Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (DPZHT) ka pranuar konstatimin e grupit të auditimit se procedura për miratimin e lejes së ndërtimit

është zhvilluar në mungesë të dokumentacionit të pronësisë për truallin në fjalë. Megjithatë, kjo nuk mund të shërbejë si precedent për trajtimin e rasteve të ngjashme, edhe kur investimi synon realizimin e një objekti me karakter publik dhe në funksion të interesit të përgjithshëm, duke u justifikuar me faktin se nëse do të ketë konflikte pronësie në të ardhmen, Bashkisë i lind e drejta për shpronësim për inerte publik. Në të gjitha rastet, si për pasuritë publike, ashtu edhe për ato private, në mungesë të një statusi të qartë ligjor mbi pronësinë, aplikimi për leje ndërtimi konsiderohet i paplotë.  
Për sa më sipër, **argumenti juaj merret pjesërisht në konsideratë.**

➤ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se Bashkia Librazhd dhe DPZHT, në **2 (dy) raste** nuk ka kërkuar/respektuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar nenit 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6, DPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto shkelje janë konstatuar në rastet në vijim, të cilat shfaqin problematikat e mëposhtme:

**1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024**, për objektin: “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, me adresë Bashkia Librazhd, dhe me zhvillues H, me problematika si më poshtë vijon:

**Bashkia Librazhd dhe DPZHT nuk ka respektuar mendimin e të gjithë autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit**, veprime jo në përputhshmëri me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6. DPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga kontrolli i dokumentacionit mbi miratimin e lejes së ndërtimit, rezulton se **nuk është respektuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit**, e cila me shkresën nr.2632 Prot, drejtuar Bashkisë Librazhd, **ka shprehur mosdakortësinë për zhvillimin e projekt-propozimit** i cili është konceptuar dhe paraqitur si 8 kate shtesë mbi 2 kate nëntokë ekzistuese.

**2. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024**, për objektin: “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, me adresë Librazhd, me zhvillues H C, me problematika si më poshtë vijon:

**Bashkia Librazhd dhe DPZHT nuk ka kërkuar mendimin e të gjithë autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit**, veprime jo në përputhshmëri me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015, “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6. DPZHT ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Nga auditimi i dokumentacionit në lidhje me sa më sipër, rezulton se leja e ndërtimit është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat regulatore shprehet qartësisht se informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën.

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6;

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: - **z. M. D**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Librazhd (për rastin 1, 2); - **z. K. B**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastin 1, 2); - **z. E. Gj**, në cilësinë e përgjegjës të DPZHT (për rastin 1, 2); - **zj. A. H**, në cilësinë e specialistes pranë DPZHT (për rastin 1, 2);

**Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 407/6 prot; datë 01.10.2025, është observuar nga funksionarët e Bashkisë Librazhd dhe DPZHT, Bashkia Librazhd, me anë të shkresës nr. 6651 prot; datë 29.09.2025, si më poshtë vijon:**

**2.1 Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me konstatimin për objektin : “Shtesë 8 kate në objekt ekzistues...”, Bashkia Librazhd shprehet se: “Sipas VKM 408, datë 13.05.2025, i ndryshuar, akti i komformimiti duhet për objektet mbi 8 kate. Në këtë kuadër, procesi është i rregullt dhe në përputhje me rregulloren”.*

**2.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me argumentimin tuaj theksojmë se, sipas konstatimit të grupit të auditimit, objekti faktik është 9 kate mbi kuotën e sistemimeve. Marrja e mendimit ose aktit të konformitetit nga AZHT përbën një detyrim ligjor. Në këto kushte, DPZHT ka kërkuar mendimin e AZHT, e cila është shprehur në mënyrë të qartë për mosdakordësinë e saj lidhur me këtë aplikim. Konstatimi i grupit të auditimit nuk lidhet me detyrimin për të kërkuar ose jo mendimin e AZHT, por me faktin se nuk është respektuar mendimi i dhënë nga autoritetet që, sipas legjislacionit në fuqi, duhet të shprehen për miratimin e lejeve të ndërtimit.

Për sa më sipër, **argumenti juaj nuk merret në konsideratë.**

➤ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **1 (një) rast**, objekti i miratuara nuk respekton kondicionet urbane, lidhur me: intensitetin maksimal të lejuar, koeficientin e shfrytëzimit të territorit, lartësinë maksimale të lejuar (e matur si në numër katesh, ashtu edhe në metra), si dhe numrin minimal të vend-parkimeve. Më konkretisht, këto shkelje janë konstatuar në rastin në vijim, i cili shfaq problematikat e mëposhtme:

**1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024**, për objektin: “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, me adresë Bashkia Librazhd, dhe me zhvillues H, me problematika si më poshtë vijon:

**Objekti i miratuar nuk respekton Intensitetin maksimal të lejuar** Intensiteti i ndërtimit (I) për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 4. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se  $I_{faktike} = 5.25$  (e përlllogaritur sipas formulës:  $4201 \text{ m}^2$  të ndërtuar mbi sipërfaqen e tokës /  $798 \text{ m}^2$ ). Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përftuar më shumë se ajo e lejuar është  $1009 \text{ m}^2$ . Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 49 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Librazhd, si dhe me përcaktimet e pasaportës së njësisë strukturore **1/102\_2**.

**Objekti i miratuar nuk respekton Koeficientin e Shfrytëzimit të Territorit (KSHT) të lejuar.** KSHT për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, sipas PPV-së, është 50%. Nga përlllogaritja e kryer nga grupi i auditimit, është konstatuar se **KSHT faktike = 73%** (e përlllogaritur sipas formulës ( $582 \text{ m}^2$  të ndërtuar në katin përdhe /  $798 \text{ m}^2$  sipërfaqen totale e parcelës ndërtimore x 100). Veprimet e mësipërme janë në kundërshtime me nenin 50 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Librazhd, si dhe me përcaktimet e pasaportës së njësisë strukturore **1/102\_2**.

**Objekti i miratuar nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar, e matur me numër katesh.** Referuar përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Librazhd, më konkretisht tabelës së të dhënave urbane të njësisë strukturore **1/102\_2**, marrim informacionin se lartësia maksimale e lejuar, e matur me numër katesh, është 8 kate. Referuar auditimit të ushtruar mbi projektin ndërtimor (prerjet teknike), si dhe përcaktimeve të nenit 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënika c); pika 2; pika 3, nënpika b); është konstatuar se lartësia e objektit në këtë fasadë është 9 kate, edhe jo 8 kate, si është specifikuar në dokumentacionin e ngarkuar në sistemin e-lejet.

**Shënim:** Lartësia në kate është matur në aksin e evidentuar me kuadrat të kuq dhe është trajtuar në mënyrë të detajuar në akt-konstatimin nr. 21, i cili është dorëzuar në protokollin e Bashkisë Librazhd.

**Objekti i miratuar nuk respekton lartësinë maksimale të lejuar, e matur me metra.** Referuar përcaktimeve të Planit të Përgjithshëm Vendor për Bashkinë Librazhd, më konkretisht tabelës së të dhënave urbane të njësisë strukturore 1/102\_2, marrim informacionin se lartësia maksimale e lejuar, e matur me metra, është 26 metra. Referuar auditimit të ushtruar mbi projektin ndërtimor (prerjet teknike), si dhe përcaktimeve të nenit 37 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënika c); pika 2; pika 3, nënpika b); është konstatuar se lartësia e objektit në këtë fasadë është 27.6 metra, edhe jo 26 metra, si është specifikuar në Rregulloren e PPV-së.

**Shënim:** Lartësia në metra është matur në aksin e evidentuar me kuadrat të kuq dhe është trajtuar në mënyrë të detajuar në akt-konstatimin nr. 21, i cili është dorëzuar në protokollin e Bashkisë Librazhd.

**Objekti i miratuar nuk respekton numrin minimal të vend-parkimeve,** të parashikuar në Planin e Përgjithshëm Vendor. Referuar nenit 55 të Rregullores së PPV-së për Bashkinë Librazhd, marrim informacionin se numri minimal i vend-parkimeve për hapësirat e banimit është 1 vend-parkim / apartament. Referuar këtyre përcaktimeve dhe llogaritjes së kryer nga grupi i auditimit, ku rezulton se numri total i apartamenteve është 40, shprehemi se numri minimal i vend-parkimeve do të duhej të ishte 40. Numri faktik i vend-parkimeve është 18.

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me - VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 37, pika 1, nënpika c); pika 2; pika 3, nënpika b); - Vendimin nr.10, datë 08.02.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, Bashkia Librazhd” i ndryshuar, neni 49, 50, 55, si dhe me përcaktimet e pasaportës së njësisë strukturore 1/102\_2;

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: - **z. M. D**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Librazhd (për rastin 1); - **z. K. B**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastin 1); - **z. E. Gj**, në cilësinë e përgjegjësit të DPZHT (për rastin 1); - **zj. A H**, në cilësinë e specialistes pranë DPZHT (për rastin 1);

**Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 407/6 prot; datë 01.10.2025, është observuar nga funksionarët e Bashkisë Librazhd dhe DPZHT, Bashkia Librazhd, me anë të shkresës nr. 6651 prot; datë 29.09.2025, si më poshtë vijon:**

### **2.1 Pretendimi i subjektit:**

Në lidhje me konstatimin se leja e ndërtimit nuk respekton kondicionet urbane, për objektin : “Shtesë 8 kate në objekt ekzistues...”, Bashkia Librazhd shprehet se: “Në plan vendosjen e miratuar, treguesit e zhvillimit janë në përputhje me treguesit maksimalë të zhvillimit. Kondicionet urbane janë të shënuara në plan vendosjen e miratuar, ku janë përcaktuar edhe sipërfaqet e objektit. Në sistem janë të ngarkuara edhe planimetritë e kateve në format PDF.

Nga matja e formës së plan vendosjes, rezulton se sipërfaqet përputhen me shënimet e saj.

Intensiteti maksimal i miratuar është përlllogaritur duke mbledhur sipërfaqet mbi tokë të miratuara në lejen e mëparshme Nr. 625, datë 21.03.2023, duke shtuar edhe sipërfaqet e lejes së re Nr. 2420/6, datë 28.06.2024.

Kati 0 i lejes së re Nr. 2420/6, datë 28.06.2024 është 272 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja shtesë e ndërtimit mbi tokë është 2,914.4 m<sup>2</sup>. Sipërfaqja e përgjithshme e lejes Nr. 625, datë 21.03.2023 dhe lejes Nr. 2420/6, datë 28.06.2024 është 3,186.4 m<sup>2</sup>. Për një sipërfaqe truall të zhvilluar me intensitet 4, miratimi i lejes është bërë duke gjykuar plan vendosjen.

Leja e dhënë është një aplikim i ri mbi një leje të miratuar më parë. Sipërfaqja e ndërtuar mbi tokë e lejes së mëparshme është e përcaktuar në kushtet e zhvillimit. Duke e konsideruar lejen e miratuar si akt të kryer, janë marrë në konsideratë kushtet e zhvillimit, të cilat tregojnë qartë se kati i parë nëntokë është pjesërisht i dukshëm dhe se intensiteti është i përcaktuar në lejen e dhënë.

*Duke iu referuar kësaj lejeje, shtesa prej 8 katësh në krahun e ekspozuar mbi tokë të lejes ekzistuese është llogaritur sipas projektit teknik si kate të shfrytëzuara mbi tokë, ndërsa nga krahu i quajtur nëntokë, është zhvilluar gjithashtu me 8 kate mbi tokë”.*

## **2.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në lidhje me argumentimin tuaj theksojmë se:

Së pari, mosrespektimi i kufizimeve ligjore në lidhje me lartësinë maksimale të lejuar (e matur në numër kate dhe në metra), koeficientin e shfrytëzimit të territorit (KSHT), intensitetin maksimal të lejuar, ka ardhur si pasojë e interpretimit të gabuar nga ana e DPZHT në vlerësimin e një objekti të mëparshëm ndërtimi, i cili lidhet funksionalisht me objektin e kësaj leje ndërtimi. Konkretisht, DPZHT ka konsideruar si kat nëntokë një kat që në fakt në mënyrë të dukshme është i ndërtuar mbi tokë, dhe që është miratuar me një leje ndërtimi të mëparshme, dhe që rezulton të jetë i pakolauduar dhe pa certifikatë përdorimi.

Grupi i auditimit i qëndron konstatimit se kati -1, sipas projektit ndërtimor të miratuar nga Bashkia, në mënyrë faktike duhet të ishte konsideruar si kat mbi tokë. Ky interpretim i gabuar ka sjellë si pasojë: tejkalimin e numrit maksimal të kateve të lejuara; mosrespektimin e koeficientit të shfrytëzimit të territorit (KSHT); tejkalimin e intensitetit ndërtimor të përcaktuar në kushtet e zhvillimit.

Së dyti, nga shqyrtimi dhe matja e projektit arkitektonik në formatin DËG, është konstatuar se sipërfaqet që janë marrë në konsideratë për përlllogaritjen e intensitetit, nuk respektojnë përcaktimet në lidhje me sipërfaqet që duhet të bëhen pjesë e përlllogaritjes së intensitetit. Më konkretisht, DPZHT ka marrë si referencë vetëm sipërfaqen e katit përdhe (kati 0 sipas DPZHT ose kati 1 sipas KLSH), duke e shumëzuar atë për çdo kat, pa evidentuar sipërfaqet reale të shfrytëzuara të çdo kati veç e veç.

Grupi i auditimit ka kryer një rillogaritje të intensitetit faktik sipas projektit në DËG, duke përfshirë të gjitha sipërfaqet reale të shfrytëzuara (duke përfshirë sipërfaqet e ballkoneve, por duke përfshirë ato të lozhave). Nga kjo rillogaritje rezulton se intensiteti ndërtimor faktik është 5.26, dhe jo 4, siç është përcaktuar nga treguesit e zhvillimit në plan vendosjen e miratuar. Diferenca e sipërfaqes ndërtimore të përfutur më shumë se ajo e lejuar është 1009 m<sup>2</sup>.

Për sa më sipër, **argumenti juaj nuk merret në konsideratë.**

➤ Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, kanë ndaj fundit publik për strehim social. Referuar përcaktimeve të nenit 19 të Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, marrim informacion se: “Çdo subjekt privat që aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi.”. Kjo problematikë është evidentuar në rastin e mëposhtëm:

**1. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024**, për objektin: “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, me adresë Bashkia Librazhd, dhe me zhvillues H, me problematika si më poshtë vijon:

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin *e-lejet*, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 3641 m<sup>2</sup>, nga të cilat **109.23 m<sup>2</sup>** do të duhej t’i kalonin të fondit publik të banesave sociale, në natyrë ose në vlerë monetare. Në sipërfaqen e përlllogaritur më sipër (3641 m<sup>2</sup>) janë përfshirë sipërfaqet e përbashkëta takuese, ballkonet, llozhat dhe sipërfaqet neto të apartamenteve.

Veprimet e sipërcituara janë në kundërshtim me Ligjin nr. 22/2018, datë 3.5.2018, “Për strehimin social”, neni 19.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi: - **z. M. D**, në cilësinë e Kryetarit të Bashkisë Librazhd (për rastin 1); - **z. K. B**, në cilësinë e drejtorit të DPZHT (për rastin 1); - **z. E. Gj**, në cilësinë e përgjegjësit të DPZHT (për rastin 1); - **zj. A. H**, në cilësinë e specialistes pranë DPZHT (për rastin 1);

**Lidhur me objektet dhe gjetjet e mësipërme, me shkresën e protokolluar në KLSH me nr. 407/6 prot; datë 01.10.2025, është observuar nga funksionarët e Bashkisë Librazhd dhe DPZHT, Bashkia Librazhd, me anë të shkresës nr. 6651 prot; datë 29.09.2025, si më poshtë vijon:**

**1.1 Pretendimi i subjektit:**

*Në lidhje me konstatimin për sipërfaqet ndërtimore që duhet të kalojnë në funksion të strehimit social, Bashkia Librazhd ka paraqitur një komunikim zyrtar nëpërmjet emailit me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit. Në këtë email, të datës 04.12.2024, ndër të tjera, theksohet se çështja është në proces shqyrtimi me qëllim arritjen e një marrëveshjeje, si dhe është planifikuar që të realizohet para procesit të pajisjes me certifikatë përdorimi. Ministria e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nëpërmjet përgjigjes së saj të datës 04.12.2024, i ka kërkuar Bashkisë Librazhd të saktësojë llojin e sipërfaqeve ndërtimore, ose, në mungesë të kësaj, të bashkëngjisë lejen përkatëse të ndërtimit, me qëllim verifikimin dhe shqyrtimin e të dhënave përkatëse.*

**1.2 Qëndrimi i grupit të auditimit:**

Në vijim të argumentimit tuaj, sqarojmë se dokumentacioni i bashkëlidhur nga ana juaj nuk ofron informacion shtesë sa i përket konstatimit të bërë nga grupi i auditimit. Konkretisht, komunikimi zyrtar i paraqitur, ndërmjet njësisë vendore dhe Ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, nuk vërteton ekzistencën apo lidhjen formale të një akt-marrëveshjeje.

Gjithashtu, përveç këtij komunikimi, nuk është paraqitur asnjë dokument tjetër mbështetës që të provojë faktikisht përmbushjen e detyrimeve të parashikuara nga legjislacioni në fuqi në lidhje me sipërfaqet ndërtimore në funksion të strehimit social.

Për sa më sipër, **argumenti juaj nuk merret në konsideratë.**

**Konkluzion i përgjithshëm:**

**1.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit, u konstatua se në **të gjitha rastet**, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Në **3 (tre) raste** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, te j atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në **4 (katër) raste** u konstatua se dokumentet e pasurisë nuk janë ngarkuar të rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi.

**2.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **1 (një) rast**, leja e ndërtimit është miratuar në mungesë të dokumentacionit të pronësisë.

**3.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **1 (një) rast**, DPZHT nuk ka respektuar mendimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila shpreh mosdakordësi për zhvillimin e projekt-propozimit. Gjithashtu në **1 (një) rast** DPZHT, nuk ka kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Leja e ndërtimit është miratuar në heshtje, pa marrë mendim nga DV ASHK.

**4.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **1 (një) rast**, objekti i miratuara nuk respekton kondicionet urbane, lidhur me: intensitetin maksimal të lejuar, koeficientin e shfrytëzimit të territorit, lartësinë maksimale të lejuar (e matur si në numër katesh, ashtu edhe në metra), si dhe numrin minimal të vend-parkimeve.

**5.** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit nr. 22/2018, datë 3.5.2018, “Për strehimin social, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, kanë ndaj fondit publik për strehim social.

**Pika 2.7. Auditimit mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit (IMT).**

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Procesverbalet e konstatimit të kundërvajtjes;
2. Vendimet e masave administrative (gjobave);
3. Vendimet e pezullimeve të punimeve;
4. Vendimet për prishjen e ndërtimeve të kundërligjshme;
5. Planet mujore, tremujore dhe/ose vjeçare të punës;
6. Dokumentacioni i IMTV-së në lidhje me gjobat e vendosura, arkëtimet, urdhrat ekzekutivë, vendimet e gjykatës etj;
7. Dokumentacioni financiar në lidhje me kontabilizimin dhe arkëtimet e gjobave;
8. Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga IMTV dhe Drejtoria e Financës.

Nga informacioni i marrë nga Drejtoria e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e Inspektoratit Mbrojtjes të Territorit Vendor për periudhën objekt auditimi (2023-2024), rezultoi se struktura e IMTV është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, e cila ka në përbërjen e saj 3 pozicione pune, nga të cilët **1** Kryeinspektor dhe **2** inspektorë si më poshtë:

Tabela 1

Nr.	Emër Mbiemër	Pozicioni	Arsimi	Emëruar/ Kryetari	Larguar/ Kryetari	Gjendja nga 01.01.2023-31.12.2024
	Sh G	Kryeinspektor	Akademia Ushtarake/ zbulim	U.NR. 479 dt.08.09.2016	Dt.10.10.2024	√
1.	G B	-Inspektor/ -Kryeinspektor	I lartë/Mësuesi shkenca edukimi [M]	-Deri në dt. 10.10.2024 -Nga dt.10.10.2024	-	√
2.	L T	Inspektor	I mesëm/ I Përgjithshëm Orientim Shoqëror	10.02.2021	-	√
3.	A B	Inspektor	I lartë/Teknologji Informacioni [B]	01.11.2024	-	√

Burimi: Bashkia Librazhd

Nga të dhënat e pasqyruara edhe në tabelën 1, u konstatua se Njësia e IMT-së Bashkia Librazhd, nuk është krijuar me numrin e nevojshëm të personelit (inspektorëve), në kundërshtim me përcaktimet e Ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020 neni 14/1,2,3, i cili përcakton se:

Autoritetet e qeverisjes vendore sigurojnë që për kryerjen e funksioneve të përcaktuara në këtë ligj, të kenë profesionistë të kualifikuar dhe me eksperiencë pune në fushat përkatëse. Numri minimal i profesionistëve që duhet të sigurojë çdo njësi e qeverisjes vendore përcaktohet nga Këshilli i Ministrave, në bazë të numrit të popullsisë së njësisë së qeverisjes vendore, dhe është në çdo rast jo më i vogël se **6 profesionistë**.

Tabela 2

Numri sipas ligjit	Numri në strukturë	Arsim i Lartë				Arsim i Mesëm	
		Inxhinieri	Juridik	Ekonomi/ financë	Të ndryshme	Ndërtim	Përgjithshëm
≥6	3	1	-	-	2	-	1

Burimi: IMTV/Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

Gjithashtu, rezultoi se në IMT Bashkia Librazhd, para periudhës objekt auditimi dhe aktualisht, është punësuar staf që nuk plotëson kriteret e përcaktuara në nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014, i cili përcakton se:

Kryeinspektorët dhe inspektorët në nivel kombëtar dhe qeverisjeje vendore duhet të kenë arsimin e

lartë të nevojshëm profesional në fushat e drejtësisë, inxhinierisë së ndërtimit, arkitekturës, urbanistikës, konstruksionit, transportit, teknologjisë së materialeve, gjeologjisë, hidrogeologjisë dhe mjedisit.

- Inspektorët e inspektoratit ndërtimor e urbanistik në nivel bashkie/komune/qarku mund të kenë arsimin e mesëm profesional në fushën e ndërtimit.( ndryshuar me ligjin nr. 183/2014, datë 24.12.2014)

- Lidhur me strukturën organizative të IMT-së Bashkia Librazhd nga verifikimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në tabelën e mësipërme, rezultoi se: deri në 31.12 2024 njësia ka funksionuar e plotë me numrin e inspektorëve **3**(1+2), konform strukturës organizative të miratuar me Urdhrin e kryetarit nr. 02 datë 09.01.2024 “Për miratimin e strukturës/organizatës/kategoritë, nivelin e pagave/klasën e pagave për çdo pozicion të administratës së Bashkisë Librazhd dhe Njësive shpenzuese në varësi të Bashkisë Librazhd për vitin 2023/2024”.

2. Për periudhën objekt auditimi 01.01.2023 – 31.12.2024, janë ushtruar inspektime në disa subjekte, për të cilat janë mbajtur proces verbal-konstatimi dhe janë nxjerrë vendime. Në tabelat e mëposhtme pasqyrohet një informacion i përmbledhur:

Tabela 3

Nr.	Lloji i aktit	2023	2024	Trendi
1	PV/Akte kontrolli			
2	PV/Akte konstatimi	8	5	↘
3	Vendime gjobe	5	2	↘
4	Vendime pezullimi	1	1	
5	Vendime prishje	2	0	↘
6	PV ekzekutimi të prishjeve	0	0	
7	Kallëzime penale	0	0	
8	Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv	5	2	
9	Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT		1	↗
10	Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori	1	1	
11	Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori	12	12	

Tabela 3.1

Procedura të mbajtura viti 2023	Numri i akteve të mbajtura	Seria e përdorur	Përdorur	Anulluar	Vlera totale (në lekë)	Vlera e paguar (në lekë)
Proces verbal- konstatimi	8	0000036-0000043 0000001-0000002	8	0		
Vendim pezullim punimesh	1	000222	1	0		
Vendim dënim me gjobë	5		5	0		
Vendim prishje objekti		000281-000282	2	0		
<b>4</b>						
PV ekzekutim prishje objekti	0					
Kallëzime penale	po					
Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv						
Plane mujore të punës së IMTV	12					
Plane vjetore të punës së IMTV	1					

Tabela 3.2

Procedura të mbajtura viti 2024	Numri i akteve të mbajtura	Seria e përdorur	Përdorur	Anulluar/d ëmtuar	Vlera totale (në lekë)	Vlera e paguar (në lekë)
Proces verbal- konstatimi	4	0000044-0000045 0000001-0000002	4	0		
Vendim pezullim punimesh	1	000223	1	0		
Vendim dënim me gjobë	3		3	0		
Vendim prishje objekti	0	0	0	0		
<b>4</b>		<b>0</b>				
PV ekzekutim prishje objekti	0	-	-	-		
Kallëzime penale	po					
Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv						
Plane mujore të punës së IMTV	12					
Plane vjetore të punës së IMTV	1					

Burimi: IMTV Bashkia Librazhd/Punoi:Grupi i auditimit

3. Nga verifikimi i dokumentacionit të magazinës [fletë hyrje /fletë dalje] **rezultoi** si më poshtë vijon:

Tabela 4

Emërtimi	Fletë hyrje (në magazinë)			Fletë dalje (për IMTV)			Diferenca	
	Nr. datë	Nr. serie	copë	Nr. datë	Nr. serie	copë		
Proces verbal- konstatimi	E hershme	0000031-0000060	1		0000031-0000060	1	0	
Vendim dënim me gjobë			1			1	0	
Vendim prishje objekti		000261- 000290	1			000261- 000290	1	0
Vendim pezullimi		000211- 000240	1			000211- 000240	1	0
Proces verbal- konstatimi	521/ 22.05.2024	0000001-0000060	2	344/ 22.05.2024	0000001-0000060	2	0	
Vendim dënim me gjobë		0000001-0000060	2			0000001-0000060	2	0
Vendim prishje objekti		0000001-0000030	1			0000001-0000030	1	0
Vendim pezullimi		0000001-0000030	1			0000001-0000030	1	0

Burimi: DFB/Bashkia Librazhd/Punoi:Grupi i auditimit

- Nga informacioni i paraqitur në tabelën 3 [3.1 dhe 3.2], dhe nga verifikimi i dokumentacionit të magazinës [fletë hyrje /fletë dalje] **rezulton se nuk ka diferencë**;

\*se numri i akteve të mbajtura të çdo kategorie, ka ardhur në rënie nga viti në vit;

\*numri i gjobave dhe vlera e arkëtimeve ka ardhur në rritje, ndërsa vlera totale e gjobave në rënie nga viti 2023 në vitin 2024;

\*“kërkesat drejtuar gjykatës për titull ekzekutiv” janë bërë për çdo rast.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në tabelën 3 rezultoi se: gjatë periudhës audituese janë **8** Akt Konstatimi për vitin 2023 dhe **5** Akt Konstatimi për vitin 2024; Vendim gjobe **5** për vitin 2023 dhe **2** Vendim gjobe për vitin 2024; Vendim pezullimi **1** për vitin 2023 dhe **1** për vitin 2024; Vendim prishje **1** për vitin 2023 dhe **1** për vitin 2024; Procesverbal ekzekutimit të prishjeve janë 0 për vitin 2023 dhe 0 për vitin 2024;

- Lidhur me kontrollet e zhvilluara gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2024, një informacion i përmbledhur i gjobave, pasqyrohet në tabelën e mëposhtme:

Tabela 5

Nr.	Viti	Nr. Subjekte	Vlera e Gjobës	Paguar			Debitor		Realizimi %	
				Gjoba	Kamatëvonesa	Totali	Nr. Person	nr.		vlerë
1	01.01.2015-31.12.2022	11	2,370,000	2,370,000	-	2,370,000		7		0
2	01.01.2023-31.12.2023	5	1,850,000	50,000	0	50,000		4	1,800,000	2.7%
3	01.01.2024-31.12.2024	3	850,000	50,000 300,000 500,000	0 0 0	50,000 300,000 500,000	3	1		85.7%
<b>Shuma Totale</b>										

Burimi: IMTV/Bashkia Librazhd

Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën 5, rezultoi se për periudhën 01.01.2023-31.12.2023 nga inspektorët e IMTV janë penalizuar me masë administrative/gjoba **5** subjekte kundërvajtësve në vlerën totale 1,850,000 lekë, nga të cilat ka likuiduar detyrimin **1** subjekt në vlerën 50,000 lekë ose në masën **2.7%** të totalit;

Për periudhën 01.01.2024-31.12.2024 nga inspektorët e IMTV janë penalizuar me masë administrative/gjoba **3** subjekte kundërvajtësve në vlerën totale 350,000 lekë, nga të cilat ka likuiduar detyrimin **1** subjekt në vlerën 300,000 lekë (vlera principale 300,000 lekë); për vitin 2024 ka shlyer detyrimin **85.7%** e subjekteve kundërvajtësve.

Në mënyrë të detajuar paraqiten si në Aneksin 2.6.1 të PRA.

- Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe informacionit të pasqyruar në tabelën/Aneks IMT1 dhe tabelën/Aneks IMT 2, **rezultoi se gjatë vitit 2023** nga **8** kontrolle të ushtruara në terren, janë përpiluar **2** Vendime për “prishje objekti” për **2** subjekte, të cilat kanë

rezultuar pa leje të lëshuar nga DPZHKT<sup>26</sup>/Bashkia Librazhd<sup>27</sup> apo mosrespektim të kushteve dhe afateve të lejes, të cilat janë shoqëruar edhe me vendosje të masës administrative;

Gjatë vitit 2024 nga **4** kontrole të ushtruara në terren, janë përpiluar **3** Vendime për “prishje objekti” për **3** subjekte kundërvajtës, të cilët kanë rezultuar pa leje të lëshuar nga DPZHKT/Bashkia Librazhd apo mosrespektim të kushteve dhe afateve të lejes.

- Nga auditimi dhe informacioni i pasqyruar në tabelën/ Anekse rezultoi se:

\*gjatë vitit 2023 janë përpiluar **8** Proces verbale konstatimi, nga të cilët janë miratuar **5** Vendime me gjobë, **2** Vendime për prishje dhe **1** Vendim pezullimi;

\*gjatë vitit 2024 janë përpiluar **4** Proces verbale konstatimi, nga të cilët **3** Vendime me gjobë, **1** Vendim për prishje dhe **1** Vendim pezullimi;

Aktet vijuese të proces verbaleve të konstatimit janë përpiluar brenda afatit ligjor (brenda 10 ditësh) konform pikës 4 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

Lidhur me **12** aktet e mbajtura “proces verbal konstatimi”, rezultoi se janë nxjerrë vendime “masa administrative” ndaj **8** subjekteve kundërvajtësve për 8 veprime kundërvajtësve, duke shmangur 4 subjekte kundërvajtësve për të cilat nuk është vendosur “masë administrative”, në kundërshtim me VKM nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;

- Nga auditimi i proces verbaleve të konstatimit, informacionin e detajuar të mangësive të konstatuara në përshkrimin e kundërvajtjes, e pasqyrojmë si në tabelën më poshtë:

Tabela nr6

Mungesa e Elementëve specifik të kundërvajtjes	Destinacioni/funksioni i objektit pa leje (banesë apo aktivitet, etj)	Materiali përbërës	Përmasat e objektit	Faza e ndërtimit në objekt	Nr. i elementeve të kundërvajtjes në çdo akt
Numri i serisë së proces verbalit të konstatimit	0000036	0000036	0000036	0000036	4
	0000037		0000037		2
	0000039	0000039	0000039	0000039	4
		0000040	0000040		2
	0000041	0000041			2
	0000042		0000042		2
				0000043	1
	0000044	0000044	0000044		3
				0000001	1
	0000002		0000002	3	
	0000045	0000045	0000045	4	
<b>Numri total i rasteve</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	<b>8</b>	<b>6</b>	

Burimi: IMTV/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi i procesverbaleve të akt konstatimeve si dhe informacionit të pasqyruar në tabelën nr. 8, rezultoi se nga **12** akte të përpiluara: në **8** raste në përshkrimin e kundërvajtjes nuk është dhënë informacion i saktë dhe i plotë mbi destinacionin/funksionin e objektit pa leje; në **6** raste nuk është dhënë informacion mbi materialin e përdorur në objektin kundërvajtës; në **8** raste nuk janë dhënë përmasat e plota të objektit; në **6** raste nuk është dhënë faza e ndërtimit në të cilën është objekti, duke cenuar klasifikimin dhe vlerësimin objektiv të kundërvajtjes, në kundërshtim me VKM 894/2015 datë 14.11.2014 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 4,

<sup>26</sup> Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe e Koordinimit

<sup>27</sup> VKM NR. 408/2015 “Rregullore e zhvillimit të territorit”, neni 6, neni 7 dhe neni 11 përcaktojnë rastet specifike të secilës kategori: punime pa leje ndërtimi, me deklaratë paraprake dhe me leje ndërtimi.

pika 7; VKM nr. 408/2015 datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit” Kreu I neni 6, 7 dhe Kreu II neni 11.

- Gjithashtu referuar përshkrimin të kundërvajtjes, **u konstatua se** mangësitë e mësipërme të konstatuara në procesverbalet e akt konstatimeve, kanë sjellë mangësi cilësore pasi vlera e masës së gjobës, nuk është vendosur konform përcaktimeve të ligjit nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e), është ndryshuar si më poshtë:

*e) kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 35,000 (tridhjetë e pesë mijë) lekë për metër katror kur ndërtimi bëhet për qëllime fitimi dhe me....*

Referuar informacionit në tabelën nr. 8 masa e gjobës e caktuar 500,000 lekë është masë e cila jo në çdo rast është mbështetur në ligj, pasi me ndryshimet e cituara më sipër, masa e gjobës përlllogaritet sipas vlerës së punimeve të kryera pa leje, dhe në çdo rast kur kemi të bëjmë me ndërtim për qëllime fitimi, masa e gjobës është jo më pak se 35,000 lekë për metër katror.

▪ Lidhur me këto mangësi, grupi i auditimit ka sqaruar në hyrje të këtij akt konstatimi, se do duhej që në stafin e IMT-së të kishte staf të kualifikuar, sidomos me profil inxhinierik/teknik, pasi me ndryshimet e ligjit nuk kemi më tarifa fikse gjobe në vlerë të përcaktuar sipas rasteve, por kërkohet analizë e situatës, ekspertizë dhe staf i kualifikuar për të nxjerrë përlllogaritjet dhe vendosur masën e gjobës në përputhje me dispozitat ligjore.

4. Nga kontrolli i dokumentacionit për periudhën objekt auditimi [2023-2024], **rezultoi se** nga IMT Bashkia Librazhd nuk janë bërë kallëzime penale ndaj subjekteve që kanë kryer punime ndërtimore pa leje, por janë bërë nga Policia si bashkëpunëtorë në zbatimin e procedurave për ndërtimet e kundërligjshme, konform nenit 4 dhe nenit 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar; VKM nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”.

## **II. Auditimi mbi ekzekutimin e vendimeve të IMTV-së; Për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative dhe procedura e ndjekur për vendimet e gjobave të pa arkëtuara nga IMTV:**

1. Nga **12** subjektet kundërvajtësve në total, për 8 subjektet të cilëve iu është vendosur “masë administrative” [5 për vitin 2023 dhe 3 për vitin 2024], nga IMT janë dërguar praktikat në Gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv si dhe informacion i detajuar për DFB të Bashkisë për kontabilizimin e tyre;

- Për **12** subjektet e inspektuara për të cilat janë mbajtur procesverbal i Akt konstatimit, **u konstatua se** është përpiluar Vendim “prishje objekti” vetëm për **3** subjekte, në kundërshtim me kuadrin ligjor: nenin 4 dhe nenin 5 germa (dh) të ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar; VKM nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, dhe vendim “pezullim punimesh” për **2** subjekte.

Në objektet e vendosura për shembje, nuk është ekzekutuar asnjë vendim nga ana e IMT-së me apo pa bashkëpunim me IKMT-në.

Nga verifikimi i dokumentacionit të dosjeve sipas tabelës 11 **rezulton se** praktika dokumentare nuk ishte e plotë, mungesa e fotove të objekteve gjatë përpilimit të Proces verbalit të Akt konstatimit, rezultoi në të gjitha dosjet.

- Kryeinspektori i IMT-së çdo 6 mujor i kërkon informacion zyrtar të detajuar 6 Njësive Administrative. Nga auditimi **rezultoi se** nga ana e NJA jo në çdo rast është kthyer përgjigje, në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 66 “detyrat e administratës së Njësive administrative” pika b.

2. Mbi komunikimin dhe raportimin, rezultoi se IMT bashkia Librazhd ka njoftuar zyrtarisht IKMT dhe IRMT Elbasan konform akteve ligjore në fuqi, si në tabelën më poshtë:

Tabela 7

Institucioni	3 mujori I	3 mujori II	3 mujori III	3 mujori IV
IKMT 2023	-	Nr. 3975/1 dt.26.06.2024	-	-
2024	-	-	-	-
	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>
IRMT Elbasan 2023	-	Nr.4602 dt. 04.07.2023	-	-
2024	Nr. 2029/1 dt.29.04.2024	-	-	-
	<b>1</b>	<b>0</b>	<b>0</b>	<b>0</b>

Burimi: IMTV/Bashkia Librazhd/Punoi: Grupi i auditimit

Nga auditimi dhe informacionit të pasqyruar në tabelën 9, u konstatua se IMT Bashkia Librazhd, nuk ka raportuar rregullisht konform kërkesave ligjore, në kundërshtim me ligjin nr. 9780/2007 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar<sup>28</sup>, neni 5 pika f ku citohet:

*Inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore, përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni*

3. Nga auditimi i dokumentacionit fizik të komunikimit mes IMT Bashkia Librazhd dhe IKMT dhe IKMT Rajonale Elbasan, gjatë periudhës 01.01.2023-31.12.2024, u konstatua se në asnjë rast nuk është paraqitur kërkesë për vënie në dispozicion të mjeteve për ekzekutimin e “vendimeve për prishje”, në kundërshtim me kuadrin ligjor në fuqi.

- Nga ana e IMT, nisur nga vonesat e IKMT për ekzekutim të vendimeve dhe pasojat përveçse ligjore e financiare por edhe sociale që sjell, nuk rezulton të jetë paraqitur në kërkesat buxhetore vjetore si nevojë imediate pajisjen e IMT-së Bashkia Librazhd (blerje) me mjetet dhe makineritë e duhura të cilat shërbejnë për prishjen e objekteve, pra për ekzekutimin e vendimeve për “prishje objekti pa leje”;

- Në kërkesat për nevojat buxhetore, është kërkuar vetëm pajisja me kancelari. Mungesa e një mjeti në përdorim vetëm të IMT-së, ka ndikuar në numrin e ulët të inspektimeve të realizuara, duke sjellë mospërmbushje të objektivave të saj dhe të Bashkisë në shërbim dhe në dobi të komunitetit, në moszbatim të Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 3 “Misioni i vetëqeverisjes vendore”;

4. Nga kontrolli i dokumentacionit dhe nga komunikimi verbal, rezultoi se:

- Nga 2 vendimet “për prishje objekti” sipas tabelës 7, rezultoi se nuk është ekzekutuar asnjë vendim. Nga komunikimi verbal, IMTV u shpreh se mungesa e mjeteve ka qenë pengesa kryesore për ekzekutimin e tyre.

Nga auditimi u konstatua se:

\*IMT Bashkia Librazhd nuk ka paraqitur në Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit kërkesë të dokumentuar për blerjen e një mjeti në funksion të veprimtarisë së kësaj strukture;

\*IMT Bashkia Librazhd nuk i ka kërkuar IKMT dhe IKMT Rajonale Elbasan bashkëpunim për vënie në dispozicion të mjeteve dhe makinerive në ekzekutimin e vendimeve “për prishje objekti”, në kundërshtim me ligjin nr. 9780/2015 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar neni 4.

U konstatua se nisur nga mosveprimet e IMT-së Bashkia Librazhd mbi ekzekutimin e vendimeve “për prishje” dhe pasojat përveçse ligjore e financiare por edhe sociale që sjell, rezulton të mos jetë planifikuar në PBA 2023-2025 dhe PBA 2024-2026 fonde për blerjen e mjeteve dhe makinerive specifike. Pajisja e IMT-së me mjetet e nevojshme (fadroma) do të sillte rritje të efektivitetit në aktivitetin e IMT-së nga njëra anë dhe besueshmërinë e

<sup>28</sup> ndryshuar me ligjin nr. 10240, datë 25.2.2010; nr.10 323, datë 23.9.2010; nr. 23/2013, datë 14.2.2013; nr. 183/2014, datë 24.12.2014 etj

komunitetit tek veprimtaria e bashkisë, në zbatim të Ligjit nr. 139 /2015 “Për vetëqeverisjen vendore” neni 3 “Misioni i vetëqeverisjes vendore”.

5. Me mosangazhimin e IKMT për ekzekutimin e vendimeve të marra nga IMT, është krijuar një periudhë e gjatë kohore inaktive. Nga ana e IMT-së për këtë periudhë, **u konstatua se** nuk është ushtruar ri-inspektim në objektet me “vendim prishje” në moszbatim të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 1/b/iii;

- gjithashtu nga IMT ka mungesë komunikimi me ASHK-në sipas kërkesave të kuadrit ligjor, mbi objektet (godina) të konstatuara dhe që i janë nënshtruar masave sipas kuadrit ligjor për aktivitetin e IMT-së. Kjo situatë e krijuar sjell rrezikun e përfshirjes së këtyre objekteve në proces legalizimi.

- Lidhur me konstatimet e mësipërme, çdo subjekti kundërvajtës i është krijuar një dosje me gjithë praktikën e ndjekur: proces verbale, vendime, etj., **u konstatua se** mungesa e fotove të objekteve që janë në kundërvajtje, ka bërë që praktika dokumentare e administruar nga IMT të jetë jo e plotë dhe me mungesë informacioni të qenësishëm, në moszbatim të kërkesave ligjore, duke rrisur rregullshmërinë e procedurës (masa administrative/gjyqësore) së ndjekur nga IMT.

6. Nga auditimi **rezultoi se** nuk ka një sistem elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga IMT, për një bashkëpunim dhe administrimin me efektivitet të informacionit nga IKMT, Drejtoria e Taksave e Tarifave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit, Koordinimit, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve njerëzore. Në mungesë edhe të mjeteve dhe makinerive të IMT-së Bashkia Librazhd, ky sistem do të bënte të mundur marrjen në kohë reale të informacionit, hartimin e një plani efektiv nga IKMT për të monitoruar apo ekzekutuar sipas rastit brenda një periudhe të afërt kohore vendimet e IMT-së.

7. Për periudhën 01.01.2023-31.12.2024 nuk rezulton që nga IKMT të jetë ushtruar inspektim apo kontroll për efektivitetin e IMT-së së Bashkisë Librazhd.

Ushtrimin e inspektimit IKMT-së ia atribuon kuadri ligjor: ligji nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet pa leje” i ndryshuar, neni 9 germa b; VKM nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 9.

8. Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, **rezultoi se** nga k/inspektori për periudhën objekt auditimi 2023–2024, janë hartuar në fillim vitit plani vjetor për vitet 2023 dhe 2024 të miratuar edhe nga kryetari i bashkisë me nr. 932 prot., datë 20.02.2024. **U konstatua se** ky plan nuk është i zbërthyer sipas çdo muaji si dhe nuk është shoqëruar me grafikun e inspektimeve hartuar mbi zonat, njësitë administrative apo fshatrat mbi të cilët do të ushtrohet kontrolli. Mungesa e një plani konkret, ku të përshkruhen qartë objektivat, kriteret dhe me një analizë të mirëfilltë të risqeve me të cilët mund të përballet IMT e Bashkisë Librazhd, cenon efektivitetin e IMT gjatë ushtrimit të veprimtarisë funksionale që i atribuon ligji;

- Referuar planit vjetor u kërkua informacion dokumentar mbi monitorimin e zbatimit të tij. Informacioni i përpunuar nga auditimi, **rezultoi si** në tabelën/Aneks IMT3.

Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion dhe pasqyruar në tabelën /Aneks IMT 3, rezultoi se k/inspektori për periudhën objekt auditimi, ka hartuar në fillim viti planin vjetor për vitet 2023 dhe 2024 të miratuar edhe nga kryetari i bashkisë. **U konstatua se** Planet vjetore dhe mujore janë të njëjta dhe me përshkrim të përgjithshëm, pa pasqyruar një grafik të hartuar mbi zonat, njësitë administrative apo fshatrat mbi të cilët do të ushtrohet kontrolli. Mungesa e një plani konkret, ku të përshkruhen qartë objektivat, kriteret dhe me një analizë të mirëfilltë të risqeve me të cilët mund të përballet IMT e Bashkisë Librazhd, cenon efektivitetin e IMT-së gjatë ushtrimit të veprimtarisë funksionale që i atribuon ligji.

Aktiviteti i IMT-së Bashkia Librazhd për periudhën 2022-2024 pasqyrohet si në tabelën më poshtë:

<i>Në lekë</i>	2015-2022	Viti 2023	Viti 2024	Σ
Numri total i gjobave		8	5	
Vlera totale		1,850,000		
Vlera e paguar		50,000	300,000	
Vlera e mbetur(debia)	2,370,000	1,800,000	500,000	
Numri i mbetur	17	4	1	22

Burimi: IMT/Bashkia Librazhd

9. Nga kontrolli, verifikimi i dokumentacionit dhe komunikimi verbal *rezultoi* se vjelja e gjobave për vendimet e marra nga IMT Bashkia Librazhd, në rastet e mospagimit vullnetar nga subjekti i kundërligjshëm janë dërguar në Gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv, nga IMT Bashkia Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike/ Sektori Juridik. Për periudhën në auditim 2023-2024 *rezultoi se* nuk ka patur asnjë vendim të zbardhur nga Gjykata.

- Me miratimin e ligjit nr. 127 datë 19.12.2024 “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 01 Janar 2015 deri më 30 Nëntor 2024 nga Inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit, Inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit, Autoriteti kombëtar i ushqimit, Inspektorati shtetëror shëndetësor, si dhe Policia e shtetit dhe ajo bashkiake”, nga IMT Bashkia Librazhd është përpiluar lista e subjekteve kundërvajtësve debitorë ndaj bashkisë nga IMT, në zbatim edhe të VKM nr. 274 datë 09.05.2025 “Për përcaktimin e procedurave që ndiqen për shfuqizimin e masave administrative të paekzekutuara”.

Lista e përpiluar është në *tabelën/Aneks IMT 4*, nga ku *rezultoi se* për periudhën 2015-2024 janë 22 subjekte kundërvajtës debitor me vlerën totale 4,670,000 lekë, e kontabilizuar, por e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë.

### III Auditimi mbi procedurat e ndjekura nga IMTV lidhur me zbatueshmërinë e kushteve të lejeve të ndërtimit si dhe bashkëveprimi me Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit dhe Koordinimit

1. Nga kontrolli i dokumentacionit, rezultoi se janë ushtruar nga k/inspektori/ët inspektime në objektet e pajisura me leje ndërtimi, dhe vetëm për ato subjekte që kanë rezultuar në kundërvajtje janë përpiluar “proces verbale konstatimi”, **u konstatua** se:

- Për subjektet e tjera nuk janë përpiluar akte kontrolli apo procesverbale, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;

- Nuk ka një regjistër ku të regjistrohen inspektimet ditore që realizohen nga inspektorët e IMTV, duke mos lënë gjurmë mbi veprimtarinë ditore të secilit inspektor. Kjo ka sjellë mungesën e gjurmës së auditimit në kundërshtim me ligjin nr. 10296/2011 “Mbi Menaxhimin financiar dhe kontrollin” i përditësuar dhe Manualin e MFK, Komponenti III “Aktivitetet e kontrollit”-Gjurmët e auditimit.

- Ndihet e nevojshme të sqarohet se në mungesë të stafit të kualifikuar tekniko- inxhinierik, ky kontroll do ishte i pamundur, pasi punonjësit nuk kanë kualifikimin sipas ligjit për të kryer akte inspektimi/ kontrolli në objektet që kanë leje ndërtimi. Kjo vërtetohet edhe nga fakti i mbajtjes së proces verbalit të konstatimit vetëm për “shkelje afati”, “shkelje të kushteve të lejes” apo “ndërtim pa leje” pra konstatim i karakterit ligjor, pa përllogaritur masën apo volumin e punimeve të kryera, mbi të cilën do të llogaritej edhe masa administrative (vlera)

- Mungesa e një mjeti në përdorim të IMTV ka ndikuar në numrin e ulët të inspektimeve të realizuara, duke sjellë mospërbushje të objektivave të saj dhe të Bashkisë në shërbim dhe në dobi të komunitetit.

*Konkluzion:* Nga auditimi, rezulton se IMT Bashkia Librazhd gjatë periudhës në auditim, nuk ka përbushur detyrimet e përcaktuara në ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe

mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” etj. Mangësitë e trajtuara në këtë akt konstatim tregojnë se IMTV nuk jep garanci për një kontroll me efektivitet të territorit që mbulon.

### **Për sa më lart, ngarkohen me përgjegjësi:**

**1. Kryeinspektori Sh G** (deri në dt. 10.10.2024) dhe kryeinspektori **G B** (nga dt. 10.10.2024 e në vijim), për mosveprime ose veprime të pjesshme në moszbatim të detyrave të tyre funksionale të përcaktuara:

- VKM nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, pika 1/b,c; pika 2,pika 3, pika 4, pika 5, pika 6, pika 7 etj;

-Rregullore e Brendshme e bashkisë.

**2. Inspektorët: G B** (deri në dt. 10.10.2024), **L T dhe A B** (nga dt. 01.11.2024 e në vijim), për mosveprime apo veprime të pjesshme në moszbatim të detyrave të tyre funksionale të përcaktuara:

- VKM nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, pika 1/b,c; pika 2,pika 3, pika 4, pika 5, etj;

-Rregullore e Brendshme e bashkisë.

### **Pika 2.8. Auditimi mbi “Zbatimin të rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm”.**

Nga KLSH, me shkresën nr. 32/8 prot., datë 09.05.2024 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin e Financiar dhe të Përputhshmërisë të ushtruar në Bashkinë Librazhd”, sipas Programit të Auditimit nr. 32/1 prot., datë 10.01.2024, janë rekomanduar për zbatim:

- **35** “Masa organizative”, nga të cilat: **14** rekomandime nga auditimi i fundit dhe **21** rekomandime të rikërkuara nga auditimet e mëparshme;

- **5** “Masa shpërblim dëmi”, nga të cilat. **2** rekomandime nga auditimi i fundit dhe **3** rekomandime të rikërkuara nga auditimet e mëparshme;

- **2** “Për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike”, të rikërkuara nga auditimet e mëparshme;

- **4** “Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia”,

- **1 (një)** “Masa disiplinore” për 4 punonjës të Bashkisë Librazhd;

- **2** “Masa Administrative”.

Nga KLSH, me shkresën nr. 854/25 prot., datë 14.10.2024 “Dërgohet Raporti Përfundimtar dhe Rekomandimet për Auditimin Tematik(Pasqyra Financiare) të ushtruar në Bashkinë Librazhd”, me, sipas Programit të Auditimit nr. 854/4 prot., datë 24.06.2024, janë rekomanduar për zbatim:

-7 “Masa organizative”;

-1 “Të ardhura të munguara”

-1 “Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia”.

Në vijim, në mënyrë të përmbledhur janë paraqitur rekomandimet e lëna nga KLSH, referuar auditimeve të mëparshme, sipas Programit të Auditimit nr. 32/1, datë 10.01.2024 dhe Programit nr. 854/4, datë 24.06.2024:

Lloji i masës	Propozuar	Pranuar	Zbatuar	Pjesërisht	Proces	Pazbatuar
Organizative	21	21	8	1	7	5
Shpërblim dëmi	5	5	-	-	3	2
EEE	2	2	-	1	1	-
Të Ardhura	1	1	-	-	-	1
Disiplinore	1	1	-	-	-	1
Administrative	2	2	-	1	-	1
<b>Totali</b>	<b>32</b>	<b>32</b>	<b>8</b>	<b>3</b>	<b>11</b>	<b>10</b>

### **Nga auditimi ka rezultuar se:**

Në lidhje me hartimin e “Plan veprimt për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga KLSH” dhe dërgimin e tij në KLSH, ka rezultuar se subjekti i audituar ka kthyer përgjigje me shkresën me nr. 32/11 prot., datë 03.06.2024 dhe shkresën nr. 854/29 prot., datë 31.10.2024, **brenda afatit 20 ditore** nga marrja e RPA, sipas nenit 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, germa (j).

Gjithashtu, në zbatim të nenit 30 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”, pika 2, subjekti i audituar ka kthyer përgjigje mbi ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6-mujor, nga marrja e Raportit Përfundimtar të Auditimit me shkresën nr. 32/12 prot., datë 18.12.2024 për sa i përket auditimit të kryer sipas programit nr. 32/1, datë 10.01.2024, por nuk ka kthyer përgjigje për sa i përket auditimit të kryer sipas programit nr. 854/4 prot., datë 24.06.2024

### **Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.**

#### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për menaxhimin financiar dhe kontrollin e brendshëm, u konstatua se ka mangësi në njohjen dhe zbatimin e pesë komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si më poshtë vijon:

-Konstatohet se përbërja e GMS nuk është në përputhje me kuadrin rregullator të fushës, pasi nuk janë miratuar si anëtar të GMS të gjithë menaxherët e nivelit të lartë.

- Nuk ka programe të trajnimit për zhvillimin profesional të stafit.

- Për vitin 2023 nuk ka pasur plan-veprimi për MFK.

- Rregullorja e brendshme e bashkisë nuk reflekton plotësisht ndryshimet në strukturën e bashkisë. Në raste të caktuara detyrat nuk janë të qarta dhe të plota.

- Në Bashkinë Librazhd nuk është hartuar “Harta e proceseve të punës”.

- Nuk është hartuar strategjia e menaxhimit të riskut.

- Nuk dokumentohet monitorimi i risqeve nga çdo drejtues pranë Bashkisë Librazhd.

- Në Bashkinë Librazhd, Sektori i Financës për mbajtjen e kontabilitetit operon me programin EXCEL dhe jo me program Kontabiliteti. Duke qenë se ka mungesa të sistemit të hedhjes të të dhënave, niveli i riskut për të gabuar është i lartë. Sektori i të Ardhurave nuk ka një sistem informatik për administrimin e taksave dhe tarifave vendore, por veprimet kryen në programin EXCEL, pra edhe këtu niveli i riskut për të gabuar/manipuluar informacionin është i lartë. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin

nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr.16, datë 20.07.2016 “Për përgjegjësitë dhe detyrat e koordinatorit të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe koordinatorit të riskut në njësitë publike”; Manuali i MFK, miratuar me Urdhrin e Ministrit të Financave nr.108, datë 17.11.2016, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/1, faqe 12-14, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**Statusi i rekomandimit:** *I pranuar.*

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i pazbatuar**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se Njësia e Auditimit të Brendshëm në planet vjetore të auditimit nuk ka programuar auditimin e fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë duke mos dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

- Në disa dosje auditimi nuk dokumentohet dhe nuk administrohet shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar.

- Konstatohet se punonjësit pjesë e NJA nuk janë të certifikuar, sipas kërkesave të neni 11, pika 2, shkronja “c” të Ligjit nr. 114/2015 datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/1.1, faqe 15-17, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*)

**2.1.Rekomandimi:** Njësia e Auditimit të Brendshëm Bashkia Librazhd, të marrë masa:

- Në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave.

- Pajisen me certifikatë të auditit të brendshëm të gjithë punonjësit të kësaj njësie me qëllimin rritjen e aftësisë profesionale të tyre.

**Statusi i rekomandimit:** *I pranuar.*

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga auditimi i pikës nr. 1 lidhur me Auditimin e Brendshëm janë marrë masa për të audituar fushat të cilat vlerësohen me risk të lartë. Për sa i përket certifikimit të punonjësve, është ende në proces.

**Rekomandimi është në proces.**

**3.Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekti auditimi, nga data 01.05.2023 deri në 31.12.2023, nga Bashkia Librazhd janë realizuar procedura me vlerë të vogël 24 procedura me vlerë fondi limit prej 12,896,183 lekë dhe vlerë kontrate 11,875,124 lekë, me një diferencë nga fondi prej 1,021,059 lekë. Nga grupi i KLSH mbi bazën e materilitet janë vlerësuar për auditim 4 procedura me fond limit 3,125,042 lekë, nga ku është konstatuar se:

- Në 4 raste urdhri i Prokurimit nuk është hartuar sipas përcaktimit ligjor.

- Në 2 raste komisioni i blerjeve të vogla nuk ka argumentuar teknikisht kriteret që ka kërkuar në ftesën për ofertë.

- Në 4 raste dokumentacioni i dorëzuar nuk është i protokolluar, me qëllim dokumentimin dhe respektimin e datës së dorëzimit, sipas kërkesës së përcaktuar në ftesën për ofertë;

- Në 1 rast nuk administrohet deklaratë garancie për mallin e prokuruar, për ti dhënë garanci autoritetit kontraktor për mallin e prokuruar;
- Në 3 raste afati i lëvrimit të mallit/realizimit të shërbimit/punës nuk është respektuar nga operatori ekonomik, si dhe nga Komisioni i blerjeve të vogla si dhe nuk janë përlloritur penalitetet. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me pikën 4 në nenin 75, pika 2 në nenin 76, neni 77, pika 2 në nenin 80 në VKM nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Pika 8 dhe pika 17 në Udhëzimin nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”. Pika 5 në Udhëzimin nr. 8 datë 01.09.2021 “Mbi hartimin e panit të zbatimit të kontratës”. Neni 32 në ligjin nr. 9902 datë 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorëve”, i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/4, faqe 36-68, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1 Rekomandimi:** Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël të marrë masa që:

- Në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlloraritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.
- Në çdo rast të mos respektimit të kushteve të kontratës (afateve), të llogariten penalitetet.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, lidhur me këtë rekomandim nga auditimi i pikës së prokurimeve me vlerë të vogël janë konstatuar në disa raste të njëjtat problematika.

**Rekomandimi është në proces.**

**4. Gjetje nga auditimi:** Për periudhën objekt auditimi nga Bashkia Librazhd janë realizuar gjithsej **31** procedura me vlerë të lartë me fond limit 224,289 mijë lekë dhe vlerë kontrate të lidhur prej 191,648 mijë lekë, më një diferencë nga fondi limit për vlerën 32,641 mijë lekë ose 14.5 % e fondit të prokuruar.

Nga auditimi i 5 procedurave prokurimit me fondin limit 208,165,932 lekë pa TVSh. u konstatua:

- Në 5 procedura, konkretisht: “Blerje fouristrade SUV për administratën e Bashkisë”, “Blerje materiale për lyerje dhe sherbetime të objekteve arsimore me Bashki dhe Njësitë Administrative”, “Ndërtim i shkollës së Mesme Polis + Palestër, Nj. Adm. Polis Bashkia Librazhd”, “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara” dhe tenderin me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Fshatit Kokreve faza e I-rë, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”, rezulton se në dokumentet standarde të tenderit nuk është argumentuar plotësisht vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe se këto kriterë nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Mungon argumentimi apo përlloraritja për nevojën e fuqisë punëtore apo makinerive sipas zërave e volumeve të punimeve.
- Në 4 procedura me fond limit 205,249 mijë lekë pa TVSh, konkretisht: “Blerje materiale për lyerje dhe sherbetime të objekteve arsimore me Bashki dhe Njësitë Administrative”, “Ndërtim i shkollës së Mesme Polis + Palestër, Nj. Adm. Polis Bashkia Librazhd”, “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara” dhe tenderin me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Fshatit Kokreve faza e I-rë, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”, OE të shpallur fitues nuk kanë plotësuar kriteret e DST të miratuara nga AK Bashkia Librazhd. KVO në vlerësimin e ofertuesve është mjaftuar vetëm me vetëdeklaratën e operatorëve mbi përmbushjen e kriterëve e cila ngarkohet në sistem dhe nuk janë marrë me verifikimin e dokumentacionit fizik nëse përputhet me formularin e vetëdeklarimit ose jo.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Nenin 2, pikën 2 në nenin 3, nenin 77 dhe nenin 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”; Shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 2, pikën 4 në nenin 39, shkronjën “c” të pikës 2 në nenin 43, pikën 1 të nenit 44 dhe pikën 4 në nenin 55, pikën 2 të nenit 82, shkronja “b” në pikën 2 në nenin 93 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/4 në faqet 36-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë të gjithë masat që në dokumentet standarde të tenderit të argumentohet vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe se këto kriterë të jenë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga auditimi i pikës së prokurimeve janë hasur problematika të njëjta.

**Rekomandimi është në proces.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i vlerës progresive të detyrimeve të prapambetura raportuar në MFE, në Bashkinë Librazhd deri në datën 31.12.2023 paraqitet në vlerën 2,035,749 lekë, vlerë e cila i përket vetëm detyrimit të krijuar gjatë vitit 2023. Prej këtyre detyrimeve, vlera 698,449 lekë ka si burim financimi buxhetin e shtetit, ndërsa vlera 1,337,300 lekë, ka si burim financimi të ardhurat e veta. Detyrimi prej 1,337,300 lekë ka si arsye mungesën e fondeve buxhetore nga të ardhurat e veta të Bashkisë Librazhd dhe përbëhet tre fatura tatimore të pa likuiduara. Pra, Bashkia Librazhd gjatë vitit 2023 ka marrë angazhime buxhetore pa pasur fonde në dispozicion për vlerën 1,337,300 lekë. Krijimi i detyrimeve të reja të prapambetura gjatë një viti buxhetor sjell mos respektim të detyrimeve kontraktuale midis Bashkisë Librazhd dhe kontraktorve, me pasojë mundësinë e lindjes së detyrimeve financiare shtesë si penalitet për njësinë vendore, si dhe mbart detyrimin për vitin pas ardhës, duke rënduar buxhetin e këtij viti.

Veprimet e mësipërme janë kundërshtim me kërkesat e Udhëzimit të MFE nr.9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, pika 153-162, Rubrika - Marrja e angazhimit dhe kryerja e shpenzimeve publike, detyrimet kontraktuale midis palëve, nenin 52 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, UMF nr. 5, datë 27.02.2014 “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”, pikat 82-91 (*Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**5.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të marrë masa për eliminimin e praktikave të marrjes së angazhimeve buxhetore pa pasur fonde në dispozicion, me qëllim uljen e riskut për lindjen e detyrimeve shtesë financiare, si rezultat i mos respektimit të detyrimeve kontraktuale me kontraktorët.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Librazhd janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i zbatuar.**

**6.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi menaxhimin e asetëve (pronave), të kaluar me VKM në përdorim dhe pronësi ndaje Bashkisë Linazhd dhe Njësive administrative (ish- Komunave Orenjë, Polis, Qendër, Stebleve, Hotolisht, Lunik), rezulton se:

Sipas VKM-ve kësaj njësie vendore i janë transferuar gjithsej 4484 pasuri, si ndërtesa, pyje, kullota, toka, terrene etj., nga të cilat **1446 pasuri në pronësi dhe 2941 pasuri në përdorim.**

**Nga Bashkia Librazhd** nuk është marrë asnjë masë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave duke kryer evidentimet përkatëse në terren me qëllim hartimin e listave të përditësuara dhe dokumentacionit hartografik më pas dërgimin e tyre në zyrat e ASHK-së për pajisjen me

dokumentacion pronësie, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, neni 37, pika 1, ku përcaktohet që, “Institucionet shtetërore dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji”.

Gjithashtu u konstatua se, nuk ekziston një regjistër kontabël ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, datën e daljes në përdorim, datë e skadencës, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia, veprime këto në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30. Nga 1446 prona në pronësi janë certifikuar deri më 31.12.2023 gjithsej 228 pasuri dhe 1011 pasuri nuk janë të pajisura me titull pronësie. Ndërsa në lidhje me pronat në përdorim nuk është ndërmarrë asnjë veprim për verifikimin dhe zbatimin e procedurës për kalimin në pronësi me VKM.

Për sa trajtuar më sipër nga Bashkia Librazhd nuk janë marrë masat e duhura ligjore për regjistrimin në kontabilitet të të gjithave pronave të cilat janë transferuar sipas VKM-ve të sipërpërmendura, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 20/2020, datë 05.03.2020, “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Kreu III, pika 35 dhe Kreu II, pika 16, neni 37, pika 1, Ligjin nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, nenet 35-41, VKM nr. 510, datë 10.06.2015, “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pasurive të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu (VI) “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme” dhe Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, pikat 26-30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.3/4, faqe 33-36 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për verifikimin e të gjithë pronave të kaluar në pronësi dhe përdorim Bashkisë Librazhd, si dhe hartojë regjistrin e plotë të aktiveve, jo vetëm për ato që janë të regjistruara në kontabilitet, por edhe për aktivet të cilat momentalisht nuk janë të regjistruara në librat e kontabilitetit. Mbi bazën e evidentimit në regjistrin e aktiveve, të bëhet inventarizimi fizik i të gjitha pasurive në teren dhe për situatën e konstatuar të hartohet një raport i hollësishëm titullarit të institucionit.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i pazbatuar.**

**6.2.Rekomandimi:** Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, për pasurit e pa regjistruara, të marrin masa për përgatitjen e dosjeve me dokumentacionin e duhur tekniko-ligjor dhe regjistrimin e tyre në ASHK. Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Sektorin e Menaxhimit të Aseteve, të llogarisë në buxhetin e PBA dhe buxhetin vjetor fondet e nevojshme për regjistrimin e pasurive në pronësi dhe në përdorim të Bashkisë Librazhd.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e specialistëve të Sektorit të Menaxhimit të Pyjeve dhe Kullotave janë bërë aplikimet për pajisjen me certifikatë pronësie për fondin pyjor dhe kullësor sipas listës së inventarit.

**Rekomandimi është në proces.**

**7.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, zhvillimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në **3 (tre) raste**, projekti ndërtimor nuk është i plotë, pasi ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore, konkretisht për:

**a. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 688, datë 06.12.2023, me zhvillues Bashkia Librazhd,** me problematika si vijon: Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungon një prerje teknike dhe dy fasada teknike; Mungon planvendosja e miratuar dhe pozicionimi mbi fragmentin e hartës në gjendjen ekzistuese; Mungon raporti i auditimit të efikasitetit të energjisë, së bashku me dokumentacionin shoqërues; Mungon projekti i mbrojtjes nga zjarri, së bashku me dokumentacionin shoqërues; Mungon studimi sizmik dhe gjeologjik, së bashku me dokumentacionin shoqërues; Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) për të gjithë hartuesit e projekteve ndërtimore; Mungon relacioni teknik për projektin elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemeve të ngrohje-ftohjes; Mungojnë licencat personale profesionale të hartuesve të projektit arkitektonik, elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemeve të ngrohje-ftohjes.

**b. Leje ndërtimi miratuar me Vendim nr. 665, datë 09.10.2023, me zhvillues z. F. Rr.,** me problematika si vijon: Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në QKB; Projekti arkitektonik nuk është i plotë, pasi mungojnë detaje teknike. Fasadat teknike nuk janë të sakta, pasi janë pamje tre-dimensionale;

**c. Certifikatë përdorimi miratuar me Vendim nr. 659, datë 31.08.2023, me zhvillues z. B. A.,** me problematika si vijon: Mungon polica e sigurimit të përgjegjësisë së ndërtuesit për dëmtime të objektit të përfunduar; Mungon akti përkatës për menaxhimin e mbetjeve urbane; Mungon projekti “as-built”; Mungojnë fotografitë të objektit në të katërta orientimet; Mungojnë aktet e kontrollit sipas fazave të ndërtimit; Mungon projekti për mirëmbajtjen e objektit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika c), ç), e), ë), g); pika 1/1, nënpika iv); neni 27/1, pika 1; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), g), gj), i), j); Ligjin Nr. 124/2015, “Për efikasitetin e energjisë”, i ndryshuar, neni 16; Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 1162, datë 24.12.2020, “Për përcaktimin e procedurave dhe të afateve për pajisjen me vërtetim për riskun të subjekteve, të cilat kërkojnë të pajisen me leje zhvillimi / ndërtimi”, shtojca 2. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/5, faqe 68-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd, të marrë masa:

- Për çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose certifikatë përdorimi, të kërkojë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionin shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi.

- Përpara miratimit të lejeve të sigurohet mbi saktësinë dhe plotësinë e dokumentacionit të ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve, në përputhje me dispozitat ligjore, përpara miratimit të këtyre lejeve si: *plotësia e projektit arkitektonik dhe ndërtimor, ngarkimi në sistem i planvendosjes së miratuar, raportit të auditimit të efikasitetit të energjisë*, etj.

- Të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga auditimi i pikës së Lejeve janë hasur të njëjtat problematika.

**Rekomandimi është pa zbatuar**

**8.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **2 (dy) raste** Bashkia Librazhd dhe Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe

Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd nuk kanë kërkuar dhe respektuar mendimin e autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, veprime në kundërshtim me nenin 21 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 6, konkretisht për:

**a.** Për lejen e ndërtimit, për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023, u konstatua se nuk është kërkuar mendimi i asnjë prej autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

**b.** Për lejen e ndërtimit, për të cilën është marrë Vendimi Nr. 665, datë 09.10.2023, u konstatua se nuk është kërkuar mendimi i Agjencisë së Zhvillimit të Territorit (AZHT), Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST), Ujësjiellës-Kanalizime (UK) dhe Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE). (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/5, faqe 68-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd para miratimit të lejeve të ndërtimit të kërkojë mendimin e autoriteteve përkatëse mbi konformitetin e objektit në zhvillim në raport me kriteret, dispozitat, infrastrukturën si dhe projektet e planifikuara të këtyre autoriteteve. Gjithashtu të kërkojë dhe marrë mendim nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), mbi statusin juridik të pronave në zhvillim.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga auditimi i pikës së Lejeve janë hasur të njëjtat problematika.

**Rekomandimi është pa zbatuar**

**9.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd ka miratuar një leje ndërtimi në mungesë të lejes së zhvillimit. Më konkretisht, kjo anomali është konstatuar në procedurën e miratimit të lejes së ndërtimit për ndërtimin e shkollës së mesme ‘Polis’ dhe ndërtim palestere, me adresë në fshatin Polis, me zhvillues Bashkia Librazhd, për të cilën është marrë Vendimi nr. 688, datë 06.12.2023, me problematika si vijon: Në zbatim të nenit 9 të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, dokumenti i lejes së zhvillimit i paraprin lëshimit të lejes së ndërtimit për ndërtime të reja nga autoritetet vendore dhe përmban nivel prone apo grup pronash. Gjithashtu, për njësinë strukturore në të cilën zhvillohet objekti, nuk ka parashikim për hartimin e Planit të Detajuar Vendor. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/5, faqe 68-73 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**9.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit, Zhvillimit dhe Mbrojtjes së Territorit (DPZHMT), Bashkia Librazhd të miratojë lejet e ndërtimit shoqëruar me lejet e zhvillimit ose Planet e Detajuara Vendore për njësitë strukturore ku ndodhet parcela në zhvillim.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Librazhd janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i zbatuar**

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi veprimtarinë e Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor (IMTV), u konstatua se:

- Struktura ka funksionuar me punonjës të cilët nuk plotësojnë kriteret lidhur me formimin arsimor.

- Janë mbajtur 7 procesverbale konstatimi nga të cilat janë nxjerrë 5 vendime për gjoba, 1 vendim për pezullimin e punimeve dhe 2 vendime për prishjen e objekteve të ndërtuara pa leje,

por rezulton se nuk ka marrë apo pasqyruar asnjë masë apo procesverbal për ekzekutimin e vendimit të prishjes së këtyre ndërtimeve.

- Nuk disponohet asnjë akt kontrolli për objektet e ndërtuara me leje ndërtimi dhe mungon korrespondenca me Inspektoratin Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Kryeinspektori nuk ka miratuar plane mujore dhe vjetore të punës, nuk administrohen dosje për praktikatat e ndjekura nga IMTV, si dhe nuk dokumentohen me foto praktikatat e mbajtura.

- Lidhur me gjobat e vendosura nga IMTV për vitin 2023, rezulton se asnjëra prej tyre nuk është arkëtuar si dhe në 2 raste është bërë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv. Në lidhje me gjobat e vendosura për vitin 2022 janë debitorë në vlerën 850,000 lekë dhe për vitin 2023 janë debitorë në vlerën 1,850,000 lekë. Lidhur me gjobat e vendosura nga IMTV për vitin 2023, rezulton se asnjëra prej tyre nuk është arkëtuar, për dy subjekte është bërë kërkesë në gjykatë për kthimin e tyre në titull ekzekutiv si dhe në asnjë rast nuk janë aplikuar kamatat vonesat. Veprimet e mësipërme, janë në kundërshtim me Ligjin 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar, neni 4, neni 5 germa (a, b, ç, d, f), neni 11; Ligji Nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” neni 51 “Inspektimi”; neni 41 “Të drejta të tjera të inspektorit”, germa (a) të ligjit me nr. 10433, datë 16.06.2011 “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”; pika 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”; pika 2 e nenit 106 të Rregullores së Bashkisë Librazhd, miratuar me vendimin nr. 5311, datë 06.12.2019 të Titullarit. *(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/6, faqe 73-77 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**10.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin të subjekteve nën juridiksionin e saj.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i pazbatuar.**

**10.2.Rekomandimi:** Nga ana e sektorit të IMTV-së të merren masa për hartimin dhe zbatimin rigoroz të programit vjetor/mujor të inspektimit, si dhe të raportojë periodikisht sipas detyrimit ligjor pranë IKMT-së.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga ana e Bashkisë Librazhd janë miratuar vetëm programe vjetor të inspektimit si dhe janë kryer raportimet periodike në IKMT, sipas detyrimeve ligjore.

**Rekomandimi është i zbatuar**

**10.3.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe IMTV Bashkia Librazhd të marrin masa për:

- Të ndjekur procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve dhe që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV për vlerën totale 2,700,000 lekë, nga të cilat 850,000 janë për vitin 2022 dhe 1,850,000 lekë për vitin 2023.

- Të ndjekë të gjitha rastet që nuk kanë paguar gjobat brenda afatit duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatatvonesat përkatëse referuar kuadrin ligjor në fuqi.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, referuar ligjit nr. 127/2024, “Për shfuqizimin e masave administrative të vendosura nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga inspektoratet vendore të mbrojtjes së territorit, inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit, autoriteti kombëtar i ushqimit, inspektorati shtetëror shëndetësor, si dhe policia e shtetit e policia bashkiake”, ku neni 1 përcakton:

Shfuqizohen të gjitha masat administrative të pa ekzekutuara deri në hyrjen në fuqi të këtij ligji, të vendosur nga data 1 janar 2015 deri më 30 nëntor 2024 nga Inspektoratet Vendore të Mbrojtjes së Territorit.

**Rekomandimi është i zbatuar**

**11.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 316/10 prot., datë 01.09.2023, rezulton se:

Nga Bashkia Librazhd me shkresën nr. 6308 prot., datë 28.9.2023 është kthyer përgjigje në respektim të afatit 20 ditorë, referuar shkronjën (j), të nenit 15, të Ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”.

Në lidhje me zbatimin e afatit 6 mujorë, referuar pikës 2 të nenit 30, të ligjit 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, afati nuk është zbatuar nga subjekt, pasi programi i auditimit në subjekt është brenda këtij afati.

Në lidhje me zbatimin e rekomandimeve, nga verifikimi rezulton se:

a- Nga **22 masa organizative** të rekomanduara, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat janë zbatuar 3 masa, **5 masa janë zbatuar pjesërisht**, 4 masa janë në proces zbatimi dhe **10 masa nuk janë zbatuar**.

b- Nga **3 masa** shpërblim dëmi me vlerë **2,529,055 lekë**, janë pranuar 100 % nga subjekti. Nga të pranuarat **nuk janë zbatuar 3 masa me vlerë 2,529,055 lekë**.

c- Nga **4 masa** për eliminimin e efekteve negative me vlerë 100,783,441 lekë, janë pranuar 100% nga subjekti. Nga të pranuarat rezulton se 1 masë është në proces zbatimi me vlerë 96,164,783 lekë, 1 masë është zbatuar, **1 masë është zbatuar pjesërisht** me vlerë 1,635,518 lekë dhe **1 masë me vlerë 2,983,140 lekë është e pazbatuar**.

d- Nga një masë administrative, pranuar 100% **por e pazbatuar**.

e- Nga një masë disiplinore, pranuar 100% nga subjekti dhe është e **zbatuar**.

*(Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/7, faqe 77-85, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**11.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

**A. Masa organizative të lëna në auditimet e mëparshëm:**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, Drejtoret e Drejtorive dhe Përgjegjësit e Sektorëve të marrin masa për hartimin e regjistrit të riskut të secilës strukturë dhe të gjithë institucionit. Të hartohet gjurma e auditimit për veprimtaritë kryesore të institucionit, kodi etikës rregullorja për parandalimin e konflikteve të interesit.

Struktura e Burimeve Njerëzore, të evidentojnë nevojat e stafit për trajnime dhe të hartojë dhe zhvillojë programe trajnimi për ruajtjen dhe ngritjen profesionale të tij.

*Nga verifikimi rezultoi se:*

*Lidhur me rekomandimin 1.1 janë marrë masat e duhura për zbatimin e tij.*

**Rekomandimi është i zbatuar**

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Sektori i Burimeve Njerëzore, të marrin masa për plotësimin me tre punonjës të Njesisë së Auditit të Brendshëm.

-Njësia e Auditit të Brendshëm të planifikojë auditime tematike për auditimin e zbatimit të rekomandimeve të lëna më parë, si dhe të dërgojë në Drejtorinë e Përgjithshme të Harmonizimit të

Auditimit të Brendshëm pranë Ministrisë së Financave raportin vjetor të veprimtarisë audituese dhe planin strategjik.

*Nga verifikimi rezultoi se:*

*Lidhur me rekomandimin nr. 2.1, nga ana e Bashkisë Librazhd janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi duke u plotësuar struktura me 4 punonjës.*

**Rekomandimi është i zbatuar.**

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

*Nga verifikimi rezultoi se, nga auditimi i pikës së prokurimeve publike janë konstatuar të njëjtat problematika.*

**Rekomandimi është i pazbatuar.**

**7.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të kualifikimit të operatorëve ekonomik, në kushtet e mos plotësimit të kriterëve, edhe në rastet e ofertave me vlerën më të ulët.

*Nga verifikimi rezultoi se, nga auditimi i pikës së prokurimeve publike janë konstatuar të njëjtat problematika.*

**Rekomandimi është i pazbatuar.**

**8.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit, të jap miratim vetëm për lejet e ndërtimit të cilat kanë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm ligjor. Gjithashtu të vlerësohet si dokumentacion i rëndësishëm edhe policat e sigurimit për projektuesit.

*Nga verifikimi rezultoi se, nga auditimi i pikës së lejeve të ndërtimit janë konstatuar të njëjtat problematika.*

**Rekomandimi është i pazbatuar**

**9.1.Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMT-së Bashkia Librazhd, të marrë masa që për të gjitha rastet e konstatimit të ndërtimeve pa leje, ose në shkelje të saj, përveç nxjerrjes së vendimeve të gjobave, të vijohet me veprimet e mëtejshme për pezullimin e punimeve, vendimin për prishjen e tyre, deri në kallëzim penal, sipas përcaktimeve ligjore për secilin rast.

*Nga verifikimi rezultoi se:*

*Lidhur me rekomandimin 9.1 janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi.*

**Rekomandimi është i zbatuar**

**9.2.Rekomandimi:** IMT të mbajë akte kontrolli për të gjitha ndërtimet për të cilat janë dhënë lejet përkatëse, me qëllim zbatimin e ligjshmërisë së standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës, si dhe të përgatitet në mënyrë periodike çdo 3 muaj informacioni drejtuar IKMT.

*Nga verifikimi rezultoi se:*

*Lidhur me rekomandimin 9.2 janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi.*

**Rekomandimi është i zbatuar**

**9.3.Rekomandimi:** IMT Bashkia Librazhd, të hapë dosje individuale për secilën procedurë, duke shmangur praktikën e mbajtjes së dokumenteve në blloqe, si dhe të dokumentojë në çdo rast praktikën e kontrollit apo kundërvajtjes me foto të situatës së konstatuar.

*Nga verifikimi rezultoi se:*

*Lidhur me rekomandimin 9.3 janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi.*

**Rekomandimi është i zbatuar**

**9.4.Rekomandimi:** Kryeinspektori i IMT në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për hartimin e kërkesave drejtuar Gjykatës për kthimin e gjitha gjobave në titull ekzekutiv, për të shmangur kalimin e afatit dhe parashkrimin e tyre.

*Nga verifikimi rezultoi se:*

*Lidhur me rekomandimin 9.4 janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi.*

**Rekomandimi është i zbatuar**

**9.5.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masa që struktura e IMT të përbëhet nga punonjës të cilët plotësojnë kriteret e formimit arsimor, sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi.

*Nga verifikimi rezultoi se:*

*Nga auditimi i pikës se IMT janë hasur të njëjtat problematika.*

***Rekomandimi është në proces.***

**10.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të kërkojë nga mbikëqyrësit e punimeve plotësimin e dosjes teknike për objektet në zbatim, hap pas hapi dhe konform kërkesave ligjore.

*Nga verifikimi rezultoi se:*

*Lidhur me rekomandimin 10.1 janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi.*

***Rekomandimi është i zbatuar***

**10.2.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të kërkojnë mbulimin e tubacionit tek mbikalimi i përroit, para përfundimit të periudhës së riparimit të defekteve.

*Nga verifikimi rezultoi se lidhur me rekomandimin nr. 10.2 nga ana e Bashkisë Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

***Rekomandimi është i pazbatuar.***

**11.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të marrë masat që me specialistë të fushës të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, si dhe për krijimin e regjistrit të aseteve.

*Nga verifikimi rezultoi se lidhur me rekomandimin nr. 10.1 nga ana e Bashkisë Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

***Rekomandimi është i pazbatuar.***

**11.2.Rekomandimi:** Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, të marrë masa dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin duhur për regjistrim në ASHK të aseteve. Drejtorisë së Financës të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

*Nga verifikimi rezultoi se lidhur me rekomandimin nr. 10.2 nga ana e Bashkisë Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

***Rekomandimi është i pazbatuar.***

**14.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 4193 Prot, datë 10.10.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon:

**14.1/1.1 Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore në zbatim të procedurave për rekrutimin e punonjësve, të marrin masa për plotësimin me 3 punonjës të Njësisë së AB, siç është miratuar dhe në strukturën organizative të bashkisë.

*Nga verifikimi rezultoi se lidhur me rekomandimin nr. 14.1/1.1, nga ana e Bashkisë Librazhd janë marrë masa për zbatimin e këtij rekomandimi duke u plotësuar struktura me 4 punonjës.*

***Rekomandimi është i zbatuar.***

**14.1/1.2. Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm të kryejë një planifikim të auditimeve duke marrë në konsideratë frekuencën e kryerjes të auditimeve, të realizojë auditime në fusha me risk të lartë dhe të thelluara, të realizojë të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB dhe të përfshijë në programet e angazhimit si drejtim vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm.

*Nga verifikimi rezultoi se nga Bashkia Librazhd janë marrë masat për zbatimin e këtij rekomandimi.*

***Rekomandimi është i zbatuar***

**14.1/2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrimin në ASHK Drejtoria Elbasan dhe nëpërmjet Drejtorisë së Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar të përlllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetimin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

*Nga verifikimi rezultoi se nga Bashkia Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.*

***Rekomandimi është i pazbatuar***

**14.1/1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 976,500 lekë pa TVSH nga bashkimi i OE “K” SHPK & “L VII” & “Ko 2” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.469 prot datë 20.10.2020, me objekt “Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Nga verifikimi rezultoi se lidhur me rekomandimin nr. 14.1/1.1, nga ana e Bashkisë Librazhd është bërë njoftimi për likuidimin vullnetare të detyrimeve në vlerën 976,500 lekë për subjektin BOE “K” SHPK & L VII SHPK & K 2007 SHPK. Me shkresën nr. 1805 prot., datë 01.04.2025, Bashkia Librazhd ka bërë Kërkesëpadi me objekt “Detyrimin e palës së paditur të kthej shumën prej 976,500 lekësh për procedurën “Rikonstruksion i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh dhe Dorez, Bashkia Librazhd”.*

**Rekomandimi është në proces.**

**14.1/2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **126,560 lekë** pa TVSH nga BOE “M” SHPK & “Sh” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.2106 prot datë 08.04.2021, me objekt “Ndërtim miniparku i qytetit pranë Argjinaturës së Lumit Shkumbin” (Faza II dhe faza III), Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njërive vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Nga verifikimi rezultoi se lidhur me rekomandimin nr. 14.1/2.1, nga ana e Bashkisë Librazhd me shkresën nr.5940/5, datë 15.09.2023 është bërë njoftimi për likuidimin vullnetare të detyrimeve në vlerën 126,560 lekë për subjektin BOE “M dhe Sh” SHPK. Me shkresën nr. 1798 prot., datë 01.04.2025, Bashkia Librazhd ka bërë Kërkesëpadi me objekt “Detyrimin e palës së paditur të kthej shumën prej 126,560 lekësh për procedurën “Ndërtim miniparku i qytetit pranë argjinaturës së lumit Shkumbin”.*

**Rekomandimi është në proces.**

**14.1/1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftim vlerësimet tatimore për debitorët duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në fund të periudhës në vlerën **85,373,491 lekë**.

*Nga verifikimi rezulton se lidhur me rekomandimin nr. 14.1/1.1, nga ana e Bashkisë Librazhd janë marrë masat për nxjerrjen e njoftimeve për debitorët.*

**Rekomandimi është në proces.**

#### **B. Masa Për Shpërblim Dëmi:**

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masat për zbritjen e vlerës 1,032,834 lekë, nga garancia e punimeve kontraktorit, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike, si dhe referencë e gabuar e çmimit për një zë punimi.

*Nga verifikimi rezultoi se lidhur me rekomandimin nr. 1.1, nga ana e Bashkisë Librazhd me shkresën nr. 5940/3 është bërë njoftimi për likuidimin vullnetare të detyrimeve në vlerën 1,032,834 lekë për BOE “M dhe Sh SHPK”. Me shkresën nr. 1785 prot., datë 01.04.2025, Bashkia Librazhd ka bërë Kërkesëpadi me objekt “Detyrimin e palës së paditur të kthej shumën prej 1,032,834 lekësh për procedurën “Ndërtimi i ujësjellësit të fshatit Pulis Gostimë, Nj.A Pulis, Bashkia Librazhd”.*

**Rekomandimi është në proces.**

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës 1,079,976 lekë, nga vlera e sigurimit të kontratës, kontraktorit BOE “E” SHPK dhe “L K” SHPK”, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike.

*Nga verifikimi rezultoi se lidhur me rekomandimin nr. 3.1, nga ana e Bashkisë Librazhd me shkresën nr. 5940/1, datë 15.09.2023 është bërë njoftimi për likuidimin vullnetare të detyrimeve në vlerën 1,079,976 lekë për BOE “E” Shpk dhe “L K” ShPK”. Me shkresën nr. 1812 port., datë 02.04.2025, Bashkia Librazhd ka bërë Kërkesëpadi me objekt “Detyrimin e palës së paditur të kthej shumën prej 1,079,976 lekësh për procedurën “Ndërtimi i parkut qendror, Bashkia Librazhd”.*

**Rekomandimi është në proces.**

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës 416,245 lekë, nga vlera e sigurimit të kontratës Kontraktorit “A-A Co” SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në sasinë e raportuar.

*Nga verifikimi rezultoi se:*

*Lidhur me rekomandimin nr. 3.1, nga ana e Bashkisë Librazhd me shkresën nr. 5940/2 është bërë njoftimi për likuidimin vullnetare të detyrimeve në vlerën 416,245 lekë për OE “A-A Co”. Me shkresën nr. 1832 port., datë 02.04.2025, Bashkia Librazhd ka bërë Kërkesëpadi me objekt “Detyrimin e palës së paditur të kthej shumën prej 416,245 lekësh për procedurën “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”.*

**Rekomandimi është në proces.**

**C. Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficence dhe efektivitet të fondeve publike:**

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Drejtoria e të Ardhurave, të marrin masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 13 subjektet debitor, sipas të dhënave në aneksin nr. 2, bashkëlidhur raportit të auditimit, të vlerës së qirasë prej **2,983,140 lekë**, si rezultat i mos pagesave të plota të detyrimeve kontraktuale në kontratat për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjor.

*Nga verifikimi rezultoi se, nga vlera debitorë prej 2,983,140 lekësh e marrjes së shfrytëzimit të fondit pyjor janë likuiduar 2,911,686 lekë dhe kanë mbetur për tu likuiduar 71,454 lekë.*

***Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.***

**3.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 1,635,518 lekë ndaj subjektit L H, për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

*Nga verifikimi rezultoi se, për subjektin z. L. H. nga llogaritja gabim e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit është bërë njoftimi zyrtar për detyrimin në vlerën 1,635,518 leke dhe procedura e masave shtrënguese ,por nuk është arkëtuar detyrimi që ka ndaj Bashkisë Librazhd .*

*Njoftimet janë bere sipas shkresave Nr. .4549 Prot , date 03.07.2023 “Njoftim për pagese dhe fature për arkëtim sipas rekomandimit të lënë nga KISH –ja”. me shkresë Nr. .6470 Prot , date 05.10.2023 “ridërgim njoftimi për pagese” ,shkresë Nr. 6467 Prot , date 05.10.2023 Njoftim*

*vlerësimi për detyrimin e papaguar si procedure e masave shtrënguese , si dhe bllokim llogarie bankare me Nr. 4074/1 , date 27.08.2024, vënie barre sigurie Nr. 4129 Prot , date 30.08.2024, kërkesë për mase bllokimi pasurie te drejtave pronësore ne QKB Nr. 4113 Prot , date 29.08.2024, vendosje barre hipotekore NR 4112 Prot , date 29.08.2024 .*

***Rekomandimi është proces zbatimi***

**D. Masa administrative**

-Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin 12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Librazhd**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga:

- Shoqëria “N S” me përfaqësues ligjor z. E. N., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Pulis Gostimë, Njësia Administrative Pulis, Bashkia Librazhd”, “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd, faza e parë” dhe “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, lidhur me rekomandimet e rikerkuara situata është si mëposhtëm:

- 9 rekomandime janë të zbatuar;
- 8 rekomandime janë të pazbatuara;
- 1 rekomandim është i pjesërisht i zbatuar;
- 6 rekomandime janë në proces zbatimi.

***Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.***

**Gjatë procesit të auditimit u konstatua përsëritje e problematikave të mëparshme, për të cilat ishin dhënë rekomandime që rezultojnë ende të pazbatuara ose pjesërisht të pazbatuar etj . Me qëllim unifikimin dhe rritjen e efektivitetit të ndjekjes së masave korrigjuese,**

**rekomandimet e përsëritura do të konsiderohen në një të vetme dhe do të rikërkohen në mënyrë të centralizuar në vijim të këtij raporti.**

**B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Plane Nj. Ad. Pulis”, Bashkia Librazhd, me vlerë të kontratës (me TVSh) 21,296,088 lekë, realizuar nga OE “B-N” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 224,115 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1424 port., datë 16.03.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe OE “B-N” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/4, faqe 36-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **224,115 lekë pa TVSh** nga OE “B-N” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1424 port datë 16.03.2023, me objekt “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Plane Nj. Ad. Pulis”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i pazbatuar.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rikonstrukcion i rrugëve Mirakë Gjovaç, Nj. Ad. Pulis”, Bashkia Librazhd, me vlerë të kontratës (me TVSh) 46,800,089.4 lekë, realizuar nga BOE “A-A CO” ShPK & “Z K” SHPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 138,800 lekë pa TVSh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 1967 port datë 11.04.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe BOE “A-A CO” ShPK & “Z K” SHPK. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/4, faqe 36-68 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **138,800 lekë pa TVSh** nga BOE “A-A CO” ShPK & “Z K” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1967 prot datë 11.04.2023, me objekt “Rikonstrukcion i rrugëve Mirakë Gjovaç, Nj. Ad. Polis”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i pazbatuar**

**C. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA**

**1.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi masat e marra nga DTTV Bashkia Librazhd për arkëtimin e taksës të ndikimit në infrastrukturë nga objektet informale për familjet dhe bizneset, rezulton se deri në datën 31.12.2023, nuk kanë paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë nga legalizimet, **213** persona me vlerë **9,049 mijë lekë**, nga e cila: detyrimi prej 6,373 mijë lekë nga debitorët familjare dhe detyrimi prej 2,675 mijë lekë nga debitorët me destinacion biznesi. Për debitorët e taksës së ndikimit në infrastrukturë nga Bashkia Librazhd nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve pasi janë nxjerrë vetëm njoftim

vlerësimet për detyrimin dhe nuk është vijuar masa të tjera shtrënguese, veprime në kundërshtim me kreun 11 të Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar të Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008, Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për taksën e ndërtimeve informale në vlerë **9,049 mijë lekë**, sipas listës paraqitur në aneksin nr.3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, në lidhje me vlerën debitore 9.049 mijë lekë deri në vitin 31.12.2023, gjatë vitit 2024 janë arkëtuar 1,442 mijë lekë dhe si rjedhje mbeten për t'u paguar 7.607 mijë lekë.

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**

**2.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se deri në datën 31.12.2023 janë debitorë për taksat dhe tarifata vendore në vlerën 83,713,560 lekë, e cila përbëhet:

- vlera prej 23,731,228 lekë nga 91 subjekte debitor të biznesit të madh.
- vlera prej 14,606,819 lekë nga 283 subjekte debitor të biznesit të vogël.
- vlera prej 3,029,351 lekë nga 66 ndërtesa social ekonomike.
- vlera prej 42,346,162 lekë nga taksapaguesit familjare qytet dhe ne njësite administrative. Vetëm për vitin 2023, vlera e detyrimeve të pa arkëtuar për taksat dhe tarifata vendore është 19,894,582 lekë, ose 21.44% e totalit të detyrimeve progresive. Kjo vlerë përbëhet nga detyrimi prej 7,256,268 lekë nga 58 subjekte debitor të biznesit të madh, detyrimi prej 2,441,949 lekë, nga 132 subjekte debitor të biznesit të vogël, detyrimi prej 745,539 lekë nga 62 ndërtesa social ekonomike, detyrimi prej 1,445,103 lekë nga 18 raste për taksën e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet e legalizuara, detyrimi prej 1,409,973 lekë nga 202 familjarët në qytet taksapaguesit familjar, detyrimi prej 6,595,750 lekë nga 4473 familjarët në gjashtë njësite administrative taksapaguesit familjar.

Nga auditimi u konstatua se për debitorët nga Bashkia Librazhd nuk janë marrë masa të plota për arkëtimin e debitorëve, por janë mjaftuar vetëm me njoftim vlerësimet për detyrimin dhe asnjë masë tjetër, veprime të cilat bien në kundërshtim me kreun 11 të Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të papaguar të Ligjit Nr. 9920 datë 19.5.2008, Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Librazhd të angazhohet gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifata vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit për eliminimin e vlerës së detyrimeve prej 83,713,560 lekë.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, për vlerën debitorë 31.12.2023 për vlerën 83,713,560 lekë janë marre masat shtrënguese si njoftim vlerësimi për detyrimet e prapambetura , bllokim llogarie tek bankat e nivelit te dyte , vënie sekuestro , barre sigurie ,etj. dhe efekti i mbledhjes se te ardhurave si me poshtë ;

Biznesi madh 91 subjekte ne vlerën 23,731,228 leke ,kane paguar 38 subjekte ne vlerën 7,562,703 leke

Biznesi vogël 283 subjekte me vlerën 14,66,89 leke , kane paguar 74 subjekte ne vlerën 2,631,322 leke .

Ndërtesa social ekonomike me një nr. 66 me vlere 3,029,351 lekë, kane paguar 25 subjekte ne vlerën 566,073 lekë.

Taksapaguesit familjare qytet dhe ne njësite administrative vlera prej 42,346,162 lekë me nr. 5562 taksapaguesish , kane paguar 2026 familjare ne vlerën 3,736,928 lekë.

Ne total vlere debitorë me 31.12.2023 nga 83,713,560 leke , janë paguar 14,479,026 leke ,me 31.12.2024 gjendja debitorë është 69,216,534 leke .

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**

**3.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Librazhd rezulton se, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime ShA nuk ka mbledhur për llogari të Bashkisë Librazhd 2,819,814 lekë, ndërsa për vlerën 5,114,663 lekë është shuma e mbledhur dhe pa xhiruar për llogari të bashkisë. Vlera e arkëtuar nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime ShA gjatë vitit 2023 është 2,933,953 lekë, (xhirimet e bëra). Bashkia Librazhd gjatë vitit 2023 ka bërë sistemime për taksapagues të kategorisë të cilët përjashtohen nga taksa e ndërtesës dhe kanë lehtësira në tarifaf vendore (invalid etj.), komisione për pagesën e agjentit tatimor.

Për sa më sipër, debitorë familjare për taksa e tarifa vendore që mbeten deri 31.12.2023 nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime janë në vlerën 7,934,477 lekë (nga këto 5,114,663 lekë janë të arkëtuara dhe të pa xhiruara ndaj bashkisë dhe 2,819,814 lekë të pa arkëtuara e xhiruara nga Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime ShA, detyrime të prapambetura nga viti 2011-2023, (sipas akt- rakordimit të datës 17.01.2023 për gjendjen 31.12.2023).

Bashkia Librazhd sipas VKB si më sipër ka miratuar treguesit e planit të të ardhurave, për vitin 2023. Në mënyrë analitike planifikimi dhe realizmi i të ardhurave për taksat dhe tarifaf vendore pasqyrohen në kapitullin Anekse – **Aneksi nr.3**, tabela nr.2, bashkëlidhur raportit të auditimit.

Për vitin 2023, të ardhurat nga taksat e tarifaf vendore gjithsej, nga 169,761,000 lekë të parashikuara, janë realizuar në vlerën 151,241,560 lekë ose 89.09 %, me një mosrealizim në vlerën 18,519 mijë lekë. Veprime në kundërshtim me Ligji nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, Kreu XI “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104, Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22, Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, pika 1.3, dhe Ligji nr. 68/2017, “Për financat e qeverisjes vendore”, neni 35 “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd dhe Drejtoria e Taksave Vendore, të marrë masa për nxjerrjen e njoftimit të vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifaf vendore deri më datën 31.12.2023.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, për debitorët 31.12.2023 janë marre te gjitha masat shtrënguese si njoftim vlerësimi , bllokim llogarie bankare , vënie sekuestro , mase sigurie mjeti , bllokim te drejta pasurore sipas protokollit ,bllokim llogarie bankare me Nr. .4074/1 , date 27.08.2024, vënie barre sigurie Nr. 4129 Prot , date 30.08.2024, kërkesë për mase bllokimi pasurie te drejtave pronësore ne QKB Nr. 4113 Prot , date 29.08.2024, vendosje barre hipotekore Nr. 4112 Prot , date 29.08.2024.

**Rekomandimi është zbatuar**

**4.Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Bashkia Librazhd në lidhje me kontratat e qirave, rezultojë se:

Nga Bashkia Librazhd (Drejtoria e Pyjeve dhe Kullotave), janë lidhur gjithsej 73 kontrata me vlerë 15,565,631 lekë për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjorë kullor.

Nga të dhënat e kësaj drejtorie konstatohet se deri në fund të vitit 2023, detyrimi i pa paguar për këto kontrata është në vlerën **2,206,200 lekë kjo për 10 kontrata.**

Nga bashkia (strukturat përgjegjëse), nuk është ndërmarrë asnjë hap ligjorë për arkëtimin e vlerë së kontratave të palikujduar, veprime të cilat kanë çuar në rritjen e nivelit te debitorëve në

këtë bashki. Veprime në kundërshtim me Ligjin Nr.7850, datë 29.07.1994 “Për K.C.R.SH-në” neni 826 i tij; të VKM Nr.559 datë 29.07.2022 “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar, për veprimtari ekonomike, si për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore”; Ligjin Nr. 57/2020 “Për Pyjet”; Ligjin Nr.9693/2007“Për fondin kullor” si dhe Udhëzim Nr.1/2016 “Për rregullat, procedurat e kërkitimit, të shqyrtimit e të miratimit të kërkesave për dhënie në përdorim të fondit pyjor dhe kullor publik. (Më hollësisht trajtuar në pikën III.2/2, faqe 17-32 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**4.1.Rekomandimi:** Drejtorja e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës dhe detyrimeve për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjorë kullor në vlerë **2,206,200 lekë**, sipas listës paraqitur në aneksin nr.3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga Sektori i Pyjeve dhe Kullotave në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave të bashkisë ka marrë masa për të bërë të mundur likuidimin e detyrimeve që subjektet i kanë bashkisë. Për këtë janë lidhur akt – marrëveshje për likuidim të detyrimeve me këste dhe aktualisht shuma që mbetet debitor i subjekteve ndaj bashkisë Librazhd është **235 704 lekë** (Procedura e likuidimit është ndjekur nga Drejtorja e Tatim Taksave). Për shumën e mbetur në bashkëpunim me Drejtorinë e Taksave do të bëhet e mundur njoftimi i subjekteve për likuidimin detyrimeve.

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**

#### **D. MASA DISIPLINORE**

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) e nenit 58 “Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, neni 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, neni 11 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Librazhd të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil/ Largim nga puna”, për 4 (katër) punonjës, si më poshtë.

1. **Z. J. M**, në cilësinë e përgjegjës të sektorit pranë DPZHMT.

2. **Znj. J. B**, në cilësinë e përgjegjës të sektorit pranë DPZHMT.

3. **Znj. A. H.**, në cilësinë e spec.-Ing. Proj. pranë DPZHMT.

4. **Z. E. Gj**, në cilësinë e specialistit pranë DPZHMT.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i pazbatuar**

#### **E. PËR NJOFTIMIN E DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË SHËRBIMIT CIVIL**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër (Drejtorja e Burimeve Njerëzore e Institucionit), pasi të zbatojë procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjore për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, të ndërmarrë veprimet si më poshtë:

1. Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

2. Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 1 Komisionari për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, të Ligjit nr. 152/2013 "Për Nëpunësin Civil", të ndryshuar.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga Bashkia Librazhd nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i pazbatuar.**

#### **F. PËR MASA ADMINISTRATIVE**

Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e prokurimeve publike, në kundërshtim me nenet 3- "Parimet e përzgjedhjeje", 98- "Anulimi i një procedure", 76- "Kriteret detyruese për skualifikim" dhe 92- "Shqyrtimi i ofertave" të Ligjit nr. 162/2020, datë 23/12/2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe nenet 67- "Klasifikimi i ofertave", 82- "Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave" dhe 83- "Njoftimi i fituesit" të VKM nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, personat përgjegjës të evidentuar dhe pasqyruar Raportit Përfundimtar të Auditimit (pika 4 e Raportit Përfundimtar të Auditimit faqen 38-72).

Mbështetur në nenin 15, të Ligjit nr. 154/2012, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit"; nenin 132 të ligjin nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe shkronjat (b, c, ç) e nenin 58- "Llojet e masave disiplinore", të Ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 "Për kundërvajtjet administrative", **i rekomandojmë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë së Prokurimit Publik**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara, duke vendosur marrjen e masave administrative (dënim me gjobë) në raport me shkeljet e konstatuara, apo rekomandimin autoritetit kontraktor (për marrjen e masave disiplinore), për **11 punonjës**, si më poshtë:

**a- Në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit për hartimin e DST.**

1. **Znj. D. B**, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe i Prokurimeve.

2. **Z. B. K**, me detyrë Specialist i Sektorit të Menaxhimit të ujërave, Mjedisit dhe Mbetjeve Urbane.

3. **Znj. A. H**, me detyrë Specialist i Sektorit Projektive dhe Zbatimit të Kontratave.

4. **Z. J. M**, me detyrë Përgjegjës Sektori, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit.

**b- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin e procedurave të zhvilluara.**

1. **Z. M. G**, me detyrë Specialist, Drejtoria e Taksave Vendore dhe Tregjeve.

2. **Znj. M. M**, me detyrë Specialiste e Sektorit të Projektive dhe i Zbatimit të Kontratave.

3. **Znj. K. Ll**, me detyrë Specialist i Sektorit Juridik dhe i Prokurimeve.

4. **Znj. E. P**, me detyrë Drejtore e Arsimit dhe Kulturës.

5. **Z. Xh. B**, me detyrë Specialist i Sektorit të Projektive dhe Zbatimit të Kontratave.

6. **Z. J. M**, me detyrë Përgjegjës Sektori i Urbanistikës.

7. **Z. H. H**, me detyrë Drejtor i Bujqësisë, Administrimit të Ujitjes dhe Kullimit dhe Mjedisit.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nga APP me shkresën nr. 1242 prot., datë 07.02.2025 i është dërguar Bashkisë Librazhd, vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 "Për verifikimin e zbatimit të ligjshmërisë së procedurave të audituara", ku ka vendosur:

**1. Të dënoj me gjobë në masën 20,000 lekë secilin, z. E. H, z. G. P dhe z. I. Ç**, si persona përgjegjës për mospermbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 34 të LPP në procedura prokurimi të audituara, sipas konstatimeve në këtë vendim;

-Me shkresën nr. 1446 port., datë 12.03.2025, drejtuar z. E. H. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 20,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

Me shkresën nr. 2177 port., datë 23.04.2025 është bërë kërkesëpadia për shfuqizimin e gjobës.

-Me shkresën nr. 1443 port., datë 12.03.2025, drejtuar z. G. P. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 20,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

Me shkresën nr. 2174 port., datë 23.04.2025 është bërë kërkesëpadia për shfuqizimin e gjobës.

**2. Të dënoj me gjobë në masën 80,000 lekë** secilin, znj. D. B. dhe znj. A. H, si persona përgjegjës për mospermbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 77 të LPP në procedura prokurimi të audituara, sipas konstatimeve në këtë vendim;

-Me shkresën nr. 1447 port., datë 12.03.2025, drejtuar znj. D. B. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 80,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

Me shkresën nr. 2174 port., datë 23.04.2025 është bërë kërkesëpadia për shfuqizimin e gjobës.

-Me shkresën nr. 1456 port., datë 12.03.2025, drejtuar znj. A. H. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 80,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

Me shkresën nr. 2176 port., datë 23.04.2025 është bërë kërkesëpadia për shfuqizimin e gjobës.

**3. Të dënoj me gjobë në masën 50,000 lekë**, znj. J. B. si person përgjegjës për mospermbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 77 të LPP në procedura prokurimi të audituara, sipas konstatimeve në këtë vendim;

-Me shkresën nr. 1441 port., datë 12.03.2025, drejtuar znj. J. B. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 50,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

**4. Të dënoj me gjobë në masën 70,000 lekë**, z. J. M. si person përgjegjës për mospermbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 77 dhe 92 të LPP në procedura prokurimi të audituara, sipas konstatimeve në këtë vendim;

-Me shkresën nr. 1440 port., datë 12.03.2025, drejtuar z. J. M. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 80,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

**5. Të dënoj me gjobë në masën 60,000 lekë**, znj. E P si person përgjegjës për mospermbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP në procedura prokurimi të audituara, sipas konstatimeve në këtë vendim;

Me shkresën nr. 1444 port., datë 12.03.2025, drejtuar znj. E. P. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 60,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

Me shkresën nr. 2224 port., datë 25.04.2025 është bërë kërkesëpadia për shfuqizimin e gjobës.

**6. Të dënoj me gjobë në masën 70,000 lekë** secilin, znj. K. Ll. dhe z. Xh. B, si persona përgjegjës për mospermbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP në procedura prokurimi të audituara, sipas konstatimeve në këtë vendim;

-Me shkresën nr. 1431 port., datë 12.03.2025, drejtuar z. Xh. B. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 70,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

Me shkresën nr. 2175 port., datë 25.04.2025 është bërë kërkesëpadia për shfuqizimin e gjobës.

-Me shkresën nr. 1439 port., datë 12.03.2025, drejtuar znj. K. Ll. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 70,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

Me shkresën nr. 2178 port., datë 25.04.2025 është bërë kërkesëpadia për shfuqizimin e gjobës.

**7. Të dënojmë me gjobë në masën 60,000 lekë,** z. H. H. si person përgjegjës për mospermbushje të detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP në procedura prokurimi të audituara, sipas konstatimeve në këtë vendim;

-Me shkresën nr. 1442 port., datë 12.03.2025, drejtuar z. H. H. është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën prej 60,000 lekë si person përgjegjës për mospermbushjen e detyrimit të përcaktuar në nenin 92 të LPP.

**8.T'i propozojë titullarit të AK,** marrjen e masës disiplinore ndaj z. B. K, për mangësitë e evidentuara në procedura prokurimi të audituara, sipas konstatimeve në këtë vendim.

-Me shkresën nr. 1448 port., datë 12.03.2025, drejtuar z. B. K. i është njoftuar Vendimi nr. 05, datë 07.02.2025 i APP, lidhur me masën disiplinore për mangësitë e evidentuara në procedurat e prokurimit.

Me shkresën nr. 1960 port., datë 08.04.2025 është miratuar urdhri nr. 319, datë 07.04.2025 "Për dhënie masë disiplinore Vërejtje".

**Rekomandimi është zbatuar pjesërisht.**

## **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi konstatohet se gjendja e llogarisë 4342 "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)", në fund të vitit 2023 paraqitet në vlerën 44,612,861 lekë, e cila përfaqëson llogaritë e Klasës së 4 të Pasivit të Pasqyrës Financiare të Pozicionit Financiar dhe nuk kuadron me Llogarinë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" të Pasqyrës së Performancës Financiare e cila paraqitet në shumën 2,035,749 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme", Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" i ndryshuar, pika 32. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të marrë masa për paraqitjen e saktë të vlerës së llogarisë 7206 "Financim i pritshëm nga buxheti" të Pasqyrës së Performancës Financiare, e cila paraqitet e nënvlerësuar për vlerën 42,577,112 lekë, për të dhënë një informacion kontabël të besueshëm.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezulton se lidhur më këtë rekomandim janë hartuar pasqyrat financiare të vitit 2024 të miratuara nga dega e Thesarit Librazhd. Trajtuar me hollësisht në pikën 3 të programit.

**Rekomandimi është në proces.**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se llogaritë e aktiveve afatgjatë e afatshkurtër materiale për periudhën 01.01.2022 - 31.12.2022, janë raportuar për gjendjen e tyre kontabël pa krahasuar me inventarin fizik pasi gjatë vitit nuk është kryer procesi i inventarizimit, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Kreu IV, pika 73, pika 74, të Udhëzimit të MFE nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme" i ndryshuar, Kreu III, pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, Drejtoria e Financës dhe NA të monitorojë procesin për inventarizimin fizik në fund të periudhës me qëllim krahasimin e gjendjes kontabël me gjendjen fizike dhe për diferencat e konstatuara të bëjë sistemimet në kontabilitet dhe të nxjerrë përgjegjësitë për mungesat e konstatuara.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Librazhd ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Me Urdhrin e Kryetarit ne. 929 datë 03.10.2024 dhe me nr. 4742 prot., datë 03.10.2024, janë ngritur 8 komisione për inventarizimin fizik dhe vlerësimin paraprak të aktiveve (mallra e materiale) të Bashkisë Librazhd dhe 6 Njësive Administrative

**Rekomandimi është i zbatuar.**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se sipas Formatit nr.7/B “Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)” llogaria 211 “Pyje, Plantacione” paraqitet në vlerën 4,662,464 lekë dhe llogaria 202 “Studime e kërkime” në vlerën 32,361,069 lekë. Referuar analizës së inventarit kontabël të këtyre llogarive konstatohet se, në llogarinë 211 “Pyje, Plantacione” është kontabilizuar gabim vlera prej 4,662,464 lekë për Projektin Bankës Botërore për sistemimin e Pyjeve, Kullotave e plantacioneve, që nuk i përket klasifikimit të kësaj llogarie kontabël, por i përket klasifikimit kontabël të llogarisë 202 “Studime e kërkime”, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, Kreu II pika 5, 36 dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**3.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, bazuar në dokumentet financiare e ligjore të saktësojë aktivet e hyra në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e 23 paraqitura në pasqyrat financiare dhe të bëjë sistemimet përkatëse në llogaritë 211 “Pyje, Plantacione” dhe llogarinë 202 “Studime e kërkime”.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financës ka marrë masat dhe me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit ushtrimor 2024, ka bërë sistemimin e aktivitetit me vlerë kontabël 4,662,464 lekë të regjistruar gabim në llog 211 “Pyje, Plantacione” në llog.202 Studime e kërkime”.

**Rekomandimi është i zbatuar.**

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi u konstatua se gjendja kontabël (kosto historike) e llogarisë 212 “Ndërtesa konstruksione” është e analizuar për 211 objekte (aktive) në vlerën 941,277,988 lekë dhe llogarisë 213 “Rrugë rrjete vepra ujore” është e analizuar për 378 objekte (aktive) në vlerën 3,509,000,652 lekë. Nga verifikimi analitik të këtyre llogarive rezulton se shtesat për rikonstrukcionin e tyre nuk i janë bashkuar vlerës fillestare të aktivitetit por janë trajtuar si aktive më vete. Trajtimi i tyre si aktive më vete ka ndikim në informacionin kontabël, që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, të numrit për efekt të inventarit fizik të tyre dhe të llogaritjes së amortizimit. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 28, 30, 74 dhe 85, Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, Kreu II pika 5, dhe Kreu III pika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të marrë masa për saktësimin e inventarit kontabël të llogarive 212 “Ndërtesa konstruksione” dhe 213 “Rrugë rrjete vepra

ujore”, të saktësojë vlerat e këtyre objekteve duke shtuar shpenzime për rikonstrukcionin dhe mirëmbajtjen e tyre në vite.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, Drejtorja e Financës ka marrë masat për saktësimin e vlerës së objekteve inventarë të llog.212 “Ndërtesa konstruksione” dhe llog.213 “Rrugë rrjete vepra ujore”.

**Rekomandimi është zbatuar.**

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se, nga 603 objekte inventari të pasurive të paluajtshme me kosto historike në vlerën 4,468,754,552 lekë, Bashkia Librazhd për 19 objekte disponon certifikatë pronësie dhe për 584 objekte inventari, nuk posedon titull pronësie, në kundërshtim me VKM nr. 510, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin dhe hipotekimin e të gjitha pronave të paluajtshme dhe të luajtshme”, Kreu VI “Transferimi i pasurive dhe regjistrimi i pasurive të paluajtshme”, pika 1 dhe 2. Për rrjedhojë edhe kontabilizimi i aktiveve afatgjata materiale, nuk është mbështetur në dokumentacionin e duhur, në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 me ndryshime, Kapitulli III, pika 35. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, të marrë masa të menjëhershme, që nëpërmjet strukturave të saj, të përgatisë dosjet me dokumentacionin e duhur për regjistrim në ASHK dhe nëpërmjet Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, buxhetin dhe burimet e financimit, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, Bashkia Librazhd ka marrë masat për zbatimin e rekomandimit. Me VKB nr. 107 date 27.12.2024 ka miratuar fondin prej 500,000 lekë për procedurën e aplikimit me titull pronësie në ASHK. VKB është konfirmuar për ligjshmërinë nga Prefekti i Qarkut Elbasan.

**Rekomandimi është i zbatuar.**

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi ka rezultuar se vlera e aktiveve e paraqitur në Pasqyrën e Pozicionit Financiar, nuk paraqet “vlerën reale” të tyre, pasi nga ana e Bashkisë Librazhd, nuk është ndërmarrë asnjë procedurë rivlerësimi ndaj tyre, bazuar në SKK 5 “Aktivet afatgjata materiale dhe aktivet afatgjata jomateriale”, Paragrafi “Trajtimet kontabël për aktivet afatgjata materiale”, pika 23-32 “Modeli i rivlerësimit”. Vlerat fillestare, apo kostot historike të këtyre aktiveve rezultojnë sipas çmimeve të blerjes si dhe kostove të tjera të drejtpërdrejta, në periudhat përkatëse të krijimit, të cilat referuar inventarit të llogarisë 212 “Ndërtesa dhe konstruksione” për 27 objekte (ndërtesa qendra shëndetësore, shkolla, etj.) variojnë nga 1,000 lekë deri në 99,000 lekë. Kjo situatë ka sjellë që vlera e aktiveve të nënvlerësohet. Mosveprimet në lidhje me vlerësimin e aktiveve janë në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 8, datë 09.03.2018, Kapitulli IV “Përgatitja dhe rregullat e plotësimit të pasqyrave financiare vjetore të konsoliduar”, pika 24 105 “Hapat që ndiqen për konsolidimin e pasqyrës së pozicionit financiar”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, për llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “ janë në proces vlerësimi dhe me mbylljen e pasqyrave financiare do të sistemohen.

**Rekomandimi është në proces.**

**7. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i pasqyrave financiare viti 2023, rezulton se llogaria 466 “Kreditorë për mjetet në ruajtje” është për vlerën kontabël 47,340,416 lekë e rakorduar me Degën e Thesarit. Nga analiza e kësaj llogarie, konstatohet se janë të ngurtësuar fonde për vlerën 26,383,676 lekë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e përpara, duke ju kaluar afati i garancisë, për të cilat Bashkia nuk ka kryer asnjë veprim sipas kushteve të kontratës për c’bllokimin e këtyre fondeve dhe përdorimin e tyre për interes publik. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar Kap. III, pikat 29, 30, 39, 50 dhe UKM nr. 3, datë 15.02.2011 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kap. II, pika 10. *Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Librazhd, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e më parë (vlera 26,383,676 lekë), për të cilat nuk ka dokumentacion për përfitimin e tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financës në Bashkinë Librazhd, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve përpara vitit 2021 ka bërë të mundur kontaktimin e Operatoreve që të sjellin dokumentet për vazhdimin e pagesës.

**Rekomandimi është në proces.**

### **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se në kredi të llogarisë 468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk janë përfshirë detyrimet për qira për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullësor për vlerën 2,206,200 lekë, me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të llogarive, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar Kreu II pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 13-22 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të kontabilizojë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlerën prej 2,206,200 lekë si e ardhur e munguar për detyrimet që kanë subjektet për qira për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullësor, me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj si dhe duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, nuk është marrë asnjë masë për zbatimin e këtij rekomandimi.

**Rekomandimi është i pazbatuar.**

### **D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR DEBITORËT.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi dhe analiza e llog. 468 “Debitorë të ndryshëm” rezulton se në fund të vitit 2022 paraqitet në shumën 116,726,663 lekë, ndërsa për vitin 2023 në shumën prej 115,544,560 lekë. Gjatë vitit 2023 kemi ulje të debitorëve në vlerën 1,182,103 lekë,

rezulton se nuk janë marrë masat e duhura për uljen e detyrimeve debitorë dhe rritjen e performancës në 25 arkëtimin e tyre. Veprime të cilat nuk janë në përputhje me Udhëzimi e MFE nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" kreu III pika 32, Kreu II pika 2/a, b, pika 22, me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, kreu II, neni 12, pika 3/g/gj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 1, faqe 14-31, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës në vlerën 115,544,560 lekë.

**Statusi i rekomandimit:** I pranuar.

**Koment i grupit të auditimit:** Nga verifikimi rezultoi se, Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, në bashkëpunim me Drejtorinë e të Ardhurave ka bërë përpjekje për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës.

**Rekomandimi është në proces.**

#### **IV. GJETJE REKOMANDIME.**

**Për përmirësimin e gjendjes rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:**

##### **A. MASA ORGANIZATIVE.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi rezultoi se komponentët e MFK janë të implementuara në shkallë të pa mjaftueshme, pasi në rregulloren e brendshme, rregullat apo proceset kryesore të përfshira nuk përshkruajnë me detaje proceset e punës dhe procedurat.

-Strukturat e bashkisë nuk raportojnë periodikisht, në mënyrë sistematike, risqet e identifikuar dhe aktivitetet e ndërmarra në përgjigje të risqeve. Gjithashtu risqet e brendshme nuk janë të lidhur aq shumë me planifikimin, proceset operacionale, burimet njerëzore, anën ligjore të mbikëqyrjes (ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive për punën e secilit punonjës) etj.

*Menaxhimi i Riskut* nuk funksionon mjaftueshëm. Nëpunësi Autorizues nuk ka krijuar Grupin e Menaxhimit të Riskut, d.m.th emërimin e personave përgjegjës, për krijimin e regjistrit të riskut, nuk ka një praktikë komunikimi për risqet e identifikuar dhe aktivitetet e ndërmarra në përgjigje të risqeve. nuk rezulton të jenë kryer analiza për rishikimin e risqeve nga ana e Grupit të Menaxhimit Strategjik. Gjatë hartimit të Regjistrit të Riskut, risqet e brendshme nuk lidhen shumë me planifikimin, proceset operacionale, burimet njerëzore, anën ligjore të mbikëqyrjes (ndarjen e detyrave, caktimin e përgjegjësive për punën e secilit punonjës etj.).

Aktivitetet e kontrollit nuk kuptohen mjaftueshëm, mungojnë kontrollet drejtuese, urdhra, udhëzime apo hartimi i planeve vjetore, objekti i të cilave janë përcaktimi i qartë i politikave, apo procedurave për përcaktimin e masave që duhet të merren për parandalimin e risqeve..

Mungesa e gjurmëve të auditimit, sipas strukturës së miratuar, ka sjellë një proces monitorimi jo efektiv, ndërkohë që ende nuk janë hartuar manualët e proceseve të punës, ku të jenë përcaktuar të gjithë proceset e detajuara në afate kohore dhe për persona përgjegjës për zbatimin dhe raportimin e tyre.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin Nr. 10296/2010 "Për menaxhimin Financiar dhe Kontrollin" i ndryshuar, neni 9, pika 4 shkronja (f), neni 11 pika 2, neni 16, neni 21, neni 22, neni 24 pika 1, si dhe me nenin 27, si edhe Manualit të MFK miratuar me Urdhrin

Nr.108, datë 17.11.2016, pika 2.2.6 dhe pika 3.1. (Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2.1, faqe 20-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**1.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me GMS të marrin masa për përcaktimin e përgjegjësive dhe të detyrimeve të çdo strukturë funksionale, ngritjen e sistemit të menaxhimit të riskut, planin e minimizimit të riskut. Vendosijen e një sistemi komunikimi dhe caktimin e përgjegjësive për funksionimin me efektivitet të këtyre sistemeve në të gjitha strukturat organizative të Bashkisë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi veprimtarinë e Njesisë së Auditimit të Brendshëm në Bashkinë Librazhd, rezultoi se drejtuesi i saj nuk është i çertifikuar si “Auditues i brendshëm në sektorin publik” si dhe nuk ka përvojë pune jo më pak se 3 vjet, në kundërshtim me Ligjin 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 11, pika 2. (Më hollësisht janë trajtuar në pikën 2.1, faqe 20-24 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd nëpërmjet Drejtorisë së Burimeve Njerzore të marrë masa që në strukturën e miratuar drejtuesi i Njesisë së auditit të brendshëm të ketë përvojë pune jo më pak se tre vjet si dhe çertifikimin e tij pranë Njesisë së Harmonizimit në MF.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga shqyrtimi i dokumentacionit pjesë e dosjes së prokurimit, për disa nga procedura e zhvilluara nga AK Bashkia Librazhd, kryesisht të procedurave me destinacion investime publike (objekte/rruge, etj.), rezultoi se në momentin e lidhjes së kontratës **nuk** ishin të depozituara “lejet e ndërtimi/infrastruktura”, veprim në kundërshtim me nenin 39 pika 3 të Ligjit nr. 107/2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar).

Gjithashtu, dhe **oponenca teknike** nuk rezultoi të jetë depozituar në dosjet e investimeve publike, edhe pse objekti i procedurës është një ndërtim publik apo me akses publik. Miratimi projektit të zbatimit në mungesë të një opoenence teknike përbën një risk të shtuar për kryerjen e punimeve të ndërtimit në mospërputhje me normat dhe standardet e përcaktuara në dispozitat ligjore që rregullojnë veprimtarinë e ndërtimit. Veprime në kundërshtim me pikën 1 të nenit 6, të Ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” (i ndryshuar), si dhe pikës 4 të VKM nr. 1055, datë 22.12.2010 “Për vendosjen e opoenencës teknike për projektet e veprave të ndërtimit”. (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e Titullarit të AK në asnjë rast të zhvillimit të procedurave të investimeve publike, të mos lidhë kontratën e zbatimit pa miratimin paraprak të “leje ndërtimi/infrastruktura” dhe opoenencës teknike të objektit (aty ku kërkohet).

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dosjeve të procedurave të prokurimit me vlerë të lartë, rezultoi se të gjitha dosjet e audituara nuk janë të inventarizuara dhe arkivuara, në kundërshtim me nenet 21, 58, 59 dhe 60 të normave tekniko-profesionale të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë. Fletët e dosjes, nuk janë të numëruara në çdo faqe, në kundërshtim me germën (g), të nenit 8 të Vendimit nr. 4, datë 19.6.2017 “Për miratimin e rregullave të njësuar të punës me dokumentet në autoritetet publike të RSH”.

Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara, mbartin riskun, e cënimit të transparencës në procedurat e prokurimit, si dhe të humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit, ose të çfarëdo dokumentacioni që është pjesë e procesit të prokurimit. Veprime në kundërshtim me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për

*miratimin e rregullave të PP” (i ndryshuar), neni 78, pika 2, neni 74, pika 3, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, (i ndryshuar) dhe Ligjit nr. 9154 datë 06.11.2003 “Për arkivat”; Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1. Rekomandimi:** Personi përgjegjës për procedurat e prokurimit Bashkia Librazhd, të marri masa për arkivimin e të gjitha dosjeve të procedurave të prokurimit të mbyllura në të gjitha fazat e tij.

#### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit me fond limit 464,216 mijë lekë ose 100 % e fondit të audituar (464,216 mijë lekë), janë konstatuar mangësi në specifikimet teknike dhe kriteret e aplikuar, të cilat janë të paargumentuara dhe jo të lidhura me tipologjinë e procedurës, veprime të cilat kanë çuar në mos pjesëmarrje e operatorëve ekonomik në garë dhe ose në skualifikim e operatorëve ekonomik me ofertë më të leverdishme dhe me mundësi për realizimin e kontratës, në kundërshtim me nenin 36 dhe 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), si dhe nenet 2, 40, 39 dhe 78 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, konkretisht për rastet:

**1-** Procedura me objekt: “Asfaltim i rrugës Lunik-Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik, Bashkia Librazhd”, me fond limit 54,166,663 lekë me fitues shoqërinë “P-V-K” ShPK, me ofertë 44,216,352 lekë.

**2-** Procedura me objekt: “Ndërtim i një qendre rinore ne Bashkinë Librazhd”, me fond limit 14,910,257 lekë, me fitues shoqërinë “H” ShPK, me ofertë 13,021,935 lekë.

**3-** Procedura me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe te pafavorizuara për vitin 2024”, me fond limit 38,054,282 lekë, me fitues shoqërinë “H” ShPK, me ofertë 33,961,615 lekë.

**4-** Procedura me objekt: “Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefet Dosku"Librazhd”, me fond limit 76,870,895 lekë, me fitues shoqërinë “E” ShPK, me ofertë 71,473,528 lekë.

**5-** Procedura me objekt: “Rikonstruksion i kanalit vaditës te Allanit Dorez-Gizavesh-Librazhd Qendër”, me fond limit 52,614,889 lekë, me fitues shoqërinë “R G-K” ShPK, me ofertë 47,237,866 lekë.

**6-** Procedura me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës Funarës-Zdranjsh ,Njësia Administrative Orenje ,Bashkia Librazhd”, me fond limit 75,000,000 lekë, me fitues OE “K.” ShPK, me ofertë 50,937,603 lekë.

**7-** Procedura me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Librazhd Katund faza e pare, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”, me fond limit 75,000,000 lekë, me fitues shoqëria “Z K ” ShPK, me ofertë 59,238,031 lekë.

**8-** Procedura me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan, faza e pare, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”, me fond limit 77,600,000 lekë, me fitues OE “L. Construction” ShPK, me ofertë 61,211,143 lekë. (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**5.1- Rekomandimi:** Autoriteti Kontraktor Bashkia Librazhd (Njësia e Hartimit të dokumenteve të tenderit), në procedurat e prokurimit që do të zhvillojë në vijim, gjatë përcaktimit të kërkesave, specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim, të marrë masa të argumentojë teknikisht dhe ligjërisht çdo kriter të vendosur, duke përdorur vetëm ato kriterë të cilat janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës si dhe duke i dokumentuar ato në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

#### *Në vijimësi*

**6. Gjetje nga auditimi:** Nga 8 procedura prokurimi të audituara, rezultoi se në **7 procedura** prokurimi me fond limit 389,216 mijë lekë ose 83.84 % e fondit të audituar (464,216 mijë lekë), nga anëtarët e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, janë kualifikuar dhe shpallur fitues OE në kushtet kur këta të fundit nuk kanë përmbushur të gjitha kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, në kundërshtim me Ligjin nr. 160, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, neni 92, pika 3 dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 82, pika 2, konkretisht për rastet:

**1-** Procedura me objekt: “Asfaltim i rrugës Lunik-Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik, Bashkia Librazhd”, me fond limit 54,166,663 lekë, me fitues shoqërinë “P-V-K” ShPK, me ofertë 44,216,352 lekë.

**2-** Procedura me objekt: “Ndërtim i një qendre rinore ne Bashkinë Librazhd”, me fond limit 14,910,257 lekë, me fitues shoqërinë “H” ShPK, me ofertë 13,021,935 lekë.

**3-** Procedura me objekt: “Përmirësimi i banesave ekzistuese për komunitete te varfëra dhe te pafavorizuara për vitin 2024”, me fond limit 38,054,282 lekë, me fitues shoqërinë “H” ShPK, me ofertë 33,961,615 lekë.

**4-** Procedura me objekt: “Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefet Dosku"Librazhd”, me fond limit 76,870,895 lekë, me fitues shoqërinë “E” ShPK, me ofertë 71,473,528 lekë.

**5-** Procedura me objekt: “Rikonstruksion i kanalit vaditës te Allanit Dorez-Gizavesh-Librazhd Qendër”, me fond limit 52,614,889 lekë, me fitues shoqërinë “R G-K” ShPK, me ofertë 47,237,866 lekë.

**6-** Procedura me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Librazhd Katund faza e pare, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”, me fond limit 75,000,000 lekë, me fitues shoqëria “Z K ” ShPK, me ofertë 59,238,031 lekë.

**7-** Procedura me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan, faza e pare, Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”, me fond limit 77,600,000 lekë, me fitues OE “L.C” ShPK, me ofertë 61,211,143 lekë. (Më hollësisht gjetjet janë trajtuar në pikën 2.4, faqe 87-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**6.1. Rekomandimi:** Titullari i AK Bashkia Librazhd, të marrë masa, të analizojë me grup pune të veçantë dhe të nxjerrë përgjegjësitë për kualifikimin e OE të cilët nuk plotësojnë kriteret kualifikuese të DST. Komisioni i vlerësimit të ofertave, të marrë masa në vijimsi, që gjatë fazës së vlerësimit të një procedure, duhet të vlerësojë të vlefshme dhe të kualifikojë një ofertë vetëm kur ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specififikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës, ftesën për ofertë apo dokumentet e tenderit që autoriteti kontraktor ka vlerësuar të nevojshme.

### **Menjëherë dhe në vijimësi**

**7. Gjetje nga auditimi:** Bashkia Librazhd në zbatim të përcaktimeve ligjore në fuqi për administrimin e aseteve në pronësi apo në përdorim, dhe krijimit të të ardhurave nga dhënia me qira të tyre për vitin 2024 kanë qenë të lidhura **78 kontrata/marrëveshje** për dhënien me qira të aseteve që ka në pronësi (ndërtesa, truall, toka bujqësore, qira pyjore). Këto kontrata/marrëveshje janë lidhur bazuar në legjislacionin përkatës me subjekte të ndryshëm fizik/juridik që kanë shprehur interes.

Nga auditimi u konstatua se janë gjithsej **9 subjekte** debitorë në vlerën **919,011** lekë në marrëdhëniet kontraktore me Bashkinë Librazhd, për marrjen me qira të objekteve/sipërfaqeve të ndryshme, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara në buxhetin e Bashkisë Librazhd, në kundërshtim me Kodin Civil në Republikën e Shqipërisë, nenet 826-840. Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, neni 36, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 143-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria Juridike në bashkëpunim me Drejtorinë e Pyjeve dhe Kullotave dhe Drejtorinë e Financës të marrin masa duke ndjekur të gjithë hapat ligjorë për arkëtimin e

vlerës **919,011** lekë nga **9 subjekte** qiramarrësit që nuk kanë paguar detyrimet për objektet/tokën e marrë me qira.

Në çdo rast të mospagesës së detyrimeve kontraktore të kërkojë prishjen e kontratës ose të mos nënshkruajë kontratën e re për objektet/tokën e lëshuar me qira, si dhe të llogarisë penalitetet, sipas rastit.

### *Menjëherë*

**8. Gjetje nga auditimi.** Nga auditimi mbi administrimin e pronave të Bashkisë Librazhd për periudhën objekt auditimi, rezultoi se sipas VKM-ve i janë transferuar kësaj njësie vendore, gjithsej **4,387 prona**, nga të cilat: 1,446 prona në pronësi dhe 2,941 prona në përdorim. Gjatë vitit 2024, janë bërë 81 aplikime nga të cilat, 18 janë pajisur me certifikatë pronësie. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5 faqe 143-145 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**8.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, nëpërmjet strukturave përgjegjëse të marrë të gjitha masat për evidentimin dhe regjistrimin e të gjitha pronave të kaluara me VKM në DVASHK Elbasan.

### *Menjëherë dhe në vijimësi*

**9. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit dhe certifikatave të përdorimit u konstatua se në **të gjitha rastet**, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Në **3 (tre) raste** janë konstatuar vonesa në shqyrtimin e aplikimeve, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore. Gjithashtu në **4 (katër) raste** u konstatua se dokumentet e pasurisë nuk janë ngarkuar e rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektet:

-Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H;

-Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefet Dosku”, miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024, me zhvillues Bashkia Librazhd;

-Leje ndërtimi “Agroturizëm dhe struktura të përkohshme me qëllim pushimi, shoqërore dhe veprimtari turistike e kampingje etj.”, miratuar me Vendim nr. 1542/5, datë 18.11.2024, me zhvillues S ShPK;

-Leje ndërtimi “Banesë individuale 2 kate + çati”, miratuar me Vendim nr. 2589/4, datë 08.08.2024, me zhvillues S A;

-Leje ndërtimi “Shtesë kati deri 250m2 në objekt ekzistues nr. pasurie 9/970”, miratuar me Vendim nr. 2676/5, datë 05.07.2024, me zhvillues B Ç;

-Leje ndërtimi “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024, me zhvillues H C;

-Certifikatë përdorimi “Shtëpi banimi 2 kat dhe rrethim prone”, miratuar me Vendim nr. 1193/4, datë 07.05.2024, me zhvillues H H.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika ë); neni 20; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), si dhe Vendimin nr. 8, datë 28.12.2020 të KKT-së “Për miratimin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor Bashkia Librazhd, të miratuar me vendimin nr. 10, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit ” neni 43/1; *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 146-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**9.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikim dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Librazhd, të marrë të gjitha masat, që gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi dhe certifikatë përdorimi:

- Të kërkojnë ngarkimin e plotë të dokumentacionit të detyrueshëm gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, siç janë: licenca për ushtrimin e aktivitetit, certifikata e

regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit për hartuesit e projekteve ndërtimore, oponencën teknike (kur është e detyrueshme), si dhe studimin gjeologjik dhe atë sizmologjik, të shoqëruar me projektin përkatës të mbrojtjes sizmike, etj.

- Të shqyrtojë aplikimet dhe të japin vendimet e miratimit ose refuzimit, brenda afateve të përcaktuara në dispozitat ligjore;

- Të sigurohet që gjatë shqyrtimit të aplikimit për leje ndërtimi, dokumentacioni i pronësisë të jetë i rifreskuar brenda një periudhe jo më të gjatë se tre muaj nga data e aplikimit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**10. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1(një) rast**, për objektin për të cilin është miratuar leja e ndërtimit, mungojnë dokumentet e pronësisë që vërtetojnë të drejtën e zhvilluesit mbi pasurinë përkatëse. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektin:

-Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefet Dosku”, miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024, me zhvillues Bashkia Librazhd. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b); (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 146-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**10.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit në Bashkinë Librazhd, të marrë masat e nevojshme që, gjatë shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, të sigurohet ngarkimi dhe verifikimi i dokumentacionit të pronësisë që vërteton të drejtën ligjore të zhvilluesit mbi pasurinë përkatëse, pasi ky dokumentacion është i domosdoshëm për të shmangur raste të zhvillimeve pa titull pronësie apo konflikte potenciale mbi pronën.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**11. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se DPZHT, Bashkia Librazhd, në **1 (një) rast**, nuk ka kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Rezultoi se leja e ndërtimit për objektin:

-Leje ndërtimi “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024, me zhvillues H C;, është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat rregullatorë shprehet qartësisht se informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Gjithashtu është konstatuar se në **1 (një) rast**, DPZHT, Bashkia Librazhd, nuk ka respektuar mendimin e autoriteteve të cilat janë shprehur sipas kompetencave që u njeh ligji, sipas fushës së kompetencës. Rezultoi se leja e ndërtimit për objektin:

-Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, është miratuar pa respektuar mendimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila shpreh mosdakordësi për zhvillimin e projekt-propozimit.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 146-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**11.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit dhe të Territorit, Bashkia Librazhd, në çdo rast që aplikohet për t'u pajisur me leje ndërtimi, të merren të gjitha masat për të kërkuar mendimin e Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, informacioni i cili përcillet nëpërmjet sistemit “e-lejet”, në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Gjithashtu,

të respektohet në çdo rast mendimi i autoriteteve kompetente, të cilat shprehen brenda fushës së kompetencave që u njeh ligji, në lidhje me aplikimet për leje ndërtimi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**12. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit, u konstatua se në **1 (një) rast**, objekti i miratuara **nuk respekton kondicionet urbane, lidhur me: intensitetin maksimal të lejuar, koeficientin e shfrytëzimit të territorit, lartësinë maksimale të lejuar (e matur si në numër katesh, ashtu edhe në metra), si dhe numrin minimal të vend-parkimeve.** Më konkretisht, këto shkelje u konstatuan për objektin:

-Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H.

Veprime e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 37, pika 1, nënpika c); pika 2; pika 3, nënpika b), si dhe Vendimin nr.10, datë 08.02.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, Bashkia Librazhd” i ndryshuar, neni 49, 50, 55, si dhe me përcaktimet e pasaportës së njësisë strukturore 1/202; (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 146-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**12.1 Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Librazhd, të marrë masa që, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të sigurojë respektimin e kushteve ligjore dhe urbane për zhvillim, duke verifikuar përputhshmërinë e aplikimeve të paraqitura përmes sistemit elektronik e-lejet, me kondicionet urbane të përcaktuara në Planin e Përgjithshëm Vendor dhe të miratojë vetëm ato aplikime që i respektojnë këto kondicione, në përputhje me parashikimet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**13. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të kontratës për punë publike me objekt: “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashki Librazhd”, u konstatua se, nga Autoriteti Kontraktor Bashkia Librazhd nuk është kryer **Oponencë Teknike**, veprim ky në mospërputhje me pikën 1 të nenit 6 të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me Ligjin nr. 120/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998”, me Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, neni 52, me VKM nr. 610, datë 22.9.2022 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”. (Më hollësisht trajtuar në nënpika 2.4.4 faqe 132-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**13.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masa që të pajisin me **Oponencë Teknike** për çdo projekt zbatimi, me objekt kontrollin dhe zbatimin e projektit të zbatimit, në përputhje me detyrën e projektimit, me dokumentet e planifikimit të kontrollit dhe të zhvillimit të territorit, me rregullat teknike të ndërtimit, kushtet teknike, standardet shqiptare në fuqi ose standardet evropiane kur mungojnë standardet shqiptare të përdorura në projekt, për të siguruar hartimin e projekteve të zbatimit me cilësi, dhe në përputhje me destinacionin e tyre.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**14. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i likuiditeteve dhe për “detyrimet e prapambetura”, rezultoi se kanë lindur detyrime të reja gjatë vitit 2024 në shumën 6,123,679 lekë për vitin 2025, krahas vlerës së trashëguar nga viti 2023 në shumën 2,090,550 lekë për “vendime gjyqësore” nga shpronësimet.

Bashkia Librazhd ka detyrime të prapambetura nga vitit i mbyllur ushtrimor 2024 për tu likuiduar në vitin 2025 në shumën totale 8,214,229 lekë, të ndara si më poshtë vijon:

- vlera 2,090,550 lekë për vendime gjyqësore;
- vlera 6,023,679 lekë për investime me të ardhurat e bashkisë;
- vlera 100,000 lekë për blerje mallrash me investimet e bashkisë

Vlera e detyrimeve të prapambetura sipas bilancit nuk përputhet me atë të raportuar në MF, pasi nuk është përfshirë për asnjë vit detyrimi i vendimeve gjyqësore për shpronësimet dhe të larguarit nga puna në vlerën totale 7,754,561 lekë, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 2 datë 20.01.2020 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2020”, pika 106 dhe Udhëzimin nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2 faqet 24-42 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**14.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë dhe Drejtoria e Financës dhe buxhetit, të marrin masa për hartimin e strategjive dhe regjistrit të riskut me vlerësim real të tij, për parandalimin e lindjes së detyrimeve të reja dhe monitorimit të zbatimit të kontratave për investime/shërbime/mallra; për të paguar detyrimet sipas planit të miratuar dhe raportuar në MF për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura me burim nga të ardhurat e veta në vlerën 8,214,229 lekë deri në fund të vitit 2025; për likuidimin e faturave për mallra/shërbime/investime në afat dhe sipas radhës; për të shmangur shpenzimet e panevojshme si dhe përdorimin e fondeve me efikasitet, me qëllim parandalimin e lindjes së detyrimeve të prapambetura në periudhat e ardhme.

**14.2. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe buxhetit të bëjë planifikim sa më real të fondeve të çdo programi në PBA dhe Planin vjetor buxhetor, si për likuidimin e detyrimeve të krijuara në periudhat e mëparshme brenda afatit të përcaktuar dhe sipas radhës, por edhe për të shmangur shpenzimet e panevojshme dhe përdorimin e fondeve me efektivitet, me qëllim parandalimin e krijimit të detyrimeve të reja gjatë vitit ushtrimor.

*Në vijimësi*

**15. Gjetje nga auditimi:** Nga analiza e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave për vitin 2024 referuar kuadrit ligjor mbi të ardhurat në NJVQV, u konstatua se:

#### **1. Kategoria I**

- TNI (nga legalizimet) për vitin 2024 është parashikuar në vlerën 3,000 mijë lekë dhe është realizuar 2,537 mijë lekë ose 85% e vlerës së planifikimit;
- Taksë e rentës minerare për vitin 2024 është planifikuar 368 mijë lekë dhe është vjelë 139 mijë lekë ose në masën 37.8%;

#### **2. Kategoria II**

- Tarifë e tregut të organizuar për vitin 2024 është planifikuar 1,250 mijë lekë dhe janë realizuar 1,038 mijë lekë ose në masën 83%;
- Tarifë mirëmbajtje kanale vaditës për vitin 2024 është planifikuar 370 mijë lekë dhe realizuar 252 mijë lekë ose në masën 68%;

#### **3. Kategoria III**

- Të ardhura nga tarifa në sektorin e pyjeve për vitin 2024 është planifikuar 23,000 mijë lekë dhe realizuar 15,763 mijë lekë ose në masën 68.5%;
- Të ardhura nga tarifa shfrytëzimi i materialit drusor nga subjektet për vitin 2024 është planifikuar 10,000 mijë lekë dhe realizuar 4,317 mijë lekë ose në masën 43.2%;
- Të ardhura nga tarifa shfrytëzimi i druve të zjarrit nga fshatarësia për vitin 2024 është planifikuar 5,600 mijë lekë dhe realizuar 1,565 mijë lekë ose në masën 28%;
- Të ardhura nga tarifa shfrytëzimi i prodhimeve të dyta pyjore, të tjera është planifikuar 300 mijë lekë dhe realizuar 97 mijë lekë ose në masën 32.4%;

- Të ardhura nga përdorimi vërtetimeve të transportit dok. Ankandi rap teknik etj, për vitin 2024 është planifikuar 620 mijë lekë dhe realizuar 257 mijë lekë ose në masën 58%;
- Të ardhura nga shitja e materialit drusor që dalin nga rrallimet për vitin 2024 është planifikuar 200 mijë lekë (sa edhe viti paraardhës 2023) dhe realizuar 0 lekë si dhe viti 2023;

#### **4. Kategoria IV**

- Të ardhura nga qira e shitje trualli për vitin 2024 nuk janë planifikuar vlere dhe nuk janë realizuar të ardhura, krahasuar me vitin 2023 ka një rënie të ardhurave me (-)357 mijë lekë ;
- Të ardhura nga pagesa e prindërve çerdhe për vitin 2024 është planifikuar 2,190 lekë dhe realizuar 1483 mijë lekë ose në masën 67.7%;
- Të ardhura nga pagesa e prindërve kopsht për vitin 2024 është planifikuar 7,744 mijë lekë dhe realizuar 4,857 mijë lekë ose në masën 62.7%;
- Nga detyrime të prapamb kopshte/ çerdhe/qendra ditore janë planifikuar 1,849 mijë lekë dhe realizuar 801 mijë lekë ose në masën 43.3%;

Mungesa e një analize të mirëfilltë nga ana e GMS për të ardhurat e (mos) realizuara në vitin 2023, ka sjellë mungesën e planifikimit të tyre ose planifikimin në vlere jo reale të pastuduara mbi të ardhurat e realizuara ndaj pritshmërisë për vitin 2024 e në vijim, në kundërshtim me Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 2 pika 6, neni 5/a, neni 34 pika 1/a, neni 36 pika 4/a, neni 40 pika 3/c, etj. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5, faqe 42-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**15.1 Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë, GMS, DTTV dhe Njësitë Administrative të analizojnë me vëmendje të shtuar shkaqet që kanë sjellë mosrealizimin e të ardhurave nga taksat e tarifave përkatëse sipas parashikimit vjetor, si dhe të marrin masa për hartimin e planeve strategjike e vjetor jo vetëm për rritjen e të ardhurave nga arkëtimi i detyrimit vjetor të tatimpaguesve, por edhe për minimizimin e vlerës së debisë progresive.

**15.2. Rekomandim:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, GMS në bashkëpunim me DTTV dhe gjithë strukturat e bashkisë që sigurojnë të ardhura nga aktiviteti i tyre të marrin masa:

- Për planifikim sa më real të të ardhurave, mbështetur në realizimet faktike të viteve të mëparshëm dhe në numrin e taksapaguesve, me qëllim që të zvogëlohet sa më shumë diferenca midis planifikimit dhe realizimit të të ardhurave;
- Të analizojnë të ardhurat që sigurohen nga agjentët tatimor DRSHTRR Elbasan, DPT, DPD dhe ASHK Vendore Elbasan, për të evidentuar gjendjen reale të të ardhurave që përfiton Bashkia Librazhd nga taksat që mblidhen nga këta agjentë.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**16. Gjetje nga auditimi:** Mbi plotësinë dhe saktësinë e informacionit të llogarive kontabël në pasqyrat financiare të vitit 2024 në Bashkinë Librazhd, sipas UMFE nr. 08, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njërive të Qeverisjes së Përgjithshme” i ndryshuar, u konstatua si më poshtë vijon:

- Llogaria 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” në “pasqyrën e pozicionit financiar”- format 1 dhe në “pasqyrën e performancës financiare”-format 2, paraqitet në shumën 77,753,417 lekë dhe duhet të kuadrojë me mbartjen e të ardhurave dhe transfertave të vitit 2024 për vitin 2025 sipas akt rakordimit me Degën e Thesarit, e cila është në shumën 163,879,078 lekë. Rezultoi se llogaria 85 “rezultati i veprimtarisë ushtrimore” është nënvlerësuar për shumën 86,125,661 lekë;
- Llogaria 4342 “Operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet në shumën 89,821,951 lekë dhe nuk kuadron me totalin e vlerës së grupit të llogarive të pagueshme për shumën 14,324,442 lekë, për keqklasifikim të faturave të palikuiduara në llog.467 “kreditorë të ndryshëm” por të deklaruara si detyrim i prapambetur;
- Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” paraqitet në shumën 117,171,082 lekë dhe nuk kuadron me grupin e llogarive të arkëtueshme, ku vlere e llog.468 “debitorë të ndryshëm

nuk është përfshirë në vlerën e saj të plotë, duke e nënvlerësuar llog. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” për shumën 11,583,628 lekë;

- Në llogaritë e klasës 20 “AAJM”/llogaria 202 “Studime e projekte” rezultoi se nga ana e DFB nuk janë marrë masat që për tetë projektet e hershme nga ish komunat në shumën totale 5,632 mijë lekë, të sigurohet informacioni i nevojshëm dokumentar, për të kaluar vlerën e tyre në llogaritë përkatëse të klasës 21 AAM;

- Në llogarinë 212 “Ndërtesa Konstruksione” paraqitet në shumën 559,422,867 lekë dhe rezultoi se: Për grupin e godinave të ndërtuara shumë herët, nga ana e bashkisë nuk janë ngritur komisione rivlerësimi, me qëllim pasqyrimin në vlerë reale të tyre në kontabilitet;

- Ujësjetësi në vlerën kontabël 5,199 mijë lekë, si aktiv nuk i përket llogarisë 212, por referuar Nomenklaturës së llogarive kontabël i përket llog.213 “Rrugë, rrjete, vepra ujore” dhe *nuk është transferuar* në Shoqërinë Rajonale UK Elbasan, referuar dhe në zbatim të Marrëveshjes së lidhur nga kryetarët e 6 bashkive të Qarkut Elbasan 2022;

- Llogaria 213 “rrugë, rrjete, vepra ujore” paraqitet në shumën 1,132,195,853 lekë dhe janë përfshirë 6 aktive të llojit ujësjetës në vlerën kontabël 70,025 mijë lekë, të cilët me lidhjen e marrëveshjes për krijimin e kompetencave të përbashkëta të ujësjetës kanalizimeve, duhet të ishin transferuar në SHRUK Elbasan sha dhe shkarkuar nga kontabiliteti i kësaj llogarie;

- Llogaria 214 “instalime teknike, mjete e pajisje” paraqitet në shumën 18,413,053 lekë rezultoi e *mbivlerësuar* për shumën 8,140 mijë lekë, që përbën vlerën kontabël të aktiveve të llojit “pajisje kompjuterike” që sipas Nomenklaturës së llogarive kontabël, i përket llogarisë 218 “Inventar ekonomik”;

- Llogaria 215 “mjete transporti” paraqitet në shumën 28,674,584 lekë dhe rezultoi mospërputhje mes vlerës së paraqitur në pasqyrat financiare dhe regjistrin të aktiveve për diferencën për shumën 182,962 lekë; Llogaria 215 “Mjete transporti” është *mbivlerësuar* për shumën 182,962 lekë;

- Në llog. 210, llog.211, llog. 212 dhe llog.213 nuk janë përfshirë asetet e transferuara me VKM për Bashkinë Librazhd, pasi procedurat për pajisjen e tyre me titull pronësie janë të papërfunduara nga ASHK dhe nuk është bërë rivlerësimi i atyre të pajisura me titull pronësie. U konstatua se këto asete janë të pa kontabilizuara;

- Vlera e amortizimit në llogarinë 212 “objekte e konstruksione” për vitin 2024 është *mbivlerësuar* në shumën 65,821 mijë lekë pasi është llogaritur gabim me vlerën e amortizimit 15%, duke pasqyruar të nënvlerësuar tepricën neto të aktiveve të saj;

- Llog. 26 “pjesëmarrje në kapitalin e vet” në pasqyrat financiare paraqitet pa vlerë. Referuar QKB për periudhën 1999-2022 vlera e aksioneve që Bashkia Librazhd zotëron në “UK Librazhd –Prrenjas” Sha ka qenë 240,772 mijë lekë, vlerë për të cilën llogaria 26 është e nënvlerësuar.

- Llogaria 7206 “financim i pritshëm nga buxheti” është në vlerën 6,123,679 lekë, e cila nuk kuadron me shumën e gjendjes së llogarisë kundërparti 4342 “operacione me shtetin (të drejta)”, e nënvlerësuar për 83,698,272 lekë. (*Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 66-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

**16.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës dhe Buxhetit të Bashkisë Librazhd të marrë masa për rregullimin dhe sistemimin e llogarive kontabël, duke përfshirë korigjimin e nën- dhe mbivlerësimeve, rivlerësimin e aseteve të paluajtshme, transferimin dhe çregjistrimin e aktiveve nga kontabiliteti, si dhe pasqyrimin korrekt të pjesëmarrjeve në kapital dhe financimeve buxhetore, me qëllim paraqitjen e saktë të pasqyrave financiare.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**17. Gjetje nga auditimi:** Mbi procedurën e inventarizimit të aktiveve të Bashkisë Librazhd, u konstatua si më poshtë vijon:

- Nga titullari i Bashkisë Librazhd nuk është ngritur Komisioni i Vlerësimit të aktiveve të cilësuar të dëmtuara nga komisioni i verifikimit fizik dhe vlerësimit paraprak, në kundërshtim

me Udhëzimin e MF nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar, kreu IV pika 95-99; pika 102; pika 104-106;

- Në përfundim të procedurës së inventarizimit të njësisë, nga Sektori i Financës është hartuar vetëm regjistri elektronik i aktiveve, i cili si pjesë përmbyllëse e praktikës dokumentare të procedurës së inventarizimit të njësisë, nuk është vijuar me miratimin nga Nëpunësi Autorizues, mosveprime këto në kundërshtim me kreun II, Paragrafi III, pika 26,27,28 dhe Paragrafi IV pika 81 të Udhëzimit e MF nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar;

- Nga komisioni për asgjësimin dhe tjetërsimin e aktiveve të vlerësuara të dëmtuara, nuk është bërë klasifikimi i tyre sipas procedurës që do ndiqet: për skrap, për groposje, për thyerje/djegje, në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30/2011 datë 27.11.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar, kreu IV, pika 107-112. . (Më hollësisht gjetjet trajtuar në pikën 2.3, faqe 66-86 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**17.1 Rekomandim:** Drejtoria e Financës dhe buxhetit të marrin masa për të ndjekur rigorozisht hapat e procedurës së inventarizimit të aktiveve të dokumentuar sipas kërkesave të kuadrit ligjor në fuqi;

*Në vijimësi*

**18. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi mbi regjistrin e parashikimeve dhe atë të realizimit të prokurimeve për blerje me vlerë të vogël, u konstatua se:

- Ndryshimet e bëra gjatë vitit 2024 në regjistrin e parashikimeve nuk janë shoqëruar me relacionet përkatëse, duke konkluduar se hartimi i regjistrit fillestar të planifikimit dhe ndryshimet e bëra gjatë vitit, janë si rezultat i mungesës së analizave paraprake dhe të një studimi të mirëfilltë të nevojave për mallra, shërbime e punë, në kundërshtim me VKM nr.285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 1/ pika 2, neni 3/pika 2;

- Për mallra/grup mallra dhe shërbime/grup shërbime të njëjta, janë parashikuar në 5 raste procedura me vlerë totale në tejkalim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë, në kundërshtim me nenin 11 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56 pika 11, Udhëzimi nr. 4 datë 18.06.2021 “Për hartimin e regjistrit të parashikimeve të procedurave të prokurimit publik dhe regjistrit të realizimeve të procedurave të prokurimit dhe krijimi i tyre në sistemin e prokurimit elektronik” kreu I pika 1 paragrafi 2; Udhëzimi nr.5 datë 25.06.2021 “Mbi përdorimin e procedurës me vlerë të vogël dhe zhvillimin e saj me mjete elektronike”.

- Për mallra apo mallra/shërbime me vlerë të fondit limit prej 1,000,000 lekë, është vetëm një procedurë “marrëveshje kuadër” për blerje materiale elektrike dhe hidraulike. Referuar nenin 52 e Ligjit nr. 162 dt. 23.12.2020 “Mbi prokurimin publik” i ndryshuar, u konstatua se nga ana e NJP nuk janë dhënë detaje në përshkrimin e procedurës, për të saktësuar arsyet e përzgjedhjes së procedurës së prokurimit në secilin rast, në kundërshtim me VKM nr. 285/2021 datë 21.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 2 pika 2/a,b,ç, neni 11 pika 1/c, pika 2, pika 3 dhe neni 12;

- Nga auditimi i regjistrit të procedurave BVV të realizuara në vitin 2024 u konstatua se Autoriteti Kontraktor (Bashkia Librazhd ) në cilësinë e njësisë shpenzuese publike vendore, ka kryer shpenzime me fonde publike me objekt "blerje mallra, punë dhe shërbime publike" me natyrë të njëjtë në tejkalim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë, në kundërshtim me Ligjin nr. 162 “Për prokurimin publik” i përditësuar, VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 56;

- Praktikrat e procedurave të prokurimit BVV ishin të sistemuara në dosje, por rezultuan të pa inventarizuara, në kundërshtim me VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 2;

- Komisioni i përllogaritjes së fondit limit, i përcaktimit të specifikimeve teknike, kritereve kualifikuese etj., jo në çdo rast ishin specialistë të fushës referuar tipologjisë së procedurës (mallra, shërbime apo punë), në mospërbushje cilësore të Ligjit nr. 162 datë 20.02.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 4 pika 38, neni 36, VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, neni 74 pika 2;

- Nga verifikimi i 9 dosjeve të procedurave të prokurimit BVV rezultoi se në të nëntë dosjet kishte mungesë të dokumentacionit bazë: kërkesa e njësisë, testimi i tregut nuk janë bërë në çdo rast dhe si rrjedhojë as procesverbali përmbledhës apo dhe vendimi mbi çmimin e mallit/shërbimit që do të prokurohet, në kundërshtim me nenin 4 pika 38, neni 13, neni 15, neni 36 të VKM nr. 285/2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar;

- Nga verifikimi i 9 dosjeve të procedurave të prokurimit BVV rezultoi se me Urdhër të titullarit nuk janë ngritur komisionet e marrjes në dorëzim të mallrave, shërbimeve apo punëve të prokuruar me BVV, në kundërshtim me pikat 42,43 (për NA), 52,53,54 (për NZ) të Udhëzimit nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në sektorin publik” i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4 faqe 87-132 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**18.1. Rekomandimi;** Drejtoria juridike dhe e prokurimeve, njësia e prokurimit e BVV dhe komisionet e prokurimit e BVV të marrin masa:

- Të grupojnë kërkesat për mallra e shërbime të të njëjtës natyrë në një procedurë të vetme prokurimi;

- Për çdo rast të përshkruajë arsyet e përzgjedhjes së llojit të procedurës së prokurimit me argumentet përkatëse;

- Në asnjë rast të mos zhvillohen procedura prokurimi me BVV për mallra, shërbime apo punë me natyrë dhe të të njëjtit lloj në tejkallim të vlerës limit prej 1,000,000 lekë;

- Të marrë masa për të inventarizuar dokumentacionin e dosjes së çdo praktike për procedurat e prokurimit të BVV;

- Për blerjet me procedura prokurimi BVV në çdo rast të përpilohet dokumenti justifikues që vërteton marrjen në dorëzim të aktiveve sipas kushteve të kontratës.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**19. Gjetje nga auditimi:** Mbi organizimin dhe funksionimin e IMT-së Bashkia Librazhd u konstatua se:

- Njësia e IMT-së Bashkia Librazhd ka në strukturën e saj 1 kryeinspektor dhe 2 inspektorë. Rezultoi se IMT e Bashkisë Librazhd nuk është krijuar me numrin e nevojshëm të personelit (inspektorëve), si dhe stafi i punësuar nuk plotëson kriteret ligjore, mosveprime në kundërshtim me përcaktimet e nenin 11 të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar me Ligjin nr. 183/2014; Ligjit nr. 107/2014 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar me Ligjin nr. 119/2020 neni 14/1,2,3;

- Lidhur me 12 aktet e mbajtura “proces verbal konstatimi”, rezultoi se nga IMT janë nxjerrë vendime “masa administrative” ndaj 8 subjekteve kundërvajtësi për 8 veprime kundërvajtësve, duke shmangur 4 subjekte kundërvajtës për të cilat nuk është vendosur “masë administrative”, në kundërshtim me VKM nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;

- Mbi procesverbalet e akt konstatimeve, rezultoi se nga 12 akte të përpiluara: në 8 raste në përshkrimin e kundërvajtjes nuk është dhënë informacion i saktë dhe i plotë mbi destinacionin/funksionin e objektit pa leje; në 6 raste nuk është dhënë informacion mbi materialin e përdorur në objektin kundërvajtës; në 8 raste nuk janë dhënë përmasat e plota të objektit; në 6 raste nuk është dhënë faza e ndërtimit në të cilën është objekti, duke cenuar klasifikimin dhe vlerësimin objektiv të kundërvajtjes, në kundërshtim me VKM 894/2015 datë 14.11.2014 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 4, pika 7; VKM nr. 408/2015 datë

13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së zhvillimit të territorit” Kreu I neni 6, 7 dhe Kreu II neni 11;

- Referuar përshkrimit të kundërvajtjes, mangësitë e konstatuara në procesverbalet e akt konstatimeve, kanë ndikuar në pasaktësi të vlerës së gjobës së vendosur; gjithashtu për shkak të mangësive të të dhënave në procesverbalet e akt konstatimeve nuk është e mundur të bëhet përlllogaritja e vlerës së sakt të tyre, duke rezultuar në kundërshtim me Ligjin nr. 119/2020 “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, në nenin 52, pika 1 germa (e);

- Mungesa e një sistemi elektronik për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga IMT ka zbehur bashkëpunimin dhe administrimin me efektivitet të informacionit nga IKMT, Drejtoria e Taksave e Tarifave, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit, Koordinimit, si dhe Drejtoria Juridike dhe e Menaxhimit të Burimeve njerëzore. Në mungesë edhe të mjeteve dhe makinerive të IMT-së Bashkia Librazhd, ky sistem do të bënte të mundur marrjen në kohë reale të informacionit, hartimin e një plani efektiv nga IKMT për të monitoruar apo ekzekutuar sipas rastit brenda një periudhe të afërt kohore vendimet e IMT-së;

- Për **12** subjektet e inspektuara është përpiluar Vendim “prishje objekti” vetëm për **3** subjekte, në kundërshtim me kuadrin ligjor: nenin 4 dhe nenin 5 germa (dh) të Ligjit nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit” i ndryshuar; VKM nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;

- Në periudhën 2024 në objektet e vendosura për shembje, nuk është ekzekutuar asnjë vendim nga ana e IMT-së me apo pa bashkëpunim me IKMT-në;

- Nga Kryeinspektori i IMT-së dhe Njësitë Administrative nuk ka patur komunikim të rregullt mbi mbrojtjen dhe zhvillimin e territorit të bashkisë, në kundërshtim me Ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, neni 66, pika b;

- Gjatë periudhës 2024 nga IMT e Bashkisë Librazhd nuk është raportuar rregullisht në IKMT dhe IRMT Elbasan në kundërshtim me Ligjin nr. 9780/2007 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, neni 5 pika f;

- Nga ana e IMT-së gjatë kësaj periudhe nuk është ushtruar ri-inspektim në objektet me “vendim për prishje” në moszbatim të VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” pika 1/b/iii;

- Për kontrollet e ushtruara nga k/inspektori/ët në objektet e pajisura me leje ndërtimi, vetëm për ato subjekte që kanë rezultuar në kundërvajtje janë përpiluar “proces verbale konstatimi”, veprim ky në kundërshtim me nenin 4, nenin 5 germa (a) të Ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar dhe nenin 51 të Ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, pikës 2 të VKM-së nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”;

- IMT nuk ka një regjistër ku të regjistrohen inspektimet ditore që realizohen nga inspektorët në terren, duke mos u dokumentuar veprimtaria ditore e secilit inspektor. Kjo ka sjellë mungesën e gjurmës së auditimit në kundërshtim me Ligjin nr. 10296/2011 “Mbi Menaxhimin financiar dhe kontrollin” i përditësuar dhe Manualin e MFK, Komponenti III “Aktivitetet e kontrollit”-Gjurmët e auditimit;

Mungesa e stafit të kualifikuar tekniko- inxhinierik, e bën të pamundur kryerjen e akt inspektimeve/ kontrollit në objektet me leje ndërtimi, pasi është i nevojshëm të përlllogaritet masa apo volumi i punimeve të kundërligjshme, mbi të cilën do të llogaritej edhe masa administrative. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7 faqe 158-166 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**19.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masa për forcimin e kapaciteteve të strukturës për të krijuar një strukturë të IMT-së me numër inspektorësh sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe të kualifikuar kryesisht të profilit inxhinieri, me qëllim rritjen e efektivitetit dhe cilësisë së inspektimeve për ndërtimet pa leje dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të lejeve të ndërtimit.

**19.2. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Inspektoratin e Mbrojtjes së Territorit, Drejtorinë e Buxhetit dhe Financës, Drejtorinë e Taksave e Tarifa Vendore dhe Drejtorinë Juridike e Prokurimeve, të marrin masa për regjistrimin në kohë të akteve të përpiluara nga inspektorët e IMT-së, si dhe planifikimin për pajisjen e IMT-së me mjete logjistike, për të rritur efektivitetin e veprimtarisë inspektuese në terren, si dhe për të bërë të mundur ekzekutimin në kohë të vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

**19.3. Rekomandimi:** Kryeinspektori dhe inspektorët e IMT-së të hartojnë e miratojnë plane mujore e vjetore konkrete mbështetur edhe në informacionin mbi lejet e ndërtimit të lëshuara nga Drejtoria e Planifikimit, zhvillimit të territorit; të mbajnë akte kontrolli me të gjithë elementët e nevojshëm teknik për çdo inspektim që kryejnë, si në objektet e ndërtuara pa leje dhe në objektet e pajisura me lejet përkatëse; të bëjnë një vlerësim real të masës së gjobës për kundërvajtësin, duke zbatuar ligjshmërinë e standardeve teknike në fushën e ndërtimit dhe urbanistikës; të hartojnë raporte periodike dhe vjetore mbi aktivitetin e IMT-së; si dhe t'i kushtohet vëmendje e veçantë masave për ekzekutimin në kohë të vendimeve “me gjobë” ndaj kundërvajtësve aktualë dhe arkëtimin e atyre të debitorëve historikë.

**19.4. Rekomandimi:** Njësitë Administrative të rrisin bashkëpunimin me IMT, me qëllim forcimin e aktivitetit dhe rritjen e efektivitetit të IMT-së në mbrojtjen e territorit dhe zhvillimin e tij në dobi të komunitetit.

*Menjëherë dhe në vijimësi*

**20. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i dokumentacionit mbi zbatimin e rekomandimeve përcjellë me shkresën nr. 32/8 Prot, datë 09.05.2024, rezulton se:

Nga subjekti është **respektuar afati 20 ditor** për kthimin e përgjigjes për marrjen e masave në zbatimin e rekomandimeve, përcjellë me shkresën nr. 32/11 port., datë 03.06.2024, në zbatim të shkronjës “j” të nenit 15 të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e KLSH”.

Gjithashtu, nga subjekti është **respektuar afati 6 mujorë** për të raportuar lidhur me plotësimin e përcaktimeve të ligjit nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 30, pika 2, përcjellë me shkresën nr. 32/12, datë 18.12.2024.

*- Në lidhje me verifikimin e zbatimit të rekomandimeve, kemi si vijon:*

**a.** Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar **21 masa organizative** të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar **8 masa** janë zbatuar plotësisht, **1 masë** është zbatuar pjesërisht, **7 masa** janë në proces zbatimi dhe **5 masa** janë të pa zbatuara.

**b.** Masa shpërbllim dëmi janë rekomanduar **5 masa bë vlerën 2,753,170 lekë** të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar **3 masa** janë në proces zbatimi dhe **2 masa** janë zbatuar pjesërisht.

**b.** Masa për uljen e borxhit tatimor dhe rritjen e performancës në arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia - (të ardhura të munguara) janë rekomanduar **1 masë në vlerën 2,606,200 lekë**, e cila është pranuar, dhe është e pazbatuar.

**c.** Masa për eliminimin e efekteve negative të konstatuara në administrimin e fondeve publike dhe për menaxhimin me ekonomikitet, eficientë dhe efektivitet të fondeve publike janë rekomanduar 2 masa, të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht, dhe 1 masë është në proces zbatimi.

**d.** Masa disiplinore janë rekomanduar 22 masa të cilat janë pranuar plotësisht, nga masat e pranuar 22 masa janë zbatuar.

**dh.** Masa administrative janë rekomanduar 2 masa të cilat janë pranuar, dhe nga masat e pranuar 1 masë është zbatuar pjesërisht dhe 1 masë e pazbatuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.8 faqe 166-190 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**20.1. Rekomandimi:** Bazuar në nenet 15 dhe 16, të Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksonimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, për përmirësimin e gjendjes, **Ju rikërkojmë** marrjen e masave për zbatimin e rekomandimeve që rezultuan të pazbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si dhe përsheptimin e atyre në proces zbatimi, si më poshtë:

#### **A. Masa Organizative.**

**1.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit; Hartimin dhe zhvillimin e programeve të trajnimeve për ngritjen profesionale të stafit; Vendosijen e një sistemi komunikimi që të ofrojë informacionin e duhur për të gjithë punonjësit, menaxherët e lartë dhe titullarin e njësisë.

**2.1.Rekomandimi:** Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Librazhd, të marrë masa:

- Në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullari t të njësisë publike në arritjen e objektivave.

- Pajisen me certifikatë të auditit të brendshëm të gjithë punonjësve të kësaj njësie me qëllimin rritjen e aftësisë profesionale të tyre.

**3.1 Rekomandimi:** Komisioni i Blerjeve me Vlerë të Vogël të marrë masa që:

- Në përcaktimin e kriterëve fituese të mbajë në konsideratë nxitjen e konkurrencës ndërmjet bizneseve të vogla, garantimin e cilësisë së mallrave, si dhe dokumentimin e çdo faze të procedurës së prokurimit, nga përlllogaritja e fondit limit deri tek marrja në dorëzim e mallrave/shërbimeve.

- Në çdo rast të mos respektimit të kushteve të kontratës (afateve), të llogariten penalitetet.

**4.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë të gjithë masat që në dokumentet standarde të tenderit të argumentohet vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim dhe se këto kriterë të jenë në përpjesëtim dhe të lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të ngrejë një grup pune me specialist të fushës për verifikimin e të gjithë pronave të kaluar në pronësi dhe përdorim Bashkisë Librazhd, si dhe hartojë regjistrin e plotë të aktiveve, jo vetëm për ato që janë të regjistruara në kontabilitet, por edhe për aktivet të cilat momentalisht nuk janë të regjistruara në librat e kontabilitetit. Mbi bazën e evidentimit në regjistrin e aktiveve, të bëhet inventarizimi fizik i të gjitha pasurive në teren dhe për situatën e konstatuar të hartohet një raport i hollësishëm titullarit të institucionit.

**10.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore, të marrë masa për të punësuar punonjës të kualifikuar për pozicionin e punës dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të rritur cilësinë e inspektimit dhe kontrollin të subjekteve nën juridiksionin e saj.

**6.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publike, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

**7.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të kualifikimit të operatorëve ekonomik, në kushtet e mos plotësimi të kriterëve, edhe në rastet e ofertave me vlerën më të ulët.

**10.2.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve të kërkojnë mbulimin e tubacionit tek mbikalimi i përroit, para përfundimit të periudhës së riparimit të defekteve.

**11.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të marrë masat që me specialistë të fushës të inventarizojë dhe saktësojë pronat sipas të dhënave të kontabilitetit, si dhe për krijimin e regjistrit të aseteve.

**11.2.Rekomandimi:** Sektori i Menaxhimit të Aseteve si dhe Drejtoria e Pyjeve, Kullotave dhe Mjedisit, të marrë masa dhe të përgatisë dosjet me dokumentacionin duhur për regjistrim në ASHK të aseteve. Drejtorisë së Financës të përllogaritë kostot për kryerjen e këtij shërbimi, me qëllim pajisjen sa më parë të pasurive të paluajtshme me titull pronësie.

**14.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë të analizojë situatën e moszbatimit plotësisht të rekomandimeve të dërguara nga KLSH-ja me shkresën nr. 4193 Prot, datë 10.10.2022, duke nxjerrë përgjegjësitë e personave të ngarkuar për zbatimin e tyre. Të marrë të gjitha masat e duhura ligjore për të përshpejtuar punën për zbatimin e rekomandimeve në proces zbatimi, si dhe për zbatimin e plotë të rekomandimeve të pa zbatuara dhe të zbatuara pjesërisht, si vijon

**14.1/1.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej 976,500 lekë pa TVSH nga bashkimi i OE “K” SHPK & “L VII” & “K 2” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.469 port datë 20.10.2020, me objekt “Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Mesit, Gizavesh, Dorëz”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**14.1/2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **126,560 lekë** pa TVSH nga BOE “M” SHPK & “Sh” SHPK në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr.2106 port datë 08.04.2021, me objekt “Ndërtim miniparku i qytetit pranë Argjinaturës së Lumit Shkumbin” (Faza II dhe faza III), Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masat për zbritjen e vlerës 1,032,834 lekë, nga garancia e punimeve kontraktorit, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike, si dhe referencë e gabuar e çmimit për një zë punimi.

**2.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës 1,079,976 lekë, nga vlera e sigurimit të kontratës, kontraktorit BOE “E SHPK dhe L K SHPK”, për punime të realizuara pa respektuar specifikimet teknike.

**3.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masa për zbritjen e vlerës 416,245 lekë, nga vlera e sigurimit të kontratës Kontraktorit “A-A Co” SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara në sasinë e raportuar.

**2.1.Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë Librazhd dhe Drejtoria e të Ardhurave, të marrin masa për ndjekjen e të gjitha procedurave administrative dhe ligjore për arkëtimin nga 13 subjektet debitor, sipas të dhënave në aneksin nr. 2, bashkëlidhur raportit të auditimit, të vlerës së qirasë prej **71,454 lekë**, si rezultat i mos pagesave të plota të detyrimeve kontraktuale në kontratat për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjor.

**3.2.Rekomandimi:** Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrin masa për arkëtimin e vlerës prej 1,635,518 lekë ndaj subjektit L. H, për llogaritje të gabuar të taksës së ndikimit në infrastrukturë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Librazhd.

*Menjëherë*

**6.1. Rekomandimi:** Bashkia Librazhd të marrë masa të menjëhershme, për kryerjen e procedurave ligjore për rivlerësimin e aktiveve, pasqyrimin e tyre në kontabilitet me vlerë reale (referuar tregut), si dhe kryerjen e veprimeve kontabël referuar rezultatit (rritje apo ulje nga

rivlerësimi), respektivisht në llogaritë përkatëse 21 “Aktive afatgjata materiale” dhe llogarisë 109 “Diferenca nga rivlerësimi”.

**7.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës në Bashkinë Librazhd, për garancitë të cilat i përkasin ngurtësimeve të viteve 2021 e më parë (vlera 26,383,676 lekë), për të cilat nuk ka dokumentacion për përfitim të tyre nga subjektet ose që janë në kushtet e parashkrimit, të procedojë sipas kërkesave ligjore pranë Degës së Thesarit, për rimarrjen e fondeve të ngurtësuar dhe përdorimin e tyre në interes publik.

*Menjëherë*

**B. Masa për shpërblim dëmi.**

**1.1.Rekomandimi:** Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **224,115 lekë pa TVSh** nga OE “B-N” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1424 port datë 16.03.2023, me objekt “Rehabilitim i shesheve dhe rrugëve lagjja Mirakë Plane Nj. Ad. Pulis”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

**2.1. Rekomandimi:** Nga Bashkia Librazhd të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **138,800 lekë pa TVSh** nga BOE “A-A CO” ShPK & “Z K” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 1967 port datë 11.04.2023, me objekt “Rikonstruksion i rrugëve Mirakë Gjovaç, Nj. Ad. Pulis”, Bashkia Librazhd, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

*Brenda datës 31.12.2025*

**C. Masa për arkëtimin e detyrimeve për tatim taksat vendore, përfshirë dhe detyrimet nga qiradhënia**

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd, Drejtoria e të Ardhurave Vendore të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës së detyrimeve për taksën e ndërtimeve informale në vlerë **7,607 mijë lekë**, sipas listës paraqitur në aneksin nr.3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

**2.1.Rekomandimi:** Drejtoria e të Ardhurave Vendore në Bashkinë Librazhd të angazhohet gjatë gjithë vitit me qëllim mbledhjen e të ardhurave nga taksat dhe tarifat vendore në nivelet më të larta sipas planifikimit për eliminimin e vlerës së detyrimeve prej 69,216,534 lekë.

**4.1.Rekomandimi:** Drejtoria e Taksave Vendore në bashkëpunim me Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerës dhe detyrimeve për dhënie me qira për shfrytëzim të fondit pyjorë kullor në vlerë **235,704 lekë**, sipas listës paraqitur në aneksin nr.3 bashkëlidhur Raportit të Auditimit.

*Menjëherë*

**D. Masa për eliminim e efekteve negative të konstatuara në administrimin e të ardhurave të munguara.**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të kontabilizojë në llogarinë 468 “Debitorë të ndryshëm”, vlerën prej 2,206,200 lekë si e ardhur e munguar për detyrimet që kanë subjektet për qira për shfrytëzim të fondit pyjor dhe kullor, me qëllim paraqitjen e raportimit financiar sipas situatës reale të saj si dhe duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore me qëllim arkëtimin e të ardhurave të munguara.

*Menjëherë*

**E. Masa për arkëtimin e detyrimeve për debitorët.**

**1.1. Rekomandimi:** Drejtoria e Financës, Bashkia Librazhd, të ndjekë të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e debitorëve në fund të periudhës në vlerën 115,544,560 lekë.

*Menjëherë*

**F. Masa Disiplinore.**

Kontrolli i Lartë i Shtetit mbështetur në nenin 15, Ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, shkronjat (b, c, ç) e nenit 58

“Llojet e masave disiplinore” të Ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, VKM nr. 115, datë 05.03.2014 “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil, nenit 37 të Ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i punës në Republikën e Shqipërisë”, nenit 11 “Masa disiplinore”, të kontratës individuale, si dhe shkronja (k) e nenit 64, të Ligjit nr. 139/2015 datë 17/12/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Librazhd të vlerësojë shkeljeve të konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit të KLSH-së, për periudhën 01.01.2023 deri më 31.12.2023, si dhe të fillojnë procedurat për dhënien e masave disiplinore nga “Vërejtje” deri në “Largim nga shërbimi civil/ Largim nga puna”, për 4 (katër) punonjës, si më poshtë.

1. **Z. J. M**, në cilësinë e përgjegjës të sektorit pranë DPZHMT.

2. **Znj. J. B**, në cilësinë e përgjegjës të sektorit pranë DPZHMT.

**Për shkeljet e mëposhtme:**

Për shkeljet e konstatuara, në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara për 2 (dy) raste. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me:

- Mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi, siç janë mangësi në plotësinë e projektit ndërtimor dhe projekteve përbërëse të tij, mangësi në dokumentacionin që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në QKB, mangësi në dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me certifikatë përdorimi.

- Mos-kërkimin e mendimit të autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

3. **Znj. A. H**, në cilësinë e spec.-Ing. Proj. pranë DPZHMT.

4. **Z. E. Gj**, në cilësinë e specialistit pranë DPZHMT.

**Për shkeljet e mëposhtme:**

Në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara për 1 (një) rast. Problematikat e konstatuara kanë të bëjnë me:

- Mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi, siç janë mangësi në plotësinë e projektit ndërtimor dhe projekteve përbërëse të tij, mangësi në dokumentacionin që vërteton statusin aktiv të subjekteve dhe regjistrimin në QKB, mangësi në dokumentacionin e nevojshëm për pajisje me certifikatë përdorimi, në një rast mungon planvendosja e miratuar, mungon raporti i auditimit të efikasitetit të energjisë, projekti i mbrojtjes nga zjarri, studimi sizmik dhe gjeologjik, relacioni teknik për projektin elektrik, licencat personale profesionale të hartuesve të projektit arkitektonik, elektrik, hidraulik dhe të instalimeve të sistemeve të ngrohje-ftohjes;

- Mos-kërkimin e mendimit të autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit;

- Për miratimin e lejes së ndërtimit, në kushtet kur zhvilluesi nuk është pajisur më parë me leje zhvillimi, dhe kur për parcelën në të cilën zhvillohet objekti, nuk është parashikuar hartimi i një Plani të Detajuar Vendor.

*Menjëherë*

**G. Masa Administrative.**

-Referuar shkeljeve të konstatuara në fushën e ndërtimit, përcaktuar në nenin 7/1 dhe 12 Kreu III, të ligjit nr. 8402, datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar dhe Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu II, Pika 3 (si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në pjesët takuese të Raportit Përfundimtar të Auditimit), mbështetur në nenin 5 shkronja (b) dhe nenin 9/1, shkronja (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, ndryshuar me nenin

12 të ligjit nr. 183/2014 datë 01.04.2013 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, bazuar në nenin 15 dhe nenin 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, **i rekomandojmë, Kryeinspektorit të Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Vendor Librazhd**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara nga:

- Shoqëria “N S” me përfaqësues ligjor z. E. N, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve në objektet “Ndërtim i ujësjellësit të Fshatit Pulis Gostimë, Njësia Administrative Pulis, Bashkia Librazhd”, “Ndërtim i Parkut Qendror, Bashkia Librazhd, faza e parë” dhe “Rikonstruksion i kanaleve vaditëse në Bashkinë Librazhd”.

*Menjëherë*

## **B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI**

Bazuar në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, germa (b) dhe (c), si dhe mbështetur në ligjin nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë” nenet 98-102, ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” nenet 21-33 dhe udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pika 93, **Titullari i Njesisë Publike në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues**, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **1,163,931 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Ndërtim i shkollës së mesme Polis + Palestër, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd” me nr. 5271 prot., datë 11.08.2023 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe, sipërmarrësit të punimeve OE “E” SHPK me vlerë të kontratës 104,004,584 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 6 (gjashtë) muaj, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, me pasojë **dëm ekonomik në buxhetin e Bashkia Librazhd**, në vlerën **279,357 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpika 2.4.4 faqe 133-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **279,357 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga shoqëria sipërmarrëse “E” SHPK ” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 5271 prot., datë 11.08.2023 me objekt “Ndërtim i shkollës së mesme Polis + Palestër, Njësia Administrative Polis, Bashkia Librazhd”.

*Menjëherë*

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd” me nr. 2854 prot., datë 12.06.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe, sipërmarrësit të punimeve BOE “Z K” SHPK & “A-A CO” SHPK me vlerë të kontratës 71,085,637 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 6 (gjashtë) muaj , rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, me pasojë **dëm ekonomik në buxhetin e Bashkia Librazhd**, në vlerën **237,234.71 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për

Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpika 2.4.4 faqe 133-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**2.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **237,235 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE “Z K” SHPK & “A-A CO” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 2854 prot., datë 12.06.2024 me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”.

*Menjëherë*

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt: “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashki Librazhd” dhe nr. 2869 prot., datë 13.06.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe, sipërmarrësit të punimeve BOE “H” SHPK & “K” SHPK me vlerë të kontratës 15,626,322 lekë me TVSH, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara për zërat e punimeve, konkretisht: *[Transport dheu dhe mbeturina me auto deri 10 km; Murë me tullë plota në lartësi deri 3 m me llaç të përzier M-25; FV Davanciale mermeri t=2cm nën dritare; FV Dyer të brendshme tamburatë të rimesuara; Patinim i mureve brenda me allçi (Stuko); Ulluk shkarkimi vertikal me llamarinë xingat Ø 100 mm; FV Mini saraçineska D20 (tek aparatet); FV Tabela tregues drejtim dalje; FV Fikse zjarri portabel pluhur, 6 kg, tipi 34AA 233BC; Trotuar me 6 cm me pllaka betoni], me pasojë **dëm ekonomik** në buxhetin e Bashkia Librazhd, në vlerën **451,390.5 lekë pa TVSH**. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpika 2.4.4 faqe 133-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).**

**3.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **451,390 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE “H” SHPK & “K” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 2869 prot., datë 13.06.2024 me objekt “Ndërtimi i një qendre rinore në Bashki Librazhd”.

*Menjëherë*

**4. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd” me nr. 3155 prot., datë 01.07.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd, dhe, sipërmarrësit të punimeve BOE “G-T” SHPK & “V K” SHPK me vlerë të kontratës 11,398,741 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 28 ditë, rezultuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, përkatësisht për zërin e punës “Struktura të holla monolite betoni C 25/30” me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkia Librazhd, në vlerën 78,200 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpika 2.4.4 faqe 133-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**4.1.Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **78,200 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga BOE “G-T” SHPK & “V K” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 3155 prot., datë 01.07.2024 me objekt “Rikonstruksion i rrugëve rurale dhe veprave të artit të Bashkisë Librazhd”.

*Menjëherë*

**5. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Rikonstruksion kanali i Allanit Dorez (Faza e parë hyrja + Skeja e në vazhdim)” me nr. 28554 prot., datë 12.06.2024 të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Librazhd dhe, sipërmarrësit të punimeve OE “Z K” SHPK me vlerë të kontratës 4,844,284 lekë me TVSH dhe, afat të realizimit të kontratës 3 (tre) javë nga data e nënshkrimit të kontratës, u konstatuan punime ndërtimi të pakryera në volumet e situacionuara, me pasojë dëm ekonomik në buxhetin e Bashkia Librazhd, në vlerën 117,749 lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpika 2.4.4 faqe 133-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**5.1. Rekomandimi:** Titullari i Bashkisë Librazhd në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike dhe Ekonomike të marrë masa për arkëtimin e vlerës **117,749 lekë pa TVSH** përfituar padrejtësisht nga OE “Z K” SHPK, për punime të pa kryera në volumet e situacionuara, parashikuar në kontratën me nr. 28554 prot., datë 12.06.2024 me objekt “Rikonstruksion kanali i Allanit Dorez (Faza e parë hyrja + Skeja e në vazhdim)”.

*Menjëherë*

## **C. MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE, TË ARDHURAT E MUNGUARA.**

**1. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd” Bashkia Librazhd, me vlerë 71,085,637 lekë me TVSH, fituar nga BOE “Z K” SHPK & “A-A CO” SHPK, rezultuan punime ndërtimi të kryera me cilësi jo të mirë dhe jo në përputhje me specifikimet teknike, konkretisht:

- ndërmjet seksionit 42 dhe seksionit 43, rruga ka pësuar dëmtime të shtresës asfaltme binder në sipërfaqen  $5 \text{ m} \times 3.5 \text{ ml} = 17.5 \text{ m}^2 \times 1,091 \text{ lekë} = 19,092.5 \text{ lekë}$  dhe, të shtresës asfaltme asfalto beton në sipërfaqen  $5 \text{ m} \times 3.5 \text{ ml} = 17.5 \text{ m}^2 \times 904 \text{ lekë} = 15,820 \text{ lekë}$ .

- ndërmjet seksionit 21 dhe seksionit 22, rruga ka pësuar dëmtime të shtresës asfaltme binder në sipërfaqen  $7 \text{ m} \times 3.5 \text{ ml} = 24.5 \text{ m}^2 \times 1,091 \text{ lekë} = 26,729.5 \text{ lekë}$  dhe, të shtresës asfaltme asfalto beton në sipërfaqen  $7 \text{ m} \times 3.5 \text{ ml} = 24.5 \text{ m}^2 \times 904 \text{ lekë} = 22,148 \text{ lekë}$ .

- ndërmjet seksionit 55 dhe seksionit 56, rruga ka pësuar dëmtime të shtresës asfaltme binder në sipërfaqen  $7 \text{ m} \times 3.5 \text{ ml} = 24.5 \text{ m}^2 \times 1,091 \text{ lekë} = 26,729.5 \text{ lekë}$  dhe, të shtresës asfaltme asfalto beton në sipërfaqen  $7 \text{ m} \times 3.5 \text{ ml} = 24.5 \text{ m}^2 \times 904 \text{ lekë} = 22,148 \text{ lekë}$ .

Vlera e shtesave asfaltike sa më sipër trajtuar, konsiderohen zë pune i realizuar *jo në përputhje me specifikimet teknike dhe kushtet e kontratës* së sipërcituar, në shumën 132,667.50 lekë pa TVSH, vlerë e cila përfaqëson përdorim të fondeve publike **pa Eficence dhe Efektivitet**.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve të sipërcituar. *(Më hollësisht trajtuar në nënpika 2.4.4 faqe 133-142 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

**1.1.Rekomandimi:** Bashkia Librazhd në bashkëpunim me mbikëqyrësin e punimeve, nisur nga fakti që kontrata për punë publike me objekt: “Sistemim asfaltim i rrugës së Fshatit Librazhd Katund, faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd” është në periudhë garancie deri me datë 27.02.2026, volumi prej  $133 \text{ m}^2$  në vlerën 132,667.5 lekë, për zërin “Shtresë binder me gur kave, 6 cm, me makineri” dhe zërin “Shtresë asfalto betoni me gur kave, 4 cm, me makineri” duhet të zbatohen në objekt (menjëherë) për të garantuar cilësinë dhe

qëndrueshmërinë e rrugës. Në rast të mos përputhshmërisë me përcaktimet kontraktore, të merren masa për zbritjen nga garancia e punimeve të vlerës **132,667.50 lekë**, përfituar padrejtësisht nga BOE “Z K” SHPK & “A-A CO” SHPK, për punime të certifikuara, por të pa realizuara me cilësi të mirë.

**Menjëherë**

**2. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua se në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 metra katrorë, kanë ndaj fondit publik për strehim social. Referuar përcaktimeve të nenit 19 të Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, marrim informacion se: “Çdo subjekt privat që aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi, ose në vlerë monetare”. Kjo problematikë është për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H.

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-lejet, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 3641 m<sup>2</sup>, nga të cilat **109.23 m<sup>2</sup>** do të duhej t’i kalonin të fondit publik të banesave sociale në natyrë ose në vlerë monetare ekuivalente **prej 4,806,120 lekë**. Në sipërfaqen e përllogaritur më sipër (3641 m<sup>2</sup>) janë përfshirë sipërfaqet e përbashkëta takuese, ballkonet, llozhat dhe sipërfaqet neto vetëm të apartamenteve. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 146-157 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**2.1. Rekomandimi:** Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtorisë Juridike në Bashkinë Librazhd, të merren të gjitha masat për:

- Të identifikuar, që në fazën e shqyrtimit të aplikimeve për pajisje me leje ndërtimi, të gjitha rastet që përbëjnë subjekt të kontributit që sektori privat duhet të japë ndaj fondit publik për strehim social. Zhvilluesit duhet të njoftohen për detyrimin që u lind në këtë kuadër dhe, përpara miratimit të lejes së ndërtimit, të lidhin akt-marrëveshje me Bashkinë për kalimin pa shpërblim të sipërfaqeve përkatëse në funksion të fondit të strehimit social, duke përcaktuar edhe pozicionimin e këtyre sipërfaqeve në planimetri.

- Të njoftuar zhvilluesin, i cili ka përfituar lejen e ndërtimit të sipërpërmendur, lidhur me detyrimin që ka ndaj fondit publik për strehim social. Nga Bashkia Librazhd duhet të ndiqen të gjitha hapat ligjorë deri në refuzimin e pajisjes me certifikatë përdorimi, nëse zhvilluesi nuk dakordësohet për hartimin e akt-marrëveshjes dhe përcaktimin e sipërfaqeve që do t’i kalojnë fondit të strehimit social, ose vlerës monetare, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

**Menjëherë dhe në vijimësi**

**3. Gjetje nga auditimi:** Nga auditimi i të dhënave në lidhje me detyrimet e tatimpaguesve nga taksat dhe tarifatat vendore që kanë ndaj Bashkisë Librazhd, u konstatua se:

▪ Deri në datën 31.12.2024 debia progresive është 107,748,411 lekë për 6,507 debitorë, nga e cila vetëm për vitin 2024 është krijuar në vlerën totale 26,875,185 lekë për 2,109 debitorë, dhe paraqitet si më poshtë vijon:

- Nga kategoria “biznes i madh”, në vlerën 28,235,942 lekë për 81 debitorë;  
Për vitin 2024 është 12,458,814 lekë për 68 debitorë;

- Nga kategoria “biznes i vogël”, në vlerën 13,625,180 lekë për 302 debitorë;  
Për vitin 2024 është 1,649,683 lekë për 118 debitorë;
- Nga kategoria “institucione” në vlerën 391,397 lekë për 2 debitorë;  
Për vitin 2024 është 0 lekë;
- Nga "ndërtesat social-ekonomike" në vlerën 6,493,131 lekë për 91 debitorë;  
Për vitin 2024 është 4,029,853 lekë për 81 debitorë;
- Detyrime progresive nga "TNI/legalizimet", në vlerën 8,377,411 lekë për 177 debitorë;  
Për vitin 2024 është 769,707 lekë për 5 debitorë;
- Detyrime progresive nga "familjet në qytet", në vlerën 6,083,077 lekë për 185 debitorë;  
Për vitin 2024 është 156,171 lekë për 57 debitorë;
- Detyrime progresive nga "familjet në 6 NJA", në vlerën 44,542,273 lekë për 5,669 debitorë;  
Për vitin 2024 është 7,810,957 lekë për 1780 debitorë;
- Në Bashkinë Librazhd nuk janë zhvilluar takime të GMS, ku të trajtohen problematikat për pa/mundësinë e vjeljes së detyrimeve të 476 debitorëve problematik dhe të atyre nga ish komunitat dhe si rrjedhojë në mungesë të një analize të mirëfilltë, deri tani nuk ka një plan masash konkrete për arkëtimin e tyre.

Veprimet apo mosveprimet janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Kreu XI, “Mbledhja me forcë e detyrimeve tatimore të papaguara”, nenet 88-104; Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 3, pikat 9-10, nenet 20-22; Ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar, neni 9, pika 1.3. dhe Ligjin nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 35, “Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.5., faqe 42-66 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

**3.1. Rekomandimi:** Kryetari i Bashkisë, GMS dhe Drejtoria e Taksa, Tarifa e Tregje në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e debisë totale progresive prej **107,748,411 lekë** për **6,507 debitorë**.

*Në vijimësi*

## **D. MASA DISIPLINORE**

### **D. 1. Për punonjësit të cilët janë pjesë e Shërbimit Civil:**

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, neni 15 “Të drejtat dhe detyrat e KLSH-së”, shkronja c., Ligjin nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe VKM-në nr. 115, datë 05.3.2014, “Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në Komisionin Disiplinor në Shërbimin Civil”, i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Librazhd, për shkeljet e paraqitura në Raportin Përfundimtar të Auditimit t’i kërkojë Komisionit Disiplinor të ngritur pranë këtij Institucioni, që bazuar në performancën dhe llojin e shkeljeve të fillojë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

**“Vërejtje”, “mbajtja deri në 1/3 e pagës së plotë për një periudhë deri në gjashtë muaj” ose “pezullim nga e drejta e ngritjes në detyrë, përfshirë rritjen në shkallën e pagës për një periudhë deri në dy vjet”, neni 58, germa (a), (b) ose (c), për 9 punonjës si më poshtë:**

#### **a- Në cilësinë e anëtarit të Njësisë së Prokurimit për hartimin e DST.**

**1. Zj. A. H, me detyrë Specialist në Sektorin e Projektive dhe Zbatimit të Kontratave,** Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe ose specifikimeve teknike, në mos argumentim dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në

mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*, neni 39, “*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*”, pika 4, dhe 78 “*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, trajtuar në faqen 88-130 të RPA, konkretisht në praktikat:

- 1- Procedura me objekt “*Asfaltim i rrugës Lunik Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik Bashkia Librazhd*”, me fond limit 54,166 mijë lekë.
- 2- Procedura me objekt “*Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefqet Dosku"Librazhd*” me fond limit 76,854 mijë lekë.
- 3- Procedura me objekt “*Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan faza e I-re Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd*” me fond limit 77,600 mijë lekë.
- 4- Procedura me objekt “*Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Allanit Dorez-Gizavesh-Librazhd Qendër*” me fond limit 52,614 mijë lekë.
- 5- Procedura me objekt “*Sistemim asfaltim i rrugës Librazhd- Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd*” me fond limit 75,000 mijë lekë.
- 6- Procedura me objekt “*Sistemim, asfaltim i rrugës Funarës-Zdranjsh, Njësia administrative Orenje, Bashkia Librazhd*” me fond limit 75,000 mijë lekë.
- 7- Procedura me objekt “*Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2024*” me fond limit 38,054 mijë lekë.
- 8- Procedura me objekt “*Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd*” me fond limit 14,910 mijë lekë.

### **Në cilësinë e specialistes DPZHT**

Për shkeljet e konstatuara në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara:

Ku në **të gjitha rastet**, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore.

Në **1 (një) rast**, është konstatuar vonesë në shqyrtimin e aplikimit dhe në **4 (katër) raste**, u konstatua se dokumentat e pasurisë nuk janë ngarkuar e rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi:

-Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H;

-Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefqet Dosku”, miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024, me zhvillues Bashkia Librazhd;

-Leje ndërtimi “Agroturizëm dhe struktura të përkohshme me qëllim pushimi, shoqërore dhe veprimtari turistike e kampingje etj”, miratuar me Vendim nr. 1542/5, datë 18.11.2024, me zhvillues S shpk;

-Leje ndërtimi “Banesë individuale 2 kate + çati”, miratuar me Vendim nr. 2589/4, datë 08.08.2024, me zhvillues S A;

-Leje ndërtimi “Shtesë kati deri 250m2 në objekt ekzistues nr. pasurie 9/970”, miratuar me Vendim nr. 2676/5, datë 05.07.2024, me zhvillues B Ç;

-Leje ndërtimi “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024, me zhvillues H C;

-Certifikatë përdorimi “Shtëpi banimi 2 kat dhe rrethim prone”, miratuar me Vendim nr. 1193/4 , datë 07.05.2024, me zhvillues H H; Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me

VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika ë); neni 20; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), si dhe Vendimin nr. 8, datë 28.12.2020 të KKT-së “Për miratimin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor Bashkia Librazhd, të miratuar me vendimin nr. 10, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit ” neni 43/1;

Në **1(një) rast**, për objektin për të cilin është miratuar leja e ndërtimit, mungojnë dokumentet e pronësisë që vërtetojnë të drejtën e zhvilluesit mbi pasurinë përkatëse. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektin: -Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefqet Dosku”, miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024, me zhvillues Bashkia Librazhd; Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b);

Në **1 (një) rast**, nuk ka kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.. Rezulton se leja e ndërtimit për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024, me zhvillues H C; , është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat regullatore shprehet qartësisht se informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Gjithashtu është konstatuar se në **1 (nje) rast**, DPZHT, Bashkia Librazhd, nuk ka respektuar mendimin e autoriteteve të cilat janë shprehur sipas kompetencave që u njeh ligji, sipas fushës së kompetencës. Rezulton se leja e ndërtimit për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, është miratuar pa respektuar mendimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila shpreh mosdakordësi për zhvillimin e projekt-propozimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6.

Në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane, lidhur me: intensitetin maksimal të lejuar (intensiteti faktik i ndërtimit, sipas projektit ndërtimor, rezulton të jetë 5.26, duke tejkaluar kufirin maksimal prej 4 të parashikuar PPV), koeficientin e shfrytëzimit të territorit (KSHT faktike rezulton 73%, duke kaluar kufirin maksimal prej 50%), lartësinë maksimale të lejuar (e matur si në numër katesh, ashtu edhe në metra), si dhe numrin minimal të vend-parkimeve. Më konkretisht, këto shkelje janë konstatuar për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H; Veprime e mesipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 37, pika 1, nënpika c); pika 2; pika 3, nënpika b), si dhe Vendimin nr.10, datë 08.02.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, Bashkia Librazhd” i ndryshuar, neni 49, 50, 55, si dhe me përcaktimet e pasaportës së njësisë strukturore 1/102\_2;

Në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, kanë ndaj fundit publik për strehim social. Referuar përcaktimeve të nenit 19 të Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, marrim informacion se: “Çdo subjekt privat që aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në

*favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t'u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi, ose në vlerë monetare".* Kjo problematikë është për objektin: -Leje ndërtimi "Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd", miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H.

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-lejet, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 3641 m<sup>2</sup>, nga të cilat **109.23 m<sup>2</sup>** do të duhej t'i kalonin të fondit publik të banesave sociale në natyrë ose në vlerë monetare ekuivalente **prej 4,806,120 lekë**. Në sipërfaqen e përllogaritur më sipër (3641 m<sup>2</sup>) janë përfshirë sipërfaqet e përbashkëta takuese, ballkonet, llozhat dhe sipërfaqet neto vetëm të apartamenteve

## **2. Zj. D. B, me detyrë Përgjegjëse e Sektorit Juridik dhe Prokurimeve.**

### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe ose specifikimeve teknike, në mos argumentim dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*, neni 39, "*Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike*", pika 4, dhe 78 "*Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*" dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 " Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, trajtuar në faqen 88-130 të RPA, konkretisht në praktikat:

- 1- Procedura me objekt "*Asfaltim i rrugës Lunik Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik Bashkia Librazhd*", me fond limit 54,166 mijë lekë.
- 2- Procedura me objekt "*Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefqet Dosku"Librazhd*" me fond limit 76,854 mijë lekë.
- 3- Procedura me objekt "*Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan faza e I-re Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd*" me fond limit 77,600 mijë lekë.
- 4- Procedura me objekt "*Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Allanit Dorez-Gizavesh-Librazhd Qendër*" me fond limit 52,614 mijë lekë.
- 5- Procedura me objekt "*Sistemim asfaltim i rrugës Librazhd- Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd*" me fond limit 75,000 mijë lekë.
- 6- Procedura me objekt "*Sistemim, asfaltim i rrugës Funarës-Zdranjsh, Njësia administrative Orenje, Bashkia Librazhd*" me fond limit 75,000 mijë lekë.
- 7- Procedura me objekt "*Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2024*" me fond limit 38,054 mijë lekë.
- 8- Procedura me objekt "*Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd*" me fond limit 14,910 mijë lekë.

### **b- Në cilësinë e anëtarit të KVO, për vlerësimin e procedurave të zhvilluara.**

## **3. Z. K. B, me detyrë Drejtor i Planifikimit, Zhvillimit Urban dhe e Mbrojtjes Teritorit; Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), neni 2, neni 76 pika 3/ë dhe 5, neni 92 pika 3, neni 98, “Anulimi i një procedure”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, trajtuar në faqen 88-130 të RPA, konkretisht në praktikat:

1- Procedura me objekt “Asfaltim i rrugës Lunik Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik Bashkia Librazhd” me fond limit 54,166 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “P-V-K” shpk me vlerë kontrate 44,216 mijë lekë.

2- Procedura me objekt “Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefqet Dosku "Librazhd” me fond limit 76,854 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “E” shpk, me vlerë kontrate 71,473 mijë lekë.

3- Procedura me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan ,faza e I-re Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd” me fond limit 77,600 mijë, ku fitues është shpallur shoqëria “L C” shpk, me vlerë kontrate 61,211 mijë lekë.

4- Procedura me objekt “Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Allanit Dorez-Gizavesh-Librazhd Qendër” me fond limit 52,614 mijë lekë, ku fitues është shpallur B/OE “R G-K ShPK & V K” shpk, me vlerë kontrate 47,237,966.

5- Procedura me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Librazhd- Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd” me fond limit 75,000 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “Z K” sh.p.k & “A-A CO” shpk, me vlerë kontrate 59,238 mijë lekë.

6- Procedura me objekt “Sistemim, asfaltim i rrugës Funarës-Zdranjsh, Njësia administrative Orenje, Bashkia Librazhd” me fond limit 75,000 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “V E” ShPK & “K.” ShPK me vlerë kontrate 50,937 mijë lekë.

7- Procedura me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2024” me fond limit 38,054 mijë lekë, ku fitues është BOE “H” & “K” ShPK me vlerë kontrate 33,961 mijë lekë.

8- Procedura me objekt “Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd” me fond limit 14,910 mijë lekë, ku fitues është B/OE “H” & “K” ShPK me vlerë kontrate 13,021 mijë lekë

### **Në cilësinë e Drejtorit PZHMT**

Për shkeljet e konstatuara në lidhje me problematikën dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara:

Ku në **të gjitha rastet**, ka mangësi në dokumentacionin shoqëruar dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore.

Në **1 (një) rast**, është konstatuar vonesë në shqyrtimin e aplikimit, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Gjithashtu në **4 (katër) raste**, u konstatua se dokumentat e pasurisë nuk janë ngarkuar e rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektet: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H; -Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefqet Dosku”, miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024, me zhvillues Bashkia Librazhd; -Leje ndërtimi “Agroturizëm dhe struktura të përkohshme me qëllim pushimi, shoqërore dhe veprimtari turistike e kampingje etj”, miratuar me Vendim nr. 1542/5, datë 18.11.2024, me

zhvillues S shpk; -Leje ndërtimi “Banesë individuale 2 kate + çati”, miratuar me Vendim nr. 2589/4, datë 08.08.2024, me zhvillues S. A; -Leje ndërtimi “Shtesë kati deri 250m2 në objekt ekzistues nr. pasurie 9/970”, miratuar me Vendim nr. 2676/5, datë 05.07.2024, me zhvillues B Ç; -Leje ndërtimi “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024, me zhvillues H C; -Certifikatë përdorimi “Shtëpi banimi 2 kat dhe rrethim prone”, miratuar me Vendim nr. 1193/4, datë 07.05.2024, me zhvillues H H; Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika ë); nenin 20; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), si dhe Vendimin nr. 8, datë 28.12.2020 të KKT-së “Për miratimin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor Bashkia Librazhd, të miratuar me vendimin nr. 10, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit ” neni 43/1;

Në **1(një) rast**, për objektin për të cilin është miratuar leja e ndërtimit, mungojnë dokumentet e pronësisë që vërtetojnë të drejtën e zhvilluesit mbi pasurinë përkatëse. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektin: -Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefqet Dosku”, miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024, me zhvillues Bashkia Librazhd; Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b);

Në **1 (një) rast**, nuk ka kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.. Rezulton se leja e ndërtimit për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024, me zhvillues H C;., është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat regullatore shprehet qartësisht se informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Gjithashtu është konstatuar se në **1 (nje) rast**, DPZHT, Bashkia Librazhd, nuk ka respektuar mendimin e autoriteteve të cilat janë shprehur sipas kompetencave që u njeh ligji, sipas fushës së kompetencës. Rezulton se leja e ndërtimit për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, është miratuar pa respektuar mendimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila shpreh mosdakordësi për zhvillimin e projekt-propozimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6.

Në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane, lidhur me: intensitetin maksimal të lejuar (intensiteti faktik i ndërtimit, sipas projektit ndërtimor, rezulton të jetë 5.26, duke tejkaluar kufirin maksimal prej 4 të parashikuar PPV), koeficientin e shfrytëzimit të territorit (KSHT faktike rezulton 73%, duke kaluar kufirin maksimal prej 50%), lartësinë maksimale të lejuar (e matur si në numër katesh, ashtu edhe në metra), si dhe numrin minimal të vend-parkimeve. Më konkretisht, këto shkelje janë konstatuar për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H; Veprime e mesipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 37, pika 1, nënpika c); pika 2; pika 3, nënpika b), si dhe Vendimin nr.10, datë 08.02.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, Bashkia Librazhd” i ndryshuar, neni 49, 50, 55, si dhe me përcaktimet e pasaportës së njësisë strukturore 1/102\_2;

Në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, kanë ndaj fondit publik për strehim social. Referuar përcaktimeve të nenit 19 të Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, marrim informacion se: “Çdo subjekt privat që aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi, ose në vlerë monetare”. Kjo problematikë është për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H.

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-lejet, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 3641 m<sup>2</sup>, nga të cilat **109.23 m<sup>2</sup>** do të duhej t’i kalonin të fondit publik të banesave sociale në natyrë ose në vlerë monetare ekuivalente **prej 4,806,120 lekë**. Në sipërfaqen e përllogaritur më sipër (3641 m<sup>2</sup>) janë përfshirë sipërfaqet e përbashkëta takuese, ballkonet, llozhat dhe sipërfaqet neto vetëm të apartamenteve

**4. Zj. K. Ll, me detyrë Specialiste në Sektorin Juridik dhe Prokurimeve.**

**5. Z. H. H, me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Bujqësisë Administrimit të Ujitjes, Kullimit dhe Mjedisit.**

#### **Për shkeljet e mëposhtme:**

Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), neni 2, neni 76 pika 3/ë dhe 5, neni 92 pika 3, neni 98, “Anulimi i një procedure”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, trajtuar në faqen 88-130 të RPA, konkretisht në praktikat:

1- Procedura me objekt “Asfaltim i rrugës Lunik Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik Bashkia Librazhd” me fond limit 54,166 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “P-V-K” shpk me vlerë kontrate 44,216 mijë lekë.

2- Procedura me objekt “Rikonstruksion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefqet Dosku"Librazhd” me fond limit 76,854 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “E” shpk, me vlerë kontrate 71,473 mijë lekë.

3- Procedura me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan faza e I-re Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd” me fond limit 77,600 mijë, ku fitues është shpallur shoqëria “L C” shpk, me vlerë kontrate 61,211 mijë lekë.

4- Procedura me objekt “Rikonstruksioni i kanalit vaditës të Allanit Dorez-Gizavesh-Librazhd Qendër” me fond limit 52,614 mijë lekë, ku fitues është shpallur B/OE “R G- K ShPK & V Konstruksion” shpk, me vlerë kontrate 47,237,966.

5- Procedura me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës Librazhd- Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd” me fond limit 75,000 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “Z K” sh.p.k & “A-A CO” shpk, me vlerë kontrate 59,238 mijë lekë.

6- Procedura me objekt “Sistemim, asfaltim i rrugës Funarës-Zdranjsh, Njësia administrative Orenje, Bashkia Librazhd” me fond limit 75,000 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “V E” ShPK & “K.” ShPK me vlerë kontrate 50,937 mijë lekë.

7- Procedura me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2024” me fond limit 38,054 mijë lekë, ku fitues është BOE “H” & “K” ShPK me vlerë kontrate 33,961 mijë lekë.

8- Procedura me objekt “Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd” me fond limit 14,910 mijë lekë, ku fitues është B/OE “H” & “K” ShPK me vlerë kontrate 13,021 mijë lekë.

#### **6. Z. Xh. B, me detyrë Specialist në Sektorin e Projektive dhe Zbatimit të Kontratave, Për shkeljet e mëposhtme:**

a- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe ose specifikimeve teknike, në mos argumentim dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve, neni 39, “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, pika 4, dhe 78 “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

b- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte më të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë “Çmimi më i leverdishëm”, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), neni 2, neni 76 pika 3/ë dhe 5, neni 92 pika 3, neni 98, “Anulimi i një procedure”, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”, neni 67, “Klasifikimi i ofertave”, neni 83, “Njoftimi i fituesit”, trajtuar në faqen 88-130 të RPA, konkretisht në praktikat:

1- Procedura me objekt “Asfaltim i rrugës Lunik Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik Bashkia Librazhd” me fond limit 54,166 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “P-V-K” shpk me vlerë kontrate 44,216 mijë lekë.

2- Procedura me objekt “Rikonstrukcion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefqet Dosku"Librazhd” me fond limit 76,854 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “E” shpk, me vlerë kontrate 71,473 mijë lekë.

3- Procedura me objekt “Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan ,faza e I-re Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd” me fond limit 77,600 mijë, ku fitues është shpallur shoqëria “L C” shpk, me vlerë kontrate 61,211 mijë lekë.

4- Procedura me objekt “Rikonstrukcioni i kanalit vaditës të Allanit Dorez-Gizavesh-Librazhd Qendër” me fond limit 52,614 mijë lekë, ku fitues është shpallur B/OE “R G -K ShPK & V K” shpk, me vlerë kontrate 47,237,966.

5- Procedura me objekt *“Sistemim asfaltim i rrugës Librazhd- Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”* me fond limit 75,000 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “Z K” sh.p.k & “ASI-2A CO” shpk, me vlerë kontrate 59,238 mijë lekë.

6- Procedura me objekt *“Sistemim, asfaltim i rrugës Funarës-Zdranjsh, Njësia administrative Orenje, Bashkia Librazhd”* me fond limit 75,000 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “V E” ShPK & “K.” ShPK me vlerë kontrate 50,937 mijë lekë.

7- Procedura me objekt *“Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2024”* me fond limit 38,054 mijë lekë, ku fitues është BOE “H” & “K” ShPK me vlerë kontrate 33,961 mijë lekë.

8- Procedura me objekt *“Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd”* me fond limit 14,910 mijë lekë, ku fitues është B/OE “H” & “K” ShPK me vlerë kontrate 13,021 mijë lekë.

### **7. Z. E. Gj, me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Projektimeve dhe Zbatimit të Kontratave.**

a- Në cilësinë e anëtarit të njësisë së hartimit të dokumenteve të tenderit (NJHDT) dhe ose specifikimeve teknike, në mos argumentim dhe vendosjen e specifikimeve teknike dhe kërkesat për kualifikim të pa argumentuara, veprime të cilat direkt ose indirekt çojnë në mospjesëmarrjen e OE në procedura duke ulur konkurrencën ose skualifikimin e OE me oferta më të leverdishme por me kapacitet për zbatimin e procedurës, të cilat nuk nxisin pjesëmarrjen e gjerë të OE në procedurat e prokurimit dhe konkurrencën ndërmjet OE, veprim në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht; me nenet 1, 2 dhe pika 1 e nenit 21 të Ligjit nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenet 41 -*Kërkesa të veçanta për kontratat e shërbimeve*, neni 39, *“Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”*, pika 4, dhe 78 *“Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”* dhe me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “ Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

b- Në cilësinë e anëtarit të komisionit të vlerësimit të ofertave (KVO), në vlerësimin dhe shpallje fituese të OE jo në kushtet e plotësimit të të gjitha kriterëve kualifikuese, procedura të cilat duhej të ishin anuluar dhe njoftuar titullarit e AK për zhvillimin e procedurë tjetër me kushte me të favorshme ose midis OE të skualifikuar KVO të vlerësonte kriterin kryesorë *“Çmimi më i leverdishëm”*, në kundërshtim me kuadrin rregullator në fuqi në prokurimin publik, konkretisht Ligjin nr. 162, datë 23.12.2020, “Për prokurimin publik”, (i ndryshuar), neni 2, neni 76 pika 3/ë dhe 5, neni 92 pika 3, neni 98, *“Anulimi i një procedure”*, si dhe VKM nr. 285, datë 19.5.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 82, *“Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave”*, neni 67, *“Klasifikimi i ofertave”*, neni 83, *“Njoftimi i fituesit”*, trajtuar në faqen 88-130 të RPA, konkretisht në praktikat:

1- Procedura me objekt *“Asfaltim i rrugës Lunik Prevalle (Loti 2) Njësia Administrative Lunik Bashkia Librazhd”* me fond limit 54,166 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “P-V-K” shpk me vlerë kontrate 44,216 mijë lekë.

2- Procedura me objekt *“Rikonstrukcion dhe ndërtim i palestrës shkolla e bashkuar "Shefqet Dosku"Librazhd”* me fond limit 76,854 mijë lekë, ku fitues është shpallur shoqëria “E” shpk, me vlerë kontrate 71,473 mijë lekë.

3- Procedura me objekt *“Sistemim asfaltim i rrugës se fshatit Vehcan faza e I-re Njësia Administrative Hotolisht, Bashkia Librazhd”* me fond limit 77,600 mijë, ku fitues është shpallur shoqëria “L C” shpk, me vlerë kontrate 61,211 mijë lekë.

4- Procedura me objekt *“Rikonstrukcioni i kanalit vaditës të Allanit Dorez-Gizavesh-Librazhd Qendër”* me fond limit 52,614 mijë lekë, ku fitues është shpallur B/OE “R G-K ShPK & V K” shpk, me vlerë kontrate 47,237,966.

5- Procedura me objekt *“Sistemim asfaltim i rrugës Librazhd- Katund faza e I-rë, Njësia Administrative Qendër, Bashkia Librazhd”* me fond limit 75,000 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “Z K” sh.p.k & “A-A CO” shpk, me vlerë kontrate 59,238 mijë lekë.

6- Procedura me objekt “Sistemim, asfaltim i rrugës Funarës-Zdranjsh, Njësia administrative Orenje, Bashkia Librazhd” me fond limit 75,000 mijë lekë, ku fitues është shpallur BOE “V E” ShPK & “K.” ShPK me vlerë kontrate 50,937 mijë lekë.

7- Procedura me objekt “Përmirësim i banesave ekzistuese për komunitete të varfra dhe të pafavorizuara për vitin 2024” me fond limit 38,054 mijë lekë, ku fitues është BOE “H” & “K” ShPK me vlerë kontrate 33,961 mijë lekë.

8- Procedura me objekt “Ndërtim i një qendre rinore në Bashkinë Librazhd” me fond limit 14,910 mijë lekë, ku fitues është B/OE “H” & “K” ShPK me vlerë kontrate 13,021 mijë lekë.

### **Në cilësinë e Përgjegjësit pranë DPZHMT**

Për shkeljet e konstatuara në lidhje me problematikat dhe parregullsitë e konstatuara në procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të lejeve të ndërtimit dhe përdorimit të miratuara:

Ku në të gjitha rastet, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore.

Në **1 (një) rast**, është konstatuar vonesë në shqyrtimin e aplikimit, tej atyre të parashikuara në dispozitat ligjore dhe nënligjore.

Gjithashtu në **4 (katër) raste**, u konstatua se dokumentat e pasurisë nuk janë ngarkuar e rifreskuar gjatë tre muajve të fundit nga data e aplikimit për leje ndërtimi. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektet: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H; -Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefqet Dosku”, miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024, me zhvillues Bashkia Librazhd; -Leje ndërtimi “Agroturizëm dhe struktura të përkohshme me qëllim pushimi, shoqërore dhe veprimtari turistike e kampingje etj”, miratuar me Vendim nr. 1542/5, datë 18.11.2024, me zhvillues S shpk; -Leje ndërtimi “Banesë individuale 2 kate + çati”, miratuar me Vendim nr. 2589/4, datë 08.08.2024, me zhvillues S A; -Leje ndërtimi “Shtesë kati deri 250m2 në objekt ekzistues nr. pasurie 9/970”, miratuar me Vendim nr. 2676/5, datë 05.07.2024, me zhvillues B Ç; -Leje ndërtimi “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024, me zhvillues H C; -Certifikatë përdorimi “Shtëpi banimi 2 kat dhe rrethim prone”, miratuar me Vendim nr. 1193/4, datë 07.05.2024, me zhvillues H H; Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika ë); neni 20; neni 27/2, pika 1, nënpika ë), si dhe Vendimin nr. 8, datë 28.12.2020 të KKT-së “Për miratimin e rishikimit të planit të përgjithshëm vendor Bashkia Librazhd, të miratuar me vendimin nr. 10, datë 08.02.2017, të Këshillit Kombëtar të Territorit ” neni 43/1;

Në **1(një) rast**, për objektin për të cilin është miratuar leja e ndërtimit, mungojnë dokumentet e pronësisë që vërtetojnë të drejtën e zhvilluesit mbi pasurinë përkatëse. Mangësitë dhe shkeljet e konstatuara janë evidentuar për objektin: -Leje ndërtimi “Rikonstruksion dhe ndërtimi i palestrës së shkollës së bashkuar "Shefqet Dosku”, miratuar me Vendim nr. 3709/3, datë 03.10.2024, me zhvillues Bashkia Librazhd; Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 15, pika 1, nënpika b);

Në **1 (një) rast**, nuk ka kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Rezulton se leja e ndërtimit për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë në objekt ekzistues, në parcelën me nr. pas. 8/190”, miratuar me Vendim nr. 3465/4, datë 09.08.2024, me zhvillues H C është miratuar pa marrë mendim pozitiv nga DR ASHK, edhe pse në dispozitat regullatore shprehet qartësisht se informacioni që mundësojnë DR ASHK, nuk duhet të kufizohet me dhënien e dakordësisë apo miratimin e heshtur, por, në çdo rast, duhet të përmbajë statusin e pronësisë apo kartelën e pasurisë/kartelat e pasurive, si

dhe hartën/hartat kadastrale për pronën/pronat e aplikimit, në përputhje me legjislacionin sektorial për kadastrën. Gjithashtu është konstatuar se në **1 (nje) rast**, DPZHT, Bashkia Librazhd, nuk ka respektuar mendimin e autoriteteve të cilat janë shprehur sipas kompetencave që u njeh ligji, sipas fushës së kompetencës. Rezulton se leja e ndërtimit për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, është miratuar pa respektuar mendimin e Agjencisë së Zhvillimit të Territorit, e cila shpreh mosdakordësi për zhvillimin e projekt-propozimit. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 21, pika 6.

Në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton kondicionet urbane, lidhur me: intensitetin maksimal të lejuar (intensiteti faktik i ndërtimit, sipas projektit ndërtimor, rezulton të jetë 5.26, duke tejkaluar kufirin maksimal prej 4 të parashikuar PPV), koeficientin e shfrytëzimit të territorit (KSHT faktike rezulton 73%, duke kaluar kufirin maksimal prej 50%), lartësinë maksimale të lejuar (e matur si në numër katesh, ashtu edhe në metra), si dhe numrin minimal të vend-parkimeve. Më konkretisht, këto shkelje janë konstatuar për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H; Veprime e mesipërme janë në kundërshtim me VKM-në nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, neni 37, pika 1, nënka c); pika 2; pika 3, nënpika b), si dhe Vendimin nr.10, datë 08.02.2017 të Këshillit Kombëtar të Territorit “Për miratimin e planit të përgjithshëm vendor, Bashkia Librazhd” i ndryshuar, neni 49, 50, 55, si dhe me përcaktimet e pasaportës së njësisë strukturore 1/102\_2;

Në **1 (një) rast**, objekti i miratuar nuk respekton përcaktimet e Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, në lidhje me kontributin që subjektet private që aplikojnë për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, kanë ndaj fondit publik për strehim social. Referuar përcaktimeve të nenit 19 të Ligjit 22/2018 “Për strehim social”, datë 03.05.2018, marrim informacion se: “Çdo subjekt privat që aplikon për leje zhvillimi dhe ndërtimi për ndërtime me sipërfaqe ndërtimore banimi mbi 2 000 metra katrorë, siguron kalimin pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Kjo sipërfaqe, në rast pamundësie për t’u dhënë në sipërfaqen ndërtimore të banimit që ndërtohet, mund të jepet në një sipërfaqe tjetër ndërtimore banimi, ose në vlerë monetare”. Kjo problematikë është për objektin: -Leje ndërtimi “Shtesë 8 kate në objektin ekzistues me leje ndërtimi nr.625 datë 21.03.2023, në pasurinë me nr.3/563, zk 2446, njësi strukturore 1/102\_2 Librazhd”, miratuar me Vendim nr. 2420/6, datë 28.06.2024, me zhvillues H.

Nga auditimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e-lejet, është konstatuar se në asnjë moment nuk i është bërë me dije zhvilluesit dhe aplikantit se kanë detyrimin e kalimit pa shpërblim të të paktën 3 për qind të sipërfaqes funksionale, në favor të fondit publik të banesave sociale. Sipërfaqja ndërtimore me funksion banim për objektin e miratuar është 3641 m<sup>2</sup>, nga të cilat **109.23 m<sup>2</sup>** do të duhej t’i kalonin të fondit publik të banesave sociale në natyrë ose në vlerë monetare ekuivalente **prej 4,806,120 lekë**. Në sipërfaqen e përlllogaritur më sipër (3641 m<sup>2</sup>) janë përfshirë sipërfaqet e përbashkëta takuese, ballkonet, llozhat dhe sipërfaqet neto vetëm të apartamenteve.

#### **8. Z. B. P, me detyrë Sekretar i Përgjithshëm, si dhe i autorizuar me detyrat dhe përgjegjësitë e NA të Bashkisë Librazhd:**

- Për mangësitë e konstatuara në procedurat e BVV: mbi dokumentimin dhe inventarizimin e dokumentacionit të praktikave për çdo procedurë të BVV, përbërjen e komisioneve të ngritura për përlllogaritjen e fondit limit, përcaktimit të specifikimeve teknike, kritereve kualifikuese etj

, mosveprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162 dt. 23.12.2020 “Mbi prokurimin publik” i ndryshuar, neni 52; VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar neni 56 etj;

- Për mangësitë e konstatuara në procedurën e inventarizimit vjetor të aktiveve, për mosdokimetimin e të gjitha hallkave të procesit, mosveprime në kundërshtim me Udhëzimin MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;

- si dhe në cilësinë edhe personit të autorizuar me detyrat dhe përgjegjësitë e NA dhe të Koordinatorit të Riskut e të MFK, për mos marrjen e të gjithë hapave ligjorë për arkëtimin e debisë progresive në vlerën 48,725,532 lekë e 476 debitorëve problematik, *veprime apo mosveprime që janë në kundërshtim me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”*; ligjin nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 9, neni 35; me ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “kodi penal në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar neni 181; ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar Kreu II-VII; Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në RSH”, i ndryshuar nenet 6 dhe 9; me Paketën fiskale të taksave dhe tarifave vendore të vitit 2024 të miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak; me Rregulloren e Brendshme të miratuar nga Kryetari neni 10, 11 dhe 38 etj.

#### **9. Znj. A H, me detyrë Drejtore e Buxhetit, menaxhimit financiar dhe mbështetjes sociale në cilësinë dhe të NZ,**

- Për mangësitë e konstatuara në llogaritë kontabël të pasqyrave financiare, veprime apo mosveprime këto në kundërshtim me Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 8, datë 9.3.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme” i ndryshuar me Udhëzimin nr. 5 datë 21.02.2022;

- Për mangësitë e konstatuara në procedurën e inventarizimit vjetor të aktiveve, për mosdokimetimin e të gjitha hallkave të procesit, mosveprime në kundërshtim me Udhëzimin e MF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar; si dhe me nenin 12 dhe nenin 44 të Rregullores së Brendshme të miratuar.

#### **E. NJOFTIMI I DEPARTAMENTIT TË ADMINISTRATËS PUBLIKE DHE KOMISIONERIT TË MBIKËQYRJES TË SHËRBIMIT CIVIL.**

Për punonjësit të cilët janë rekomanduar masat disiplinore sa më sipër, Bashkia Librazhd, pasi të zbatohet procedurat e nevojshme ligjore dhe nënligjorë për fillimin e ecurisë disiplinore dhe pas përfundimeve të afateve ankimore, **të ndërmarrë veprimet si më poshtë:**

**a.** Të njoftojë Departamentin e Administratës Publike, për regjistrimin e masës disiplinore në Regjistrin Qendror të Personelit, në zbatim të neneve 7 dhe 17, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**b.** Të njoftojë Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në zbatim të nenit 11, të Ligjit nr. 152/2013 “Për Nëpunësin Civil”, i ndryshuar.

**Për sa më sipër paraqitet ky Raport Përfundimtar Auditimi.**

